



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
TË MBAJTUR MË 1 dhe 5 KORRIK 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 1. i 5. JULA 2010. GODINE

KORRIK – JULI
2010

E enjte, më 1 korrik 2010, ora 10:00

Drejton seancën Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 53 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Ju njoftoj se në pajtim me nenin 15, paragrafi 3 dhe të nenit 42 të Rregullores së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Para se të fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës – Koha për deklaratimet jashtë rendit të ditës, fjalën e ka kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar,
Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

Po flas në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ju e dini se jemi në një fazë mjaft të ngushtë të bërjes së ligjeve që kanë të bëjnë me pakon fiskale dhe rregullimin e sektorit financiar në Kosovë. Po ashtu edhe me kohën kur kemi Projektligjin për rishikimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2010 dhe unë kisha kërkuar që t'i jepet kohë Komisionit për Buxhet dhe Financa që të punojë dhe t'i shqyrtojë të gjitha ato kërkesa nga agjencionet buxhetore për rishikim të buxhetit që ky projektligj të futet sot në rend të ditës, në mënyrë që vërtet të plotësojmë edhe atë kushtin që na është vendosur nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, siç është Fonti Monetar Ndërkombëtar, se deri më 21 të muajit korrik, ne duhet ta përmbyllim pakon e të gjitha ligjeve që i kemi në procedurë, por edhe rishikimin e buxhetit. Prandaj kërkoj dhe lus Kuvendin që t'i japë kohë Komisionit për Buxhet dhe Financa që sot të shqyrtojë këtë projektligj dhe të fillojë procedura e mëtutjeshme në Komision dhe të jemi të përgatitur për kohën, të cilën e kemi në një farë mënyre të kushtëzuar dhe të afatizuar.

KRYETARI: A keni biseduar në Komision si mendon Komisioni, apo po shkojmë me shefat e grupeve parlamentare?

Grupi i Parlamentar i Partisë Demokratike, kryetari Ramë Buja, si mendon?

RAMË BUJA: Zoti kryetar,
Mbështetur në këto arsye që jep kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa ne si grup parlamentar e mbështesim këtë gjë dhe jemi për t'u futur sot në rend të ditës.

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Ne gjithë e dimë që Kryesia ka vendosur që të jetë më datën 8. Ne biseduam sot në grupin tonë parlamentar, duke kuptuar edhe rëndësinë që e thotë Ganiu, por edhe rëndësinë tjetër që ky material vërtet kërkon edhe qasje, normalisht po them që sot nëse shqyrtohet nuk është serioze, po kërkon një analizë më të thellë. Ne si grup parlamentar nuk e kundërshtojmë, por nuk kemi marr vendim që ta përkrahim anbllok, prandaj deputetët duhet vetë të vendosin gjatë votimit a të hyjë apo jo në rend të ditës?

KRYETARI: Faleminderit!
Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, e ka fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mendojmë se nuk është mënyrë e mirë për të vepruar kështu. Fillimisht, Kryesia e Kuvendit ka vendosur më datën 8-të, atëherë ka ardhur një letër, është vendosur ndryshe. Prapë dje në Kryesi të Kuvendit, me shefat e grupeve është vendosur që të mos vijë sot në seancë plenare, deputetët nuk janë përgatitur të flasin për njërin prej çështjeve më të rëndësishme për të cilën vendos Kuvendi. Edhe ne si grup jemi absolutisht kundër këtij kontrabandimi të kësaj kështu kaq shpejt në rend të ditës edhe refuzojmë të marrim pjesë në vendimarrje edhe refuzojmë të jemi pjesë në Kuvend nëse kështu vazhdon të punojë Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së, nuk është i gatshëm për të debatuar sot për këtë projektligj.

KRYETARI: Në emër të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është për të ardhur keq se po të njëjtit të cilët kanë insistuar në Kryesinë e Kuvendit me çdo kusht që të paraqitet kjo çështje, të diskutohet më datën 8-të, sot e ndryshojnë mendimin. Është për të ardhur keq nga jo serioziteti që demonstron karshi një çështje që është fundamentale dhe më serioze dhe më e rëndësishme në Kuvendin e Kosovës. Ne e kundërshtojmë dhe kërkojmë që të respektohet vendimi edhe i Kryesisë dhe argumentet që janë bërë në Kryesinë e Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, predsedniče!

I mi shvatamo važnost urgentnog uvrštavanja ove tačke u dnevni red. Ja se slažem sa prethodnim govornicima da treba vremena za ovu tačku. Vi ste dovoljno razloga izneli prethodno i o tome smo razgovarali. Mi smo prethodno prihvatili većinsku odluku da to bude 8.jula. Međutim, u međuvremenu je došlo do promena, do izmena okolnosti i mi opet uvažavamo te razloge, ali idemo na jedno alternativno rešenje. Mi smo za to da budžet uđe na ovoj seansi, al da sutrašnji dan bude posvećen njegovoj analizi. Ako bar u ovoj situaciji, u ovom tesnacu vremenskom bar da ostavimo jedan dan da imamo vremena makar iole da se ozbiljno pripremamo za ovu seansu. Sasvim je drugo pitanje da li ćemo konačno glasati za budžet ili ne, bez obzira na to što smo deo koalicije, to su već neki drugi razlozi. Znači, mi u principu prihvatamo, ali predlažemo da to bude sutra, da sutrašnja seansa cela bude posvećena dakle ovoj tački. Toliko, hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit për Integritet, deputeti Grbiq e ka fjalën.

BRANISLAV GBRIĆ: Hvala!

Uvaženi predsedavajući,

Poštovani ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Mi smo u vezi ove tačke razmatrali kao Poslanička grupa i slažemo se da se ova tačka odloži sa period koji će biti adekvatniji da se zaista argumentovano razgovara o ovoj tački I da se zaista argumentovano donose odluke. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Për hir të vërtetës, dua të them që rreth kësaj pike të rendit të ditës është zhvilluar debat, ashtu siç e tha deputeti Ardian Gjini, por sipas nenit 42 të Rregullores, paragrafi 2, po e lexoj tekstualisht çka thotë: “Rendi i ditës konsiderohet i miratuar, përveç se kur në fillim të mbledhjes, një ose më shumë grupe parlamentare, përfaqësues të një ose më shumë komisioneve, së paku 6 deputetë ia propozojnë me shkrim kryetarit një amendament për rendin e ditës, përkatësisht nëse një deputet e ngrit një çështje të ngutshme dhe kjo merret miratimi i shumicës”. Thotë, kështu shkruan në nenin 42 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Në këtë rast, çështjen e ka ngritur kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar, faleminderit!

E mora fjalën, sepse nuk ka nevojë nga këndi për të më treguar a është proceduar Ligji për Prishtinën, po ju tregoj që është proceduar në Kuvend. Kjo është e para, e dyta, zoti kryetar, e thashë edhe në fillim se edhe ne dëshirojmë të jemi unik në kuptimin e përkrahjes për diçka që e llogarisim që është e mirë. Unë kam propozim që jo sot, por të hënën të jetë seancë e veçantë, vetëm për buxhet. Kemi mundësi të premten, të shtunën, të dielën të përgatitemi mirë dhe është propozimi im dhe parimisht jo për sot. Faleminderit.

KRYETARI: Urdhëro, Gani!

Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Unë kërkesën e bëra në emër të kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, mbështetur në rregullat e Rregullores së Punës së Kuvendit. Të gjithë anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa e dinë se me çfarë pune dhe me çfarë vëllimi të punës janë sot të angazhuar dhe do të jenë edhe nesër dhe do të jenë edhe të hënën, dhe ishte kërkesë imja duke pasur parasysh që vërtet kemi një punë shumë serioze rreth rishikimit të buxhetit që të futet në rend të ditës. Unë besoj që kam pëlqimin edhe të anëtarëve të tjerë të Komisionit, nëse jo sot, nesër ose siç e tha edhe kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Ismet Beqiri, që e hëna të jetë ditë kur ne ta bëjmë shqyrtimin e parë të Projektligjit për rishikimin e buxhetit. Kështu do t'i krijojmë një hapësirë më të madhe kohore Komisionit për Buxhet dhe Financa që me përgjegjësi të vet ta kryejë punën dhe misionin e vet për të cilën e ka. Kjo është kërkesa, është vullnet i deputetëve, është vullneti i Kuvendit se si të vendosë. Nuk është vullneti i një grupi politik, nuk është vullneti i një individi, është vullneti i Kuvendit që t'i ndihmojë në këtë rast Komisionit për Buxhet dhe Financa, jo kryetarit të Komisionit, por Komisionit për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi dy propozime, Xhezair Murati tha për nesër dhe për të hënën. A jeni dakord për të hënën? Kush është për të hënën? Faleminderit! Kush është “kundër”? Shumica janë “për”. A abstenon kush? Nuk ka. Faleminderit!

Prezentë janë 82 deputetë,

Konstatohet se me 59 vota “për”, 15 “kundër”, do të thotë rishikimi i buxhetit të bëhet të hënën, si pikë e veçantë, seanca vazhdon në orën 10:00, vazhdim i seancës. Faleminderit!

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Ju njoftoj se në bazë të nenit 47 të Rregullores së Kuvendit, koha për diskutime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupit parlamentar zgjasin deri në 5 minuta, ndërsa diskutimet e deputetëve 3 minuta.

Në bazë të nenit 47.3, deputetëve të lajmëruar dhe të cilët kanë mbetur pa diskutuar, u jepet fjala në fillim të mbledhjes plenare të radhës.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti Riza Smaka, a është, vjen dhe nga seanca e kaluar?

RIZA SMAKA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Nga 56 punëtorë të ndërmarrjes shoqërore Tregtare ” Marketingu” në Prishtinë, kam marrë shkresën 046 dhe këtë tani këtu e shpreh shqetësimin dhe brengosjen, zhgënjimin dhe dëshpërimin e tyre të bazuar siç vijon.

Me kontratën 106, ata për qëllime biznesore, legale, kanë blerë 2000 metra katrorë në katet 5,6,7,8 të objektit të ish - Bankës së Lubjanës, tani të njohur të OSCE-së, nga viti 1999, nga bisedimet e shpeshta me përfaqësues të autorizuar të OSBE-së, procedime gjyqësore komunale, qarkore deri në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të drejtën pronësore të argumentuar leges artis e me asgjë të mohuar nga kapricet teknoburokratike e neglizhuese gjithnjë nuk e kanë sendërtuar. Madje edhe sipas qëndrimit profesional kompetent të Zyrës Juridike të UNMIK-ut, të artikuluar shkrijimisht nga zotëri Alexander Olivier, OSBE-ja do të duhej që punëtorëve të NSHT “Marketingu” për periudhat e mbajtjes së lokaleve, se është fjala për ndërmarrje shoqërore, përderisa nuk u lirohen e dorëzohen, për ato lokale t’ua paguante rentat mujore sipas standardeve vendore. Duke gjykuar se 56 punëtorët e “Marketingut” pa dyshim kanë të drejtë absolute në pronat e veta, apeloj, veçanërisht në Odën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës, ta gjykojë menjëherë këtë rast juridik në favor të pronarëve legjitim të 2000 m² të lokaleve në fjalë si dhe autoritetet e OSCE-së, që pa vonesë ta përfillin statusin e vet të qiramarrësit ndaj qiradhënësve, pronarëve të lokaleve lëndore konform me atë relacion juridik e të trajtojnë dhe të vendosin këtë çështje. Në këtë kontekst fjala për rendin juridik, ju lutem, pelegrinët e Shën Vidit e shkelën rendin edhe qetësinë, abuzuan qëllimin paraprakisht të deklaruar për procesion religjioz, por nga autoritetet zyrtare nuk u ndërmorën masa ligjore. Këto janë shqetësime në kontekstin e pa përfilljes së ligjit edhe të rendit juridik në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pra, nga seanca e kaluar jam duke e respektuar rendin që ka mbetur.

Fjalën e ka Drita Maliqi.

DRITA MALIQI: Faleminderit!

Përshëndetje!

Dua sot të paraqes edhe një herë para ekzekutivit të vendit apo më mirë të themi para koalicionit famoz PDK – LDK se deri kur do të vazhdohet me shantazhe ndaj shërbyesve civilë, të cilët çdo ditë e më tepër po largohen nga puna dhe po kanosen me largim nga institucionet e nivelit edhe qendror dhe atij lokal, vetëm pse nuk janë pjesë përbërëse e partive të tyre politike. Andaj në bazë të dhënave që disponojmë deri më tani rreth 80 shërbyes civilë janë larguar nga vendet e tyre të punës vetëm pse janë anëtarë dhe simpatizantë të Lidhjes Demokratike të Dardanisë.

Kemi rastin e fundit më eklatant , të nderuar, në Kamenicë, kryetari i komunës së Kamenicës, Shaip Surdulli, kërcënon dhe shantazhon me largim nga puna anëtarët e Lidhjes Demokratike të Dardanisë, që janë të punësuar në komunën e Kamenicës.

Shtrohet pyetja, a e mbikëqyr kush punën e këtyre kryetarëve të komunave, të cilët jo vetëm që nuk po punojnë në përmbushjet e premtimeve të tyre elektorale, por po veprojnë si po iu teket në dëm të qytetarëve të vendit duke mos respektuar legjislacionin në fuqi. Andaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kërkoj që të ndërpritet çdo veprim antiligjor i largimit të shërbyesve civilë dhe në baza të bindjeve politike. Të ndalohen shantazhet e koalicionit PDK – LDK, përndryshe jemi të përgatitur të ndërmarrin hapa të tjerë të demaskimit të këtyre veprimeve dhe metodave që i ngjasojnë një sistemi të kaluar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj- Bujupi, nga seanca e kaluar, nuk është këtu. Pra e ka ndërruar vendin. Paska ardhur te të pavarurit.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: I nderuar kryetar,

Duke marrë parasysh që unë kam kërkuar fjalën javën e kaluar, ka kaluar kjo kohë e kam pasur rendin e fjalës dhe ju s'ma keni dhënë fjalën, faleminderit, sot kjo kohë nuk është relevante më ajo çka kam dashur të them.

KRYETARI: Lexojeni Rregulloren vetë, se unë s'po e lexoj, se e kam lexua nja 2 – 3 herë. Lexojeni dhe shikoni, unë po shkoj sipas Rregullores. Fjalën sipas rendit të ditës nga mbledhja e kaluar e ka deputetja Besa Gaxherri. Ke qenë e lajmëruar aty. Mirë, faleminderit. Atëherë, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar e ka kërkuar fjalën. Ka përparësi opozita në këtë pikë të rendit të ditës.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke njohur në kuptimin më të thjeshtë se shteti është organizim ku qeverisja i subkoordinohet interesave të popullit të vet e për fat të keq te ne po ndodh e kundërta. Në Kosovë qeverisja u shërben të gjithëve, por vetëm interesave të shtetit jo, të paktën shërbimet aktuale të kësaj qeverisje s'kanë asgjë të përbashkët me interesat e shtetit dhe popullit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në seancën e fundit, Lidhja Demokratike e Dardanisë ngriti si pjesë të shqetësimit permanent të vetin dhe të qytetarëve të Kosovës lidhur me cenimin e vazhdueshëm të sovranitetit të vendit nga grupet kriminale të cilët para jo shumë ditëve, dhunuan kufijtë dhe sistemin kushtetues të vendit dhe si rrjedhojë e njëjtë, një skenar i tillë i paraqit edhe javën e kaluar ku nga këto grupe kriminale, por tani të shoqëruar edhe nga zyrtarët e lartë serbë në qendër të Kosovës përcollën mesazhin e gjenocidit, të njëjtat porosi të cilat iu gjasojnë me ato të viteve 90-ta. Edhe në këtë rast koalicioni qeverisës, qeverisja aktuale i mbyll sytë dhe u bë e verbër sikurse e tëra kjo të kishte ndodhur në një kontinent tjetër.

Por, të nderuar deputetë,

Shumë më e rëndë dhe më e dhimbshme se injoranca dhe indiferenca ditore e kësaj qeverisje është kur të dëgjosh se institucionet e vendit, të dala nga sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, i përkrahin dhe financojnë strukturat paralele të Qeverisë së Serbisë në Kosovë, të cilat po të njëjtat struktura, kjo qeverisje para jush dhe këta pas meje, i kanë quajtur dhe i quajnë grupe kriminale. Pra është tragjike që me paratë e taksapaguesve të Kosovës të financohen strukturat paralele në Kosovë, absurditet i llojit të vet dhe më tepër se falimentim është përdhosje e sistemit kushtetues.

Të nderuar deputetë,

Edhe me këtë rast Kuvendi dhe qytetarët e Kosovës duhet t'i mbyllin sytë ose ta thërrasin ndërgjegjen dhe të kërkojnë përgjegjësi. Por një gjë është e sigurt në realitetin kosovar se ky realitet nuk mund të zgjasë shumë. Realiteti tregon se Kosova ka popullin më të varfër në Evropë, sistemin institucional më defunksional dhe Qeverinë më të pasur në Evropë. Dhe kjo lirisht mund të quhet edhe preambulë e kësaj qeverisje, prandaj, kjo do të ishte edhe një turp që keqpërdorohen paratë e taksapaguesve.

Të nderuar deputetë,

Unë gjithë dokumentacionin për financimin e strukturave paralele në komunën e Graçanicës, do t'ia dorëzoj kryetarit të Kuvendit Komunal, në fakt kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Shefi i Grupit Parlamentar “7+”, Xhezair Murati e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedniče!

Dozvolite da pozdravim vas, premijera, zamenike, ministre, kolege,

Evo, da i mi iskoristimo ovu novu praksu našeg parlamenta, komentare na koje nemamo pravo replike i tako dalje.

Ja bih danas malo govorio o procesu decentralizacije, uvažene kolege. Naime, ovaj proces na Kosovu je u toku i formirane su opštine sa srpskom većinom: Gračanica, Ranilug, Klokot, Parteš i tako dalje. Svesni smo da su organizovani izbori u drugim opštinama, dakle unutar Kosova: Štrpce, Novobrdó, Mamuša, Junik, Elez-Han i tako dalje, sve nas ovo raduje i mi to pozdravljamo, ali razmišljamo glasno ili pitamo dokle se stiglo sa decentralizacijom u sredinama gde većinu čine druge nevećinske zajednice, dakle Bošnjaci, Gorani, Haškalije i tako dalje. Ovde ću pomenuti član 12. Zakona o administrativnim granicama opština koji je direktno preuzet iz Ahtisarijevog plana. Naime, citiram: “Vlada će ući u konsultacije sa nevećinskim zajednicama u slučajevima kada ta zajednica sačinjava najmanje 75% populacije nadovezanih sveukupnom populacijom od najmanje 5 hiljada građana sa ciljem stvaranja novih opština”. Prema našim informacijama, Vlada nije napravila nikakav pomak po ovom pitanju, što ispada da je tretman zajednica, dakle ostalih zajednica neravnoopravan. Na osnovu iznetog, očigledno je da se ostale zajednice osećaju zapostavljenima zaobidenima, kako hoćete, a nažalost i ostali relevantni faktori međunarodne zajednice po tom pitanju su jednaki.

Ja sam prošle nedelje ustvari bio član kosovske delegacije na međuparlamentarnim razgovorima Evropske zajednice i kosovskog parlamenta, gde smo čuli sugestiju o sporom procesu decentralizacije, pa sam lično i tamo govorio o ovome. Ja se ovde glasno pitam i razmišljam – zašto ne bismo koristili pozitivna iskustva nekih zemalja, kao što su recimo Makedonija i Albanija u susedstvu, gde je broj opština 87, odnosno prek 200 ili Slovenija i tako dalje. Ne znam čemu bojazan i zašto ovo za nas izgleda i dalje tabu tema. Pozivamo znači predstavnike Vlade i ostale institucije da počnemo da pravimo pomake po ovom procesu. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Armend Zemaj e ka fjalën. Qeveria e ka kohën e vet, kryeministër.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kryeministër, ministra, zëvendëskryeministra,

Sigurisht, ndoshta në këtë temën e decentralizimit, ndoshta në të ardhmen duhet paraqitur nevojën që Strellci të jetë komunë, sepse si Deçan, vend i vogël kështu s’po na bëni hesap edhe fjalën në fund po na jepni.

Si deputet i Kuvendit të Kosovës, zotëri kryetar, kolegë do ta parashtoj një çështje e cila është mjaft domethënëse për qytetarët e komunës së Deçanit dhe mendoj mbarë Kosovës, posaçërisht për fëmijët.

Fjala është për Pushimoren e Fëmijëve ” Pishat e Deçanit”, që dikur ishte vendi më i bukur atraktiv për popullatën e Kosovës dhe më gjerë. Pas çlirimit të vendit, me dislokimin e forcave të NATO-së në Kosovë, objektet e kësaj pushimore ishin marrë në shfrytëzim nga ana e kontingjentit të KFOR-it italian, të cilat janë shfrytëzuar deri më tani. Nga informacionet që kemi, tani objektet e pushimores janë në proces të lirit të shfrytëzimit nga ana e KFOR-it. Në vazhdimësi është kuptuar se ajo ka kaluar në kompetencat e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në përcaktimin e statusit të saj organizativ. Prandaj, kërkoj së pari nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Qeveria e Republikës së Kosovës, që të shqyrtojë mundësinë që e njëjta pronë të mbetet nën shfrytëzimin e pushtetit vendor si pronë me interes të veçantë për zhvillim ekonomik të Deçanit dhe të vendit në përgjithësi. Në të kundërtën, ajo pronë si e tillë ishte e qytetarëve dhe e tillë duhet të mbetet nën përkujdesjen e organit kompetent, pa iu nënshtruar procedurave të transformimit nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pushimorja e Fëmijëve, me të drejtë duhet të cilësohet si zonë e interesit të veçantë, pasi që është e vetmja qendër rekreative të cilën e kishte më parë komuna e Deçanit, andaj kjo qendër sportive- rekreative duhet të

mbetet si e tillë dhe duhet të jetë në shërbim të plotë të plotësimit të nevojave të qytetarëve të Republikës së Kosovës e në veçanti të fëmijëve të komunave të Deçanit, Gjakovës, Pejës e më gjerë. Ju lutem, transformimi i pronës shoqërore në atë private nuk nënkupton gjithmonë që shteti i Republikës së Kosovës do të përfitojë më tepër, përkundrazi ajo do të ndikojë në mënyrë indirekte në mirëqenien e popullatës. Kjo kërkesë imja që është edhe kërkesë aktuale e qytetarëve të Deçanit, mendoj dhe është e nevojshme të hasë në mirëkuptim, në të kundërtën, mospërfillja ndaj kësaj kërkesë do të jetë në dëm të drejtpërdrejtë të qytetarëve të komunës së Deçanit, në radhë të parë e më pas edhe të mbarë shtetaseve të Republikës së Kosovës. Për fund nëse dikush tenton të anashkalojë këtë për shkaqe sigurie, unë ju them se nuk ka asgjë më të sigurt se buzëqeshja e fëmijëve të Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Kaqusha Jashari e ka fjalën.

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Nesër është 2 Korriku, data kur delegatët e Kuvendit të Kosovës në kushte shumë delikate, pas ngjarjeve, tubimeve masive 1988-ës dhe të ngjarjeve 1989, kur populli ka kundërshtuar ndërrimin e Kushtetutës dhe ka bërë kërkesën për pavarësi dhe të vrasjeve shumë të vrashda nga pushteti serb, por unë nuk do të flas për këtë. Nuk do të flas as për rëndësinë e Deklaratës Kushtetuese të 2 Korrikut 1990, këtë do ta bëjnë historianët dhe u takon atyre. Nesër është edhe një simpozium i Institutit të Historisë, kushtuar 2 Korrikut 1990, por kjo që unë mendoj që nuk diskutohet është një veprim i kësaj gjenerate të deputetëve 1990, një veprim i cili ka qenë edhe obligativ ndaj kërkesës të cilën e ka shtruar populli.

Nesër ata marrin një dekoratë nga kryetari i Republikës së Kosovës, që është një shenjë falënderimit, po pse jam lajmëruar unë me dy fjalë. Unë mendoj se ky Kuvend i cili ka shpallur pavarësinë dhe është arritur synimi që Kosova është shtet sovran, kemi një obligim ta aprovojmë edhe një akt ligjor për deputetët e Kuvendit të 2 Korrikut, pasi ata nuk janë përfshirë deri më tani me asnjë dokument. Kemi obligim sikur që kemi obligim edhe për gjeneratat tjera që kanë dhënë kontributin deri më tani për këtë ditë, prandaj unë do të jem edhe iniciatore e një akti ligjor për këtë gjeneratë të deputetëve 1990, 2 Korrikut. Faleminderit!

KRYETARI: Emrush Xhemajli e ka fjalën.

EMRUSH XHEMAJLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë dhe të pranishëm,

Po afrohen pushimet verore dhe dhjetëra, mijëra kurbetçarë ia mësyjnë vendlindjes, Kosovës. Ata shfrytëzojnë rastin që në këtë kohë ta rregullojnë dokumentacionin e tyre. Për ata, nxjerrja e certifikatave të lindjes, kurorëzimit, shtetësisë, letërnjoftimeve dhe pasaportave, është bërë shumë më e lehtë dhe e shpejtë se sa vitet e kaluara, por megjithatë nuk është e tepërt që të theksohet se ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, që vijnë në pushime duhet të kihet shumë kujdes në shërbime të shpejta, pa zvarritje nga ata që e mbulojnë administratën, Shërbimin Policor e kështu me radhë.

Jam i thirrur nga shumë qytetarë të Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë që të përsëris shqetësimin e tyre të disa viteve lidhur me disa vështirësi që ata hasin gjatë ardhjes dhe qëndrimit në Kosovë në pushimet verore. Por, në veçanti presin që Qeveria të punojë që sa më parë të hiqet taksa për sigurimin e auto-veturave kur hyhet në Kosovë. Nëse heqja nuk është e mundur krejtësisht, kërkoj që mundësisht që së paku të zbritet sa të jetë e mundur kjo taksë, sepse për momentin është e mbingarkuar. Ata një herë paguajnë taksë në vendin ku janë, domethënë, të auto- përgjegjësisë edhe një herë kur vijnë këtu.

Nuk duhet të harrojmë se në këtë drejtim ka anomali shumë të madhe, sepse taksë nuk paguhet kur hyhet në Republikën e Kosovës, nga pronarët e veturave me regjistrim të Serbisë, andaj këto dukuri të parregullta duhet të punojmë që sa më shpejtë të eliminohen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Ismet Beqiri, a e ke kërkuar fjalën?

E ka fjalën Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Me qenë se është këtu edhe ministri, zoti Hoxhaj, do të dëshiroja ta ngre një çështje që nuk është ndoshta vetëm në këtë komunë, po që na është adresuar neve. Është fjala po e lexoj shumë shpejt: “Duke respektuar vendimin e Ministrisë të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, numrin s’po e them, sepse e di besoj edhe ministri, të datës 21.8.2009, për përfshirjen e gjithë nxënësve që përfundojnë klasën IX në klasën e X. Drejtoria Komunale për Arsim në këtë rast e Podujevës, po ka edhe komuna të tjera, ka bërë të gjitha përgatitjet dhe me kohë ka bërë regjistrimin e gjithë nxënësve. Fillimisht është shtuar numri i nxënësve në klasat ekzistuese X dhe më pas, për shkak të numrit të madh të nxënësve të interesuar për vazhdimin e mësimin, janë formuar edhe 21 paralele të reja të klasave të X-ta. Rrjedhimisht 21 paralele më shumë do të prodhonin mbi 30 vende të reja të punës në shkolla të mesme e të larta, mirëpo komuna i ka angazhuar disa mësimdhënës edhe nga shkollat e mesme të ulëta dhe të larta me normë jo të plotë në mënyrë që të mbahet minimumi i të punësuarve. Në kuadër të kësaj janë angazhuar 23 punëtorë”- thuhet në shkresën e komunës së Podujevës, në proces mësimor, që nga fillimi i vitit shkollor 2009, të cilët sot e kësaj dite nuk e kanë realizuar të drejtën e tyre për t’u paguar për punën që e bëjnë.

Në vitin e ri shkollor 2010 – 2011, Ministria, po ashtu ka marrë vendim që gjuha angleze të fillojë nga klasa e parë, me çka pajtohem edhe ne, thuhet në shkresë, sidoqoftë edhe pse është planifikuar buxheti për këtë çështje në shumë prej 22 mijë e 800 euro, përsëri nuk është paraparë shtimi i numrit të mësimdhënësve prej 7 mësimdhënësve, që do të shfrytëzonin këtë buxhet, siç është vepruar me pozitën e pagës të një pedagogu në komunë. Prandaj, kërkohet nga Ministria në këtë rast dhe këtë e them edhe në emër të Grupit, që të përdoret autoriteti dhe gjëja kompetencat që këta punëtorë të arsimit që punojnë një vit edhe nuk paguhet, kjo pagesë për ta e pagës për punën që e bëjnë, të bëhet. Dhe kësaj shkrese që është adresuar tek ne i bashkëngjiten të gjitha vendimet e Ministrisë, shkresat e departamentit përkatës komunal, kërkesa po ashtu e Departamentit Komunal për buxhet shtesë e datës 10 mars të këtij viti. Prandaj, edhe lista është e bashkëngjitur, zoti ministër, po e shfrytëzoj rastin dhe e ngrita këtë problem se nuk është i vetmi që ta shqyrtoni, sepse është puna e pagave së njerëzve që punojnë një vit dhe nuk paguhet. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, po kjo ishte për pyetje parlamentare në pikën tjetër të rendit të ditës. Faleminderit! Po, përqendroni edhe ju pak.

Deputeti Basri Musmurati e ka fjalën.

BASRI MUSMURATI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar, në krye me kryeministrin,

Unë do të shtroj një çështje që është shqetësuese. Në brezin kufitar mes Kosovës dhe Shqipërisë, mes komunave të Dardanës dhe të Bujanovcit, banorët e fshatrave

Karaçevë e Epërme dhe Karaçevë e Poshtme dhe Novoselë, janë shqetësuar dhe të preokupuar në vazhdimësi nga policia dhe xhandarmëria serbe. Ata e ndjejnë veten të pasigurt në shtëpitë e tyre, në arat e tyre edhe nga fakti se rruga që i shpie në shtëpitë e tyre vizitohet dhe patrullohet shpeshherë nga xhandarmëria dhe policia serbe. Rrugën në fjalë dhe arat që gjenden në të dy anët e rrugës, pronë kadastrale e komunës së Dardanës, Serbia i konsideron si të vetat, andaj edhe sillen në këtë mënyrë. Banorët e fshatrave në fjalë janë detyruar që të devijojnë rrugën e tyre që e kanë pasur gjithmonë në të kaluarën dhe të kalojnë në rrugën dytësore, të cilën e ka hapur KFOR-i në vitin 2000. Arat e tyre, livadhet, kullosat e malet që i kanë me tapi të përhershme të

regjistruara në librat kadastral të Dardanës, shpesh mbesin të papunuar, që nga viti 2000, sepse kanë drojën e xhandarmërisë serbe. Faktikisht, punktet serbe të vendosura mes fshatrave Muhovc, Muhovci është në komunën e Bujanovcit dhe Karaçevë, si dhe punkti tjetër i vendosur ndërmjet fshatrave Breznicë, Breznica është me komunën e Bujanovcit dhe Novosellë janë të vendosura në tokat e banorëve të Karaçevës dhe të Novosellës që janë në territorin e Kosovës. Xhandarmëria serbe e bën shqetësimin dhe frikësimin e banorëve të këtyre fshatrave me patrullimet e shpeshta me armë automatike jo në krah, por gjithmonë i bart në gjendje gatishmërie. Kjo po ndikon që fëmijët si në rrugë, në fushë, me bagëti, të jenë të frikësuar, ndërsa të rriturit të mendojnë në vazhdimësi për shpërngulje. Segmenti rrugor në fjalë patrullohet nga njësitë e KFOR-it mjaftë rrallë dhe eventualisht kur banorët vendas e thërrasin atë.

Fshatrat shqiptare që janë në komunën e Bujanovcit si janë Qarr, Novosellë, Priboc, Suharne në Zarbicë, gati plotësisht janë të boshatisura. Banorët e këtyre fshatrave nga presioni i ushtrisë e policisë serbe janë shpërngulur dhe shumica e tyre janë vendosur në Gjilan dhe në fshatrat e Dardanës. Nga këtu kjo gjendje si është e krijuar dhe është tepër e rëndë dhe shqetësuese, me tensione shpeshherë të shpërthimit, kërkohet një angazhim shumë më i madh, si i institucioneve tona ashtu edhe i atyre ndërkombëtare. Këta banorë kanë nevojë më të madhe të përkrahjes se institucioneve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi, le të përgatitet Nurishahe Hulaj.

NAIM RRUSTEMI: Unë kam menduar se jam pas Driton Talit, por s'e di, të paskan hequr prej rendit të ditës!

KRYETARI: Je nga mbledhja e kaluar, zoti deputet, nëse e do, mund ta marrësh fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Po, po do ta marr.

Në vitin 2010 deri më tani janë raportuar 5 vdekje të shkaktuara nga ethet hemorragjike të bartura me ngacmime të rriqrave dhe të infektuara me virusin Krime Kongo, apo siç njihet në popull pickimi i rriqrave. Për vitet e kaluara as mos të flasim, kur kemi pasur deri 17 të vdekur vetëm gjatë një viti. Rastet e etheve hemorragjike vijnë kryesisht nga komuna e Malishevës, por edhe nga komuna të tjera që janë ngjitur me Malishevën. Në mediat vendore, por edhe në ato

të huaja raportohet se nuk po mund të menaxhohet me rastet për shkak të mungesës së trajtimit adekuat dhe menaxhimit me kohë të këtij virusi, ndoshta edhe nuk kanë kohë, sepse janë të zënë. Po me çka janë të zënë? Sipas studimeve fillestare kalkulimi fillestar i një analize për ethet hemorragjike të shkaktuara nga rriqrat dhe brejtësit, pra Krime- Kongo dhe sindromi renal kushton diku rreth 200 mijë euro dhe që do të mund të realizohej në një afat dymujor edhe ashtu ekziston një strategji nga Instituti. Sipas parallogarive të para del se rreziku nga ethet hemorragjike do të mund të zvogëlohej deri mbi 90%, me një shpenzim maksimal prej 2 milionë eurove. Gjithashtu Kosova ka kapacitete njerëzore dhe teknologjike për implementimin e një projekti të tillë, i cili do të zgjasë 3 vjet me radhë duke filluar nga muaji mars, deri në muajin tetor. Por sikur të mbaheshin premtimet për zvogëlimin e shpenzimeve të burokracisë qeveritare dhe paratë e kursyera vetëm nga drekat, darkat dhe udhëtimet e panevojshme jashtë shtetit të këshilltarëve të shumtë në numër, atëherë edhe problemi i etheve hemorragjike që kanë shkaktuar aq shumë vdekje dhe panik veçanërisht tek qytetarët e komunës së Malishevës, do të kishte mbetur vetëm si një kujtim i keq në memorien e njerëzve.

Por, si duket, Qeveria e ka gojën plotë mirëqenie dhe premtime për zonat ku i kanë fituar zgjedhjet, ndërsa veprimet korruptive për pasurimin e anëtarëve të saj dhe familjarëve të afërt të anëtarëve të Qeverisë, jo vetëm që po humbin imazhin e Kosovës për shtet ndërtim, por fatkeqësisht grykësia e qeveritarëve po shkakton edhe viktima në zonat ku edhe gjatë luftës kanë qenë më të atakuar nga forcat serbe. A duhet dikush ndonjëherë të mendojë edhe për jetën e qytetarëve apo vetëm të lajmërohen si raste, pas pasojave?

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit!

Në emër të stafit të Fakultetit të Edukimit në Prizren ngre këtë çështje. Ditë më parë është plasuar informata se në Fakultetin e Edukimit në Prizren nuk do të regjistrohen studentë në vitin akademik 2010 – 2011 dhe lidhur me këtë ka shumë reagime nga stafi arsimor, studentor, prindor si dhe nga masa e popullatës së Prizrenit, Suharekës, Rahovecit, Malishevës dhe Dragashit, ngase nga këto komuna vijnë Fakultetin e Edukimit shumë studentë. Fakulteti i Edukimit përgatit kuadro të duhura për institucione, duke filluar prej parashkollorëve e gjer te klasat e nënta të shkollës së mesme të ulët. Fakultetet e tilla në kuadër të universiteteve ekzistojnë në shumë vende të rajonit dhe të botës dhe nuk është e arsyeshme që një fakultet i tillë të përqendrohet vetëm në Prishtinë. Në kohën kur Fakulteti i Edukimit në Prizren po përgatitet të shënojë 50 - vjetorin e themelimit, së pari Shkollë e Lartë Pedagogjike, tani si fakultet i edukimit, publikohet informata se ky fakultet do të mbyllet. Strukturat arsimore- edukative të këtij fakulteti në Prizren konsiderojnë se marrja e qëndrimit për plasimin e informatës publikisht se do të mbyllet Fakulteti i Edukimit në Prizren, është i paarsyeshëm, i pastudiuar mirë, hap i ngutshëm dhe i papranueshëm për shumë arsye.

E para, mundësia e punësimit në arsim është më e madhe se sa në veprimtaritë tjera, lidhur me këtë është stafi se nga këto komuna rreth 200 punëtorë të arsimit dalin në pension e në Fakultetin e Edukimit nuk diplomojnë çdo vit nga 200 studentë, që domethënë ende ka nevojë për kuadro të tilla rajoni i Prizrenit. Në vitin akademik 2009 – 2010 në Fakultetin e Edukimit ka qenë konkurrenca 1 me 18, domethënë, 18 kandidatë kanë konkurruar për një indeks, një gjë e tillë nuk ka qenë në fakultetet tjera të Universitetit të Prishtinës.

E dyta, në Fakultetin e Edukimit në Prizren vijnë studimet 1500 studentë, 90% janë femra nga 5 komunat e rajonit të Prizrenit, nga rajoni i Kukësit, pjesës veriore të Shqipërisë si dhe trevave të tjera të një rëndësie të veçantë.

E treta, nëse nuk u mundësohet studentëve të rinj, veçanërisht femrave që regjistrohen në vitin e parë të Fakultetit të Edukimit, atëherë shumica prej tyre nuk kanë mundësinë materiale që të vazhdojnë edukimin në qendrat tjera më të largëta. Rekomandimet e dhëna nga stafi i Fakultetit të Edukimit në Prizren.

E para, stafi i Fakultetit të Edukimit në Prizren, konsideron se më e arsyeshme do të ishte reformimi i këtij fakulteti me programe promovuese, edukative se sa të mbyllet.

E dyta, kërkohet që në kuadër të Universitetit që do të hapet më 1 tetor 2010, në Prizren, të vazhdojë punën Fakulteti i Edukimit me të gjitha aktivitetet arsimore- edukative për të cilat të rinjtë kanë shumë interesim.

Dhe e treta, universiteti pa profil arsimor- edukativ, që ka dhjetë programe, nuk mund të ekzistojë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Edhe me këtë koha për deklaratimet jashtë rendit të ditës është harxhuar. Për seancën e ardhshme kanë mbetur, deputeti Driton Tali dhe Qamile Morina.

Tani është koha dhe Qeveria e ka kohën e vet për deklaratime jashtë rendit të ditës.

Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Tanimë veç kemi hyrë në një fazë të re të marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, raporte këto që çdo ditë e më tepër po thellohen dhe konkretizohen në një bashkëpunim shumë të ngushtë për perspektivën evropiane të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim tani gjithnjë e më tepër autoritetet institucionale të Kosovës, qofshin përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës apo të Parlamentit dhe

institucioneve tjera, janë më prezentë në Bruksel. Në të njëjtën kohë kjo rrit edhe më tepër përgjegjësitë e gjithë neve që të jemi edhe më serioz në të gjitha angazhimet tona. Këtu kanë luajtur një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm edhe shoqëria civile e në të njëjtën kohë edhe mediat. Javën tjetër do ta vizitojë Kosovën edhe kryetari i BE-së, kështu që do të dëshiroja që në këtë proces jashtëzakonisht të rëndësishëm kur në këtë javë u konfirmua që edhe për Kosovën, në fund të verës, do të ketë udhërrëfyes apo strategji për liberalizimin e vizave pas zbatimit të kriterëve që i kemi implementuar në Kosovë dhe zotimeve tona për të ardhmen. Pra është një lajm tepër i mirë për gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës që edhe për Kosovën, për shtetin tonë, për qytetarët tanë po hapet perspektiva për liberalizimin e vizave edhe konkretisht. Në këtë drejtim ftoj të gjithë, të gjitha grupet parlamentare, duke i falënderuar për punën e tyre, por edhe opozitën që të jenë pjesë e reformave demokratike që udhëheq Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, të nderuar deputetë, po i afrohem kohës kur do të prezantohet edhe opinionimi i Gjykatës Ndërkombëtare për statusin e Kosovës. Një gjë është e sigurt, për Kosovën edhe pas këtij prezantimi të opinionit, do të vazhdojnë njohje të reja. Integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i paprekshëm, i pacenueshëm dhe i njohur ndërkombëtarisht. Pra, Kosova do të funksionojë si shtet i pavarur dhe sovran, shtet demokratik dhe multietnik. Do të kemi një konsolidim edhe më të fuqishëm të institucioneve të saj, ndërsa në anën tjetër dëshiroj të theksoj se sikur me çdo shtet tjetër të rajonit apo fqinj, të fqinjësisë së mirë që po zhvillojmë, do të mund të ketë takime për çështje praktike edhe me autoritetet e Serbisë, por dëshiroj t'ua sqaroj gjithë juve dhe gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës se disa ide që po prezantohen aty-këtu dhe po krijojnë një huti në opinionin publik e mund të them një huti edhe në skenën politike të Kosovës, në asnjë rrethanë nuk do të ketë negociata, siç pretendon ndokush. Çështjet teknike, siç kemi diskutuar me autoritetet e Maqedonisë, të Shqipërisë dhe të Malit të Zi, natyrisht kemi obligim edhe shtetëror, por edhe ndërkombëtar, sepse është në interesin e dy vendeve tona edhe të Kosovës edhe të Serbisë, që të ndërtojmë relacione të reja në bazë të standardeve euroatlantike.

E gjithashtu edhe sa i përket një opinionimi të prezantuar ditëve të fundit nëpër disa medime, dua të theksoj se në asnjë rrethanë nuk do të tolerohet të diskutohet apo e të ngritët tash e tutje edhe si ide shkëmbimi i territoreve. Kosova ka territorin e vet dhe unë ju ftoj të gjithëve që ta injoroni në ekstrem këtë ide, sepse nuk është as që e ka ngritur dikush, por është një spekulim medial. Prandaj, dëshiroj të jem shumë i qartë para të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit!
Tash kthehemi në rend të ditës.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 17 qershor 2010.

Pyes, nëse ka vërejtje në këtë procesverbal? Pasi nuk ka, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 17 qershor 2010.

3. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 60 minuta. Deputeti për një mbledhje mund të parashtojë më së shumti 2 pyetje parlamentare.

Fillojmë me pyetjen e parë. Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Lutfi Haziri.
Deputete e ke fjalën.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje për të gjithë!

Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta edhe pse i miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës qysh në vitin 2006, ende nuk është i zbatueshëm. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji për mbrojtjen e

të drejtave të autorëve e pyes ministrin e Kulturës se ku qëndrojnë shkaqet që ndikojnë që ligji të mos funksionojë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI LUFTI HAZIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Dauti,

Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, ashtu siç thatë ju përmes pyetjes tuaj është miratuar nga ky Kuvend, më 29 qershor të vitit 2006, me numër 2004/45 dhe është shpallur nga autoritetet e kohës, më 24 gusht 2006. Atëherë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me kryeministrin ka formuar Komisionin ndërqeveritar për hartimin e Rregullores mbi themelimin e kësaj zyre për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta brenda Ministrisë së Kulturës. Kjo rregullore e përfunduar është dorëzuar në Zyrën Ligjore të Qeverisë, gjatë vitit të kaluar dhe është aprovuar përmes mbledhjes së rregullt të Kabinetit qeveritar. Me marrjen e detyrës si ministër në këtë mandat dhe me kërkesën e kryeministrit është vendosur në prioritet zbatimi i ligjeve që kanë të bëjnë me fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve. Për këtë arsye, më 17 maj 2010 është miratuar nga ana e Qeverisë, Rregullorja për themelimin e kësaj zyre dhe natyrisht është nënshkruar nga vetë kryeministri.

Në mbledhjen e datës 26 maj 2010, po ashtu rregullorja me strukturë është funksionalizuar dhe është emëruar ushtruesi i detyrës së kësaj zyre. Gjatë këtij viti do të ngritën kapacitetet implementuese të zyrës duke filluar nga viti i ardhshëm do të fillojë certifikimi i subjekteve për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe do të përcaktohen të gjitha procedura për mbrojtjen e pronësisë intelektuale. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Vazhdojmë. Deputeti Driton Tali, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi, apo për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi.

Deputet, e ke fjalën.

DRITON TALI: Kohë më parë, zoti kryeministër, në opinion ka filluar të flitet për fillimin e bisedimeve teknike apo bisedimeve, ri negociatave, siç po i thuhet. Flitet që kjo do të fillojë në shtator. Pyetja është kjo: Zoti kryeministër, na tregoni se çka janë gjërat teknike apo cilat janë çështje teknike për të cilat niveli më i lartë shtetëror i Kosovës dhe i Serbisë do të bisedojnë apo rinegociojnë si doni thoni, e bëj këtë pyetje sepse ta kam pas bërë këtë pyetje të njëjtë shumë herë përpara, po e shfrytëzoj transkriptin e 26 shtatorit, atëherë kur dyshohej që edhe tash po dyshohet se 6 pikshi i famshëm i Ban Ki Munit ende është në lojë. Atëherë ju patët thënë: “dëshiroj t’ju ftoj sinjerisht që të mos ndikoni nga deklaratat e Jeremiqit dhe askujt tjetër”, pastaj patët vazhduar i keni në faqe 9, “të mos ndikoni nga shtypi i Beogradit, të mos ndikoheni nga deklaratimet e Beogradit, të mos frustroheni prej kërcënimeve dhe mesazheve frikësuese të Jeremiqit”, për të përfunduar me “Beogradi gënjen, gënjen dhe gjithmonë gënjen për Kosovën” dhe 6 pikshin e famshëm e patët shpallur të vdekur. Por siç po shihet, Beogradi nuk e paska pasur dhe krejt çështje të rinegociatave apo bisedimeve apo 6 pikëshin thuaj qysh ti duash, krejt rrenë. Bile edhe gazetatat e juaja apo afër me juve, tash japin kryetituj si Hashim Taçit dhe Boris Tadiq do t’i drejtojnë bisedimet teknike Prishtinë – Beograd. Edhe një herë a na tregoni apo i tregoni opinionit kosovar se çka janë ato çështje teknike për të cilat kreu më i lartë i dy shteteve do të bisedojnë, në këtë rast kryeministri apo presidenti i Kosovës me presidentin apo kryeministrin e Serbisë, sepse jemi në amulli, për gjërat teknike për aq sa dimë ne, bisedojnë në nivele të ulët e jo nivele të larta, niveli i lartë shtetëror bisedon për çështje strategjike, thashë nëse bisedoni për t’iu dhënë më shumë autonomi vendeve ku serbët....

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Kryeministër e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar deputet Tali,

Përsëri po theksoj se nuk duhet të ketë askush pikë reference opinionin e Beogradit për të ardhmen e Kosovës e as citimin e Tanjugut , për agjendën euroatlantike të rajonit dhe të bashkëpunimeve rajonale mes shteteve. Qeveria ime i ka tri adresa të përgjegjësisë dhe që respekton, e para është, populli i Kosovës, pastaj është Uashingtoni dhe Brukseli. Ndërsa sa i përket bashkëpunimeve rajonale e theksova edhe më herët, bashkëpunim rajonal do të ketë si dy shtete të pavarura, qoftë për energji, për transport, dokumente të udhëtimit, Ceften është një bashkëpunim rajonal sipas parimeve dhe standardeve më të larta euroatlantike. Kur thashë tri adresat fola për respektimin e plotë të vullnetit të qytetarëve të Kosovës për të integruar në NATO dhe Bashkim Evropian, që është edhe vizion i politikës shtetërore dhe i gjithë spektrit politik në Kosovë, duke përfshirë këtu integrimin e Kosovës në OKB në të ardhmen e afërt.

Unë kam besim të plotë në të ardhmen e fuqizimit të shtetit të Kosovës dhe këtë perspektivë nuk e shoh me hezitim , përkundrazi e shoh shumë të qartë dhe të mbështetur plotësisht nga i gjithë komuniteti ndërkombëtar në këtë drejtim unë dua të besoj fuqishëm se do të kemi një bashkëpunim të ngushtë të gjithë këtu si spektër politik, institucional dhe shtetëror. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! A ke pyetje shtesë?

Fjala deputetit Driton Tali!

DRITON TALI: Zoti kryeministër, kësaj radhe nuk më dhatë kurrfarë përgjigje, sidoqoftë një pyetje konkrete apo pyetje konkrete. Nëse Beogradi kërkon edhe më shumë autonomi për qytetarët serbë në Kosovë, me theks të posaçëm për ata që jetojnë në veri të Kosovës, a do të insistoni ju që për reciprocitet që të njëjta të drejta t'i gëzojnë edhe shqiptarët në Serbinë Jugore, siç edhe e tha parafolësi deputeti nga partia e juaj, fshatrat në Gollak nga presioni janë shuar, po thuaj se atje askush s' jeton. A do ta hapni temën e dëmeve të luftës, pagesës së dëmeve të luftës, se megjithatë ka pasur dëme të luftës, apo çka do të flitni? A do të flitni atje për sa tavolina do t'i ketë kjo gjykata në Graçanicë apo Mitrovicë të veriut apo mbase edhe ndarjen e Mitrovicës? Opinioni nuk ka kurrfarë informata, krejt çka dimë ne është se dikush iu thotë biseda praktike, tash është futur edhe një term i ri më parë ...

KRYETARI: Kryeministër, e ke fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Për mua është gjithçka e qartë se çdo hap i mëtutjeshëm do të jetë hap i cili do të nxirret nga vendimet e Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe Parlamenti i Republikës së Kosovës ka nxjerr ato vendime. E ka aprovuar me unanimitet të plotë dokumentin e Presidentit Ahtisari dhe unë do ta respektoj në pikëpikëri dokumentin e presidentit Ahtisari, Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e Kosovës. Ne jemi duke punuar që të kemi ligjshmëri në veri dhe këta hapa do t'i shihni shumë shpejtë. Punojmë maksimalisht për formimin e komunës së re, për organizimin e zgjedhjeve të lira në tri komuna të tjera dhe në angazhimet tona socio-ekonomike. Por përsëri ju them se në asnjë rrethanë përderisa të vazhdojnë në këto angazhime të fuqishme shtetërore idetë që mund të prezantohen aty- këtu e që mund të përkthehen mund të them lirisht edhe këtu, nuk janë serioze, nuk janë të përgjegjshme, nuk i ndihmojnë askujt, sepse për Kosovën nuk do të ketë ndarje dhe këtu duhet të përmbillet ky kapitull edhe së diskutuari njëherë e përgjithmonë. Nuk është mirë dhe nuk i bëjmë nderë besoni askujt nëse hapim tema të tilla, diskutimi në Parlament, nëse hapim tema të tilla shkëmbime terriroresh në Parlamentin e Republikës së Kosovës dhe mos u çuditni pastaj kur dikush tjetër ngrit si ide. Nuk janë ndihmuese këto ide, këto teza, këto opinione. Kosova është shtet i pavarur sovran, ka integritetin territorial të saj të paprekshëm, pacenueshëm, të njohur ndërkombëtarisht dhe kështu do të funksionojë një herë e përgjithmonë dhe kjo është përgjigja ime për gjithmonë, zoti Tali në këto pyetje tuaja për ndarjen e Kosovës, për autonomi të serbëve brenda Kosovës, për shkëmbim territorial, për ndryshim të kufijve në rajon. Çdo herë do ta kesh përgjigjen e njëjtë ti dhe gjithë ithtarët e këtyre ideve. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Në vitin 2009, zoti ministër, PTK-ja shpalli fituese e një tenderi shumë kontraverz për operatorin virtual konzorciumin “Dardafon”. Por kohë më parë u bë publike se PTK nënshkroi kontratë me një kompani tjetër “Dardafon.net” dhe nga ART në mbledhjen e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion konfirmoj se është nën hetime te EULEKS-it. Pra rasti është çështja e hapur legale. Të gjithë juristët, të gjithë në botë e dinë që ka shkelje flagrante të ligjit aty, ndërrim, dhënie të kontratës pa konkurruar. Gjithashtu në mbledhjen, me datë 1 prill 2010 me rastin e Dardanof versus - Dardafon.net, ju patët hedhur përgjegjësi mbi ART-në. Citoj: nga transkripti. “Unë vetëm do t’ju lusja që për të gjitha këto të kontaktoni me ART-në. Gjithashtu, Qeveria e Kosovës para dy ditëve mori vendim për shitjen e “Valës” dhe Telekomit i Kosovës dhe ka vendosur që të shesë 75% të aksioneve të Telekomit dhe “Valës”, sigurisht të bazuar në preferencat e këshilltarëve të kontraktuar të transaksionit. Pyetja- Çfarë iu kanë sugjeruar këshilltarët për rastin Dardafon dhe Dardafon.net, si çështje që gjithmonë mund të hapet ndoshta nga një Qeveri e ardhshme apo ndoshta nga njerëz të tjerë dhe të shpallet e pavlefshme dhe çfarë ndikimi ka pasur kjo kontratë në vlerën e supozuar të shitjes së “Valës”? Me fjalë të tjera, zoti ministër nuk jeni i sigurt se PTK ka kontratë valide me Kompaninë “Dardafon.net” që fare nuk ka konkurruar, janë shkelur procedurat ligjore në Kosovë? Sa ka ndikuar në çmimin e supozuar të “Valës” dhe Telekomit.

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari zoti kryetar,

I nderuari zoti kryeministër, zëvendëskryeministra, koleg ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet,

Kjo pyetje është shtruar disa herë dhe mbase unë jam përgjigjur përafërsisht në këtë pyetje të njëjtë apo të ngjashme. Sa përket temës që është diskutuar, unë konsideroj ende adresa është e njëjtë, është ART-ja dhe është Ligji mbi ndërmarrjet publike të cilat u japin kompetencë bordeve të ndërmarrjeve publike që të menaxhojnë në frymën e qeverisjes korporatave asetet të cilat janë pronë publike. Çdo ndërhyrje e Qeverisë përtej kësaj do të ndërronte komplet sistemin dhe ne nuk jemi të gatshëm për ta bërë atë.

Në fazën e procesit të privatizimit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë disa masa të cilat janë në frymën e masave që i lejon ligji dhe të cilat sigurojnë që gjatë procesit të tranzicionit të ndërmarrjeve publike të ketë një ruajtje të aseteve të veta për të mirën e qytetarëve të Kosovës dhe për rritjen e outputit gjatë procesit të privatizimit. Çdo kontestim i ndonjë marrëveshje komerciale apo ndonjë licence që është bërë në periudhën e kaluar natyrisht që do të ndikonte në outputin e ndonjë transferi të një aseti nga një formë në formën tjetër. Ne nuk mund të hymë në supozime, besojmë plotësisht në profesionalizmin e ART-së dhe besojmë plotësisht që gjatë analizave të ndërrimit të statuseve të operatorëve virtual janë marrë për bazë ligjet dhe ne besojmë. Ata që nuk kanë respektuar ligjet ose procedurat, ligji përcakton përgjegjësinë për secilin individualisht dhe nuk do të komentoja më tej. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Fjala deputetit Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Edhe pse ministri nuk u përgjigj në pyetjen konkrete atë çka unë ia drejtova, më duhet t’ia them se s’është e vërtetë që është bërë e njëjta pyetje gjithmonë. Unë po flas në çmimin e supozuar, nuk janë fjalë koti këto, janë fjalë që po kushtojnë me lekë, i nderuar ministër edhe ke thënë se ne kemi ekspertë e ekspertët para se të shitët diçka e parashikojnë çmimin, e vlerësojnë. Me fjalë të tjera, unë po ju pyes- Sa ju ka dëmtuar kjo kontratë e paligjshme? Pyetja konkrete: Sa ia ka zbritur çmimin edhe kur ju e çekët se do të ndërronte sistemin, të gjithë ne jemi të interesuar të ndërrojmë sistemin, pse pikërisht ajo çka po kërkohet që mos të lidhen kontrata jashtëligjore edhe nuk është ikja e përgjegjësisë ta gjuash topin prej kryeshefit

ekzekutiv të PTK-së në kryeshefin apo përfaqësuesin ligjor atëherë të “Dardafonit”- tash shef i ART-së , ta dërgosh topin te Qeveria, ju jeni përgjegjës i drejtpërdrejt për menaxhimin e ndërmarrjeve publike. Edhe një herë po ju pyes sa sipas ekspertëve ...

KRYETARI: Ministër, a ke përgjigje?

MINISTRI AHMET SHALA: Ma ka mundësuar Rregullorja e Parlamentit.

Faleminderit! Në një nuk jem as ti as unë për ta përcaktuar ligjshmërinë e asaj kontrate. Prandaj, ta sqarojmë ju kisha lutur shumë dhe nuk kisha dashur që deputetët ose ministrat të bëhen komentues përfundimtar të ligjit. Ato janë të rregulluar me ligj shumë mirë dhe kur të marrë një institucion që është përgjegjës për ligjshmërinë, atëherë do të merret kjo parasysh. Një çështje, jemi të sigurt se çdo vendim që e ka marrë ART-ja dhe bordi i ndërmarrjes publike, në këtë rast PTK-së, dua të besoj fuqishëm që ka qenë në dobi të PTK-së dhe unë nuk dua të hyj si ministër në kompetencat e anëtarëve të Bordit dhe vendimmarrjes së tyre. Vendimi për të privatizuar një pjesë të aksioneve të Postë- Telekomunikacionit, është në dobi të shtetit dhe popullit të Kosovës, është në dobi të zhvillimit të këtij sektori, është në dobi të përmbylljes së projekteve nacionale të cilat i kemi fillua. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetë më të durueshëm, vazhdojmë. Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Edita Tahiri, ministrja nuk është këtu. Doni ta lexoni pyetjen deputet? Lexoje! Fjalën deputetit Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Është çështje e rëndësishme, është fjala për, ndër të tjera, ndër të tjera, në vendin tonë jo vetëm në segmentin e gjyqësorit, por edhe në atë të ekzekutivit a këtu është poenta, këtu është apostrofimi, aktualisht ka shumë raste juridike- administrative përfundimtare të cilat nga shkaqe më së të ndryshme, por kryesisht të paarsyeshme nuk përmbahen. Konkretisht hiq më pak se 76 vendime përfundimtare të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, aktualisht nuk përmbahen. Po ashtu, atij numri duhet shtuar edhe 46 vendime të tilla për të cilat autoritetet punëdhënëse nuk e kanë informuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, referuar pa përmbahimit të tyre edhe këto të fundit me bazë mund të dyshohet se nuk janë përmbahur. Ju lutem, Kushtetuta nuk shkelet vetëm në pjesën e veriut a ndonjë vend tjetër, ndonjë pikë, po kjo është shkelje direkt nga një numër i konsideruar i ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës të cilët janë të obligueshëm nollens vollens për t’i përmbahur pa kurrfarë diskutimi vendimet e formës së prerë, nuk i përfillin ato. Ndërsa zonja ministresh që ishte dashur të ishte aty ku do të duhej të ishte, nuk është, nuk është në rregull absolutisht është një shkallë e neglizhencës edhe e papërgjegjësisë të paparë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputet, menjëherë po ta jap fjalën. Ke pyetje për ministrin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: I nderuar kryetar,

Të nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra, deputetë,

I nderuar ministër Shala,

A vlerësoni edhe ju se vendi ynë edhe për shkak se gjithnjë iu ka hyrë në programe financiare me Fondin Monetar Ndërkombëtar rrezikon t’i humbë përafërsisht 230 milionë euro donacione për buxhet, më parë të zotuar nga Komisioni Evropian dhe Banka Botërore. Gjithsesi përfitimi i donacioneve sipërthëna, ndër të tjera, kushtëzohet edhe me plotësimin e rekomandimeve të FMN-së, referuar reformimeve në administratën publike si dhe përmirësimeve të politikave makroekonomike në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari deputet Smaka,

I nderuar profesor,

Në fakt, Qeveria e Republikës së Kosovës pas shumë negociatave diku 4 misione të Fondit Monetar Ndërkombëtar të ardhura në Kosovë dhe një në Uashington kemi dakorduar në parim marrëveshjen për program me fondin Monetar Ndërkombëtar, i cili do t'i mundësojë Republikës së Kosovës akses të drejtpërdrejtë në 106 milionë euro kredi të butë pra një arazhman stenbaj i gatshëm çdo herë të ekzekutohet. Në qoftë se Qeveria e Republikës së Kosovës zbaton programin me Fondin Monetar Ndërkombëtar i cili program i mundëson në të njëjtën kohë edhe derdhjen e 210 milionë euro ato që i thatë ju rreth 150 milionë euro nga Komisioni Evropian dhe 60 milionë euro nga Banka Botërore. Këtë e konsideroj një sukses të madh të gjithë qytetarëve të Kosovës një lidhshqip të theksuar të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe një punë konsideroj vizionare për të mirën e gjithë këtij rajoni e posaçërisht të Republikës së Kosovës.

Më lejoni t'i elaboroj në pika pak më të thella këtë dhe t'ju siguroj që ne jemi shumë të përkushtuar që këtë program ta realizojmë, pikat e agjendës të rendit të ditës sot që janë pika të cilat jemi zotuar se do t'i realizojmë si aksione paraprake, si veprime paraprake pra, disa ndryshme në ligjet aprovimin e Ligjit, ndryshim ligjit të buxhetit si dhe shumë ligje të tjera Ligji mbi akcizën, Ligji mbi financat publike, mbi Bankën Qendrore dhe mbi procedurat e Administratës Tatimore, të gjitha këto duhet të përmbyllen në qoftë se vërtet jemi zotuar që të hymë në program, 5 ditë para se Bordi i Fondit Monetar Ndërkombëtar të ketë mbledhjen të cilën e presim diku kah pjesa e tretë e korrikut. Prandaj, kryeministri i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar se do t'i kryejë të gjitha këto. Në kuadër të programit, pas shumë debateve dhe vështirësive nëse mund të them, kemi arritur që të fusim projekte nacionale, qoftë të sferës sociale, qoftë të sferës infrastrukturore. Mund të them pa modesti se ka qenë një sukses i jashtëzakonshëm që përveç infrastrukturës rrugore ne kemi arritur të fusim në program edhe Ligjin për pensionistët, edhe Ligjin për shërbyesit civilë edhe kemi futur këtë vit rritjen e pagave të shërbyesve civilë, të policëve dhe shumë aspekte tjera sociale të cilat vërtet nuk ka qenë lehtë për t'i negociuar.

Andaj, dua përfundimisht t'ju falënderoj të gjithë juve

KRYETARI: Hajt, edhe një minutë ministrit!

MINISTRI AHMET SHALA: Dua të falënderoj Kryesinë e Kuvendit dhe gjithë pjesëtarët e grupeve parlamentare që vërtet me përkushtim kanë futur sot në agjendë të 4 ligjet për aprovim dhe do t'ju kisha lutur që t'i fusim në përmbyllje në afatin sa më të shkurtë 5 ditë para mbajtjes së Bordit të Fondit Monetarë Ndërkombëtarë që thash pritet të jetë në javën e tretë të këtij muaji. Dua t'ju informoj se në Bordin e fondit nuk janë vetëm shtetet që kanë njohur Kosovën, andaj ka zëra të tillë që dëshirojnë që neve mos t'i përmbushim këto kushte, por ka më shumë zëra dhe miq që vërtetë do të donin që ky program të realizohet i cili do t'i mundësonte 210 milionë euro nga donatorët dhe 106 milionë euro nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, andaj do t'ju lusja që të përmbyllim këtë sa më shpejt që është e mundur. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëndetje, zoti kryeministër,

Të nderuar ministra prezentë,

KRYETARI: Më falni, deputeti ka pyetje shtesë. E ka fjalën deputetit Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Unë e vlerësoj lart afirmativisht përkushtimin, profesionalizmin, seriozitetin dhe përgjigjen adekuate, kuptimplote në pyetjen kuvendore. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Tani është deputetja Nerxhivane Dauti, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, kryetar!

Ligji për ndërtimin është me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës, duke marrë parasysh faktin se ky ligj do të krijonte një bazë të mirë juridike për përcaktimin e kërkesave kryesore për projektim, ndërtim, përdorim të produkteve ndërtimore, mbikëqyrje profesionale, si dhe për procedurat e lejeve të ndërtimit, lejeve të përdorimit dhe inspektimin e ndërtimit rrjedhimisht shtrohet nevoja e domosdoshme që ky ligj të miratohet sa më shpejtë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji, për ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, paraqes këtë pyetje: Në cilën fazë të përgatitjes është ky ligj?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryetar,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara deputete Nerxhivane Dauti,

Ligji aktual i ndërtimit nuk plotëson kërkesat në këtë fushë dhe realitetin në politikë. Në këtë aspekt Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marrë iniciativën për hartimin e ligjit të ri për ndërtim, kështu që dëshiroj t'ju njoftoj se grupi punues qeveritar ka përfunduar punën me datë 16 qershor, i cili tani është në procedurë të lekturimit dhe përkthimit e pas përkthimit do të procedohet në Ministrinë e Integritetit Evropian dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, për të siguruar dokumentet përcjellëse- deklarata dhe pajtueshmërisë dhe deklarata financiare. Por, gjithashtu dëshiroj t'ju informoj se ende ekzistojnë disa dilema ku duhet të sqarohet edhe në mes të faktorit të brendshëm edhe me faktorin ndërkombëtar, sepse është një ligj i ndjeshëm. Unë besoj që këto ditë do të kemi konsultime në Kabinetin qeveritar edhe së shpejti pas realizimit të konsultimeve do të vijë edhe në Qeveri dhe mandej të procedohet edhe në procedurat parlamentare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputete, ke pyetje shtesë? Regjia, fjalën deputetes!

NERXHIVANE DAUTI: Pyetje shtesë nuk kam, por e falënderoj ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor për përgjigjen shumë koncize, i dëshiroj punë të mbarë!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Teuta Hadri, pyetje për ministrin Bujar Bukoshi. A doni ta lexoni pyetjen?

Regjia, fjalën deputetes Teuta Hadri.

TEUTA HADRI: Sipas burimeve mediatike, në QKUK më 10 qershor ka hyrë një kontigjent i barërave me afat të skaduar nga KFOR-i gjerman, kryesisht reagenca biokimik për analizat e gjakut, me afat mbi 6 muaj të skaduar, domethënë nuk guxojmë t'i përdorim. Pyetja: Zoti ministër, pse QKUK u bë depo e pranimit të barërave me afat të skaduar, kur e dimë se shkatërrimi i tyre kushton shumë, ku edhe vetë KFOR-i gjerman i ka ikur këtij demolimi, se kushton shtrenjtë. Desha më tepër për qytetarët ta dinë se sa ministri...

KRYETARI: Mirë, faleminderit! Ministri s'është këtu. Deputeti Naim Rustemi, pyetje për Bujar Bukoshin. Regjia, fjalën deputetit Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Unë do t'ia lexoj pyetjen se në shtator veç ai ndoshta do ta japë përgjigjen lidhur me 6 hektarë tokë të QKUK-së. Edhe do t'ia lexoj pyetjen se në shtator sigurisht do të vije me përgjigje se kush janë uzurpatorët e 6 hektarëve tokë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ministri i Shëndetësisë, Bujar Bukoshi e ka iniciuar procedurën e shkarkimit të drejtorit ekzekutiv dhe në arsyetimin e vet e ka cituar nenin

17.2 të statutit të QKUK-së. Unë e lexova nenin 17.2 të statutit të QKUK-së dhe aty tregohet se iniciohet procedura vetëm kur është fala me mos aprovimin e raportit për rezultate afariste, me fjalë të tjera aspak s'ka pasur lidhje me këtë gjë. Por, drejtori ekzekutiv i QKUK-së, në mënyrë shumë transparente pat bërë publike shumë afera korruptive që përcjellin punën e QKUK-së si dhe pat bërë publike aferën e shpronësimit apo dhënien në shfrytëzim ndërmarrjeve private në mënyrë të paligjshme dhe paushall të tokave publike që për dekada me radhë kanë qenë në shfrytëzim të QKUK-së. Pyetja ime që i drejtohet atij: A është transparenca arsye për shkarkim apo cilat janë arsyet e vërteta që kanë iniciuar shkarkimin e drejtorit ekzekutiv?

KRYETARI: Faleminderit!

Unë mendoj që kjo çështja e 6 hektarëve, mund të jenë edhe më shumë se 6 hektarë, aq shumë është përsëritur sa i mbetet prokurisë të veprojë, do të thotë, mendoj që nuk do të duhej të ishte temë tani më në Kuvend. Dhe, pyetja e fundit, deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Pyetja është kjo, zoti ministër,

Cilat ishin arsyet të cilat e shtyn Qeverinë që të ndërhyjë në PTK për t'ia kufizuar asaj buxhetin për sponzorimin e donacioneve, ngrijë punësimin dhe anulimin e tenderit disa dhjetëra milionësh, kur dihet se PTK-ja që në fillim kur erdhi kjo Qeveri ka qenë në agjendë për t'u privatizuar dhe Qeveria ashtu siç sot deklaruar nuk keni ndërhyrë në atë kontratën famoze të "Dardafonit", pastaj nuk reaguat në punësimet të qindra vetave atje pa kurrfarë konkursi. Pastaj 400 mijë euro kur iu dhanë Universitetit të KENT-it për trajnime, sponzorimin e 45 mijë euro për kuajt e prot-garën me kuaj, 100 mijë euro sponzorim që iu dha filmit të regjisorit Halil Budakova, me kusht që ai t'ia jepte një rol djalit të kryeshefit të PTK-së, kur u blenë makinat, kerret mbi 120 mijë euro në vlerë, bonuset marramendëse, bile të është bërë pyetje më 28 shtator 2008, t'i pate thënë se, kështu po të ceku, keni pas thanë se "Bordi i ndërmarrjeve publike është ajo që i udhëheqë ndërmarrjet, Qeveria e Kosovës mund të sugjerojë, por nuk diktoj, sepse nuk jemi shtet etatist, unë s'po ju kuptoj pse tash më në fund u bëtë shtet etatist dhe ndërhyt në këto aktivitetet e fundit, po them edhe një herë duke pasur parasysh se PTK-ja ka qenë gjithnjë në agjendën e Qeverisë për ta privatizuar, kësaj Qeverie kur erdhi në pushtet. Pse atëherë nuk ndërhytë e tash, a po ju dukët që e tepruam duke vjedhur, a çka është muhabeti?

KRYETARI: Fjala "etatist" është fjalë e huaj, që do të thotë shtet edhe ajo në një formë. Urdhëro, ministër e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryetar!

Nëse në çdo shtet, në çdo Qeveri në qoftë respekton qeverisjen korporative derisa nuk merr vendim që një aset, një ndërmarrje publike ta transferojë në një formë tjetër, nuk do të duhej të përzihej në punët ditore të një ndërmarrje publike, përveç të përcaktojë kodin e sjelljes dhe rregullat korporative. Në momentin kur Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur që të privatizojë Postë-Telekomunikacionin e Kosovës, KEK-un apo Aeroportin, ai duhet të dijë që nuk do të menaxhojë, e kam fjalën me resurset dhe... outputet e saja në të ardhmen e largët. Andaj, nuk do të kishte kuptim që Posta t'i ketë në xhirollogarinë e vetë 200 milionë euro dhe do të transferohet në ato 200 milionë euro ose 80 milionë euro do të transferohet te blerësi me 80 milionë euro, por me asete të caktuara dhe obligime jo afatgjate të caktuara. Nuk mundesh një ditë para se ta shesë shtëpinë t'i instalosh lusterë të rinj, po marrë një shembull më falë shkollor, sepse blerësi i jashtëm ndoshta ata lusterë nuk do të ngjet fare, ndoshta do ta ndërrojë kulmin të tërin. Dhe këto janë koncepte edhe më të thjeshta që një qytetari i Kosovës mbasi i kupton. Andaj vendimi për ndaljen e punësimit është në frymën që transferet e punësimeve të tepruara mos të jenë të pakufishme në të ardhmen, ndonjë kontratë afatgjatë qoftë për investime kapitale, qoftë për ndonjë projekt tjetër i cili për blerësin e ardhshëm nuk do të ketë të njëjtën vlerë të paktën karshi udhëheqësve tani, nuk do të ishte në logjikën e çdo qeverisjeje që të mos marrë masa të tilla dhe unë besoj që të gjitha këto kanë hyrë në funksion dhe në të mirë që autputet gjatë procesit të privatizimit të pjesërisht apo të tërësishëm të Postës të jenë në të mirë të Qeverisë dhe shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!
Deputet, a ke pyetje shtesë?
E ka fjalën Driton Tali.

DRITON TALI: Kjo qeveri, sinqerisht, e ka humbur udhën në oborr dhe s'di më çka është kah deklaron. Unë po të citoj edhe në të njëjtin transkript, do t'i sjell krejt seancat çka ke fol, mbani mend çka jeni kah deklaroni, jeni duke dhënë fjalë publike. Kështu keni thënë në shtator të vitit 2008: "Qeveria është absolutisht e përcaktuar për ta privatizuar PTK-në". Në aspektin strategjik, ai është vendim i marrë, o zotëri, më 2008 keni lënë të bëhen gjithë ato abuzime, tash reagoni për një tender. Pse s'e keni shfrytëzuar të drejtën e aksionarit atëherë? Ato ndërmarrje publike ju i kontrolloni në emër të qytetarit të Kosovës, o zotëri, që keni pasur interesa tuaja grupe, ajo është çështje tjetër, edhe s'po e them unë, po le të thonë organet ligjore, por mos deklaroni lidhje pa lidhje sende, mos bini në kundërshtim me vetveten.

KRYETARI: Deputet, kujdes në fjalorin parlamentar.
Ministër, a ke përgjigje?

MINISTRI AHMET SHALA: Derisa një shtet, një Qeveri nuk ka një vendim, mund të shpreh vizionet e veta. Një grup ndërministror, të cilin e udhëheq unë, derisa nuk e merr vendimin Qeveria, unë nuk mund të veproj ndryshe. Pra, si vizion ka qenë transformimi i ndërmarrjeve publike në sektorin privat dhe kjo nuk ka qenë e mundur deri në aprovimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe nëse ju kujtohet, ligjet për ndërmarrjet publike të Republikës së Kosovës janë përfunduar në qershor të vitit 2008. Ne kemi shprehur si vizion sektorin privat si forcë lëvizëse të zhvillimit ekonomik, pra juridikisht pas marrjes së vendimeve mund të veprosh konform atij vizioni, jo ndryshe. Po të ketë ndryshe dikush ndoshta kur të vish ti në pushtet nëse e ke shansin do të marrësh me një koncept tjetër. Këto janë qasje të cilat ne i konsiderojmë që janë absolutisht në frymën më të mirë të qeverisjes kooperative dhe të strategjisë së zhvillimit të sektorit privat në Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Ju njoftoj se pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Punës së Kuvendit.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin për Ekonomi dhe Financa, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin në fjalë. Lus deputetët që janë jashtë sallës së Kuvendit të kthehen në seancë. Ministër e ke fjalën.

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zoti kryeministër,

I nderuari zoti zëvendëskryeministër, kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Marrëveshja jonë me Fondin Monetar Ndërkombëtar për hyrjen në program, shton nevojën për amendamente të disa ligjeve në kuadër të cilëve është edhe Ligji për menaxhimin e financave publike si ligj organik i një shteti për financa publike.

Ky proces i hyrjes në program përfshin arritjen siç e thashë të shumë detajeve në letërën e qëllimit të mirë për memorandumit e politikave ekonomike dhe financave të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Këto dy dokumente, pra letra e qëllimit të mirë dhe memorandum i politikave ekonomike formojnë substancën e programit me fondin Monetar Ndërkombëtar, i cili do të sjellë përfitime të konsiderueshme për popullin e Republikës së Kosovës.

Me këto dy marrëveshje, Republika e Kosovës zotohet të ofrojë një raportim financiar ashtu që progresi ynë në këtë program të mund të monitorohet dhe të diskutohet në baza tremujore.

Amendamentimet në këtë ligj janë në mbështetje të këtyre aranzhimeve dhe marrëveshjeve me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Amendamentimet e propozuara në nenin 19 dhe 21, kërkojnë raportim shtesë nga Qeveria e Republikës së Kosovës kur përgatisim rishikimin e 6 mujorit të dokumenteve buxhetore për Kuvendin dhe kur përgatisim kornizën vjetore afatmesme të shpenzimeve. Këto kërkojnë tabela shtesë që tregojnë efektin financiar të vendimeve dhe për politikën që merren gjatë procesit buxhetor. Këto ndryshime risin transparencën që do ta bëjë më të lehtë mbajtjen e diskutimeve tona të vazhdueshme me fondin dhe do të mbështesin punën e Kuvendit në shqyrtimin e buxhetit vjetor dhe të rishikimit 6 mujor.

Programi me Fondin Monetar Ndërkombëtar do të ofrojë siguri më të madhe sa i përket rezultateve fiskale të arritura në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nga institucionet tjera në Republikën e Kosovës. Kjo në specifika do të thotë që suficitin apo deficitin final i arritur në mbarim të vitit duhet të jetë shumë afër planit buxhetor origjinal të aprovuar.

Një nga mekanizmat për arritjen e kësaj sigurie më të lartë është të sigurojë që ndryshimet në buxhet dhe rishikimin e 6- mujorit që përgjithësisht bëhen në qershor apo korrik të viteve, të jenë neutrale sa i përket buxhetit.

Amendamentimet në nenin 25 do të kërkojnë që përshtatjet e ardhshme gjatë rishikimit të 6 mujorit të jenë neutrale sa i përket buxhetit, ku të gjitha shpenzimet e reja duhet kompensuar me shumën e njëjta kursimesh apo të hyrash.

Programi i fondit Monetar Ndërkombëtar kërkon që të raportojmë rregullisht në Kuvend sa i përket bilancit të shpenzimeve të pashlyera, përkatësisht fatura që nuk janë paguar me kohë.

Në fakt ne jemi të përkushtuar që të sigurojmë se të gjitha faturat do të paguhen në kohën e duhur, ashtu siç e përcakton edhe ligji aktual, por me ndryshimet që i ka afruar këtu specifikohen në mënyrë më të qartë zotimet dhe obligimet dhe format e shlyerjes së obligimeve ndaj partnerëve të tretë.

Amendamentimet tjera teknike kanë për qëllim qartësimin e tekstit në lidhje me rolin e auditorit gjeneral për të sjellë aty në linjë me standardet më të mira ndërkombëtare. Ky nuk është një ndryshim fundamental dhe nuk do të dobësojë në asnjë aspekt mënyrën në të cilën Zyra e Auditorit Gjeneral operon apo i raporton Kuvendit.

Ky amendamentim është përpiluar edhe harmonizuar edhe me Auditorin Gjeneral të Kosovës.

Amendamentimet e propozuara në pjesën e 13 të ligjit qartësojnë rolin e Ministrisë së Drejtësisë në rastet kur Qeveria është palë në procedura gjyqësore. Këto amendamente adresojnë shqetësime sa i përket gjuhës së mëhershme të ligjit në lidhje me ndarjen ndërmjet degëve ekzekutive dhe legjislative të qeverisjes.

Përsëri ky është një ndryshim teknik që nuk ndryshon në mënyrë fundamentale qëllimin e ligjit, por që qartëson rolin e Ministrisë së Drejtësisë sa i përket përfaqësimit të saj nëpër procedura gjyqësore në rast se Qeveria është paditur ose padit dikë.

Më lejoni që të theksoj se të gjitha këto amendamente janë koordinuar dhe harmonizuar me partnerët tanë ndërkombëtarë, pra edhe me Fondin Monetar edhe me Komisionin Evropian dhe janë në pajtueshmëri të plotë me programin, përkatësisht me letrën e qëllimit të mirë dhe programin për politika fiskale dhe ekonomike, memorandumit e mirëkuptimit me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe si të tilla ju propozojmë dhe ju lusim që t'i aprovonit në kohën sa më të shpejtë të mundshme, në mënyrë që të arrijmë që programi për shtetin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar të aprovohet në kohën e paraparë, në javën e tretë të korrikut. Faleminderit, shumë!

Drejtimin e seancës e merr anëtarin e Kryesisë, zoti Naim Maloku

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit hapi debatin për diskutim në parim.

Në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministri i dha vetë shpjegimet se ky projektligj ka për qëllim krijimin e parakushteve të nevojshme ligjore për përmbushjen e kërkesave të Programit për Kosovën të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe prandaj kjo ka qenë ajo arsyeja e ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji. Të vetëm çështje që unë do ta kisha ngritur, për sa i përket këtij projektligji është një dispozitë ku në rast të kontesteve eventuale ose paraqitjes para organeve të drejtësisë ose organeve të arbitrazhit që i jepet një rol i veçantë Ministrisë së Drejtësisë, këto çështje ne duhet t'i kemi parasysh dhe duhet të qartësojmë pak më mirë, për vetë faktin se jo në të gjitha rastet Ministria e Drejtësisë mund të merr rolin e avokatit për sa i përket autoriteteve tjera publike. E kemi pasur ne në shqyrtim Projektligjin për Bankën Qendrore, ku në këtë rast Bankës Qendrore si autoritet krejt autonom, në konteste të caktuara para organeve të drejtësisë, Ministria e Drejtësisë e merr kompetencën e përfaqësimit të Bankës Qendrore, që mendoj nuk do të duhej të ishte, sepse për vetë faktin se ka raste të caktuara kur Banka Qendrore mund të jetë ose mund të ketë kontest me vetë Qeverinë si agjent fiskal i Qeverisë, në këtë rast, Ministria e Drejtësisë nuk mund në të njëjtën kohë të jetë përfaqësues i dy në një mbrojtje ose në një kontest, ose në një arbitrazh i dy etniteteve publike.

Prandaj, ne si Komision për Buxhet dhe Financa kur e kemi shqyrtua Projektligjin për Bankën Qendrore këtë ndryshim e kemi bërë atje dhe do t'i paraqitet Kuvendit, por do të kemi parasysh edhe gjatë shikimit dhe shqyrtimit të këtij projektligji që ta qartësojmë më mirë rolin e Ministrisë së Drejtësisë në rastin kur ajo është avokat ose përfaqësues i organeve publike ose Qeverisë në përgjithësi. Kjo është ajo dilema që e kemi pasur dhe kërkojmë që vërtetë të kemi edhe një koment nga Ministria e Drejtësisë lidhur me rolin e sajë si avokat i institucioneve publike.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare ta marrin fjalën. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputeti Hajdin Abazi e ka fjalën.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë vjen në kohën e duhur pasi që ne veç kemi përfunduar marrëveshjet me Fondin Monetar, Bankën Ndërkombëtare dhe shtrohet nevoja që ne të fillojmë edhe t'i inplementojmë standardet ndërkombëtare si dhe praktikat më të avancuara në këto fusha. Prandaj, edhe këto ndryshime dhe këto plotësime kanë pikërisht këtë qëllim që të arrijnë t'i fusin në ligj këto standarde dhe praktika më të avancuara me qëllim që ne t'i plotësojmë kushtet

konform programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, që ne të mundemi pastaj të përfitojmë edhe për çështje kredish, por edhe për donacione që parashihen në tri vjetët e ardhshme.

Këto ndryshime dhe këto plotësime praktikisht Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e racionalizojnë dhe e bëjnë shumë më praktik se sa që ka qenë në disa sfera deri më tash, si për shembull kur është çështja e raportimit më të rregullt si dhe paraqitja e kornizës afatmesme në bazë të cilës mandej edhe buxheti duhet të funksionalizohet dhe të miratohet.

Ajo çka bie në sy dukshëm është kjo se me këto ndryshime fuqizohet shumë roli i Auditorit të Përgjithshëm, gjë është provuar se është i dobishëm për të mirën e shtetit dhe për mbarrëvajtjen funksionale të Qeverisë, që të metat eventuale që mund të manifestohen të eliminohen duke i marrë parasysh vërejtjet, sugjerimet që mund t'i jep auditori gjeneral.

Gjithashtu edhe tek roli i Ministrisë së Drejtësisë megjithëse për këtë foli edhe zoti Koci do të thotë këto duhet të definohet edhe kjo çështje me çfarë raste ka të drejtë dhe mundet të jetë dhe në ndonjë rast sikurse që është Banka Qendrore e Kosovës që mund të bjerë në konflikt interesi dhe prandaj nuk mundet të jetë njëkohësisht edhe avokat ose mbrojtës, ose përfaqësues i saj.

Po ashtu ky projektligj sjell edhe një qartësi më të madhe sa i përket përkufizimeve sepse ka futur dy nocione të përkufizimeve, atë të zotimeve dhe të obligimeve, gjë që e bën edhe më të qartë dhe faktikisht jep mundësi që ligji të jetë më gjithëpërfshirës dhe t'i rregullojë më mirë gjërat që cilat i ka rregulluar deri më tash.

Prandaj, Grupi i PDK-së do ta mbështesë këtë projektligj dhe do të votojë për.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ftoj deputetët pasi që prezantimin e projektligjit e ka bërë Qeveria, të diskutojmë në parim. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ftoj deputetin Naser Osmani, ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Është një draft të cilin ne si deputet e kemi pritur që të vijë në kuptimin e asaj që ligji të harmonizohet me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, në kuptimin e asaj që të jetë në funksion më praktik dhe efikas ajo që ka të bëjë me menaxhimin e financave publike.

Në parim Grupi Parlamentar i LDK-së do ta përkrahë, mirëpo do t'i kemi parasysh disa çështje që kanë të bëjnë me forcimin e auditorit të përgjithshëm që mirëpresim sidomos që ka të bëjë me nenin 47 ku i zgjerohen kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm që të bëjë auditimin edhe te ndërmarrjet publike. Mirëpo duhet të kemi kujdes te neni 4 ku në një farë mënyre duhet të precizohet saktësisht që drejtori i përgjithshëm i Thesarit a e ka kompetencën që t'i drejtohet Auditorit të Përgjithshëm me urdhëresë apo me rekomandim. Derisa inspeksioni i auditorit të përgjithshëm është autonom, shumë i pavarur një ndërhyrje e tillë do ta cenonte pavarësinë e saj me qenë se edhe Komisioni për Mbikëqyrjen Financiare mund vetëm t'i rekomandoj, por asnjëherë ta detyrojë për një auditim. Po do ta kemi parasysh punën që do të jetë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe shpresoj që kjo do të procedohet në mënyrën sa më të shpejtë në Kuvend që të aprovohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ftoj deputetin Haki Shatri, ta marrë fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Siç e dimë Ligji për menaxhimin e financave publike është ndryshuar disa herë që nga aprovimi i parë i tij në vitin 2004. Ndryshimet e këtij dokumenti bazik kanë qenë të arsyeshme për vetë faktin se Kosova në këtë periudhë ka kaluar nëpër faza të ndryshme të cilat lidhen me kompetencat në sferën e politikave fiskale, pra në

financat publike, prej situatës kur Shtylla e Katërt e UNMIK-ut ka pasur kompetencën e plotë në këtë sektor deri te shpallja e pavarësisë dhe kalimi i kompetencave në kompetencat e Qeverisë dhe të vendorët. Në qoftë se këtij fakti te ndryshimit disa herë të ligjit i shtohet edhe fakti që kemi fituar një përvojë në sferën e financave publike, përvojë e cila tejkalon disa momente të cilat i zgjidh ligji aktual në formën siç është, konsiderojmë që nuk është rrugë e mirë që nën presionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për të rritur kontrollin dhe procesin e mbikëqyrjes si pasojë e gjetjeve tepër të rënda dhe rrezikut që i vjen sistemit buxhetor, por mendojmë që është rruga më e mirë për vendin që ky ligj me qenë se është ndryshuar disa herë të rridhohet, të eliminohen ato zbrazëti që dalin vetvetiu nga arnimet e kohëpaskohshme të ligjit dhe të na sillt një ligj organik me një lidhje më të mirë, më të qartë dhe të eliminohen ato si jo teknike, por edhe mangësi të tjera. Ligji që është ofruar, përveç nenit 19, 20 dhe 21, të cilët meritojnë vëmendje për përmbajtjen e mirë që kanë, pjesët tjera janë më tepër plotësime dhe ndryshime kozmetike.

Po ashtu, konsiderojmë se kanë mbetur edhe pjesë tjera të ligjit, të cilat me këtë ndryshim nuk janë rekomanduar dhe që duhet të bëhen. Prandaj, mendojmë që do të ishte më e racionale, më e rrugës dhe më zgjidhje e mirë që Ministria e Financave të përgatitë komplet një ligj të ri, i cili do të përfshinte edhe ndryshimet dhe do të eliminonte ato zbrazësi teknike që eventualisht janë për shkak të kaluarës të këtij ligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputetin Riza Smaka ta marrë fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,
Kolegë të nderuar,

Në parim e miratojmë, e mbështesim këtë dokument. Disa vërejtje parimore të shkurtra, me theks se atë që e apostrofoi zotëri Shatri, konsideroj se do të ishte punë shumë e mirë, sepse ndryshimet e plotësimet e ndryshimeve dhe plotësimeve gjithmonë krijojnë kontraverza të caktuara, a gjithmonë kemi nevojë për një ligj të karakterit organik, do të thotë e ka një rrjedhë. Kur bëhen shumë ndryshime e plotësime, zakonisht krijohen edhe kontradikta në dispozita të caktuara.

Bie fjala, në parim, “shërbyesi civil, ka kuptimin e përcaktuar me Ligjin për Shërbimin civil”. Tash kjo nuk është rregull legjislativ dhe do të duhej që në të gjitha aktet tjera mos të veprojmë kësi soji sikur këtu, po e zëmë. Pse? Do të duhej dikush që do të dinte nocionin e shërbyesit civil, në kontekstin e këtij dokumenti ta merrte atë ligj, po e zëmë, e ndoshta nuk do të mund ta merrte përnjëherë, por çka ka, tre rreshta, përshkruhet fundi i fundit prej atij dokumenti këtu. Domethënë, është fjala për teknikë, por qëllimi është që t’i bëjmë aktet ligjore të thjeshta, të lexueshme, të kuptueshme, të qarta. Ose bie fjala te neni 6, paragrafi 3, përdoret termi “qarkore”. Qarkore është term kolokual, nuk është term që përkon me Kushtetutën, ... atje i kemi aktet nënligjore të cilat janë, do të thotë t’i përshtatemi, t’i përmbahemi se do të ishte, si të them, një rrjedhë konzistente, se kjo është më tepër konstruktion, ne e quajmë konstruktion juridik i rastit ad-hoc, qarkorja. Ose bie fjala, te neni 47, tash këtu janë përcaktuar me këtë ligj që ky nuk është ligj special, referuar auditorit gjeneral, është Ligji për auditorin gjeneral ligj, lex specialis, lex derogat, lex gjereralis, që do të thotë ai i suporpunohet këtij kurdoherë sa i përket auditimit, auditorit të përgjithshëm. Prandaj, nuk është e vendit as e rrugës që me këtë dokument ta trajtojmë pozicionin e auditorit gjeneral, sepse është fjala për Ligjin special që e kemi atje.

Edhe në parim, ju lutem, po e zëmë neni 25, - Rastet e pa zgjidhura në gjykatë. Do të duhej të thuhet - raste gjyqësore, se këto janë raste gjyqësore, case, domethënë raste gjyqësore të pazgjidhura. Kjo edhe ne serbisht “nerešeni slučajevi na sudu”, nerešeni sudski slučajevi. Edhe në anglisht asi soji, por nuk po dua të ndalem ashtu pikë për pikë. Edhe te neni 26, “ndryshim teknik”, nuk ka ndryshim teknik në ligj, ju lutem, teknika është për shembull forma, metodologjia teknike e aplikimit a çka po di unë. Ky nuk është ndryshim teknik, ky është ndryshim nocional apo shprehimor, prandaj do të duhej të zëvendësoj. Edhe neni 27, kjo nuk përkon me standardin e miratuar nga ky Kuvend sa i përket miratimit, shpalljes në “Gazetën zyrtare” dhe hyrjes në

fuqi. Këtu thotë, bie fjala: “Ky ligj”, bile me “I” të vogël, është dashur me “L” të madh, “hyn në fuqi më 1 korrik 2010”. Domethënë, sot po hyka në fuqi. Ama është fjala për..., sot e kemi leximin e parë. Do të duhej të thuhej që, për shembull, “hyn në fuqi 15 ditë pas ditës së shpalljes, me aplikim nga data 1 korrik”, me fjalë të tjera për shprehje t’ia përshtatim kësaj teknikës që e kemi miratuar në këtë Kuvend.

Natyrisht, përfundimisht e miratojmë këtë dokument. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë, kolegë deputetë, zoti ministër, paraprakisht dua t’i jap dy vërejtje teknike, të cilat vërtet dhe natyrisht që pengojnë, por tashmë nuk kemi arsytim që nuk jemi në gjendje të ofrojmë dokument praktik. Për shembull, ligji i cili ka ardhur për ndryshim, Ligji për menaxhimin e financave, është dashur të vjen Ligji aktual me ndryshimet në dy shtylla dhe natyrisht që ne ta kemi më të qartë, më të lehtë të veprojmë dhe ta bëjmë krahasimin. Domethënë, kjo duhet të ndodhë, jo vetëm për këtë ligj, për këtë ligj në mënyrë të veçantë, sepse ligji është i rëndësisë së veçantë, por për të gjitha ligjet. Dhe, vërejtjen e dytë e kam për memorandumin shpjegues. Zoti ministër, unë i lexova edhe memorandumet shpjegues edhe për Ligjin për akcizën dhe për Ligjin për Administratën Tatimore, ato fatbardhësisht janë pak më në rregull por, të nderuar kolegë, kam qejf secili ta lexojë memorandumin shpjegues të projektligjit dhe vetëm 4-5 fjali përsëriten në të gjitha fushat e veprimit në këtë memorandum. Këtu nuk e di kush ta ka bërë këtë memorandum, zoti ministër, por seriozisht është turp. Absolutisht, nuk thuhet ndryshe kushtimisht në fushën e veprimit të projektligjit, titulli i projektligjit, arsytim për projektligjin, qëllimi i projektligjit, në të gjitha këto fusha të njëjtat fjalë përsëriten. Kjo është sikur të thuhet - hajt se po ua çojmë deputetëve këtë material, se ata nuk dinë çka po ju qojmë ose nuk e lexojnë. Le të mbetet kjo për herën tjetër, mos të u përsëritet dhe do të mundohem t’i jap disa vërejtje më konkrete, për të mos e zgjatur shumë.

E kemi parasysh se Ligji duhet të harmonizohet me FMN dhe ne mendojmë se Ligji për menaxhimin e financave është ligj i rëndësisë së veçantë, por natyrisht që në bazë të ecjes të ndryshimeve të reformave të politikave fiskale të vendit, Ligji ka nevojë për amendamentim në afatet e caktuara, prandaj dhe e kemi shqyrtuar me shumë kujdes dhe konkretisht ndalem tek neni 4. Tek neni 4 thuhet: “Nëse drejtori i përgjithshëm i Thesarit...”, mos ta lexoj krejt tekstin, se me siguri ju, zoti ministër, e dini ku është fjala, tek drejtori që e ka të drejtë të thërret këtë auditorin, por në pikën e fundit, domethënë 14.7, thuhet: “Nëse gjatë auditimit nga auditori i përgjithshëm konstatohet se ka pasur dështim sistematik për kryerjen e detyrës nga zyrtari kryesor financiar ose zyrtari certifikues, zyrtari kryesor administrativ e shkarkon personin në fjalë nga pozita përkatëse” dhe shih çka thotë tash, e shkarkon, domethënë nëse ky zinet, vetëm e shkarkon dhe zyrtarët financiarë, të shkaktuar në këtë mënyrë, nuk mund të emërohen zyrtarë financiarë në asnjë organizatë buxhetore. Jo veç që nuk mund të emërohen, por në bazë të kësaj këta zyrtarë duhet të merren menjëherë në përgjegjësi.

Kemi nenin 5, tek përgatitja e Kornizës afatmesme të shpenzimeve, i keni paraqitur të gjithë dokumentacionin të cilin duhet ta paraqitni për të paraqitur Kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe më bëri përshtypje pika (m), ku thotë: “dhe çfarëdo informatash të tjera, të cilat ministri dëshiron t’i përfshijë”. Nuk është dashur të jetë kështu, por unë mendoj që duhet të thuhet: “dhe çfarëdo informate tjetër të cilën e kërkon Komisioni i Buxhetit ose Kuvendi”. Domethënë, duhet ta kompletoni dokumentacionin me kërkesat e Kuvendit apo të komisioneve funksionale.

Neni 6, pika 3, thotë: “në pikën (iii) të paragrafi 20.4, zëvendësohen fjalët: “Ligjin për financat e pushtetit lokal” me shkurtesën “LFPL”. Nuk ka nevojë kjo, gjithqysh duhet të jetë edhe shkurtesa, edhe vetë titulli.

Neni 6 dhe neni 20, i cili, pika 4.8 thotë, ne jse është fjala te auditori i përgjithshëm dhe unë kam vërejtje në pikën 48.5: “Në mes datës 31 gusht dhe 31 tetor, Kuvendi shqyrton Raportin përfundimtar vjetor të auditimit dhe deklaratat financiare të Qeverisë dhe miraton çfarëdo direktive dhe rezolute lidhur me to, jo më vonë se 31 tetor. Nëse Kuvendi nuk vepron, Raporti vjetor i auditimit dhe deklaratat afincancare të Qeverisë konsiderohen të pranuar në formën e dorëzuar nga auditori i përgjithshëm”. Unë nuk e kam të qartë çfarë nënkupton nëse Kuvendi nuk vepron. Kuvendi është i obliguar në bazë të procedurave që t’i kryejë obligimet e veta dhe kjo nuk guxon të figurojë në ligj, zoti ministër!

Natyrisht, ne kemi vërejtjen sidomos tek neni që duhet të definohet qartë roli i Ministrisë së Drejtësisë. Unë pajtohem që është mirë që t’i marrë disa përgjegjësi edhe Ministria e Drejtësisë, por realisht duhet të definohen qartë. Unë mendoj se në kuadër të komisioneve funksionale, siç është ai i Buxhetit, Lidhja Demokratike e Dardanisë do të japë edhe aty kontributin e vet dhe në parim e mbështet.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “ 7+”, deputetja Shpresa Murati.

MUFERA SHINIK: Jo, jo unë, nuk e kam kartelën.

KRYESUESI: Po, këtu është Shpresa Murati. Urdhëroni, folni!

MUFERA SHINIK: Teşekkür ederim saygılar!

Kamu Finasman ve Sorumlulukların yürütülmesine ait Yasanın değişme ve tamamlamalarına ilişkin Yasa Tasarısı iyi bir şekilde hazırlanmış görülmektedir. Avrupa standartlarına uygun hazırlandığından dolayı özellikle önem taşımaktadır. Ancak madde 7’nin 5. e noktasında merkez ve belediyeler düzeyinde giderlere ait özel tabelada daha belirgin bir şekilde açıklama verilmesi gerekmektedir. Aynı zamanda var olan Yasanın 9. maddesinde 26.1 noktasına verilen değişiklik teklifinin de ayan bir şekilde belirtilmesi gerekmektedir. Ki bunun da tercümeden kaynaklabileceği olasılığı ortaya çıktığını düşünüyoruz.

Bunları diktate alınacağını düşünerek bu değişiklikleri 7+ Parolmenter Grubu olarak kabul etmekteyiz.

KRYESEUSI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk kam të paraqitur, nuk ka. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Pozdravljam sve prisutne u sali!

Pred nama je danas jako važan Zakon o izmenama i dopunama Zakona 03/L-048 za upravljanje javnim finansijama i odgovornosti. Mi znamo da ovaj prethodni zakon nije bio u potpunosti razrađen, puno puta kada ovde razmatramo zakone koje dobijamo od ministarstva, ukazujemo na neke potrebe, da kažem, koje se u članovima ili u stavovima preskaču, ne znamo iz kojih razloga.

Moramo da kažemo još ovo, da je ovaj zakon normalno donet, da kažem dopuna ovog zakona na inicijativu Međunarodnog monetarnog fonda. Sa učlanjenjem u Međunarodni monetarni fond, mi ne samo da ćemo imati privilegije za korišćenje sredstava, nego ćemo imati i obaveze ta sredstva kako trošimo i namenski dajemo izveštaj trošenja tih dobijenih sredstva u vidu kredita.

Ovaj zakon, znači predlog zakona je sa osnovnim ciljem uspostavljanja neophodne zakonske politike za ispunjavanje zahteva programa za Kosovski Međunarodni monetarni fond i izmene i dopune su takođe namenski date da bi uticale na rast same discipline koja mora da se poboljša u izvršenju budžeta, kao i povećanje zahteva izveštavanja. Ovaj zakon pojačava isto nadzor revizora. Mi smo imali Zakon o reviziji i u

ovom zakonu se ponovo još jednom dvostruko povećava nadzor generalnog revizora, i to u skladu sa međunarodnim standardima.

Dalje, ovaj zakon je mnogo važan kada je u pitanju ne samo disciplina u knjigovodstvenom sektoru, nego i disciplina kada je u pitanju Ministarstvo pravde, u slučaju kada je vlada stranka sudskog postupka. Mi znamo kako je na terenu gde imamo jako nerešena pitanja svojina, te Vlada kada je predmet sudskog postupka, da taj predmet može da preuzme sud u Ministarstvo pravde u ime Vlade.

Jako neophodno za sam postupak zakona, jeste da bude prilagodljiv, da bude funkcionalan na terenu, da ima na primer na centralnom nivou disciplinu i ima posebno disciplinu kada je budžet u pitanju, kada opštine traže grantove. Ovde je jako dobro opisano kako opštine treba da sačine plan i program razvoja, kako da dođu do grantova i što je obaveza svih opština, da daju kako su budžetska sredstva potrošena od grantova koje su preuzeli i ovde su dati svi rokovi kada je u pitanju analiza centralnog budžeta, analiza lokalnih budžeta, tako da je to jedna celina koju do danas nismo imali, ne znam iz kojih razloga, zakone smo imali, ali celinu nismo imali.

Nešto što hoću da dam do znanja, da ne zamaram mnogo kolege, ali hoću da dam do znanja da je prevod na srpskom jeziku jako loš, da nemaju rečenice smisao, da je jako teško da se neke stvari razumeju, tako da kada treba da dajemo svoj doprinos, mi smo stvarno u jako teškoj situaciji da prvo napravimo logiku o zakonu, terminologiju, da ga sami razumemo, da bi mogli da ga prezentujemo a znamo da svi nismo pravnici, pa je jako teško za poslanike, te apelujem odavde da se stvarno stručni ljudi zapošljavaju kada su u pitanju zakoni i da svaka radna grupa ima lektora kako bi imali bolji pristup zakonima.

Mi ćemo kao grupa da podržimo ovaj zakon zato što je preko potreban kosovskoj strukturi zakona, ali ćemo da damo i svoj doprinos kao grupa. Toliko od nas, hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Kalojmë te deputetët sipas radhës, duke i lutur që t'i shkyçin telefonat para se ta marrin fjalën, se dëgjohet dhe maltretohen deputetët. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni, përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Kolegë deputetë,

Natyrisht që si deputet e mbështes qëndrimin e grupit parlamentar dhe do ta votojmë projektligjin, në parim, mirëpo do të mundohem të mos i përsëris ato çka i thanë kolegët, mirëpo megjithatë duhet bërë disa intervenime, sepse nëse shkon kështu, unë konsideroj që janë dhe mbeten shumë çështje të paqarta.

Së pari, është një plotësim-ndryshim i projektligjit dhe nuk ka nevojë të ketë përkufizime. Nëse duhet të ketë përkufizime, atëherë duhet të qartësohen përkufizimet, sepse nëse duhet prapë, nëse kemi thënë të thirremi në Ligjin e shërbimit civil, çka është shërbimi civil, atëherë nuk po i ndihmojmë lexuesit, por po e obligojmë të shkojë e ta lexojë Ligjin e shërbimit civil, edhe pse këto janë të njohura, edhe obligimet, edhe nocioni i shërbimit civil dhe këto. Do të kisha dashur që komisioni funksional mos t'i fshijë, sepse vetëm po e ngarkojnë.

Çështje tjetër me interes është, gjithashtu kemi thënë në nenin 5.1, në kuadër të Ministrisë do të themelohet Departamenti i Buxhetit. Ekziston ai edhe nuk e di si... Mandej, keni paraparë edhe kush do ta udhëheq departamentin – drejtori i përgjithshëm. Konsideroj që është e panevojshme, nuk po flasim për strukturën organizative, po flasim për një plotësim-ndryshim të projektligjit.

Në neni 14.4, paragrafi 14.7, bisedoj edhe e nderuara deputet Besa, mirëpo nuk e tha ndoshta krejt qëllimin. Natyrisht, shkarkimi duhet të ndodhë dhe përgjegjësitë vijnë vetvetiu sipas procedurave, por mua po më intereson – zyrtar kryesor i administratës, nuk është në asnjë ligj, ose sekretari i përhershëm ose organi përgjegjës, por zyrtar kryesor i administratës mundeni ta kuptoni edhe drejtorin e administratës që është dhe ai nuk ka kompetenca ta shkarkojë zyrtarin certifikues. Prandaj, do të ishte mirë për t'u thirrur komplet në zyrtarin i cili e ka autoritetin të shkarkojë. Nëse e kanë menduar te sekretari i përhershëm, si organ më i lartë i shërbimit civil, është krejt në rregull. Nëse e kanë menduar te drejtori i departamentit përkatës, edhe kjo është në rregull, mirëpo atëherë nuk bisedohet për shkarkim, por bisedohet për suspendim të përkohshëm, sepse Ligji i shërbimit civil e ka procedurën që suspendohet, mandej komisioni disiplinor e shkarkon në rast se konstatohet që janë bërë shkelje të detyrave. Kjo duhet gjithsesi të ndërrohet, sepse bie në ndeshje me ligjet aktuale që i kemi në fuqi.

Çështje tjetër. Po obligohet ministri të nxjerrë qarkore. Po më duket, në të gjitha projektligjet po gabojnë. Duhet të obligohet Ministria. Ministri është autoriteti i fundit që e nënshkruan, qoftë udhëzimin, qoftë ato qarkoret, qoftë ato urdhëresa që nxirren, mirëpo nuk obligohet ministri, tash ministri do të nxjerr qarkoren. Absolutisht jo. Këto qarkore bëhen prej grupeve punese, hartohen, qohen në zyrën e ministrit, mandej ministri është autoriteti përfundimtar që e shtinë në fuqi, por mos..., nuk po del mirë kështu qysh e keni shkruar.

Është shumë me interes, zoti ministër, edhe pse tashmë ju nuk do të jeni, por çështja e procedimit të projektligjeve të reja. Keni kërkuar çdo nismë të vijë te ju. Edhe tash është ashtu, por jo ju të jepni opinion. Konsideroj se nuk ka mundësi, asnjë institucion tjetër, ju duhet të jepni version, deklaratë përfundimtare për implikimet buxhetore, jo vetëm opinion, sepse ne do të biem në dilema, zoti ministër, nëse ju dilni në opinion, edhe ne që kemi filluar një nismë ligjore me opinion, shtrohet çështja çka do të vendos Kuvendi. Unë konsideroj që Ministria për Ekonomi dhe Financa duhet të nxjerrë deklaratën përfundimtare për implikimet buxhetore. Ne në fillim mund të japim një opinion për ndikimet buxhetore, por ju të nxirrni deklaratë, sepse kështu si e keni shkruar, nuk e di a keni pasur nevojë se janë nja 50 rreshta për një çështje krejt, nuk e di, nuk mund t'i dalim në skaj qysh e keni filluar të jepni opinion mandej Kuvendi prapë ta çojë opinionin në seancë, sponsorizuesit a pajtohen a nuk pajtohen, të mblidhen ato dy komisionet. Unë konsideroj që, shkurt, Ministria për Ekonomi dhe Financa e jep deklaratën përfundimtare për implikimet buxhetore, sepse është ajo përgjegjëse për buxhetin.

Dhe, krejt në fund, këtu duhet ta kemi kujdesin primar. E kemi prezent edhe ministrin e Drejtësisë. Konsideroj që nuk duhet dhe nuk kemi mundësi t'i japim detyra ministrit të Drejtësisë me këtë ligj. Bile i keni dhënë detyrë shumë të rëndë që ministri i Drejtësisë është i autorizuar që të raportojë pranë organit kompetent disiplinor. Nuk e di qysh e keni menduar, mirëpo është mirë edhe ju, kur t'i procedojmë ligjet, nëse na shkon kështu, ka për të qenë edhe qesharake - para cilit autoritet, cilit komision disiplinor ministri ka për të dhënë përgjegjësi. Ministri, nëse duhet të japë përgjegjësi, e ka atë vijën, e ka Kuvendin, por nëse duhet dhënë përgjegjësi për çështje tjera, ndoshta duhet të japë para kryeministrit, para Qeverisë, por jo para ndonjë komisionit disiplinor, qysh e keni shkruar. Por, nuk është ndoshta esenca krejt këtu. Kjo duhet të ndryshohet gjithsesi, por esenca është edhe që e keni autorizuar Ministrinë e Drejtësisë për t'i mbrojtur në aspektin juridik. Nuk e ka krejt mundësinë për çështje ekonomike Ministria e Drejtësisë të jetë mbrojtëse. Unë e di që jeni thirr tash me çështjet e mbrojtjes së ligjshmërisë, që bëhet për shërbimin civil, ku e keni autorizuar përfaqësuesin ligjor të Ministrisë së Drejtësisë të jetë në gjykimet që bëhen për pagat, për shkëputje të kontratës. Për këto duhet të kemi një diferencë dhe këtu duhet Komisioni për Buxhet, në bashkëpunim me ju mos t'ia japë këtë barrë Ministrisë së Drejtësisë, sepse do ta qitni para një akti plotësisht të kryer që një zyrtar ligjor nuk ka për të ditur as të mbrojë, as të japë qëndrime, se janë terme ekonomike, janë probleme ekonomike, janë probleme të tatimeve, prandaj është mirë që këtë çështje ta kapë në aspektin ekonomik ndonjë organ përgjegjës, të autorizohet, por asnjëherë zyrtarët ligjorë, sepse nuk do të mund të ju ndihmojnë, përveç kësaj ankese. Këto i bëra me qëllim që të mos na jepni mundësinë që ne duhet të

intervenojmë për t'i eliminuar, por Komisioni për Buxhet dhe Financa ta rregullojë, sepse e qartëson dhe e bën të qartë projektligjin.

Edhe një herë, natyrisht që do ta votojmë, mirëpo gjithsesi t'i përmirësojmë disa nga konstatimet që u dhanë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Nekibe Kelmendi e ka fjalën, të përgatitet deputeti Danush Ademi.

NEKIBE KELMENDI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra,

Unë kam një koment të përgjithshëm. Në tërë tekstin e Ligjit përdoret termi autoritet. Autoritet ka shumë kuptime, është autoriteti i njërit, është autoriteti i organit, autoriteti i atij e këtij, kështu që në tërë tekstin të jepet termi adekuat, organi ky, ai, ai, ai e tjera, e mos të përdoret autoriteti.

Koment i veçantë. Neni 24 i këtij projektligji duhet të ndryshohet asi soji që me të parashihet që neni 67 i Ligjit mbi menaxhimin e parasë publike të fshihet krejt, sepse Ministria e Drejtësisë nuk ka kapacitet t'i përfaqësojë të gjitha ministritë e linjave, madje me kërkesë të komunave – edhe komunat në konteste të ndryshme dhe në procedura të ndryshme gjyqësore. Me rastin kur është tentuar të bëhet reforma e administratës publike e tjera, është paraparë që e ka rekomanduar edhe Human Dynamic, që Ministria e Drejtësisë mos t'i përfaqësojë ministritë e linjave, por përfaqësimi t'u transferohet atyre ministrive, sepse të gjitha ministritë e linjave i kanë shërbimet e veta ligjore, i kanë zyrtarët ligjorë dhe mund ta përfaqëson vetveten. Të mbetet që Ministria e Drejtësisë ta përfaqësojë vetëm Qeverinë si subjekt para organeve të ndryshme, qoftë edhe para arbitrazhit, e jo edhe ministritë e linjave. Kur e them këtë, kam një arsye shumë të fuqishme, sepse nuk ka bashkëpunim midis ministrive të linjave dhe Ministrisë së Drejtësisë sa i përket përfaqësimeve gjyqësore, një, nuk dërgohen me kohë provat të cilat gjykata i kërkon dhe Ministrisë së Drejtësisë i mbetet fajti nëse humbet një kontest. Humbet kontesti, sepse nuk i ke dhënë fakte dhe prova Gjykatës dhe, nga ana tjetër, janë konteste që janë milionëshe dhe Ministria e Drejtësisë nuk ka kapacitet profesional që t'i përfaqësojë të gjitha ministritë e linjave. Sa për komuna, secila komunë e ka gjithashtu ose avokatin e popullit ose e ka juristin, të cilin e autorizon kryetari i komunës që të përfaqësojë nëpër gjykata.

Prandaj, neni 24 duhet të mbetet vetëm që Ministria e Drejtësisë ta përfaqësojë Qeverinë, por jo edhe ministritë e linjave. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I fundit, deputeti Zef Morina e ka fjalën!

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për menaxhimin e financave është i mirëseardhur pasi mendoj që ky, nga të gjitha ligjet, duhet t'i përshtatet kohës dhe kritereve në ndryshime dhe amendamente.

Projektligji përmban disa ndryshime dhe plotësime të ligjit ekzistues, të cilat e obligojnë Qeverinë për të qëndruar në kuadër të kufijve të cilët i përcakton Fondi Monetar sa i përket buxhetit dhe menaxhimit të tij. Gjithashtu, i eliminon disa mangësi të cilat kanë qenë gjer më tani në ligjin aktual.

Në këtë projektligj janë përforcuar, domethënë, transparenca, efikasiteti i menaxhimit të financave në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Ajo që më bëri përshtypje dhe desha ta pyes ministrin, është tek neni 3, pika 5, ku thuhet që në kuadër të Ministrisë së Financave, domethënë të Ekonomisë dhe të Financave, themelohet Departamenti, ndërsa drejtori i përgjithshëm emërohet. Unë mendoj se këtu ndoshta ose është

ndonjë lëshim, ose thjeshtë është ndonjë keqkuptim, sepse emërtimet në vende profesionale dhe në vende menaxheriale nuk bëhen, por zgjedhen. Emërtimet dihet që janë politike, ndërsa zgjedhja dhe përcaktimi i njerëzve në vende menaxheriale, duhet të bëhet sipas konkursit dhe performancave që i kanë personat. Në kuadër të kësaj, desha të bëj pyetjen, përndryshe në përgjithësi ky projektligj është shumë më i avancuar nga ligji aktual dhe unë e mbështes në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në fund, përfaqësuesi i Qeverisë, ministri e ka fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Ju falënderoj të gjithëve!

Pajtohem me shumicën prej jush se ky ligj, në fakt, do të duhej të vinte me një ridraftim të tërësishëm dhe pajtohem edhe me Hakiun, besoj që nuk do të ma zë këtë për replikë, ta shfrytëzoj rastin. Qëllimi i këtyre ndryshimeve, të cilat janë një dy a tri thelbësore dhe kryesisht janë teknike dhe draftime ndoshta terminologjike, për të cilat ju falënderoj për këshillat dhe vërejtjet, është thjeshtë qëllimi që me Fondin Monetar, janë kërkesat e Fondit Monetar Ndërkombëtar për të hyrë në program dhe kërkojnë dy gjëra që janë esenciale: që rishikimi i buxhetit, faktikisht ky ligj ndryshon nga i kaluari, që çdo rishikim i buxhetit, mund të ndodhë, por nuk mund të ketë ndryshime në qoftë se nuk ka shkurtime ose nuk ka të hyra të reja, në mënyrë që shteti dhe vendi ynë të ketë një qëndrueshmëri fiskale, dhe kjo është esenca. Dhe, dy, kemi bërë disa propozim – ndryshime për formën e shkallës së elaborimit të Kornizës afatmesme të shpenzimeve në prill, karshi tetorit. Ka kërkesa nga stafi që Korniza afatmesme e shpenzimeve të mos elaborohet deri në detale, në mënyrë sektoriale në prill, sepse është, siç dihet në ligjin duhet ta sjellim deri më 30 prill, por të jenë makro indikatorët kryesor në prill, ndërsa pjesët sektoriale tabelare në detale, çdo program të jetë në fund, kur dorëzohet buxheti për vitin vijues.

Ka ende dilema rreth asaj, do të diskutojmë nëpër grupet parlamentare, në komisionet parlamentare për këtë çështje. Sa i përket çështjes së drejtësisë, vërtetë është një dilemë, a t'i jepet kompetencë e veçantë Minsitrisë së Drejtësisë, apo ministrive të linjës.

Pajtohem në qoftë se duhet të ndryshohet ligji, pajtohem që theksi të vendoset që Ministria e Drejtësisë kryesisht të përqendrohet në mbrojtjen apo në prezantimin e vetëm të institucioneve të Qeverisë, përkatësisht të agjencioneve dhe të ministrive, ndërsa sa i përket institucioneve tjera, sidomos ato të pavarura, pajtohem plotësisht që duhet të rirregullohet drafti. Ka praktika të ndryshme kur Ministria e Drejtësisë, në kuadër të stafit të vet ka ekspertë komercial, ekspertë të drejtësisë mjekësore e tjera, nuk di a është më mirë të zgjidhet në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë apo nëpër ministrinë e linjës. Neve konsiderojmë që në këtë fazë kalimtare do të ishte mirë që Ministria e Drejtësisë të jetë adresa kryesore, pastaj koordinimi përbrenda Ministrisë ose ministrive të linjës ose institucioneve tjera të jetë më mirë e organizuar. Ky është tash për tash propozimi ynë. Unë besoj që gjatë komisionit do t'i zbërthejmë të gjitha, por çka është me rëndësi, neve duhet ta përmbylлим këtë proces sa më shpejt që është e mundur, në mënyrë që javën e ardhshme ta përmbylлим edhe si lexim të dytë dhe që të jemi të përgatitur për të gjitha këto veprime, paraveprime, të jemi të gatshëm që 5 ditë para mbledhjes së Bordit të Fondit Monetar që pritet të jetë javën e tretë të korrikut, t'i përmbylлим të gjitha këto 5 ligje, të cilat janë kryesisht amendamente, ndërsa zotohem se do ta sjellë sa më shpejt që është e mundur si një draft të ri të këtij Ligji të financave publike, që është domosdoshmëri e kohës dhe në harmonizim me trendet e reja në sferën e financave publike. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë në parim plotësim – ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Në sallë janë 65 deputetë. Përgatitemi për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 8 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për plotësimin e dhe ndryshimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, dhe komisionet e përhershme, të cilat duhet që në afatin më të shpejtë të mundshëm, Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Dhe tani, pasi që nuk kemi pasur fare pauzë, i kemi edhe tri pika të rendit të ditës, pauzë për drekë deri në orën 14.00.

Lus deputet që me kohë të vijnë më sallë. Ju faleminderit!

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës të seancës së sotme:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë

Konstatime hyrëse:

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin. Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë të pranishëm,

Kam kënaqësinë që sot para jush ta paraqes Projektligjin për ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Republikën e Kosovës. Duke marrë parasysh prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zhvillim ekonomik të vendit, dinamikën e lartë të investimeve publike, fillimin e realizimit të projekteve madhore, si dhe aranzhmanin me Fondin Monetar Ndërkombëtar, është proces i natyrshëm dhe i kuptueshëm se është paraqitur nevoja për fonde shtesë buxhetore, të cilat do t’i japin efektet e veta pozitive në zhvillimin ekonomik të vendit.

Këto investime publike shtesë, si dhe politikat e nevojshme sociale kërkojnë patjetër rritjen e buxhetit në vitet e ardhshme. Ministria e Ekonomisë dhe e Financave ka analizuar dhe shqyrtuar për një kohë të gjatë dhe me kujdes maksimal skenarët e ndryshëm të rishqyrtimit të tatimit të normës së akcizës. Kemi bashkëpunuar dhe bashkëbiseduar aktivisht edhe me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit, si dhe me grupet tjera të interesit për të paraparë efektet e këtyre masave. Mund të them se gjatë këtyre diskutimeve dhe analizave është arritur një shkallë e lartë e mirëkuptimit të situatës dhe të qëllimeve të Qeverisë për të rritur të hyrat buxhetore, sidomos duke ndikuar në rishqyrtimin e normave të akcizës.

Njëra nga synimet e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe e Qeverisë së Republikës së Kosovës në aspektin e politikave fiskale është edhe intenca për harmonizimin me legjislacionin fiskal të vendeve të regjionit dhe të atyre të Bashkimit Evropian, në njërën anë, si dhe, natyrisht, me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar për stabilitet fiskal të Republikës së Kosovës.

Meqenëse normat tatimore në Kosovë janë më të ulëta sesa në vendet e regjionit, atëherë propozimi për ngritjen e disa normave, në veçanti në mallrat me akcizë, vlerësohet të jetë alternativa më e mirë sesa hyrja në borxhe publike apo rritja e TVSH-së. Kosova tashmë është në procesin e fillimit të marrjes, faktikisht, ose në

procesin e shqyrtimit të pashmangshëm të marrjeve edhe të kredive ndërkombëtare. Andaj, si e tillë, kërkohen masa tjera që konsideroj se do të ishin më të lehta për qytetarët e Kosovës sesa hyrja në borxhe.

Sidoqoftë, për t'iu shmangur, siç e thashë, një vlerë të lartë eventuale të pjesëmarrjes në borxhe, në krahasim me bruto produktin vendor, që do të duhej të kishte parasysh edhe përdorimin adekuat të instrumenteve të politikave fiskale, ne konsiderojmë që ndërrimi i politikave në mallrat me akcizë është më adekuate sesa çfarëdo politike tjetër. Duke pasur parasysh këto që u thanë më lartë, si dhe trendet aktuale ekonomike në vend, e sidomos prioritetet strategjike dhe rrethanat tjera, ne vendosëm që t'i qasemi hartimit të projektligjit, të cilin sot jemi duke e shqyrtuar bashkërisht.

Me këtë projektligj propozohet ngritja e akcizës në duhan, alkool, naftë dhe benzinë, ndërsa propozohet heqja e akcizës në kafe dhe vendosja e akcizës në gazin propan – butan. Kemi shqyrtuar dhe besoj që gjatë komisionit, mbase mund të harmonizohemi, edhe disa alternativa tjera për ndryshimin e akcizës në importimin e makinave, por për hir të konsultimeve të mëtejme, konsiderojmë që në qoftë se në komisionin parlamentar dakordohemi, ne në Qeveri do ta mbështesim cilëndo nga alternativat që do ishte e pranueshme për të gjitha palët.

Sa i përket gazit propan – butan, dëshiroj të jetë e qartë se kjo nuk do të vendoset për bizneset, të cilat këtë produkt e shfrytëzojnë si lëndë të parë në procesin e prodhimit, por vetëm për nevojat tjera të këtij produkti. Në këtë projektligj ndryshon kryesisht Shtojca A, pra nuk janë sjellë vetëm amendamentet e caktuara, Shtojca A e ligjit në fuqi. Më lejoni që shkurtimisht t'i përmendi ndryshimet detale.

Ngritja e akcizës së naftës dhe benzinës për secilën, pra edhe për naftën, edhe për benzinën nga 5 centë për litër. Kjo ngritje mund të shkaktojë një ngritje të vogël të çmimeve të produkteve, por arsyeshmëria e kësaj mase qëndron në faktet që i përmenda më lartë, situatën momentale, si dhe synimet tona për orientimin e zhvillimeve të reja, që patjetër do të rezultojnë me rritjen e sigurt të të hyrave buxhetore. Gjithashtu, kjo normë e re e propozuar, është shumë e përafërt me normat e akcizës në vendet fqinje.

Rritja e akcizës në duhan nga 21 euro për kilogram në 25 euro, propozimi për ngritjen e akcizës në duhan është bërë duke analizuar ngarkesat tatimore të vendeve të regjionit dhe të atyre të Bashkimit Evropian. Nga këto analiza kemi konstatuar se vendet e regjionit kanë ngarkesa fiskale më të larta se Kosova, përveç Shqipërisë, por duke pasur parasysh që Shqipëria ka edhe TVSH tjetër, konsideroj prapë Kosova mbetet më e ulët sesa regjioni, andaj ka hapësirë të mjaftueshme për një ngritje të vogël të akcizës, pa rrezikuar nga ky produkt të hyjë kontrabandë dhe të shkaktojë evazion fiskal, si dhe zvogëlim të kërkesës për këtë produkt.

Rritja e akcizës së alkoolit nga 300 euro për hektolitër, të alkoolit absolut, në 500 euro për hektolitër të alkoolit absolut. Dihet që vendet e regjionit në përgjithësi kanë akcizë më të lartë në këto produkte, andaj konsiderojmë që Kosova mundet pa rrezikuar ndonjë element, të qesë, të vendos këtë ngritje.

Ministria e Ekonomisë dhe Financa, në kuadër të ndërmarrjes së masave lehtësuese për prodhuesit e vendit, ka hequr masat e mbikëqyrjes doganore për mazutin, i cili përdoret në procesin e prodhimit, kështu që tash e tutje bizneset mund të importojnë pa kurrfarë barriere administrative doganore. Përveç arritjes së normave të akcizës për produktet që i përmenda më lart, me këtë projektligj bëhet gjithashtu edhe heqja e akcizës në kafe dhe vendosja e akcizës për gazin propan – butan, i cili nuk ka pasur akcizë, siç e thashë, deri me tani. Megjithatë, me këtë projektligj akciza nuk i vendoset gazit propan-butan, për të cilin e theksova më lartë dhe konsideroj që kjo, si politikë, ka qenë me kujdes e trajtuar.

Llogarisim dhe presim që nga të gjitha këto ndryshime të propozuara të kemi të hyra shtesë prej 21 milionë euro për gjysmë vjetorin e dytë të vitit 2010 dhe rreth 42 milionë euro për vitin 2011.

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Deputetë të nderuar,

Edhe një herë po e ritheksoj se me miratimin e këtij projektligji nga ana e juaj, do të arrihen disa efekte që u përmenden deri më tani, por po ashtu nuk bën të harrohet as aspekti shëndetësor, sepse me këtë do të mbrohet mënyra më efikase e shëndetit të qytetarëve, duke siguruar në të njëjtën kohë mjete shtesë të domosdoshme për përmbushjen e disa aspekteve qoftë në shëndetësi, qoftë në trajtimin e problemeve sociale, ligje të cilat sot i përmenda më herët.

Duke pasur parasysh këto dhe zbërthimet tjera që janë në ligj, unë ju lus që ta mbështetni këtë projektligj dhe ta aprovojme në periudhën sa më të shkurtër të mundshme, si paketë të masave të cilat i ka marrë Qeveria e Republikës së Kosovës për t'u harmonizuar me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Hapi debatin për diskutim, në parim. Në emër të komisionit funksional, ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Gani Koci, ta marrë fjalën.

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ndryshmet në këtë ligj kanë qenë të nevojshme që të plotësohet politika fiskale dhe t'i përafrohet asaj të regjioneve dhe të Bashkimit Evropian dhe në emër të komisionit konsiderojmë se ky ligj i plotëson të gjitha kushtet që të procedohet dhe të miratohet. Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar propozoj që ky ligj të miratohet. Një vërejtje që është më tepër një vërejtje parime, në ligj shkruhet se ky ligj hyn në fuqi më 1 korrik të vitit 2010, ligjet janë shumë të rralla ato që do të duhej të kenë veprim retroaktiv. Ne sot më 1 korrik po e shqyrtojmë për herë të parë, do të thotë në lexim të parë dhe ka një procedurë deri në leximin e dytë dhe në shpalljen në "Gazetën zyrtare", prandaj kjo çështje të mbetet të rregullohet pastaj në komision. Këtë po e them edhe për vet faktin se kur e kemi miratuar Ligjin për TVSH, kemi pas caktuar në datë, 1 janar 2010, dhe pikërisht për shkak të vonesave të miratimit të atij ligji, ka qenë e pamundshme zbatimi i ligjit më 1 janar dhe është dashur të ndryshohet dhe të fillohet më 1 korrik, prandaj kjo është ajo vërejtje, të cilën ne si Komision për Buxhet dhe Financa, po edhe si grup parlamentar do ta përmirësojmë dhe do ta ndryshojmë dhe të përshtatemi me procedurat e miratimit dhe të hyrjes në fuqi të ligjeve.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Në emër të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, e ka kërkuar fjalën kryetari i komisionit, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Me qëllim që ta ndihmojmë edhe komisionin funksional, është që në fillim mendoj, zoti ministër, është fjala për plotësim dhe ndryshim të projektligjit, prandaj është bërë lëshim dhe nëse shkohet në këtë aspekt, atëherë del që sot po aprovojme ligj të ri dhe duhet ndoshta menjëherë të flasim për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit në fjalë, bile edhe numrin ta vendosim. Dhe, është një çështje tjetër, ndoshta që duhet ta kemi një vëmendje të veçantë rreth nenit 2 dhe nenit 3. Neni 2, në të vërtetë, paragrafi i parë dhe i dytë. Paragrafi i parë është krejt në rregull, domethënë kuptohet gazet e naftës lirohen nga kjo akcizë, nuk është me rëndësi, mirëpo paragrafi 2, thotë: "Lirimet nga tatimi i akcizës sipas paragrafit të parë të këtij neni, duhet të aprovohen paraprakisht nga doganat". Nuk do të kishte kështu kuptim. Nëse paragrafi i parë kërkon që me nen përkatës të lirohet, atëherë nuk duhet asnjë shkresë tjetër nga asnjë institucion, sepse nuk e fiton dot fuqinë më të madhe se vet ligji për të cilin është. Këto dy vërejtje i kam, si komision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kalojmë te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, ishte deputeti Gani Koci. Për Grupin Parlamentar të LDK-së, ftoj deputetin Armend Zemaj ta marrë fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, zoti kryesues!

Të nderuar ministra, zëvendëskryeministër,
Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, dhe mendojmë që ndryshimi i normave tatimore duhet të bëhet me shumë kujdes. Kjo vlen për faktin që instrument i vetëm, në kuadër të politikave ekonomike, për ne në Kosovë janë politikat fiskale. Ne tani kemi bërë një vit e gjysmë kur reforma tatimore filloi së implementuari. Kjo reformë, siç e dimë, bëri reduktim të normës së tatimit në fitim të korporatave, si dhe normën e tatimit në të ardhurat personale, në mënyrë shumë sinjifikante. Ky reduktim është mirëpritur mjaft mirë për të gjitha bizneset dhe nga të gjithë qytetarët në Republikën e Kosovës. Edhe përkundër këtyre reduktimeve në normat tatimore, efektet në nivelin e të hyrave janë ndier po aq, apo jo shumë për faktin që plani i të hyrave është realizuar në nivelin e projektuar dhe kjo duhet konsideruar një sukses i konsiderueshëm.

Propozimi që kemi sot në rend dite për ngritjen e normës së akcizës për disa produkte, duhet të jetë në harmoni me synimet tona për krijim të një ambienti të favorshëm për investime përmes politikave tatimore me normat e ulëta të tatimeve dhe bazë të gjerë të aplikimit. Unë këtu do të përmendsha veçanërisht akcizën në naftë dhe në derivate të naftës, të cilat ndikojnë direkt në rritjen e kostos së prodhimit, koston e transportit dhe si rezultat – edhe shtrenjtimin e një numri shumë të madh të produkteve në treg që ndërlidhen me to.

Kjo ngritje e çmimeve duhet të shikohet me kujdes se a do të jetë në favor të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe sigurisht që i konvenon, në anën tjetër, edhe hyrjeve buxhetore apo mbledhjes së tatimeve. Në të njëjtën kohë, është mjaft evidente që ngritja e nivelit të të hyrave për buxhetin e Kosovës është më se e nevojshme për faktin që shumë projekte të rëndësishme kanë filluar të realizohen, për të cilat kërkohen edhe fonde shtesë. Gjithashtu, edhe marrëveshja e lexuar me FNM-në, tash së fundi ka pasur si rrjedhojë dy efekte. Së pari, do të jemi në gjendje të marrim mjetet e premtuara nga donatorët në vlera 210 milionë euro, si dhe mbështetjen e FMN-së, në vlerë prej 106 milionëve. Këto fonde do të kontribuojnë në ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale gjatë tri viteve të ardhshme.

Nevojat për fondet shtesë duket të jetë edhe më e madhe me qëllim të sigurimit të financimit të mjaftueshëm për projektet tona dhe kjo ngritje e të hyrave buxhetore në këtë moment do të mund të bëhej vetëm përmes normës të TVSH-së, apo ngritjes së normave të tatimeve tjera. Prandaj, ngritja e normës të TVSH-së do të kishte për efekt ngritjen e të gjitha çmimeve në vendin tonë dhe do të konsiderohej një vendim jo i mirë. Për këtë arsye, Grupi Parlamentar i LDK-së, duke analizuar gjendjen aktuale, si dhe nevojën imediate për ngritjen e të hyrave buxhetore, do ta përkrahim propozimin dhe e përkrahim këtë ligj për ngritjen e normës së akcizës për disa produkte, duke shpresuar që implementimi i këtyre ndryshimeve do të bëhet në formën më të mirë nga institucionet relevante.

Ne besojmë që Ministria për Ekonomi dhe Financa i ka kryer të gjitha analizat, në mënyrë që normat e reja të propozuara të mos jenë më të larta se sa të vendeve në regjion, sepse në të kundërtën do të mund të na sillte kofra efekte në nivelin e të hyrave.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah këtë Projektligj, në parim, dhe me përkushtim të veçantë anëtarët tanë në komisionin funksional do ta japin kontributin maksimal. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar atë AAK-së, deputeti Haki Shatri, e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar deputetë,

Në fakt, Ligji për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës i ka dy elemente esenciale në formën, siç na është ofruar neve. E para, ndryshimi i normës së akcizës për disa artikuj, që kryesisht përmbledhen në tre, dhe e dyta, që është shumë interesant, por është më interesant se si asnjë nga parafolësit nuk e identifikon

si problem, i cili shkel rregullat e nxjerrjes së vendimeve në lëmin e financave publike. Neni 3, i cili i jep të drejtë Qeverisë kurdo që do për të ndërruar edhe normën e akcizës, edhe listën e artikujve në tabelën Ahtojcë A, që do të thotë prej tash e tutje Qeveria, nëse aprovohet ky ligj, nuk ka nevojë fare ta pyet Kuvendin as për normë të akcizës, as për futjen, heqjen ose shtimin e ndonjë artikulli në tabelën e Shtojcës A. Unë mendoj që Qeveria ka bërë një veprim racional, se edhe ashtu askush nuk po e pyet Kuvendin, pse të humb kohë të bie vendime në Kuvend, t'i humbë dy javë, kështu vet vendosin, por kjo është shkelje drastike e rregullave në lëmin e politikave fiskale.

Më tutje, tre artikuj të cilët ndryshohen, kryesisht me nuancat e tyre, dy prej tyre drejtpërdrejt ndikojnë në standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës. Edhe pse duhani konsiderohet artikull luksi, për ata që e pinë është artikull i domosdoshëm i jetës dhe shtrenjtimi i tij ka njëfarë impakti, sidomos te shtresat e varfra. Po ashtu, shtrenjtimi i naftës dhe i derivateve të naftës për 5 cent litri, ka efekte zinxhir, përpos shtrenjtimit të derivateve, të karburanteve, edhe në artikujt tjerë dhe në veprimtaritë tjera, sepse ndikon edhe në shtrenjtimin e punës në bujqësi, në jetën familjare e tjera. Këto janë rezervat tona.

Për sa i përket alkoolit, mendoj që alkooli mund të konsiderohet dhe konsiderohet artikull luksi. Ne nuk kemi ndonjë qëndrim të posaçëm kundër, përveç asaj që duhet të shikohet rritja e normës së akcizës për verën e cila prodhohet në vend. Kjo e ka njëfarë ndikimi te prodhuesit vendor të verës. Prandaj, edhe këtu kemi njëfarë rezeve. Më tutje, që të jemi në korrent të ngjarjes, domethënë, përveç problemit me nenin 3, të dy pasuesit nenit 3, ne mendojmë që rritja e këtyre normave nuk bëhet për arsye tjera, përveç për të shtuar të hyrat buxhetore të cilat po dështohet të inkasohen në rrugë të rregullt përmes eliminimit të evazionit fiskal. Fjalën e kam të eliminimit të evazionit fiskal edhe nga qarkullimi i mallrave të paligjshme në kufi, por edhe të eliminimi i ekonomisë së hirtë, si quhet ose jo formale, dhe në mungesë të kësaj, Qeveria tash synon që të gjejë një burim shtesë të të hyrave, me qëllim që ta plotësojë kërkesën e Fondit Monetar Ndërkombëtar për një qëndrueshmëri buxhetore më të sigurt. Mendojmë se do të ishte më mirë që mos të ndërhyhet me kuadro në Administratën Tatimore, me kuadro të përgatitura dhjetë vite për të kryer punë, po ashtu edhe në Shërbimin Doganor, sepse vetë ndërhyrja ka ndikuar që në vitin e fundit, sidomos në 6 muajt e parë të këtij viti të kemi një rënie në dinamikën e të hyrave edhe në vend, edhe në kufi. Por, kjo ndërhyrje ka sjellë rezultate negative dhe tash ato rezultate kërkohet të plotësohen me rritjen e normës së akcizës. Për ne, politikisht, për naftën dhe derivatet e saj dhe për duhanin mendojmë se është e pa pranueshme, sepse ndikon direkt në standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, neni 3 është absolutisht i pa pranueshëm dhe në qoftë se Kuvendi e miraton nenin 3, unë po ju them se ka bërë një gabim fatal në kundërshtim me të gjitha rregullat që janë në sferën e politikave fiskale. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar i AKR-së, deputeti dhe shefi i Grupit Parlamentar, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ministri më mirë do të ishte të na thoshte që po e harmonizojmë këtë ligj, jo me normat në rajon, por për shkak të nevojës që kanë për ta mbushur buxhetin, për shkak të dështimeve të Qeverisë për t'i realizuar të hyrat e parapara deri tash. Rritja e normës së akcizës, ministër, e vështirëson jetën e qytetarëve sepse, ju e dini, para dhjetë ditësh kur kjo është përmendur se do të rritet akciza, janë shtrenjtuar të gjithë artikujt ushqimorë në vend dhe, natyrisht, kjo e ka varfëruar edhe më tepër jetën e qytetarëve, në veçanti rritja e akcizës për naftën i ngrit çmimet në përgjithësi.

Ajo çka e tha parafolësi, do të ishte shumë më mirë, po ashtu të na thoni, na nevojitet një ligj që Qeveria të bëjë gjithçka çka të dojë dhe jo të na sillni kështu nenin 3, që nënkupton se ju, si Qeveri, sa herë t'ju duhen mjete, mund ta rritni normën e akcizës sa herë të doni dhe, po ashtu, edhe kësaj listës së mallrave që do t'i nënshtrohet normës së akcizës mund ta... Kjo i bie, nëse e përkthejmë në shqip, që ju vet pa Kuvendin, çka të

doni bëni, edhe kur bie shi, edhe kurdo qoftë. Prandaj, për Grupin Parlamentar të AKR-së, është i pa pranueshme ky ndryshim i Ligjit, ky projektligj dhe, si i tillë, nuk mund ta ketë besoj as mbështetjen e shumicës parlamentare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

Lidhja Demokratike e Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë. Paraprakisht dua të them se çdo vend në botë praktikon akcizën, është e vërtetë që Kosova duhet ta harmonizojë ngritjen e kësaj akcize me gjendjen ekonomike në vend dhe duhet të jemi shumë të kujdesshëm, por megjithatë akciza duhet të ndodhë. Prandaj, unë mendoj se komision funksional në këtë aspekt do ta shqyrtojë mirë këtë propozim ndryshim të ligjit.

Nuk mundemi ta tejkalojmë në këtë rast edhe memorandumin shpjegues, të cilin e përgëzoj, zoti ministër, janë edhe anëtarët e grupit punues që e kanë qitur emrin këtu dhe i përgëzoj. Prandaj, kërkoj që çdo memorandum shpjegues të jetë në nivel, siç është për këtë ligj. Çështjen të cilën ne e ngrehim dhe nuk pajtohemi, natyrisht që është neni 3. Në qoftë se është kështu, si thuhet në propozim, Qeveria e Republikës së Kosovës me vendim mund ta ndryshojë normën e tatimit të akcizës në Aneksin A, të bashkëngjitur në këtë ligj, në rast të veçantë tha se Qeveria e Republikës së Kosovës mund të shtojë listën e mallrave në Aneksin A të këtij ligji, që do t'i nënshtrohet normës së tatimit të akcizës, atëherë zoti ministër, ne nuk kishim pasur nevojë hiq ta kemi këtë listë përpara, as ta diskutojmë, as ta votojmë, sepse këtë çështje e kishit kryer ju atje, pa e prurë në Kuvend fare. Andaj, ky nen gjithsesi dhe pa pretendime pozitive – opozitive, duhet të ndryshohet dhe të rregullohet. Natyrisht, edhe vetë listën duhet ta shqyrtojmë pa menduar në aspektin pozitiv – opozitiv, por vërtet kjo taksë të vilet në masë dhe në specifikat e vendit që i kemi ne.

Dua të potencoj, me theks të veçantë, ngritjen e akcizës në karburante. Duhet ta kemi parasysh prodhimin, sidomos në bujqësi, por prodhimin në përgjithësi dhe në transport. Mund të nxjerrim qoftë listë, qoftë nen...me ligj, ku mund të ketë akcizë karburanti dhe kur nuk mund të ketë, sepse drejtpërdrejt e prek prodhimin, e prek bujqësinë sidomos dhe e prek transportin.

Çështje tjetër që duhet ta ngrejë këto ditë, zoti ministër, ne kemi informata se janë bllokuar të gjitha doganat, mallrat nëpër dogana, të cilat mallra janë hyrë në këtë listë dhe kjo është shumë e papranueshme që ju të pretendoni t'i bllokoni atje dhe t'ua vilni akcizën ende pa e aprovuar ligjin. Kërkojmë që urgjentisht të zhbllokohen doganat dhe ligji me procedurë të rregullt të aprovohet dhe pastaj të fillojë të aplikohet kjo akcizë.

Zoti ministër, shuma e cila shkon deri në 41 milion për vitin 2011, dhe për këtë vit 21, nëse nuk gabo, propozojmë, sepse këto janë taksat qytetarëve të Kosovës, që ky fond automatikisht të shkojë për të nxjerrë Ligjin për sigurime shëndetësore dhe mos të kemi më arsyeshmëri ose mos t'i shpërndajmë këto taksa nëpër mallra dhe shërbime, por me këtë taksë që e vjelim nga qytetari i varfër, t'i ofrojmë sigurim shëndetësor këtij qytetari. Andaj, kërkoj nga të gjithë kolegët e mi deputetë, që të na përkrahin në këtë propozim dhe atëherë vjelja e kësaj akcize do ishte e mirëseardhur, sepse do t'i kthehet drejtpërsëdrejti qytetarit duke ia siguruar, pra, duke i siguruar sigurimet shëndetësore.

Këto janë në pika të shkurtra vërejtjet nga Lidhja Demokratike e Dardanisë dhe ne premtojmë se do të japim kontributi tonë në komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ftoj deputetën Mufera Shinik ta marrë fjalën.

MUFERA SHINIK: Teşekkür ederim,

Kosova Tüketim Vergisi Normunun vergiye dahil edilmesine dair Yasa Tasarısının değişikliği ile ilgili önerilerin gerekli olduğu görülmektedir. Ancak bu konularda da verilen teklifler, vatandaşlara yük olarak ortaya çıkmaktadır, çünkü az da olsa fiyatlara zam getirecektir. Tüketim vermisi normunun vergiye dahil edilmesi etkisi minimum olarak görülsede, örneğin petrol, ki burda petrol geçmektedir petrol anlamına mı geliyor boks benzin anlamına mı geliyor, tercümede farklı görülüyor, bu da 2,5 sent kahve, su, gaz örneklerinde görülmektedir. Ki suyun vatandaşların temel ihtiyacı olduğunu düşünerek ve su şebekelerinin yıprandığını ve arındırma tesislerinde de sorun olduğunu gaz önünde bulundurursak, bilhassa şehir merkezlerinde yaşayan vatandaşların içme sulu konusunda ek olarak aile bütçeelerini etkilemektedir. Aynı zamanda özellikle burda vurgulanması gereken bir konu var ki bütün yasalarda olduğu gibi bu fasada da tercüme sorunu görülmektedir. İster Sırpçada ister Arnavutçada sorun var, ayrıyetten bakanlıklara lektor mü girer, hukuki anlamda tercüme mi gelir, bu sorunların yaşanmaması dileklerimle, tüm bunlara dikkat etmemize gerektiğini vurgulamaktayız ve 7+ Parlamenter Grubu olarak bu değişikliklerle birlikte Yasa Tasarısının değişikliklerini kabul ediyoruz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk shoh të lajmëruar. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Imamo pred sobom Zakon o obavezi za akcize, plaćanje akciza na pojedinu vrstu proizvoda. Ovaj zakon je jako potreban ovde na Kosovu. Mi znamo da je sada u toku usklađivanje Zakona sa zemljama Evropske Unije, to jest sa zemljama regije. Sve zemlje u regiji i zemlje Evropske Unije imaju akciznu stopu, to jeste akciznu normu ili da kažemo dodatno oporezivanje pojedinih proizvoda na ime nomenklature gde ovi proizvodi pripadaju.

Vidimo iz tabele da su to proizvodi kao što su proizvodi u oblasti duvana, duvanske industrije, alkoholna pića, nafta, gas i proizvodi od gasa i ovde imamo u akcizi da je kava oslobođena akcize, pržena i ne pržena kafa, pošto je imala veliki pad u 2009. godini, u poređenju sa 2008. godinom, ona je oslobođena od sadašnje akcize i smatra se napitkom koji nije luksuzan. Ovaj zakon mi ćemo kao grupa da podržimo zato što će sa ovim zakonom samo da se smanji krijumčarenje robe u regionu. Za ovaj zakon, Vlada Kosova je obavezna, ne samo Vlada Kosova, nego i svi mi na Kosovu obavezni smo na osnovu dve evropske regulative, koje ja neću ovde da čitam, a član tri, o kome se ovde dosta čulo, koji kaže da Vlada Republike Kosova može da posebnom odlukom izmeni poresku normu akcize iz Aneksa (a), koji je u prilogu ovog zakona i, pod dva, u posebnim slučajevima Vlada Republike Kosova može da dopuni listu roba iz Aneksa A ovog Zakona koja će se podvrgnuti poreskoj normi akcize, trebalo bi da postoji i kao tačka 3, da sve ove promene treba ponovo da dođu pred Skupštinu, ovde pred nama poslanicima, da vidimo znači listu proizvoda i posebne slučajeve gde može biti oslobođanja ili dodatno oporezivanje na ime akciza.

Mi znamo da je sada veliko krijumčarenje robe i naročito se Kosovo proziva zbog tog krijumčaranja robe i moramo da znamo da moramo da opeglamo naše zakone sa zakonom u regiji ako jedan proizvod ima osnovni porez, mora da ima i dodatni porez, a to su akcize.

Jedno što hoću da kažem da se ne slažemo puno sa budžetskom procenom implikacije oko dobiti koja će biti, tako da je mnogo izračunato, za prvu godinu kaže da će biti negde oko 20 miliona, u 2011. godini 40 miliona, 2012 40. i ponovo 2013. 40, što znači 120 miliona u okružnom bilansu do 2013, 120 miliona. Kamo sreće kad bi ova sredstva mogli da inkasiramo, jer znamo u ovom zakonu da je organ za sprovođenje ovog zakona Carinska služba. Ja podržavam, ne ja već i svi mi u grupi ovaj zakon o akcizama i građani će imati malo povećanje na ime cene, ali će budžet i država i isti građani, na ime socijalne i ekonomske šeme, imati dobiti od ovog zakona. Toliko od nas. Hvala.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kalojmë te deputetët sipas radhës, duke i lutur që t'i përmbahen diskutimit në parim për Projektligjin për plotësim dhe ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë. Të lajmëruar janë 7 deputetë. Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demalijaj, përgatitet deputeti Riza Smaka.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari zoti ministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministri i Shëndetësisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Po ashtu, sikurse edhe parafolësit më herët lidhur me Projektligjin për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, që sot e kemi para vetes, e shohim se ka filluar edhe një herë në mesin e këtij viti një diskriminim që edhe të kthehen retroaktiv, por edhe i jep mundësi Qeverisë së Kosovës që të manipulojë sa herë të dojë me qytetarin e Kosovës, në këtë rast, duke e parë fillimisht, prej fillimit e deri sot një mospërkrahje të hapur ndaj bizneseve që funksionojnë në Kosovë.

Ne gjithmonë kemi folur edhe kemi menduar të hartojmë politika për përkrahjen e bizneseve në Kosovë, sot këtë e orientojmë në anën e kundërt, që është një mospërkrahje e hapur, do të thotë një shfrytëzim i biznesit kosovar, duke mos llogaritur se kjo e arrin duplikimin, duke e ditur se kjo u kushton xhepave dhe shpenzimeve të qytetarëve të Kosovës edhe në qoftë se një biznes ka paguar më pak akcizë për një mall që e importon në Kosovë, ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se çmimet hypin menjëherë edhe kjo ndikon te qytetari i Kosovës. Bllokada, që e thanë deputetët më herët, në doganat e Kosovës, është për të të ardhur gjynah, e them në këtë rast, ta dijë publiku më mirë se si bllokohen mallrat edhe në këtë rast fuzionohen dhe mbështeten kontrabanduesit, duke e ditur se në dy pikat doganore nuk kemi doganë hiq. Ajo zhvillohet në thellësi të Kosovës, edhe këtë e them për një mangësi timen personale që e kam, që i kontribuoj keq shëndetit tim, jam konsumues i duhanit, do të thotë që një muaj kontrabanduesit e kanë marrë vesh se do të ketë rritje të akcizës, të normës së akcizës në Kosovë dhe duhani është shtrenjtuar që një muaj. Këta ose duhet të jenë të afërt me Qeverinë e Kosovës, se kanë njerëz në Qeveri, që e dinë para deputetëve të Kosovës se do të ketë rritje të akcizës në Kosovë. Në radhë të parë, ky ligj nuk është në Strategjinë legislative të Kuvendit të Kosovës për këtë vit hiq. Në radhë të dytë, në këtë rast remitancat që janë në zbritje, do të thotë ... nga diaspora çdo vit që bien për shkak të këtyre kushteve të rënda që u ka ofruar Qeveria e Kosovës qytetarëve tanë që vijnë nga diaspora, e ka dënuar qysh në kufi., Do të thotë, paguajnë afër 200 euro me rastin e hyrjes në vendlindjen e vet, çka nuk ndodhë askund në Evropë. Vijnë në Kosovë edhe duke i lutur Policinë e Kosovës që ata të mos dënohen gjatë qarkullimit në komunikacionin rrugor, çka do të thotë që 8 dënime për 3 javë apo një muaj sa janë në Kosovë, që do t'ua shqiptonte Policia e Komunikacionit në Kosovë, nuk e arrijnë atë lartësi sa e paguajnë me rastin e hyrjes.

Mirëpo, edhe me rritjen e normës së akcizës, këtu Qeveria ka planifikuar, e ka bërë këtë strategji, e ka hartuar keq që edhe këto remitanca çka hyjnë, mbesin dhe rritet, bëhet një rritje buxhetore dhe të themi në fund të vitit që na kemi realizuar një rritje të buxhetit të Kosovës, kemi arritur planifikimet tona duke e dënuar në radhë të parë qytetarin e Kosovës.

Hyrja në fuqi, do të thotë, shkruhet në Ligj, e përcaktojnë, është hyrë në fuqi ende pa ardhur, as pa u shpallur në "Gazetën zyrtare", as pa u nënshkruar, do të thotë kanë përcaktuar datën kur për herë të parë shqyrtohet në Kuvendin e Kosovës. Ne nuk jemi kundër politikave që ndodhin në rajon, por ne kemi pasur rastin mbrëmë, ku Qeveria e Shqipërisë, kryeministri shqiptar ka bërë dallime në mes të varfërve dhe të pasurve dhe ndoshta në kundërshtim edhe me vet Fondin Monetar dhe Bankën Botërore e politikat ndërkombëtare në rritjen e pensioneve. Duhet t'i harmonizojmë edhe ne politikat financiare dhe politikat e mundësive që i kemi si qytetarë më të varfër dhe më të papunë në botë, të them, kryesisht. Është diçka e patolerueshme. Unë edhe vetë jam anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ne do ta shqyrtojmë atje. Është një ligj i vogël, ka 5

nene, por me këtë ligj Qeveria është munduar që këtë t'ia drejtojë Qeverisë sikur të jetë një rregullore e Qeverisë, me 5 nene, por me nenin 3, t'i japë atë të drejtë vetes që kjo kurrë mos të shqyrtohet në Kuvendin e Kosovës, por Qeveria të luaj me normën e akcizës sa herë të dojë në kuadër të këtij tatimi. Ju faleminderit shume, po shpresojmë se të gjithë deputetët do t'i kontribuojmë kësaj çështjeje, sepse kemi shumë forma alternative që të mund t'i rregullojmë këto çështje e jo nëpërmes rrugëve të kontrabandimit, se me ligje nuk kontrabandohet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Edhe unë shpresoj se do të mbaheni në temë. Deputeti Riza Smaka e ka fjalën, përgatitet deputeti Rexhep Hoti.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotëri kryesues!

Kolegë të respektuar,

Diskutuesit paraparak theksuan çështje të cilat, natyrisht, nuk do t'i përsëris. Konsideroj se e kishin me vend. Do të isha përqendruar vetëm referuar nenit 3. Ju lutem, e llogarita këtu, 795 vjet më parë, më 1215, në Angli, atëherë nuk ka qenë Britani e Madhe apo Mbretëri e Bashkuar, luftë është bërë që mos të bëhet kjo zgjidhje që është propozuar këtu edhe është miratuar një dokument që është quajtur dhe THE GREAT CHARTER OF THE LIBERTATY apo MAGNA KARTA LIBERTATO, do të thotë nuk është zgjidhje e mirë që ekzekutivi të autorizoj për të caktuar akcizë, se ky është tatim, ju lutem, bile ekstra tatim. Prandaj, kjo dispozitë duhet të riformulohet ose të hiqet fare, se dihet implicite dhe eksplicite se kush e bënë këtë punë, këtë punë e bën ky organ, legjislativi më i lartë në shtet. Këtë pikë, meqenëse veç e dhashë një propozim apo vlerësim kritik sa i përket nenit 5 në dokumentin e mëparshëm, ajo vlen edhe për këtu, se nuk mund të qëndrojë ky formulim, bie fjala, ky ligj hyn në fuqi me këtë datë. Po, këtë formulim ndoshta do të propozoj për projekt amendament. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti, përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Projektligji për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, që ndryshon dhe rregullon normat e tatimit të akcizës për mallrat e paraqitura në Aneksin A, është i hartuar mirë dhe në përputhje me procedurat e kërkuara. I paraqitur nën ndikimin e programit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, projektligji a në fjalë përmbush kriteret e Qeverisë së Republikës së Kosovës, që dalin nga marrëveshja me Fondin Monetar Ndërkombëtar për programin e stabilitetit fiskal dhe mbi bursimin e pagesës së parë të kredisë.

Pritjet nga projektligjet në aspektin e të hyrave për buxhetin e Kosovës janë mjaft pozitive. Për shembull, periudha korrik-dhjetor i vitit 2010, pritet që buxheti i Kosovës të rritet për 19.7 milionë euro. 2011 për 39.6 milion, 2012 për 41.2 milionë, 2013 pritet të jenë 42.8 milionë euro. Kjo do të thotë, të nderuar zonja dhe zotërinj, se Qeveria e sotme garanton shtimin e buxhetit të Kosovës në vijimësi edhe pas zgjedhjeve të vitit 2011, të cilat natyrisht do t'i fitojë në mënyrë të padiskutueshme prapë Partia Demokratike e Kosovës.

E mira tjetër e këtij projektligji është se me hyrjen e tij në fuqi nuk do të ketë shpenzime dhe komplikacione shtesë buxhetore. Siç dihet, nga të dhënat në projektligj, propozimi në ngritjen e akcizave...

KRYESUESI: A bën të kthehesh në temë, deputet? Diskutimi në parim është i ligjit, jo prezantimi, e ka bërë ministri. Diskuto në parim, të lutem!

(Duartrokitje në sallë)

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, shumë, zoti kryesues!

E mira tjetër e këtij projektligji është se me hyrjen e tij në fuqi nuk do të ketë shpenzime dhe komplikacione shtesë buxhetore. Siç shihet nga të dhënat në projektligj, propozimi për ngritjen e akcizës dhe uljen e saj në disa vende janë bërë duke analizuar ngarkesat tatimore të vendit, të rajonit dhe atyre të BE-së. Harmonizimi i tillë është pjesë tjetër pozitive e këtij projektligjit, zoti kryesues, në qoftë se vetëm e kuptoni atë që po e them. Ngritja e akcizës për duhanin, për alkoolin, naftën, gas prom-butanin e tjera, sipas analizave, fillimisht, nuk do ta rrezikonte shtimin e kontrabandës dhe as evazionin fiskal në vend. Kjo është gjithashtu një anë tjetër shumë pozitive, zoti kryesues, në qoftë se veç e kuptoni e nuk më ndërhyini.

Në anën tjetër, edhe ngritjet e lehta të çmimeve për këto produkte nuk pritet të shkaktojnë probleme të mëdha për konsumatorin, bazuar në nivelin aktual të zhvillimit ekonomik dhe të hyrave buxhetore. Madje, për këtë ngritjen e çmimit të duhanit duhet domosdo të kemi një ndikim pozitiv në uljen e nivelit të konsumit të përgjithshëm, e kjo do të thotë, zoti kryesues i Kuvendit, momentalisht që e drejtoni seancën, Kosova do të jetë më e shëndetshme. Duke qenë më e shëndetshme, ajo kursen të hollat e buxhetit në sektorë tjerë, siç është për shembull sektori i shëndetësisë dhe dikasteret tjera të Qeverisë, zoti kryesues i Kuvendit.

(Duartrokitje)

E bukura e Kuvendit është se këtu lejohet të fol gjithkush, edhe atyre që kanë kontrabanduar me votën e qytetarit, por na lejoni që ne t'i japim mendimet tona, sepse Kosovën do ta bëjmë pavarësisht nga dëshirat e tyre. Pikë tjetër, ndërsa ulja e akcizës për kafën, që parimisht bëhet për ta luftuar kontrabandën e këtij produkti, do të mund të kishte sukses vetëm nëse bëhet fuqizimi dhe shtrëngimi i masave sanksionuese ndaj kontrabanduesve, sepse parimisht kompetencë ekskluzive për luftimin e kontrabandës janë organet e rendit publik.

Në fund, marrë në tërësi, ngritja buxhetore prej 143.3 milionë euro, sa pritet të jenë të hyra në tri vitet e ardhshme nga kjo ngarkesë tatimore, siç u tha, është e harmonizuar me vendet tjera të Bashkimit Evropian dhe të rajonit, është një aspekt pozitiv që realisht ngarkon të pasurit, zoti kryesues i Kuvendit, i ndihmon ata që kanë nevojë për ndihmë dhe që kanë nevojë për të pasur më shumë. Ju falënderoj shumë!

KRYESUESI: Po, tash, pasi m'u drejtove disa herë, fare nevojë nuk kam pasur për këto ligjërata tuajat, ju sugjeroj që ta lexoni çka do të thotë diskutimi në parim për një projektligj në lexim të parë dhe jemi krejt në rregull atëherë. Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet deputetja Luljeta Shehu.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se vërtet Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka dhënë dritë të gjelbër, në parim, këtij ndryshimi të ligjit ekzistues apo këtij ligji të ri, unë i shpreh rezervat e mia, duke marrë parasysh se gjendet në shqyrtimin e parë apo në leximin e parë, andaj rezervat e mia shpresoj që merren, mirëkuptohen duke marrë në konsideratë atë se ka mundësi të përmirësimit të ndryshimit dhe të funksionalizimit të këtij ligji nga komisionet funksionale. Vërtet, në qoftë se e kemi vënë vetit objektiv të ndërtojmë një mjedis të përshtatshëm për biznes në Kosovë dhe padyshim të mbajmë edhe një paqe sociale në kuptimin e mbajtjes së mirëqenies së qytetarëve të Kosovës, unë mendoj se ligji në fjalë do të ketë refleksione apo konsekuenca qoftë në aspektin e nivelit të mirëqenies së qytetarëve, qoftë në aspektin e zhvillimit të mjedisit ndërmarrës në Kosovë. Unë do t'i përmend vetëm efektet e këtij ligji në tri dimensione. Padyshim që rritja e akcizave, duke marrë parasysh produktet e lartë cekur, kanë efekte në rritjen e të hyrave buxhetore, kjo nuk ka dilemë, gjë që është edhe qëndrim apo është objektiv i Qeverisë. Mirëpo, konsekuencë tjetër e këtij ligji është edhe mundësia e rritjes së evazionit fiskal. Vetë rritja e akcizës, respektivisht rritja e normave të taksave, qoftë të këtyre fiskale, që mblidhen në dogana, qoftë të këtyre të brendshmeve, lejon mundësinë e kontrabandës, lejon mundësinë e keqpërdorimeve të ndryshme, andaj kjo duhet të shtojë edhe kapacitetet e

Autoritetit Qendror Fiskal, por padyshim edhe kapacitetet e doganave të Kosovës, sepse rritja e akcizave padyshim i inkurajon të gjithë ata që dëshirojnë t'iu ikin qoftë doganave, qoftë formave tjera të taksave apo

tatimeve, i inkurajon t'i ikin tatimit. Dhe, efekti i tretë është në rritjen e kostos edhe të biznesit vendor, por padyshim edhe të kostos së qytetarëve.

Në qoftë se bëjmë një analizë të kësaj politike fiskale tatimore, nuk do të japë efekte pozitive në rritjen apo në motivimin e mjedisit biznesor në Kosovë, duke marrë parasysh se kapacitetet tona të doganave, nga aspekti i ofiçencës nuk janë në atë shkallë të bëjnë diferencim të saktë apo selektim të produkteve cilat janë për konsumim të qytetarëve, cilat janë për tregtim të mëtejshëm dhe cilat janë si gjysmë produkte apo produkte që hyjnë apo ndihmojnë proceset industriale në Kosovë. Duke marrë parasysh se mungojnë këto kapacitete ofiçiente të doganave të Kosovës, unë frikohem se mund të ketë efekte negative.

Dhe, së fundi, dëshiroj të theksoj edhe këtë. Përveç shumës së të hyrave që rriten nga aplikimi i këtij ligji, gjë që e tha ministri, ne nuk kemi parë në analizën që bëri ministri, nuk kemi parë efekte tjera që do të jenë si konsequenca qoftë buxhetore, qoftë jobuxhetore në Kosovë, në qoftë tse zbatohet ky ligj. Mbes me shpresë se komisionet funksionale, padyshim edhe ndonjë këshilltar, eventualisht edhe pjesëmarrja e kompetentëve qeveritarë, të bëjnë një analizë të thuktë, efektet pozitive dhe negative qoftë të biznesit, qoftë të mirëqenies së qytetarëve dhe pastaj vërtet të orientohemi në këtë politikë të taksave apo politikë tatimore, gjë që ndoshta është dimension i vetëm i politikës ekonomike të Kosovës që e kemi në duart tona. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Luljeta Shehu, përgatitet deputeti Driton Tali.

LULJETA SHEHU: Ju faleminderit, kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Në Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, nëse e shohim Aneksin A, në të cilin radhiten mallrat që u nënshtrohen akcizave dhe tarifave përkatëse, hetohet se te përshkrimi i këtyre mallrave janë lëshuar gabime të natyrës gjuhësore, për të cilën unë nuk jam kompetente të flas. Por, ato të natyrës kimike, mund të jap kontributin tim sepse, nëse ndryshon emërtimi, mund të fitohet një komponim tjetër, e jo për atë që bëhet fjalë. Për shembull, “ujërat jo të ajrizuar” por të “gazuar”, “alkooli etilik” ose “metanoli”, e jo “etil-alkool”, jo “tretësit kompozit organik”, por “tretësit e komponimeve organike”, jo “holluesi”, por “tretësit që përdoren te ngjyrat apo llaqet e tjerë”.

Prandaj, të njëjtat vërejtje i kemi edhe te disa nene. Korrigjimet në këtë aneks mendoj se janë të nevojshme, sepse edhe vetë Projektligji për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-112 për tatimin e normës së akcizës është bërë për shkak të ndryshimeve të këtij aneksi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të them të drejtën, unë nuk e kam të qartë se a po flasim për nenet që duhet t'i ndryshojmë të këtij ligji, a po flasim për listat apo po mbajmë ligjëratat në ekonomi këtu, tash varësisht nga disponimi ditor i disa deputetëve, sidomos të atyre që kur ishte për çështjet madhore të strategjisë, që domethënë kishin të bëjnë edhe më shumë se kjo politikë afatmesme apo afatshkurtër që është, heshtnin, tash na e mbajmë ligjëratat të ekonomisë, se çka, si duhet të bëhet. Ajo do të jetë në debate, në fushata elektorale, a pajtohemi a nuk pajtohemi për ngritjen e akcizave. Sidoqoftë, këtë nenin e tretë unë nuk po e shoh edhe ndonjë problem të madh, se edhe ashtu Qeveria e ka atë mundësi edhe me vota, gjithmonë duke pasur parasysh se kjo i mbetet debatit të partive politike në programet e tyre elektorale se çka i ofrojnë elektoratit të vet. Prandaj, edhe nuk është fort problem krahasuar, po them, gjithmonë me atë se çka kanë votuar disa deputetë këtu, që tash të na mbajnë ligjëratat, po them, edhe një herë të ekonomisë.

Problemi tjetër është me listë, por unë mendoj se kjo lista e këtyre produkteve është përsëri çështje e përzgjedhjes së Qeverisë, e cila në fund edhe do të duhej ta jepte përgjegjësinë me efektin pozitiv apo negativ që do ta kishte. Ne tash mund të flasim për këtë listë, unë personalisht, për shembull, nuk pajtohem me këtë akcizë nëse veç po fusim kësi debati. Sa i përket cigareve, unë do t'ua shtoja akcizën edhe më shumë për shkak se ata duhangjitë të cilët po na helmojnë, le të na paguajnë edhe shërimin, pra. Prej asaj akcize le të financohet shëndetësia apo edhe këta konsumuesit e alkoolit, që po bëjnë ndeshje, le të na paguajnë edhe lëndimet trupore, të cilat pastaj po duhet ne t'i paguajmë prej xhepit, me këtë xhepin tonë të fukarallëkut.

Singerisht, edhe një herë, unë edhe nenet në parim i përkrah. Kur duan të bëjnë politikë partitë politike, vjen fushata, atëherë i ofrojmë qasjen tonë qoftë socialiste, qoftë të djathta, qoftë të majtat, qoftë të qendrës, e mos të mbajmë ligjërata këtu për ekonomi, por të flasim për ligjin në fjalë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, përgatitet deputeti Gani Buçinca

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit, zoti kryesues i seancës!

Përshëndetje, zëvendëskryeministër, ministra!

Kolegë deputetë,

Për shkak të impaktit të madh që ka ky projektligj ose draft i ofruar, edhe pse e ka ndoshta vetëm një amendament, një nen, prandaj edhe meriton një shqyrtim pak më përmbajtësor. Në kuadër të kësaj, nga kjo që është ofruar në draft, unë do të kërkoja nga ministri dhe Ministria përkatëse që megjithatë të jenë më të kujdesshëm sa i përket kësaj politike të taksave doganore për vetë faktin që kanë efekt të madh në xhepin e çdo qytetari, pastaj duhet të shihet a është në harmoni apo në interes të asaj strategjie buxhetore, që realisht e stimulon prodhimin vendor apo nuk i jep shans kontrabandës, rritjes, një efekti tjetër negativ që e ka në jetën ekonomike të vendit dhe kur t'i matim këto, duhet të shohim pra realisht kërkesën për ndryshime dhe plotësime.

Në anën tjetër, pse vërejtja ime në parim do të ishte te neni 3, që e përmendën shumë deputetë, mendoj se kjo duhet të kompletohet ose të modifikohet, të bëhet pak më ndryshe nga ana e komisionit funksional, ndoshta të jetë një praktikë pak më e mirë që në kuadër të kompetencës për ndryshimin qoftë të tarifave, qoftë të listës, të mos jetë vetëm Qeveria, por të jetë një organ tjetër i cili do të propozojë, do të shqyrtojë për një transparencë dhe mundësi tjetër që Qeveria në fund ta aprovojë. Mund të jetë Këshilli fiskal, mund të jetë sektori doganor, mund të jetë ndonjë komision i parlamentit, në mënyrë që të kemi një transparencë dhe një përgatitje paraprake për arsyet që biznesi ta dijë se çka po ndodhë nesër në jetën ekonomike të vendit.

E them këtë për një arsye, jo që i jap vetit të drejtë, domethënë, të paragjykoj, por e di nga praktika ose nga e kaluara shpeshherë ka ndodhur që vendimet e Qeverisë, që kanë këtë kompetencë, ndërrohen brenda natës, paralajmërojnë filan biznesin, thonë importoje, po bie fjala ose bëre gati në Kinë filan mallin, një sasi të madhe, se nesër kemi për ta hequr akcizën dhe pas 10 ditëve kthehet, e rikthen akcizën serish dhe e pengon biznesin. Nuk e them, sepse kjo ka ndodhur dhe mund të ndodhë. Prandaj, për t'i ikur, e thashë atë të parën para kësaj, që është mirë pra një organ tjetër që para përgatit qoftë transparencën, debatin, propozimin edhe bashkërisht me Qeverinë ta bëjë edhe listën edhe tarifën. Prandaj, unë dua t'i ngrejë edhe dy raste këtu, të cilat duhet të merren në konsideratë gjatë punës në kuadër të listës dhe të normave, që kemi të bëjmë me veturat, me akcizën, me vjetërsinë, me gjërat tjera të cilat duhet të merren parasysh, pra të gjendet një zgjidhje më e mirë se që është aktualisht, si dhe këtu në këtë listë, unë nuk e kam parë asnjëherë, as në të kaluarën as tash, mundësinë apo lejimin e importimit të vajrave për djegie, një lëndë djegëse e cila ka një rëndësi të madhe, ose një impakt në ekonominë familjare në vend. Ne tani shpeshherë kemi biseduar në Parlament, kemi diskutuar çështjen e shfrytëzimit të pyjeve, pra, si resurse për nevojat të ngrohjes në ekonominë familjare, që bëhet me të madhe në Kosovë, po prandaj mendoj që efekti i saj është shumë i

madh, një, në ruajtjen e kësaj natyre, e dyta, nuk do të kishim atë eksploitim të drurit për këtë nevojë dhe do të kishim ashtu qysh e kanë mundësinë edhe vendet e tjera, që e përdorin vajin për djegie. Pse kjo nuk lejohet të importohet në Kosovë? Tjetër, a duhet të ketë pastaj akcizë, apo nuk duhet të ketë akcizë, është çështje tjetër, por duhet të lejohet, mendoj, sepse është bërë një e padrejtë qytetarit, i cili pra ka mundësi ta përdorë teknologjinë e re në vend që ta përdorë një resurs, siç është druri. Këtë e ka Shqipëria, e ka Maqedonia, ndoshta ata i kanë prodhime të veta, por ne mendojmë që duhet ta lejojmë, pra, në kuadër të këtyre, të kësaj liste edhe këtë lëndë djegëse, me të cilën do të ndihmohen ekonomitë familjare dhe do të ruhet natyra. Pra, unë parimisht mendoj që komisioni funksional duhet t'i marrë parasysh këto, edhe nenin 3, të bëjë një korrigjim i cili do të jep një mundësi propozimi një organi tjetër kompetent dhe Qeveria pastaj ta marr, pra, në plotësim dhe ndryshim e mos të mbetet kështu siç është në këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, përgatitet deputetja Myrvete Pantina

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ju përshëndes, të nderuar ministra dhe ju kolegë deputetë!

Shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin e normës së akcizës në Kosovë, duhet parë nga një këndvështrim pozitiv për ecurinë e zhvillimeve të përgjithshme shoqërore në Kosovë, sidomos të atyre ekonomike. Duhet parë në kontestin e ngritjes së mirëqenies së qytetarëve të Kosovës, që gjithsesi është më e mirë se në të kaluarën dhe mund të bëhen disa korrigjime në këtë drejtim.

Unë, si deputet i Kuvendit, jam habitur që nga paslufta e këndej, duhani dhe alkooli kanë qenë dy produkte të cilat nuk kanë shënuar kurrfarë ngritje të çmimeve dhe shpesh jam befasuar. Le të më falin të gjithë duhangjitë, se edhe vetë jam duhangji, mirëpo norma e akcizës për duhanin edhe me këtë propozim të Qeverisë është shumë e ultë. Duhani duhet të shtrenjtohet në mënyrë drastike me qëllim që të mbrohet shëndeti i qytetarëve, se jemi dëshmitarë se duhani ka filluar të përdoret edhe te adoleshentët nëpër shkolla, kurse gjithashtu mendoj edhe për alkoolin. Në rast se dëshirojmë të emitojmë Evropën në shumë sfera të jetës, gjë që është shumë pozitive, duhet të marrim mësim edhe nga qëndrimi që e kanë qeveritë evropiane në lidhje me këta dy artikuj, për alkoolin dhe për duhanin. Mund t'ju them se në Suedi, ata që jetojnë në shtetet skandinave, më mirë janë të mbrojtura dyqanet ku shitet alkooli, se vetë bankat nëpër qytet. Do të thotë, ne duhet t'i marrim këto masa drastike edhe për faktin se këto kanë ndikim pozitiv në buxhetin e Kosovës dhe mund të shfrytëzohen këto para shumë mirë për mbrojtjen e të varfërve në Kosovë dhe sidomos për shtimin e buxhetit për Ministrinë e Shëndetësisë.

Unë pajtohem me diskutuesit të cilët thanë se neni 3 është tepër jo real për një shtet demokratik. Ekzekutivi në asnjë mënyrë kurrë nuk duhet të marrë ingerenca të ... dhe ky nen, jo që duhet të formulohet, ashtu siç është, mirëpo në asnjë kontest nuk mundet Qeveria t'i ngritë çmimet sa herë të dojë me një nen të ligjit edhe mbase konsultohet me Parlamentin.

Unë e përkrah në parim. Besoj se ligji do të pësojë edhe ndryshime në procedimin e mëtutjeshëm dhe mendoj se kjo do të jetë në dobi edhe të qytetarëve të Kosovës. Kurse e kam një vërejtje serioze. Akciza për naftën dhe derivatet e naftës nuk duhet t'i prekë ato produkte të cilat shfrytëzohen në bujqësi. Këtu duhet pasur kujdes për arsye se e rritë koston e punimit të tokës dhe këtu ndoshta do të duhej të kemi kujdes që bujqit mos të ngarkohen me akcizë për ato produkte të cilat i përdorin për bujqësi. Ju falënderoj për vëmendje!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Projektligji për ndryshimin, për tatimin e normës së akcizës, të cilin po e shqyrtojmë sot, mendoj se duhet të miratohet në parim, siç u tha edhe nga përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, por megjithatë mendoj se duhet të kemi parasysh disa fakte, të cilat mund të dalin si rezultat i zbatimit të këtij projektligji në praktikë.

Vërejtjet që u dhanë sot këtu nga disa deputetë, mendoj se mund të merren parasysh gjatë punës në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe mendoj që mund të marrë formën që është më e përshtatshme për t'u zbatuar në praktikë.

Në radhë të parë, e dimë që kemi nevojë për mbushjen e buxhetit, thjeshtë të rrisim buxhetit e shtetit tonë, mirëpo kjo edhe synohet të arrihet me këtë projektligj, të cilin po e shqyrtojmë sot. Sipas mendimit tim, shqetësim më të madh e paraqet ngritja e normës së tatimit të akcizës në naftë dhe në derivatet e saj, sepse kjo ngritje do të ndikojë, përveç ngritjes së çmimit të naftës, do të ndikojë në mënyrë zinxhirore edhe në shtrenjtimin e shumë produkteve tjera, gjë që do të reflektohet edhe në zhvillimin ekonomik, thjeshtë mund të ketë efekte negative në zhvillimin ekonomik, çka neve nuk e kemi si synim. Ndërsa sa i përket ngritjes së taksës në normën e akcizës për duhan dhe për alkool, pajtohem plotësisht, madje përveç ndikimit në buxhet që do të ketë nga ngritja e normës së tatimit të akcizës në këto produkte, do të ketë ndikime pozitive edhe në mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve tanë.

Kujdes duhet të kemi, siç u theksua edhe nga deputetët tjerë, me nenin 3, sepse me këtë nen, që është propozuar me këtë projektligj, duhet të jemi të kujdesshëm pasi që ky nen i jep të drejtën Qeverisë të ndryshojë normën e tatimit të akcizës dhe të shtojë listën e mallrave që do t'i nënshtrohen normës së akcizës. Vendimet e tilla, natyrisht që i prekin interesat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, prandaj mendoj se ato edhe duhet të merren jo vetëm nga Qeveria, por nga Kuvendi i Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, Një minutë kundër replikë, sipas Rregullores së Punës, e ka deputeti Rexhep Hoti, duke i kërkuar falje që nuk e kam parë që është lajmëruar dhe ia kam dhënë fjalën deputetit të radhës, kështu që nuk e prisha radhën. E keni fjalën, një minutë, deputet!

REXHEP HOTI: Ju faleminderit shumë! Kjo më disponoi jashtëzakonisht: Ju lusim, reagimet tjera t'i bëni me një minimum të kulturës politike, të kishit reaguar si deputet, nuk do t'ua kisha zënë për të madhe fare, por unë me sa ju njoh, ju e keni keqpërdorë pozicionin **atëherë** dhe mos e keqpërdorni në të ardhmen. Ju falënderoj shumë, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Jam i obliguar t'ua lexoj Rregulloren e Punës së Kuvendit, neni 41, ku thotë: "Kryetari i Kuvendit, kryesuesi kujdeset për rregull dhe mbarëvajtje të mbledhjeve në Kuvend, kryetari ose kryesuesi ia tërheq vërejtjen secilit deputet ose anëtarit të Qeverisë kur:

a) Diskutuesi shmanget nga çështja e shtruar për diskutim. E kam përdorë këtë nen sipas vlerësimit tim dhe pikën (a) të këtij neni dhe, pika d) Ngritë një çështje që është jashtë temës së debatit ose të mocionit.

Keni ngritur çështje të fushatave dhe të votimeve të ardhshme. Ju faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministri Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Faleminderit shumë për trajtimet, konsideroj qëllim mira të shumicës prej jush dhe besoj që shpjegimet u dhanë edhe nga disa deputetë, që çdo ngritje e akcizës në një mënyrë apo tjetër ose e taksave ka një ndikim të drejtpërdrejtë apo anësor me ndonjë ngritje të një faktori tjetër. U tha me shumë saktësi se ndoshta do të ishte më mirë që ne të kishim rritur kapacitetet për mbledhjen e taksave nga ekonomia jo formale dhe mos t'i

ngrisim akcizat, edhe kjo qëndron. Realiteti në Kosovë është ky që e kemi sot. Para nesh është shtruar kërkesa që t'i mundësojmë vetes zgjedhjen e mjaft problemeve sociale dhe të projekteve tjera të infrastrukturës nacionale dhe është dashur të zgjedhim një alternativë. Ne kemi pasur shumë presion nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që të rritim TVSH-në, siç ka pasur presione tash në Greqi për t'i shitur ujdhesat, në Serbi për t'i qitur 14.000 veta prej pune e tjera, e tjera. Në Kosovë kemi pasur kërkesë të rriten taksat e TVSH-së prej 3 deri 4%. Neve s'kemi pranuar këtë dhe për të mbushur arkën e shtetit, kemi zgjedhur një rrugë tjetër, që konsiderojmë se akcizat janë më pak të pa dhembshme dhe prekin pjesën e varfër më pak, sidomos në ato produkte të luksit.

Mënyra se si të mbrojmë bujqësinë dhe mënyra se si të mbrojmë të varfrit, konsideroj që janë përmes formave të ndryshme dhe praktika të ndryshme ka në regjion, të cilat ne do t'i marrim. I falënderoj disa nga deputetët që e ngritën çështjen e bujqësisë dhe çështjen e të varfërve dhe besoj që ne kemi dhënë shembuj që mund t'i trajtojmë këto gjëra në formën ku nuk mund të keqpërdoret ndonjë vrimë e zezë në sistem për të keqpërdorur në emër të varfërve, në emër të bujqësisë të bëjmë një vazion tjetër fiskal.

Organi për të vendosur ngritjen e akcizave është Kuvendi apo Qeveria, ka praktika të ndryshme botërore. Sa më efikase dhe sa më e shpejtë që të jetë, aq më pak do të ketë mundësi për manipulim, siç kanë filluar disa, s'dua t'i përgjithësoj, por disa njerëz të spekulojnë në emër të..., nëse mund të them pas ngritjes së vendimit në Qeveri për ngritjen e akcizave, në dogana kanë vërshuar bote me plotë naftë, kanë vërshuar plotë mauna me plotë cigare. Në kodin e akcizës, në kodin e doganës është shkruar me shumë mençuri një nen, i cili i jep të drejtë drejtorit të doganave që asnjë import mbi mesataren e nëntë muajve të kaluar nuk mund të lejohet, sepse ka qëllime spekulative. Qysh u bë që nëntë muaj një firmë ka importuar për çdo muaj nga një x sasi dhe tash përnjëherë po e trefishon. Ne e dimë që ai ka qëllime spekulative për t'i ikur akcizës dhe për t'iu ikur taksave për shtetin e Kosovës.

Andaj, pa dhembshuri dhe jo për gjynah, siç u theksua nga disa deputetë, ne do të veprojmë kundër atyre sepse është përpjekje për spekulim dhe manipulim të gjendjes, kështu që do të ju falënderoj shumë në qoftë se e mbështetni këtë, besoj se do ta gjejmë mekanizmin i cili atë që u propozua nga deputetë këtu, që nuk është qëllimi këtu veç Qeveria ta ketë vendimmarrjen në vendosjen e akcizës, ne jemi shumë të hapur që të gjejmë një mekanizëm efikas të shpejtë për vendosjen e ndonjë akcize apo zgjerimin e listave, sepse ardhja në Parlament të paktën i ka dy muaj. Hajde të gjejmë bashkë një mekanizëm i cili, natyrisht, nuk ia lë veç Qeverisë në dorë dhe nuk jam i interesuar ta bëjmë atë, por që ka një efikasitet më të shpejtë në vendimmarrje, e cila është në të mirë të politikave efektive të shtetit në momente të caktuara. Faleminderit shumë për përkrahje dhe uroj që bashkërisht ta përmbyllim në kohën e duhur. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër! Tani kërkoj deklarinimin me votim për miratimin në parim të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

Në sallë janë 71 deputetë. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota "për", 15 "kundër" dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin e normës së akcizës në Kosovë.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisioni për buxhet dhe financa, si komision funksional dhe komisionet e përhershme, të cilat duhet që në afatin më të shpejtë të mundshëm Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat

Konstatime hyrëse: Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji. Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. E keni fjalën, ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Po ashtu kam kënaqësi të veçantë që para jush të paraqes një ekspozitë të shkurtër në lidhje me plotësim – ndryshimin apo Projektligjin për administrimin në Administratën Tatimore dhe procedurat dhe më vjen shumë mirë që sot kam këtë mundësi që në vazhdim të një pakete, nëse mund të them, ligjesh të cilat janë shumë të domosdoshme edhe për qëndrueshmërinë fiskale, por edhe për zotimet tona ndërkombëtare të procedojmë edhe me këtë ligj, i cili është një nga ligjet shumë të rëndësishme në ngritjen e kapaciteteve të administratës publike, në tërësi, dhe administratës tatimore, në veçanti.

Ky ligj është po ashtu shumë i rëndësishëm për të rritur mundësinë e grumbullimit të të hyrave buxhetore dhe në kuadër të zotimeve tona besoj që do t'i mundësojmë Administratës Tatimore që të jetë më efektive dhe më efikase.

Siç e thashë edhe më herët, Fondi Monetar Ndërkombëtar pas negociatave të shumta ka vu disa kushte që me këtë ligj të përmirësohen disa nga të drejtat dhe autorizimet e Administratës Tatimore që të jetë më efektive në mbledhjen e taksave dhe sidomos në ngritjen e procedurave penale dhe t'i japë kompetenca Njësisë për Hetime që të përmbushë obligimin e vet ligjor dhe mandatin që e ka si mision dhe si administratë.

Sikur që është cekur edhe në letrën e zotimit që e kemi nënshkruar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne kemi treguar përpjekje serioze për të adresuar humbjet në lidhje me ekonominë jo formale dhe skemat e mashtrimeve tatimore elementare, të cilat u paraqiten edhe nga folësit, nga deputetët e nderuar, të cilët plotësisht me të drejtë ngritën çështjen që të jemi më efikas ndaj ekonomisë jo formale dhe konsideroj që ky ligj e shton këtë aspekt dhe i jep mundësi Administratës Tatimore që të ketë kapacitet dhe bazë ligjore më të fuqishme për këtë.

Administrata Tatimore në vazhdimësi është duke zhvilluar kapacitetet e veta administrative. Sa më efektive që të jenë ligjet tatimore, aq më evidente do të jenë edhe sukseset e kësaj administrate, andaj më lejoni që në pika të shkurtra t'i them disa nga aspektet që trajton Projektligji në mënyrë specifike.

Krahas shkeljeve penale në fushën e tatimeve, përfshihet edhe nevoja për ndëshkime shtesë që lidhen me implementimin e arkave fiskale, për shembull, një nga pikat që i trajton ky ligj.

Nevojën për dispozita shtesë që lidhen me pagat dhe përfitimet e Administratës Tatimore jashtë dispozitave të Ligjit të shërbimeve të shërbyesve civilë. Konsideroj që Administrata Tatimore, doganat dhe institucionet mbledhëse duhet të mos trajtohen sikurse një zyrtar që rri, rri – punon në zyrë, por që të ketë një stimulim, e kam fjalën – inspektori, që të mbledhë sa më shumë taksa, është faktikisht sikurse dallimi në mes të burokracisë në një ndërmarrje prodhuese dhe asaj të vetë prodhuesit në galeri.

Dispozitat shtesë që lidhen me çështje rreth antikorrupsionit në Administratën Tatimore, është në mënyrë mjaft precize e ngritur kjo çështje.

Ndryshimet e nevojshme për të bërë bordin e pavarur për shqyrtim më efektiv dhe për të ndihmuar në emërimin e anëtarëve të ri të bordit, si dhe një numër ndryshimesh tjera, ku të gjitha janë të përpiluara me

qëllim që të përmirësojmë administrimin e sistemit tatimor dhe të gjenerojmë sa më shumë të hyra për qytetarët e Kosovës.

Po ashtu, ekziston një varg i amendamenteve të bëra me qëllim që të harmonizohet deri në shkallën më të lartë të mundshëm Ligji mbi Administratën Tatimore dhe procedurat me Ligjin mbi tatimin e të ardhurave të korporatave dhe tatimit në të ardhurat personale.

Ndryshimet në Ligjin mbi Administratën Tatimore dhe procedurat, po ashtu, ngrisin autorizimet e Administratës Tatimore me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të saj për zbatim të drejtë dhe të vendosur të ligjeve tatimore.

Në këtë drejtim fuqishëm besojmë se masat e përfshira në ligj do të ndihmojnë bizneset, të cilat në mënyrë të ndershme zbatojnë ligjet dhe do të penalizojnë mjaft ashpër ato të cilat përpiqen t'i anashkalojnë, keqpërdorin ose abuzojnë ligjet.

Sikur e dini, Kosova ka kërkesa dhe nevoja të shumta buxhetore dhe rritja e grumbullimit të të hyrave është kusht i domosdoshëm për t'i plotësuar ato, andaj me ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve të Administratës Tatimore, ky objektivi besoj do të rritet me sukses dhe në kohë.

Ka edhe elemente tjera të detajizuara, të cilat janë paraqitur në memorandumin shpjegues. Unë do ta përmbyll me kaq, duke ju lutur që ta mbështetni, në parim, dhe do të jemi shumë në disponim që të bashkëpunojmë gjatë komisioneve funksionale dhe komisioneve të tjera që administrata, stafi im dhe unë personalisht të jemi në bashkëpunim të ngushtë për të aprovuar këtë ligj në kohën sa më të shpejt të mundshme. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër! Të nderuar deputetë, hapi debatin për diskutim, në parim, të këtij projektligji.

Në emër të kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk shoh të lajmëruar. Ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, deputetin Bahri Hyseni ta marrë fjalën!

BAHRI HYSENI: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

Unë nuk do të doja të lëshohem në vërejtjet tjera, mirëpo është një vërejtje parimore të cilën duhet ta respektojmë. Është për çudi që Projektligji ka ardhur dhe fillon me nenin e parë nga përkufizimet. Nuk është praktikë, deri tash s'kemi pasur asnjëherë praktikë, domethënë shumë e pakuptueshme që nga neni i parë të jenë përkufizimet ende pa e kuptuar cili është qëllimi i ligjit, cila është fusha e zbatimit dhe të fillojë prej përkufizimeve.

Unë e kuptoj që edhe ministri nuk ka mundësi ndoshta të... sepse nuk është jurist, por është mirë dhe po e bëj vërejtjen qëllimisht që është mirë zyrtarët ligjorë së paku mos ta ndryshojnë atë praktikën e mirë që e kemi - të fillojmë prej qëllimit të ligjit, fushën e zbatimit dhe mandej te përkufizimet. Kjo vërejtje është mirë që të përmirësohet dhe gjithsesi të futet qëllimi i ligjit dhe fusha e zbatimit. Faleminderit.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për Grupin parlamentar të PDK-së ftoj deputeten Safete Hadërgjonaj ta marrë fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat dhe është i mendimit se me ofrimin e këtij projektligji dhe projektligjeve tjera të cilat i shqyrtoam më parë, Qeveria e Kosovës po shihet se po angazhohet në vendosjen e politikave që kanë të bëjnë

me rritjen e qëndrueshmërisë fiskale dhe me ruajtjen e stabilitetit financiar dhe njëkohësisht po punon në konkretizimin e marrëveshjes së saj mbështetëse për 106 milionë euro nga ana e Fondit Monetar Ndërkombëtar, prandaj ne sot kemi këtë pako të ligjeve që rregullojnë fushën e politikës fiskale, duke ju përshtatur rrethanave të reja të krijuara pas anëtarësimin në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe pas kalimit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave të Njësisë për Hetime Tatimore.

Me këtë projektligj janë qartësuar format e deklarimit financiar që reflektojnë në zbulimin dhe pengimin e korrupsionit. Janë qartësuar dispozitat që kanë të bëjnë me implementimin e arkave fiskale, janë përcaktuar detyrimet ligjore të përfaqësuesve të subjekteve juridike dhe menaxherëve të aseteve, parakushte këto të domosdoshme për hetimin e veprave penale tatimore, janë krijuar mundësi për të revokuar dënimin penal në rast të deklarimit vullnetar të veprës penale tatimore para se të iniciohet procedura e hetimit, është përcaktuar baza juridike për hetime të njësisë së hetimeve tatimore, si dhe përgjegjësia e kësaj njësie në Administratën Tatimore të Kosovës, si dhe është themeluar juridiksioni territorial i gjykatës kompetente penale në përputhje me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Po ashtu, si nevojë e domosdoshme që e shohim që është bërë mirë në këtë projektligj, është edhe se ligjet e reja të cilat i kemi nxjerrë mbi korporatën... mbi tatimin e korporatave dhe tatimin e të ardhurave personale janë harmonizuar tani me Ligjin e Administratës Tatimore dhe procedurave.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i mendimit se Qeveria ka bërë një punë të mirë me këto projektligje dhe se miratimi i këtij projektligji, që ne po shqyrtojmë tani, do të krijojë një bazë të fuqishme juridike që do të konkretizojë shumë çështje të cilat kanë qenë të pa konkretizuara në ligjin e mëparshëm dhe do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të Administratës Tatimore dhe njëkohësisht do të kontribuojë në rritjen e të hyrave që reflektojnë, pra, me rritjen e buxhetit të Kosovës.

Grupi ynë Parlamentar e përkrah në parim këtë projektligj, kurse kontributin tonë do ta japim përmes anëtarëve të cilët i kemi në komisionin funksional që ky Projektligj për Administratën Tatimore dhe procedurat dhe dy projektligjet tjera të mëparshme të miratohen sa më shpejt në lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Në emër të Grupit parlamentar të LDK-së, ftoj deputetin Armend Zemaj ta marrë fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, zoti kryesues!

I nderuar ministër i Financave,
Kolegë deputetë,

Nevoja imediate për konsolidimin e Ligjit Nr 2004/48 për Administratën Tatimore dhe procedurat me një ligj të vetëm, i plotësuar me Ligjin Nr 03-L/071 mbi amendamentimin dhe plotësimin e Ligjit 2004/48 për Administratën Tatimore dhe procedurat, si dhe plotësimi i mëtejme i këtij ligji konform kërkesave dhe zotimeve për fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve të ATK-së në luftimin e informalitetit dhe të skemave të evazionit fiskal, gjithsesi se paraqet nevojën e draftimit të Projektligjit të ri për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Pra, esenca e prezantimit të këtij draftligji në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së dhe mbështetja që do t'i japim, i cili si i tillë edhe në dy versionet paraprake është përkrahur dhe miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, është pikërisht fuzionimi apo konsolidimi i këtij ligji në një ligj të vetëm për lehtësi të referimit dhe administrimit, i cili në një masë të konsiderueshme do të lehtësonte shfrytëzimin më të lehtë të këtij ligji si nga tatim paguesit dhe përfaqësuesit e tyre, ashtu edhe nga zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës, si administrues të saj.

Harmonizimi i këtij projektligji konform kërkesave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare rregullon edhe disa fusha të cilat deri më tani kanë krijuar një zbrazëti juridike ose si të tilla nuk kanë ekzistuar fare, të cilat

në këtë mënyrë kanë krijuar vështirësi të konsiderueshme në implementimin praktik të saj nga ana e Administratës Tatimore të Kosovës.

Në këtë kontekst, çështjet që janë adresuar, ndër të tjera, dhe që na bënë neve si Grup Parlamentar të përkrahim ligjin, do t'i potencojë: rishikimin e disa përkufizimeve të caktuara dhe harmonizimin e tyre me ligjet e reja për tatimit në të ardhurat e korporatave dhe tatimin në të ardhurat personale të aprovuara së fundi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, disa definicione të reja lidhur me pajisjet elektronike fiskale dhe hetimet e veprave penale tatimore, përcaktimin e ndëshkimit të veçantë për dështimin për të instaluar dhe përdorur arkën fiskale, përcaktimin e ndëshkimit të veçantë për mos lëshimin e kuponit fiskal, sqarimin e të drejtave të Administratës Tatimore për të publikuar emrat e tatimpaguesve që kanë refuzuar regjistrimin ose që janë çregjistruar nga ATK-ja, ndryshon ndëshkimin për mallrat pa origjinë, përcaktimi i përgjegjësisë së Njesisë së Hetimeve Tatimore në kuadër të ATK-së, që është përgjegjësi e re, përcaktimi i bazës juridike për hetimet e Njesisë së Hetimeve Tatimore në ATK dhe konform se ato do të kryhen në përputhje me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës dhe përcaktimi i rregullave të bashkëpunimit në mes të ATK-së, autoriteteve të policisë, të prokurorisë publike dhe të gjykatave penale. Prandaj, me këtë shqyrtim nga Grupi Parlamentar i LDK-së dhe zotimi për përkrahje të mëtutjeshme edhe në komisionin funksional, ne i japim përkrahje, në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka deputeti Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka lexuar me vëmendje Projektligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat dhe për dallim nga dy grupet e para, përveç lëvdatave që i japin Qeverisë, ne do t'i qesim në pah të metat e këtij ligji.

Unë do të thosha që shqetësimi kryesor për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës janë neni 4 dhe 5, te zgjedhja e zëvendës drejtorëve dhe e menaxherëve, ku zëvendës drejtorët dhe menaxherët në administratën qendrore zgjedhen nga drejtori, edhe pse formohet një panel, mirëpo fjalën përfundimtare e ka drejtori, ndërsa shkarkimin prapë e bën për jo profesionalizëm, thuhet se e bën drejtori. Nëse drejtori e zgjedh për si profesionist shumë të mirë dhe mandej e shkarkon si jo profesionist, atëherë duhet të japë përgjegjësi edhe vetë drejtori.

Administrata Tatimore që të jetë efikase dhe që të ketë rritje të hyrave tatimore, do të kishte qenë mirë që në radhë të parë të depolitizohet. Unë dhe ministri i Ekonomisë kemi shumë kolegë në Administratë Tatimore dhe, të them të drejtën, secila parti që vjen, i ndërron edhe menaxherët, i ndërron edhe drejtorët dhe është një e metë dhe këtu në këtë vit kemi rënie të të hyrave nga Administrata Tatimore. Prandaj, ky shqetësim është jo vetëm i Partisë së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por duhet të jetë shqetësim për të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Parimisht, po them, e përkrahim dhe do ta përkrahim dhe kontributin tonë do ta japim në komisionin funksional dhe në komisionet tjera, mirëpo do të kishte qenë mirë që kjo administratë e cila është, që edhe ti në fillim e the, është një administratë e cila duhet ta bëjë qëndrueshmërinë buxhetore dhe të rritë të hyrat buxhetore, duhet që të depolitizohet sa më shpejt. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputetin Riza Smaka ta marrë fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

Të nderuar deputetë,

Duke e mbështetur në parim miratimin e këtij dokumenti, po asisoj në parim disa vërejtje principiele, kështu. Bie fjala, nenet janë jashtëzakonisht ekstensive, që nuk është në konformitet me rregullat elementare të onomoteknikës. Janë nenet të tipit deskriptiv, sikundër të ishte shkruar një referat, si të them, mos të them referat politik që për aq i bëjnë këto dispozita vështirë të kuptueshme ose të shumë kuptueshme, që është edhe më keq, sepse në praktikë më pastaj mund të aplikohet në atë variant, bie fjala, sipas komenteve.

Nuk është e definuar, nuk është e specifikuar sa dhe si duhet nocioni i tatimit dhe i kontributit, tek e fundit edhe kontributi është tatim, po megjithatë nuk është tatim.

Me këtë projekt ligjor lëshohet në nivelet e materies së akteve nënligjore. Bie fjala, drejtori, zëvendësdrejtori e kështu me radhë do të duhej të definoheshin, të specifikoheshin me një organogram, me një akt për sistematizim, për organizimin e brendshëm, po jo edhe me aktin ligjor. Nuk është e parë kjo. Nuk është presedente, që me ligj ta rregullojmë statusin e zëvendësdrejtorit, bie fjala. Ose disa shprehje që nuk janë të familjarizuara kështu në jurisprudencë. Bie fjala, “vendim shpjegues publik”. Si vendim? Vendimi është akt me të cilin vendoset një çështje juridike administrative, a këtu nuk është fjala për vendosje, është fjala për informim, prandaj do të duhej të thuhej - njoftim publik, bile shkohet edhe më tutje, thotë – vendim njoftues individual, vendim njoftues kolektiv a kolegjal, po njoftim edhe me atë...

Me këtë dokument shkohet në një sferë që nuk mund të shkohet. Bie fjala, përcaktohen vepra penale. Unë kam dëshirë t’i quaj akte penale, se kur thuhet vepër, ma zgjon asociacionin e një punës të madhe, sublime, a ajo akti penal është e kundërta e sublimes. Gjithsesi, aktet penale përcaktohen me Kodin penal, po jo edhe me këtë ligj apo me cilindo ligj tjetër.

Nuk ka konsistencë në terminologji. Herë përdoret “person juridik”, herë “subjekt juridik”, herë “entitet juridik”, apo “entitet legal”. Mund të përdoret kjo ose ajo, por nëse përdoret në fillim, atëherë do të duhet ab-initio, gjithkund në tekst të jetë bie fjala “entitet legal” ose “subjekt juridik” ose “person juridik”, por jo herë person, herë entitet, herë subjekt.

“Interesi”, bie fjala te neni 28. Jo “interesi”, po “norma interesore”, ose eventualisht “kamata”, se “interesi” jep një diksion krejt tjetër fare dhe nuk është “interesi”, po “norma interesore”.

Te neni 50, 58 e kështu me radhë, bie fjala, “ndëshkimi administrativ”, nuk është fjala për ndëshkim, po është fjala për “masat administrative”, se me këtë akt nuk është qëllim ndëshkimi, po masat që përcaktohen eventualisht në qoftë se nuk përfillen dispozitat e këtij dokumenti. Ose, bie fjala, me nenin 61, iu ka dhënë, po qe se do të miratohej ingjierenca apo kompetencë MEF-it – Ministrisë për Ekonomi dhe Financa që me Udhëzim administrativ të përcaktonte sanksione shtesë. E paparë është kjo që me udhëzim, me akt nënligjor të përcaktohen masa. Ajo është e palejuar, e pa toleruar. Ju lutem, kjo duhet të fshihet medoemos, se vetëm me akt ligjor mund të përcaktohen masat, por jo edhe me akt nënligjor.

Këto dhe shumë të tjera, por këto janë, në parim, sugjerime dhe propozime. Ne e miratojmë, e konsiderojmë këtë dokument të nevojshëm për ta miratuar. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues! Edhe ky ligj është një ligj i rëndësishëm shumë të veçantë që hyn në pakon e ligjeve, në pakon fiskale dhe, realisht, duke pasur parasysh strukturën e të hyrave buxhetore të shtetit tonë, ky ligj ka një rëndësi shumë të veçantë. Fatkeqësisht, duke pasur parasysh se të hyrat dërmuese në buxhetin e Kosovës vijnë nga doganat në Republikën e Kosovës, ndërsa nga Administrata Tatimore kemi shumë ngecje dhe ky ligj është i mirëseardhur, natyrisht, me ristrukturimin e tij apo me pasurimin e tij që kohë pas kohe ashtu - kështu duhet gati çdo ligj të pasurohet, sidomos në aspektin ekonomik.

Megjithatë, ky ligj, unë nuk dua ta zgjas dhe t'i përsëris kolegët përveç nenit 4.5, që pajtohem se duhet theksuar qartë se vërtet a ka të drejtë drejtori edhe t'i zgjedhë ekspertët, edhe t'i shkarkojë, sepse kemi vërtet një situatë reale në terren që Administrata Tatimore është shumë e politizuar. Aty në qoftë se nuk janë njerëzit e PDK-së dhe të LDK-së, nuk mund të punojnë. Kemi rastin e përzgjedhjes së menaxherëve të fundit, që ata menaxherë të cilët nuk kanë qenë në PDK dhe LDK, janë larguar dhe për këtë kemi edhe Raportin e progresit, që e thekson decidivisht që duke ndërruar njerëzit me përvojë, të cilët nuk krijohen brenda dite, por për ta duhet kohë, duhen trajnime, investim dhe një gjë e tillë ka ndodhur, por në qoftë se vjen në pushtet partia e caktuar, ata ekspertë dhe ata njerëz me përvojë duhet të largohen dhe pastaj kemi ngecje se faktike është që për këtë vit Administrata Tatimore ka rënie në të hyrat e saj.

Natyrisht, përmes këtij ligji, që prapë mos të harroj të theksoj, memorandumit sqarues shumë mirë e gjithpërfshinë deri diku plotësimin e këtij ligji dhe realisht me këtë do të pretendohet, shpresoj, shpreson LDD-ja që të kompletohet ky ligj dhe të përmirësohen performancat në Administratën Tatimore, sepse vërtet ka informalitet të madh dhe natyrisht që Republika e Kosovës duhet të pretendojë që të hyrat t'i ngrisë në Administratën Tatimore dhe jo të varet, të gjitha të hyrat ose shumicën e të hyrave t'i kemi nga doganat.

Ne, si grup parlamentar do të japim kontributin tonë përmes komisioneve funksionale dhe shpresojmë shumë se ky ligj do të jetë më i mirë se që ka qenë deri sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "7+" deputeti Enis Kervan e ka fjalën.

ENIS KERVAN: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Bu Yasa Tasarısının oluşumu, konuyla ilgili bazı tanımlamalarını gözden geçirmeyi ve işletme şirketler ve kişisel vergilere Vergi Yasasıyla uyumlaştırılmasını hedeflemektedir. Bundan başka çeşitli engellemeler, işbulma ve işten uzaklaştırmayla ilgili koşulların belirlenmesi, vergi denetiminin uygulanması gibi konularından da ibarettir.

Yasa Tasarısını inceleyen 7+ Parlamenter Grubu bu Yasa Tasarısının anlamını ve özetini tamamiyla değiştiren tercüme konusunda özel uyarısı vardır. Bütün Yasada tercüme hataları özellikle 18.3'ü ile 18.7 maddeleri boyunca tercüme yanlışlarıyla kendini belli etmektedir. Dolayısıyla 7+ Parlamenter Grubu, Yasa Tasarısını kabul etmektedir, katkılarını komisyonlarda sunacaktır. Teşekkürler.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Mursel Halili e ka fjalën.

MURSELJ HALILJI: Zahvaljujem, gospodine predsedavajući!

Gospodine ministre,

Dame i gospodo poslanici,

Parlamentarna grupa SLS je u dobroj nameri pokušala da shvati ovaj tekst Nacrta zakona, međutim konstatujemo sa žaljenjem da nismo bili u stanju da shvatimo sadržinu ovog predloženog teksta, obzirom da postoje nejasnoće u samom tekstu, tekst je inače konfuzan i iz tog samog teksta ne može da se shvati sadržina samog zakona.

Mi smatramo da ovaj zakon je veoma bitan za dalju poresku politiku na Kosovu i ovog puta upućujemo zahtev ili prigovor da se sam tekst ovog zakona ispravi u što skorije vreme kako bi mogli da damo doprinos u sledećoj fazi razrade ovog nacrta zakona.

S toga, mi kao Parlamentarna grupa nemamo stav povodom ovoga jer nismo u stanju da shvatimo samu suštinu i sadržaj ovog nacrta zakona. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala, ponovo na datu reč!

Imamo ispred sebe Zakon o Poreskoj administraciji i postupcima za razmatranje u sferi poreske administracije na Kosovu.

Nacrt zakona definiše, svi znamo, obavezu plaćanja poreza na Kosovu, definiše Poresku administraciju, Poresku službu, Poresku upravu, kako želimo da je nazovemo i, normalno, sa druge strane poreske obveznike, tojest dužnike.

Moram da kažem da je ovaj nacrt zakona donet danas pred nama na osnovu potrebe koju je zatražio od nas Monetarni fond, međutim ja moram danas da kažem da je ovaj zakon jedan od možda najgore prevedenih zakona, da nema nikakav smisao, da smo ga jako – jako teško pročitali, ali pošto znamo i pošto smo na tržištu gde porez nije nešto ne shvatljivo za građanina, ja sam se potrudila i mi u ime grupe da definišemo neke stvari i da ih postavimo na pravo mesto i u pravom smislu.

Naročito apelujemo na funkcionalnu komisiju koja bude radila – Komisija za budžet na ovom zakonu, da se obavezno obrati pažnja na članove ovog zakona koji su jako – jako nejasni i nemaju smisla.

Jedno što hoću da dam do znanja, vidimo da je negde korišćen hrvatski prevod, pa negde makedonski prevod, tako da neki članovi nam u opšte nisu bili jasni. Na primer, član 53 – neuspeh na slanje kreiranja ili dostavite podatke. Nema nikakvog smisla, da li je to neuspeh na stanje kreiranja ili dostave podataka. Tako da naslov člana nije jasan, a ne posle opis člana.

Naročito su nejasne i kategorije gde se obavezuju subjekti da li je to pravno ili je fizičko lice ili je to radnik gde treba da plati porez i doprinos na ime ličnog dohotka – takse, takse i kazne.

Dalje, jako nejasna lista koja je u ovom zakonu, što moram da kažem da nije usklađen i meni je žao što gospodin ministar ovo nije pogledao što Ministarstvo praktično nije ni pročitalo ovaj zakon, nego nam ga danas praktično samo fizički serviralo. Zašto ovo kažem...? Član 58. kaže – administrativne kazne u vezi sa PDV-om. Član 1.1. kaže - 15% od PDV-a, mi znamo da je danas na Kosovu 16% PDV. Nije usklađen prvo procenat takse, što znači da je ovaj zakon praktično samo išao procedurom kopi-paste, da se zadovolji potreba Monetarnog fonda. Ja mislim da je ovaj zakon mnogo važan, da ima jako velike segmente tamo gde opisuje obaveze društvenih preduzeća koja nisu izvršila obaveze prema radnicima i prema Poreskoj upravi na ime plaćanja poreza, na ime plaćanja dohotka i ličnih dohodaka radnika, tamo gde je jako osetljivo polje, gde je nedostatak da znamo na Kosovu koliko radnika ima neplaćene plate i neplaćen doprinos i nepovezan staž, tako da preuzima Agencija za privatizaciju. To je bilo u Makedoniji, to je bilo u Hrvatskoj, gde se sve ispoštovalo, ali sa ovakvim zakonom, kao što je ovaj zakon, praktično ja da kažem kao da je to neka tezga sa neke buvlje pijace i sve je nam ovde tako samo nabacano, nije regulisano, nije sređeno, nema formu te mislim da ne trebamo da ga vraćamo, ali funkcionalne komisije da se maksimalno potrude da ovaj zakon pojasne i da ga čitaju u svim verzijama. Ja verziju na albanskom jeziku nisam mogla da analiziram, ali verzija na srpskom jeziku stvarno nije sređena. Svuda, eto imate stav 2.1, ponovo 15% od očiglednog smanjenja ili povećanja iznosa poreza na dodatnu vrednost. Molim vas, Ministarstvo bi trebalo ovo da pazi jer ima armiju svojih radnika i ovo ne bi trebalo da se dešava, mi poslanici da ukazujemo na oho. Ja vidim da su poslanici bili umorni i da nisu stizali da ga čitaju, na primer da kažem 50-tu, 60-tu, 70-tu stranicu, ali ovo ne bi trebalo da se dešava u budućnosti. Toliko od naše grupe. Hvala na pažnji!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Kalojmë te deputetët, sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Rexhep Hoti, të përgatitet deputeti Adem Hajdaraj.

REXHEP HOTI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar zonja e zotërinj,

Një kornizë ligjore e përshtatshme dhe e plotë gjithmonë krijon kushte për menaxhim efikas, funksional dhe prosperues. Ligji aktual në shumë pika është konfuz dhe është e domosdoshme të bëhet një unifikim dhe harmonizim i shumë ndryshimeve në një ligj të vetëm për të ndikuar pozitivisht në implementimin e tij nga ana e ATK-së.

Si përparësi të këtij projektligji, ndër të tjera, mund të theksoj.

1. Krijimi i Njesisë së Hetimeve Tatimore, neni 74, si dhe përcaktimi i kompetencave të Njesisë së Hetimeve Tatimore gjatë procedurës penale, neni 75, njësi e cila do të kryej hetimet në rastet e mosdeklarimeve reale të obligimeve tatimore.
2. Parashikimi i ndëshkimit administrativ për mospërdorimin e pajisjeve elektronike fiskale, për mosregjistrim të transaksioneve, neni 57, me qëllim për krijimin e një ambienti sa më efektiv për luftën e ekonomisë jo formale.

Megjithatë, pas rishikimit të këtij projektligji mund të hasim në disa nene të cilat mendoj se duhet sqaruar më hollësisht me qëllim të interpretimit sa më praktik, të drejtë e profesional.

Sugjerimi i parë. Neni 4, zëvendësit e drejtorit të përgjithshëm, rrjedhimisht zëvendësdrejtorit të përgjithshëm. Me këtë rast duhet shikuar se si mendohet funksionimi me dy pozita të zëvendësdrejtorëve të drejtorit të përgjithshëm të ATK-së. Nuk mund të besoj se dyzimi i pozitave do të mund të ndikojë në përmirësimin e funksionimit sa më efikas të ATK-së. Mendoj se po krijojmë një burokraci të panevojshme në hierarkinë drejtuese të ATK-së.

Sugjerimi i dytë. Neni 6. Zyrtarët e tatimeve. Te ky nen duhet të sigurohemi që stafi i ATK-së të largohet nga shërbyesit civilë, duke u bazuar në punën specifike e të stafit të ATK-së dhe të krijohet bazë ligjore për këtë çështje dhe jo të mbetet në kompetencë të ministrit për përcaktimin e nivelit të pagesës. Ka qenë kjo edhe njëra ndër kërkesat e rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar në të gjitha raportet lidhur me punën e ATK-së, si dhe të krijohen të ardhura në nivel të vendit dhe me rajonin.

Sugjerimi i tretë. Neni 78. Themelimi i bordit të pavarur për rishqyrtim. Me rastin e emërimit të anëtarëve të bordit duhet të kihet parasysh që të mos vazhdohet me emërimin e praktikave të personave jo profesionalë, si dhe të atyre politikë, ku mund të vijë deri te konflikti i interesit, siç ka qenë rasti i deritashëm, ku personat të cilët janë drejtues në ndërmarrje publike të jenë edhe anëtarë të bordit, si dhe komuniteti i biznesit të jetë i përfaqësuar me anëtarë profesionalë, si kontabilistë ose auditorë të certifikuar. Çështja e tatimit është shtylla kurrizore, truri dhe zemra e çdo shteti, prandaj një shtet perspektivën e vet e bazon mbi rregullimin e kësaj çështjeje, madje lufta në këtë drejtim, që edhe ministri duhet ta ketë parasysh, konsiston në faktin se, po jap vetëm një shembull, kur Al Kapone vriste njerëz në midis Amerikës, kurrë nuk ishte e mundur ta zinin dhe ta fusnin në burg, sepse bënte kërcënimin e dëshmitarëve e gjëra të tjera.

Çështja fiskale është çështje aq e ndjeshme sa që ajo është patriotizmi numër një dhe abc-eja e rrjedhës së një shteti, prandaj në këtë drejtim mendoj se duhet të kemi një përkushtim më të madh. Ju faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj, të përgatitet deputeti Naim Rrustemi.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryesues!

Ministër,
Deputetë të nderuar,
Administratë, e tjerë,

Unë desha t'i shtroj disa çështje këtu përkitazi me këtë ligj, që më duket se ndonjë gjë e kanë thënë edhe të tjerët, por unë do të përpiqem t'i formuloj këto në njëfarë mënyre. Edhe ky projektligj, sipas mendimit tim, i jep nocionet e sqarimet e panevojshme shpesh. Sidomos atë në fillim, "kjo nënkupton", diçka që zakonisht po përsëritet edhe në projektligje të tjera, por edhe në këtë, që mua më duket janë të panevojshme. Po ashtu, çështja tjetër që dua ta shtroj, është se jepen këtu përkufizime duke u thirrur në ligjet e tjera, për shembull në Ligjin, Projektligjin për tatimin e vlerës së shtuar, në Projektligjin për shoqërinë tregtare, aty është mbi shoqërinë tregtare, mbi tatimin e shtuar, dhe tash lexuesi duhet të kërkojë atë ligj, ta shoh. Janë të panevojshme, u tha më parë dhe e përmendi një deputet këtu, Bahriu, më fal, dhe unë mendoj se kjo është ndër të metat edhe të ligjeve të tjera që të jepen përkufizimet, duke u thirrur në ligjet e tjera, që është e panevojshme.

Po ashtu, çështje tjetër është edhe përsëritja e paragrafëve të njëjtë, që shpeshherë e rëndon projektligjin. Kështu, fjala vjen, paragrafi 1.21 dhe 1.26.3 përsëriten të njëjtat gjëra vetëm se thuhet me një fjali, pak a shumë duke ndryshuar fjalët dhe në thelb është e njëjta gjë, që unë mendoj se duhet të kihet kujdes shumë kur formulohen fjalitë brenda për brenda nenit, brenda për brenda ligjit, sepse ligji nuk duron përshkrime e ku ta di unë, si letërsia, ta zëmë, ose si ndonjë punim tjetër, kështu, po ky, do të thotë, ligji duhet të ketë përkufizime të qarta dhe vetëm një fjalë e rëndon brenda për brenda nenit ose brenda për brenda paragrafit.

Strukturimi i ligjit fillon me përkufizime, jo me qëllimin kryesor. Edhe ky, edhe u thanë edhe në ligjet tjera, u theksua edhe këtu, është e metë e madhe kur nuk jepet në fillim qëllimi i ligjit, por jepet përkufizimi. Qëllimi shkruan atje, e jepet përkufizimi, që e rëndon ligjin dhe është e panevojshme.

Një gjë tjetër që është shumë e rëndësishme, sipas meje, është një lidhje strukturore e atyre që emërojnë. Kështu, fjala vjen, drejtorin e ATK-së e emëron kryeministri, drejtori pastaj, domethënë i Administratës Tatimore të Kosovës, drejtori i emëron zëvendësdrejtorët. Zëvendësdrejtorët, përsëri shkon në mënyrë zinxhirore, po ashtu drejtori i përgjithshëm edhe e jep edhe koeficientin e caktuar. Ai, po ashtu, edhe menaxherët e zyrave rajonale dhe qendrore, që u thanë këtu, janë këto jashtëzakonisht të panevojshme dhe unë mendoj se është një strukturim, një organizim i centralizuar, që në vendet demokratike dhe në ligjet që janë të vendeve demokratike nuk duhet të jenë ashtu të lidhura, domethënë, po duhet një grup ose ku ta di unë, e jo që në formë të centralizuar të caktohen këtu. Domethënë, kompetencat për emërimin dhe shkarkimin në ATK i kanë personat e tillë, sipas nevojës për të zbatuar dispozitat e këtij ligji në përputhje me rregullat e Shërbimit Civil të Kosovës, prapë ajo që e thashë, e njëjta gjë, vetëm se thirret në shërbimin civil, prapë është e pakuptueshme për lexuesin, ndoshta edhe për gjykatësin, se duhet gjykatësi ta kërkojë këtë ligj dhe të shohë se çka është atje.

Disa terma që unë ndonjëherë i kam vënë në spikamë, po përsëris edhe një herë se "nënkupton" e tjera, "persona të lidhur" është, "persona të lidhur" që për disa ligje po përdoret, madje edhe në këtë ligj për të cilin po bëjmë fjalë. Nuk janë "persona të lidhur", nuk mund të jetë person i lidhur, por është "person në bashkëpunim", ta zëmë, ose bashkëpunëtor i këtyre, e tjera, e tjera ose "në lidhje", e jo "persona të lidhur". Nëse donë të përdoret lidhja, duhet të jetë "persona në lidhje" e jo "persona të lidhur", por më mirë është "persona në bashkëpunim".

Një çështje tjetër që, po ashtu, e rëndon këtë që thashë, çështjen e centralizimit atje, që e përmenda, është se edhe komisionin disiplinor e cakton drejtori i ATK-së. Nuk mund ta caktojë ai, mendimi im është. Duhet ta caktojë një grup tjetër ose një organ i ATK-së, e jo një person, sepse përsëri është formë e centralizuar.

Në fund, unë mendoj se secili paragraf ka gabime gjuhësore, kalke, përsëritje, formulime të ndikuara nga gjuhët e tjera. Nuk përjashtohen, nuk përfillen versionet shqip, anglisht, serbisht, por bëhen përkthime bukfalet, të drejtpërdrejta, pa i parë natyrat e këtyre gjuhëve. Ka shumë, por nuk po ndalem këtu, se do të duhej një kohë më e gjatë që të bisedohet për këtë. Ndoshta bisedojmë diku tjetër, por nëpër komisione duhet të japim

kontributin atje, por parimisht e votoj, meqë edhe në grupin parlamentar jemi marrë vesh kur do t'i shqyrtojmë këto më hollësisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi, të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues për fjalën e dhënë!

Unë personalisht do të votoj kundër edhe në leximin e parë, duke pasur parasysh disa prej faktorëve dhe njëri prej faktorëve kryesor është se mendoj që ligji, çfarë na është sjellë në Kuvend, nuk ka saktësi e as qartësi. Fjalitë janë shumë të gjata, që lejojnë shumë kuptueshmëri. Teknikat e hartimit të ligjeve s'është dashur, administrata sigurisht i dinë, edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me të gjithë ata ekspertë, që po i përmend ministri se i ka në Ministri, e di që nuk është mirë të jenë fjalitë kaq të gjata.

Për shembull, po e marrim nenin 14. Në nenin 14 kemi një fjali, ministër, e ke një fjali, i ka 101 fjalë. Që ka kush, as në beletistikë nuk lejohet një gjë e tillë. As në shkencë! Edhe ata që e kanë përdorur, 101 fjalë, një fjali! Prej pike në pikë. Unë veç një e mora kështu, si rastësisht, thashë hajt t'ia numëroj fjalët, 101 fjalë. Krejt ligji është përplot me fjali të stërzgjatura. Në momentin kur kemi fjali shumë të gjata, aty rritet mundësia të ketë shumë kuptueshmëri, e ligji me shumë kuptueshmëri nuk është mirë të na sillet. Kjo ishte nga teknikat e hartimit. Unë jam inxhinier, por kështu s'e kisha prurë.

Dhe, faktori i dytë, në përmbajtje do të trajtoj dhe sugjeroj, në nenin 12, apo në nenin 13, te krijimi dhe mbajtja e regjistrave, që në versionin e ligjit paraprak ka qenë neni 12, për shembull, fillon një fjali dhe thotë: "tatimpaguesit janë të detyruar të mbajnë libra dhe regjistra në pajtim me legjislacionin tatimor", pjesa tjetër e tekstit mbetet e pandryshuar. S'ka kurrfarë kuptimi! Ndoshta është.. por s'transmeton kurrfarë ndryshimi. Por, unë mendova kur e pash këtë gabim pikërisht në këtë nen, filloi të ma trazojë mendjen dhe fillova të mendoj – a thua është e qëllimshme? Sepse, pikërisht këtu kemi të bëjmë me arkat fiskale. Me arkat fiskale, sepse edhe në njërën prej pyetjeve parlamentare që i jam drejtuar ministrit – pse arkat fiskale janë kaq shtrenjtë, në krejt dhe në udhëzime administrative të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, kur flitet për pajisje me arka fiskale, e kemi një kaos. Për shembull, Udhëzimi administrativ 12/2009 për plotësim-ndryshim të Udhëzimit administrativ Nr 06/2009 – zyrtare nga ueb-faqja, e kam nxjerrë nga ueb-faqja e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, ky udhëzim administrativ nuk ekziston, ministër - 06/2009!

Dhe, tentova, thashë hajt ta lexoj. Po edhe brendësia e udhëzimit administrativ është një pështjellim dhe s'po di qysh ta emëroj, përpos se është me tendencë për të bërë pështjellim, për të krijuar një mjegull, që më pastaj të krijojë monopol në arka fiskale dhe të sillen dy kompani, të merren vesh ndërmjet veti dhe arka fiskale në Kosovë të kushtojë dyfish sa në Maqedoni. Dhe, më pastaj, për t'u arsyetuar përpara popullit, të dalë: e kemi hap ne tregun, ku në të njëjtën kohë iu dërgohen dënime – pse s'i keni blerë arkat fiskale. Me fjalë të tjera, gjithçka është mbrapsht, e përzier poshtë e lartë. Nuk ke të drejtë t'iu drejtosh dënime, pajisuni me arka fiskale, le ta ngopim tregun me këta që janë prezentë, kur ngopet tregu me këta që janë prezentë, ta hapim tregun për të tjerët. S'ke për kë e hap tregun më tutje. Kërkoj, pra, që në këtë ligj, neni 13 të jetë shumë më i saktësuar se si pajisen bizneset dhe ndërmarrjet me arka fiskale. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi dhe i fundit për këtë pikë të rendit të ditës, Driton Tali le të përgatitet!

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me leximin e draftit me kujdes, por edhe nga ekspozea që e tha ministri, mendoj që shihen edhe qëllimet edhe objektivat, po edhe ajo çka është mendua që të jetë si përmbajtje e këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve me

shumë rëndësi për këtë institucion, me plotë risi që i ka brenda. Unë, po ashtu po e përkrah zotëri Naimin, deputetin lidhur me atë që e tha se është vërtet vështirë të interpretohet dhe pastaj të nxirret një përfundim i logjikshëm në disa pjesë nga ajo stërzgjatje nëpër kapituj, e shihni edhe vetë.

Por, në anën tjetër, dua ta falënderoj ministrin që në fund të pikës së kaluar e pranoi dhe e tha se e pret me dashamirësi atë, kur ishte çështja e ndryshimit dhe plotësimit të amendamentit 3. Pa, të shohim pak, të testojmë pak edhe nja dy-tri çështje që do t'i shtroj këtu, në qoftë se e kanë rezonin ose arsyen e vet.

E para, ka të bëjë me vërejtjen në parim, pa i përmendur ato që u thanë nga kolegët, ku ka të bëjë me kapitullin i cili flet për ministrin dhe autorizimet e veçanta që i ka dhënë sa i përket shkallës së posaçme të rrogave në ATK, së bashku me disa çështje të tjera të cilat a janë në harmoni apo i tejkalojnë diçka, mos është diçka pak më tepër se që duhet.

Vërejtja tjetër e imja ka të bëjë me kapitullin, po ashtu, ku kemi te ndëshkimet dhe autorizimet. Një diçka tjetër që duhet, mendoj, të sforcohet brenda këtij projektligji, ka të bëjë, mendoj, që pas kësaj përvoje të madhe që ka ATK-ja, inspektorati i caktuar, unë mendoj që këtu duhet të shikohet pak të forcohet më shumë kontrolli, të forcohet më shumë kodi i punës, i cili ka në mes të biznesit dhe autoritetit të caktuar që inspekton, që aty mos të kemi pastaj abuzime dhe çështje të tjera, e së fundi të jetë qëllimi i ndëshkimit ose i dënimit. Mendoj që duhet të shikohet kjo pjesë.

Dhe, çështja e fundit, po ashtu që u përmend këtu nga kolegët, ndoshta po edhe unë nuk po e kaloj, do të jem i rezervuar të shoh modelin, zgjidhjen e ofruar tek kjo çka është dhënë në kapitullin përkatës lidhur me emërimin e drejtorit të përgjithshëm të ATK-së. Nuk e di si është ndonjë praktikë, në ndonjë vend tjetër, por të shihet pak ndoshta mos është një ndërlidhje e sforcuar në mes ministrit, në mes kryeministrit dhe procedurave të tjera të cilat ndoshta nuk janë të kënaqshme në kuadër të projektligjit për zgjedhjen e këtij... Mos është më e drejtë ta mendojmë pak çështjen e ndonjë paneli më të veçantë për shkak të rëndësisë dhe peshës së madhe që e ka ky autoritet, për natyrën e punës, për institucionin në të cilin zgjidhet, e përfaqëson, në mënyrë që ndikimi të jetë pak më i vogël. Pra, a ka mundësi që disi ta përthekojmë ose ta kodifikojmë në pikëpamje ligjore, në mënyrë që t'i ikim asaj, si të themi, pjesës, edhe pse politika dhe kjo shkojnë bashkë, po unë mendoj që duhet pak ta lehtësojmë, ta shkarkojmë pak nga kjo që është dhënë në projektligj. Prandaj, i mbetet komisionit funksional dhe mendoj që realisht të punojë, sepse ka peshë të madhe kjo. Pra, janë këto tri vërejtje parimore të cilat i vë në diskonim, zotëri ministër. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti, Driton Tali!

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kështu, i fundit, s'po më mbetet çka të flas, por po iu bashkëngjitëm edhe unë të gjithë atyre që e kritikuan këtë projektligj, në kuptimin e stilit të të shkruarit, se me të vërtetë është një përzierje që shumë vështirë është për ta kuptuar, për ta kuptuar edhe profesionisti, them njeriu i lëmisë, e aq më pak ata të cilët nuk janë të lidhur me këtë lëmi.

Kam edhe vërejtje të shumta, po mbase do t'ia jepja komisionit adekuat sa i përket edhe terminologjisë. Këtu kemi related persons, në faqe 8 - persona të lidhur. Nuk ma merr mendja se është përkthim adekuat. Pastaj, kemi edhe këtë “punëdhënësi” dhe pastaj është “i punësuar”. Mendoj se i punësuar është edhe punëdhënësi edhe punëtori. I punësuar ose duhet të jetë rrjedhimisht punëmarrësi, ose punëtori. Sepse i punësuar është edhe pronari i cili punon aty.

Ajo që desha ta ceku, është arsyeja pse ekziston ATK-ja. ATK-ja ekziston për ta mbledhur tatimin, në njëfarë mënyre për t'i disiplinuar ndërmarrjet apo bizneset, për të paguar borxhin e tyre ndaj shtetit. Dhe, këtu pikërisht me qëllim që ato të disiplinohen në mbajtjen e librave dhe të kontove. Këtu te neni 53, tash mos të shkojmë te neni 54, domethënë te ndëshkimet, është bërë, mendoj ose qëllimisht... Ja se çka thotë: “çdo

person”, pika 2 po them, neni 53, “çdo person nga i cili kërkohet të krijojë ose mbajë regjistrimin, përfshirë kërkesën për të vendosur numrin fiskal të biznesit në të gjitha kuponët dhe faturat e lëshuar sipas legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Kosovës dhe i cili nuk kryen këtë do t’i nënshtrohet një ndëshkimi administrativ, si vijon”.... Arsyeja pse biznesi gjithkund në botë nuk i bëjnë këto, është për ta ulur qarkullimin dhe për ta fshehur profitin dhe ATK-ja ka detyrë që mos t’i lejojë ndërmarrësit e pandershëm të bëjnë evazion fiskal. Dhe, ja se çfarë është ndëshkimi. Thotë, 2.3-shi: “tërë tatimpaguesit me qarkullim vjetor mbi 30.000 deri në 200.000 euro, gjoba është 250 euro”. Pastaj mbi 200.000 deri në 500.000 euro, gjoba është 500 euro dhe unë jam i bindur se secili ndërmarrës i talentuar do të ishte i kënaqur me këtë gjobë dhe unë s’di si mund ti disiplinohet. Po them, ka shumë, se është ligj voluminoz, unë besoj se edhe më tutje do të pastrohet. Unë jam në dilemë a ta përkrah a mos ta përkrah, pikërisht për shkak të disa lëshimeve esenciale që janë këtu.

Po them, për të mos e zgjatur, se po shoh deputetët janë lodhur, të shohim se çfarë do të bëhet, po pres çfarë po na propozon ministri. Përndryshe, është ligj jo i shkruar mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka ministri, Ahmet Shala!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më së pari, u kërkoj falje deputetëve jo shqipfolës për gjuhën sa u tha. Unë nuk e kam lexuar në gjuhët tjera, e kam lexuar në gjuhë shqipe dhe vërtet pas disa kritikave u përpoqa t’i kap disa segmente dhe shihet qartë se në gjuhën serbokroate nuk është përkthim adekuat dhe unë kërkova nga stafi im që menjëherë të bëjë gjithçka që është e mundur që para leximit të dytë dhe para shqyrtimit në komision të vjen një tekst më i pastër dhe më i saktë, të paktën në aspektin gjuhësor.

Sa i përket stilit të të shkruarit, unë vet nuk e kam shkruar ligjin, sinqerisht, por disa ligje janë detyrimisht që të detyrojnë të jesh pak më i gjerë në disa nene, ashtu sikur që i pash edhe unë dhe pajtohem se ndoshta disa nga nenet janë tepër të gjata, por qëllimi i këtij ligji në fund të fundit është që t’i japë Administratës Tatimore pushtet dhe forcë për të zgjedhur më shpejt aspektet që kanë të bëjnë me keqpërdorimet, t’i japë forcë inspektorit, t’i japë efikasitet institucionit që të veprojë shpejt.

Niveli i gjobave ka të bëjë për një rast të caktuar të kapjes, jo për tërë. Pra, në qoftë se inspektori shkon dhe e kap një subjekt ekonomik për një faturë të mos lëshuar, ato janë shkallë të gjobitjes.

Të drejtën të them, nuk kam ndonjë sens tani për tani për të reaguar se a është shkallë shumë e lartë apo shkallë shumë e ulët. Nuk është qëllim në veti gjobitja. Qëllim i çdo ligji është edukimi dhe përpjekja që përmes një edukimi të konsumatorëve dhe të vetë ndërmarrësve të respektohet ligji.

Gjithsesi neve në komisionin parlamentar do ta shqyrtojmë këtë me shumë seriozitet dhe falënderoj deputetin për këtë që e ngriti.

Sa i përket çështjes së drejtorit, deri në fazën tranzitore, drejtori i Administratës Tatimore sikur që është edhe drejtori i taksave, i thesarit dhe doganave, pas aprovimit nga Qeveria duhet të merret pëlqimi nga përfaqësuesi ndërkombëtar, pra TCN-ja.

Nuk është praktikë e mirë që të ndërhyhet në nivele më të ulëta, e kam fjalën, nga ndonjë panel, përveç ndonjë rasti të jashtëzakonshëm. Ne kemi pru këtu Ligjin për Agjencionin e shpëlarjeve të parave, faktikisht që kemi përcaktuar një panel për përzgjedhjen e drejtorit, por jo të zëvendës drejtorëve dhe nuk do të konsideroj se është zgjedhje e mirë. Gjithsesi, ju falënderoj për observimin dhe rekomandimet dhe do të përpiqem që disa nga vërejtjet që i dhatë gjatë shqyrtimit me deputetët, t’i tejkalojmë disa nga elementet që besoj do të jenë në përmirësim të ligjit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, ministër!

Më lejoni, të nderuar deputetë, që në fund të këtij debati të kërkoj deklarinimin tuaj me votim për miratimin, në parim, të këtij projektligji.

Në sallë janë prezent 63 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 54 vota “për”, 4 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, dhe komisionet e përhershme, të cilat duhet që në afatin më të shpejtë të mundshëm Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës për sot:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Konstatimet hyrëse: Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj – besoj raportuesen e Komisionit funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, zonjën Nerxhivane Dauti që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. E keni fjalën, deputete.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Në cilësinë e udhëheqëses së Grupit punues për hartimin e amendamenteve lidhur me Ligjin kundër dhunës në familje, konstatoj se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe ka konstatuar se në përmbajtjen e disa neneve të këtij projektligji është e nevojshme të bëhet amendamentimi.

Me qëllim të rritjes së efektit normues të neneve, në mënyrë që ato të jenë sa më të qarta, me qëllim që të lehtësohet zbatimi i tyre në praktikë, Komisioni ka hartuar amendamentet për nenet 1, 2.1, 3.3, 4.1.

Në nenin 13 është paraparë të shtohet një paragraf i ri.

Është bërë amendamentimi edhe në nenet 14.1, 14.1.4, në nenin 27 dhe 28.1, ndërsa në nenin 22 është shtuar një paragraf i ri.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, duke marrë parasysh nevojën që ligji të jetë sa më i qartë për zbatim, ka propozuar ndryshime dhe plotësime në formë të amendamenteve dhe i rekomandon Kuvendit të Republikës së Kosovës miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara. Komisioni ka hartuar gjithsej 13 amendamente. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport nga komisioni funksional.

Në sallë janë 61 deputetë.

Amendamenti 1.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 59 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Në sallë janë 62 deputetë.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5.

Për amendamentin e radhës 5, fjalën e ka deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Këtu është një gabim ose një lëshim teknik, ku thuhet, tek neni 4.1, në rreshtin 3, pas fjalëve “masë tjetër” shtohet fjala “parandaluese”. Mendoj se këtu duhet “masë parandaluese”, sepse fjalia nuk do të kishte kuptim po qe se nuk do të kishte parashtrësën në fjalë “parandaluese”.

Nëse dëshironi, mund ta lexoj. “Masë mbrojtëse e trajtimit psiko-social mund t’i shqiptohet kryerësit të dhunës në familje në kombinim me ndonjë masë tjetër” ka qenë, domethënë hiqet. Nëse mbetet “parandaluese” atëherë s’do të ketë kuptim fjalia. Prandaj, duhet “masë parandaluese”. Faleminderit!

KRYESUESI: Referuesja, a e dëshiron fjalën? Nerxhivane Dauti e ka fjalën!

NERXHIVANE DAUTI: Ekzistojnë masat e ndryshme parandaluese, prandaj Komisioni ka vendosur në këtë mënyrë. Ekzistojnë, do të thotë, edhe në raste tjera është kështu. Është masë tjetër parandaluese.

KRYESUESI: Zef Morina e ka fjalën, prapë.

ZEF MORINA: Po, këqyrni, fjala “masë parandaluese” duhet të shtohet, do të thotë vetëm “masë”, sepse këtu thuhet të hiqet. Jo, thotë të hiqet, “masë tjetër” të hiqet dhe të shtohet vetëm “parandaluese”, a kuptoni. Përndryshe, është dashur të shkruhet, të hiqet vetëm “tjetër”, ndërsa t’i shtohet “parandaluese”.

KRYESUESI: Konstatohet se edhe në emër të komisionit pranohet kjo vërejtje e deputetit.

(Ndërhyrje)

Bahri Hyseni e ka fjalën!

BAHRI HYSENI: Unë konsideroj se deputeti nuk e ka versionin përfundimtar, është duke lexuar diçka tjetër. Prandaj, është mirë të shikohet çka është duke lexuar.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Debati u krye për këtë pikë, për këtë amendament. Vë në votim amendamentin 5. Pra, versioni i komisionit funksional.

Konstatoj se me 54 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 51 votë “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, një “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 56 votë “për”, një “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

Dhe, i fundit, amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

Në sallë janë 63 deputetë.

Lus deputetët që të përgatiten për votimin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash:

Konstatoj se me 61 votë “për”, 1 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë

Konstatime hyrëse: Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme dhe Siguri, deputetin Rustem Mustafa që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime. Deputeti, Rustem Mustafa e ka fjalën!

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuar kryesues i Kuvendit,
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për klasifikim të informatave dhe verifikimin e sigurisë është miratuar në lexim të parë në seancën plenare, datë 18. 12. 2009, ndërkohë që Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri është caktuar si komision funksional për shqyrtimin e këtij projektligji.

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri ka caktuar grupin punues, i cili ka mbajtur takime në të cilat janë involvuar edhe akterë relevantë për shqyrtimin e këtij projektligji.

Qëllim i këtij ligji është themelimi i një sistemi unik për klasifikimin dhe ruajtjen e informacionit që ka të bëjë me interesat e sigurisë së vendit, si dhe për verifikimin e sigurisë së personave që kanë qasje në këto informacione.

Në mënyrë që Projektligji të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe të rregullojë të gjitha institutet juridike të kësaj fushe, në pajtim me mendimet dhe opinionet e ekspertëve dhe në të njëjtën kohë të adresojë edhe shqetësimin e qytetarëve, Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, gjegjësisht Grupi punues ka organizuar një dëgjim publik, i cili është mbajtur me datë 15.01.2010, ku kanë qenë të ftuar përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, si ICO, EULEX, OSBE dhe grupe tjera të interesuara, si dhe asociacione tjera, të cilat kanë bërë rekomandime dhe komente të ndryshme përkitazi me dispozitat konkrete të projektligjit.

Raporti final me rekomandime për këtë projektligj, i proceduar në Kuvend, përmban gjithsej 36 amendamente.

Për të qenë plotësisht i zbatueshëm projektligji, të cilin e kemi sot para veti, jemi përkujdesur dhe kemi theksuar nevojën që sipas nenit 51, amendamenti 36 të Ligjit në fjalë, aktet nënligjore do të hartohen nga ... dhe miratohen nga Qeveria.

Ligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë zbatohet ndaj të gjitha institucioneve publike që ushtrojnë kompetenca ekzekutive, legjislativë dhe gjyqësore, Presidencës së Kosovës, ndaj personave fizikë dhe juridikë, të cilët në çfarëdo forme mund të kenë qasje në informacionet e klasifikuara.

Komisioni ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit në fjalë, me amendamentet e propozuara, ofrojnë një kornizë ligjore lidhur me klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë, andaj i rekomandojmë Kuvendit miratimin e Projektligjit për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është lajmëruar deputeti Sabri Hamiti. Unë konsideroj se duhet të cekim... Urdhëroni! Për amendamentin 1 doni ta merrni fjalën? Faleminderit! Lidhur me këtë, desha të theksoj se në bazë të Rregullores, nuk parashihet debat. Faleminderit!

Pra, kalojmë në votimin e amendamenteve veç e veç të komisionit funksional në lidhje me këtë projektligj.

Amendamenti 1.

Për fjalë është paraqitur deputeti Sabri Hamiti. Urdhëroni, zoti deputet!

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues! Bile unë e ti jemi moti këtu dhe e dimë kur duhet e qysh të lajmërohemi, prandaj u lajmërova më herët për të mos me u bërë ndonjë konfuzion më vonë.

Unë mendoj që amendamenti numër 1, nuk duhet të votohet. Dhe, pse s'duhet të votohet? E di që Komisioni është përpjekur ta bëjë kishe një precizim gjuhësor, por e ka bërë të kundërtën. Projektligji për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë duhet të mbetet kështu, sepse në shqip informatë dhe informacion ka dy kuptime, dy konotacione që nuk është e njëjta. Informata, do të thotë sasi faktesh e të dhënash që është saktësisht çka kërkon ligji, ndërsa informacioni, në të vërtetë, prodhon kuptimin themelor në shqip – një proces.

Pra, po i bie shkurt. Mendoj që varianti i amendamentit nuk duhet të votohet sepse nuk e precizon, përkundrazi, e komplikon titullin dhe përmbajtjen e titullit dhe të ligjit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të komisionit, Rrustem Mustafa e ka fjalën. Ju lutem, shtypni butonin dhe me këtë edhe kërkon fjalën!

RRUSTEM MUSTAFA: Unë nuk do të flas shumë për gjuhën se cila duhet të përdoret, por po flas për terminologjinë juridike.

Kemi pasur shumë ekspertë para vetes, shumë njerëz që janë marrë edhe me terminologjinë juridike dhe ata e kanë bindur komisionin se termi “informacion” e saktëson informatën të cilën duhet ta ruajmë ose ta japim. Informata bëhet më shumë dhe ky është qëllimi pse komisioni është bindur dhe komisioni në tërësinë e tij ka votuar për këtë amendament, prandaj kërkoj nga deputetët që ta votojnë amendamentin numër 1.

KRYESUESI: Faleminderit! E vë në votim amendamentin 1, varianti i komisionit funksional. Votojmë tash:

Në sallë janë 62 deputetë.

Ju faleminderit! Me 25 vota “për”, 23 “kundër”, 9 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 1.

Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, kryesues!

Kam parasysh amendamentin numër 1. Tjetër është ne çka votojmë, po çka do të duhej të ishte në realitet. Dhe atë që e tha deputeti Hamiti, ka plotësisht të drejtë. Ky Kuvend nuk duhet të bëjë gabime të tilla, të cilat duhet të përmirësohen në të ardhmen. Prandaj, kjo ishte një çështje.

Dhe, çështja e dytë, sepse nuk do ta marr më fjalën, është te neni 50 atje, kur të shkojmë te ai amendament. Pse ky ligj të parashohë mënyrën e sanksionimit penal, kur ne e kemi Kodin penal. Nëse në secilin ligj përshkruhen veprat penale, atëherë shtrohet pyetja – çka i duhet vendit Kodi penal për deri sa të gjitha, në secilin ligj, parashihet. Prandaj, do të ishte mirë që të mos ngutemi, por të nxjerrim ligje ashtu çfarë do të duhej nxjerrë dhe jo vetëm të votojmë për diçka të cilën plotësisht ka të drejtë deputeti Hamiti në kërkesën e parë. Janë informata – informacione.

KRYESUESI: Lus deputetët që t’i përmbahen Rregullores së Punës që e kanë votuar vetë. Unë i jam përmbajtur Rregullores së Punës dhe aq deputetë kanë menduar se komisioni funksional e ka mirë dhe është votuar dhe ju lus të mos ndërhyjni dhe përmbajuni Rregullores së Punës të Kuvendit.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3.

Armend Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Është vetëm vërejtje parimore, për shkak edhe të terminologjisë gjuhësore që po e përdorim, por edhe të hierarkisë kushtetuese. Unë mendoj që duhet të jetë kështu dhe po e citoj, meqë e keni ligjin para veti: “Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha institucioneve publike që ushtrojnë kompetenca”, së pari duhet të jetë “legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore” si dhe “ndaj Presidencës së Kosovës”. Kjo është e para, si vërejtje.

Dhe, e dyta është, kërkoj që në tërë tekstin ku është “e Kosovës” të përdoret “Republikës së Kosovës” sepse edhe ashtu ka laramani në terminologji, diku është “e Kosovës” diku është “e Republikës së Kosovës” dhe kjo të mos na përdoret apo të na paraqitet si shprehje dhe atëherë po i kemi devijimet e mëtutjeshme gjatë këtij fjalori.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të komisionit, nëse ka? Po, urdhëroni. Deputeti Rustem Mustafa e ka fjalën.

RRUSTEM MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Për këtë terminologji e kemi konsultuar edhe legjislacionin shqiptar. Edhe në Shqipëri është, po flas edhe për të parën – informacion, edhe në Kushtetutë është informacion. E kam për të parën.

Dhe, për të dytën, e kemi konsultuar terminologjinë edhe shqiptare, por kemi konsultuar edhe shumë njerëz konsulentë që janë profesionistë të fushave të vendit tonë, prandaj mbetem pranë qëndrimit të komisionit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Vë në votim amendamentin 3 dhe votojmë tash:

Me 47 vota “për”, 6 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Amendamenti 4.

Për fjalë është paraqitur deputeti Gani Buçinca.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Dëgjoni si është formuluar gjuhësisht ky amendament, edhe amendamenti 3, por që, për të katërtin po flas. “Ky ligj zbatohet edhe ndaj personave fizikë”. Nuk thuhet kështu, amani ju qoftë! “Ky ligj është i detyrueshëm ndaj personave fizikë dhe juridikë” formulim gjuhësor krejt, krejt, ku ta dimë në çfarë sintakse sillave apo ku ta di unë, çfarë sintakse është. Ashtu shkoi edhe amendamenti numër 3.

Domethënë “ky ligj është i detyrueshëm edhe ndaj personave fizikë dhe juridikë” e jo “ky ligj zbatohet edhe ndaj...”. Do të thotë, kështu duhet të jetë një formulim, më i qartë gjuhësor. Ndoshta edhe ka ma të saktë gjuhësisht, unë s’jam ekspert gjuhësor, por kështu qysh është, nuk mund të jetë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Mendoj se duhet të provojmë për të ndihmuar për një sqarim, jo të jetë ashtu – jo patronizim. Amendamentet i ka bërë komisioni. Amendamente kanë të drejtë t’i sjellin edhe deputetët vetë.

Mirëpo, diskutimi për nenet e amendamenteve, pra amendamentet në këtë rast, nuk mundet të jetë sjellja e amendamenteve të reja në këtë seancë, për shkak se komplikohet votimi. Mendoj se Kuvendi e ka një problem, që këtë material që e kemi marrë ndoshta nuk është diskutuar sa duhet nëpër grupe parlamentare, sepse nëse ishte diskutuar, atëherë në komision ishin bërë diskutimet të cilat po bëhen sot. Nuk mund të nxjerrim ide të reja tani. Këtu diskutohet për ta votuar apo mos votuar amendamentin, përndryshe po na komplikohet puna në seancë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë iu përmbajta vetëm Rregullores së Kuvendit, neni 58, paragrafi 1 dhe jam i detyruar që kur kërkohet fjala para votimit të amendamentit, ta jap fjalën. Vë në votim amendamentin 4 dhe votojmë tash:

E kemi fjalën për versionin e komisionit funksional. Faleminderit!

Me 48 vota “për”, 3 “kundër”, 11 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Me 51 vota “për”, 1 “kundër” dhe 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 1 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

Në radhë është amendamenti 13.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 3 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Me 60 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Me 51 votë “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 22.

Në sallë janë 70 deputetë.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Me 57 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 27.

Amendamenti 28.

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 28.

Amendamenti 29.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 29.

Amendamenti 30.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 30.

Amendamenti 31.

Fjalën e kërkon deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Problemi është që të gjitha, përafërsisht të gjitha këto amendamente kanë një përpjekje të precizimit gjuhësor, në princip, rreth 90%, por në këtë farë malli për ta bërë këtë punë që e ka bërë një lektor, po më duket mua, i cili bash mirë edhe s’e di shqipen. Gabimi i madh ishte 1-shi. Ai shkoi.

Unë po ju them që edhe 31-shi. Kjo që e kanë provuar këta, është veç se për ta mjegulluar kuptimin e parë që është shumë i saktë, se kuptimi i parë është – titulli i këtij neni reformohet, është qasje urgjente në informatat e klasifikuara, është shumë e qartë. Janë informatat e klasifikuara dhe ka qasje urgjente ose të jashtëzakonshme në to.

Ajo që është propozuar, thotë: “qasja në informacion të klasifikuar në raste të jashtëzakonshme”, absolutisht nuk është ky kuptim. Nuk ka të bëjë me këtë. Ato janë paraprakisht të klasifikuara. Po, çështja është në to. Domethënë, është... Komisioni le ta shohë vetë, unë vetëm po sugjeroj që ajo që është bërë, është e kundërta e objektit kryesor të nenit. Kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të komisionit, fjalën e ka deputeti Rrustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: Zoti kryesues,

Unë ju thashë, kjo fjalë në Kushtetutë të Republikës së Kosovës është informacion. Në legjislacionin shqiptar i thonë informacion. Unë e di se profesor Hamiti e di gjuhën më mirë se unë, por unë po ju them se njerëzit e terminologjisë juridike, të çdo niveli profesional, i kemi konsultuar dhe kanë prurë këto përfundime, të cilat ne po ju sugjerojmë t’i aprovoni, me këto amendamente. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Ibrahim Makolli e ka fjalën!

IBRAHIM MAKOLLI: Po më duhet edhe një herë që ta përkrah atë që tha profesor Hamiti, sepse e ndryshon rrënjësisht amendamenti i propozuar.

Kjo i bie njëjtë sikur që nganjëherë na bie të dëgjojmë, të themi: dyer për garazha automatike. Nuk e dimë a janë garazhat automatike apo dyert. Në këtë rast, amendamenti i komisionit nuk do të duhet të kalojë, sepse ndryshon krejt qasjen. Thotë: “për informacione të klasifikuara në raste të jashtëzakonshme”. Qëllimi është në raste të jashtëzakonshme të jetë, jo e kundërta. Prandaj, amendamenti i komisionit nuk do të duhej të shkojë, sepse e ndryshon komplet pjesën...

KRYESUESI: Deputeti Sabri Hamiti e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Unë respektoj absolutisht punën e komisionit, mos ta marrim ndryshe, prandaj është Kuvendi, se është Kuvendi që vendosë, Komisioni propozon. Unë e respektoj punën e tyre, atje ku ka nuanca.

Këtu më s'kemi të bëjmë me konceptin informatë – informacion. U krye ajo punë! Këtu kemi derivim të kuptimit. Kuptimi që ofron formulimi i komisionit, e tjetëron kuptimin e alinesë. Kaq, le ta lexojnë mirë, nëse këta mendojnë, le të votojnë deputetët. Unë e kisha parasysh ligjin, kurrë më shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Votojmë për amendamentin 31, kuptohet varianti i Komisionit.

Votojmë tash:

Me 14 vota “për”, 37 “kundër”, 10 abstenime, nuk kalon amendamenti 31.

(Reagim i deputetëve)

Mbetet qysh ka qenë në ligj!

Amendamenti 32.

Votojmë tash:

Me 54 vota “për”, 3 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 32.

Amendamenti 33.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 2 “kundër”, 6 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 33.

Amendamenti 34.

Votojmë tash:

Me 52 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 34.

Amendamenti 35.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 35.

Amendamenti i fundit, 36.

Votojmë tash:

Me 56 vota “për”, 1 “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 36.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Në sallë kemi 72 deputetë. Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 1 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për klasifikimin e informacionit dhe verifikimin e sigurisë, me amendamentet e votuara sot.

Ju faleminderit! Seanca vazhdon punën të hënën, në orën 10:00 Ju faleminderit!

Nuk është seancë e re, por vazhdohet seanca, propozim ka qenë i rendit të ditës sot.

E hënë, më 5 korrik 2010, ora 10:00

Drejton seancën: kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuari kryeministër, ministra të Kabinetit qeveritar,

Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 1 korrik 2010, për pikën e mbetur.

Konstattoj se në sallë janë të pranishëm 62 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia nisur me punë.

Para se të fillojmë rendin e ditës, shfrytëzoj rastin që t'i them disa fjalë për zhvillimet e fundit në pjesën veriore të Kosovës, konkretisht me plagosjen, do të thotë tentim vrasjen e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Petar Miletij, i cili është plagosur, të cilit i dëshirojmë shërim të shpejtë.

Konsideroj që këto zhvillime janë duke ndodhur në prag të opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për statusin politik të Kosovës dhe të gjitha këto zhvillime janë duke ndodhur në prag të këtij opinionit dhe të gjitha këto ngjarje janë të iniciuara, të nxitura, ndoshta edhe të kryera, por këtë duhet ta konstatojnë hetimet që do të bëhen, nga politika serbe e Beogradit.

Ne kërkojmë që edhe Këshilli i Sigurimit, që do të mbledhet këto ditë, ta ketë parasysh se të gjitha këto aksione janë të nxitura, të shtyra dhe të organizuara nga politika e Beogradit, e cila do ta shfrytëzojë edhe këtë rast për të bërë një sulm mbi shtetin e pavarur, sovran dhe demokratik të Kosovës.

Fillojmë me rendin e ditës. Urdhëro! Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit, zoti Krasniqi!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Veç e theksoi kryetari i Parlamentit, por dëshiroj që rreth kësaj çështje të prezantoj para jush dhe para të gjithë qytetarëve të Kosovës qëndrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe në të njëjtën kohë edhe informatën për ju.

Fillimisht, dua të shpreh keqardhjen time të thellë për ngjarjen fatale që rezultoi me humbjen e jetës së një qytetari të Republikës së Kosovës si pasojë e shpërthimit në veri të Mitrovicës. Me këtë rast, unë i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së të ndjerit, do të thotë, për ngjarjen e së premtës.

Dëshiroj t'ju informoj se organet kompetente vendore dhe ato ndërkombëtare janë duke punuar që t'i ndriçojnë rrethanat e këtij rasti.

Siç edhe jeni të informuar, Qeveria e Republikës së Kosovës ka hapur një qendër – zyre për shërbimet civile në veri të Mitrovicës. Është ky vendim pas 11 viteve të lirisë së Kosovës. Kjo qendër do të ofrojë shërbime që janë të nevojshme dhe të domosdoshme për të gjithë qytetarët që jetojnë në atë pjesë të Republikës së Kosovës. Në këtë qendër do të punojnë zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe janë duke punuar, gjithashtu, edhe të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe të autoriteteve lokale të komunës së Mitrovicës.

Qytetarët e Kosovës, të të gjitha komuniteteve, do të mund të pajisen në këtë zyrë me dokumente të ndryshme personale për nevojat e tyre. Kjo qendër iu shërben të gjithë qytetarëve që jetojnë në atë pjesë të Mitrovicës dhe nuk paraqet rrezik për askënd, përkundrazi është ndihmesë dhe shërbim për të gjithë.

Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar që t'iu sigurojë shërbime të gjithë qytetarëve të Kosovës kudo që jetojnë ata, pavarësisht përkatësisë etnike.

Qeveria e Republikës së Kosovës i fton të gjithë qytetarët që të përmbahen nga veprimet e dhunshme, të rrinë të qetë dhe pakënaqësitë eventuale t'i shprehin në mënyrë paqësore dhe demokratike.

Dua të ritheksoj edhe një herë se Qeveria e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar për sundimin e rendit dhe të ligjit për t'u shërbyer të gjithë qytetarëve anekënd Republikës së Kosovës.

Në ditët e ardhshme pres dhe jemi duke punuar për hapjen e gjykatës në veri. Ky vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës është kushtetues dhe ligjor, në pajtim me dokumentin e presidentit Ahtisari dhe ju ftoj të gjithëve për mbështetje të këtyre angazhimeve, në mënyrë që të mos politizohet ky proces. Jam i vendosur, por edhe Qeveria e Kosovës është e vendosur dhe nuk do të ketë kthim prapa për asnjë milimetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër, ministra,

Kolegë të nderuar,

Kryetari i Kuvendit e tha dhe unë mendoj që është një shenjë shumë e keqe që ne kemi sot një atentat ndaj një deputeti të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe një shefi të grupit parlamentar.

Mendoj që është momenti që ky Kuvend, kjo Qeveri dhe të gjithë ata që janë partnerë ndërkombëtarë në ndërtimin e Kosovës të kërkojnë një punë shumë më efektive të organeve të cilat e ndjekin krimin.

Zonja dhe zotërinj,

Veriu i Mitrovicës u vërtetua se është qerthull i krimit. Ne duhet të kalojmë nga deklaratimet retorike në të gjitha nivelet, edhe institucionet tona, edhe institucionet ndërkombëtare që kanë marrë mandat të krijojnë siguri – në veprim konkret. Nuk mjafton që të themi ne, as ne si deputetë, as Qeveria, as partnerët ndërkombëtarë që kurrkush nuk është mbi ligjin. Është atje ku ka krim të organizuar, ka njerëz që janë mbi ligjin. Së paku, tash për tash. Dhe, kjo u vërtetua në dy veprime që ndodhën brenda disa ditësh.

Mendoj që ata që kanë marrë mandatin që të merren me sundimin e ligjit atje, duhet ta ushtrojnë funksionin e vet. Nuk ka mundësi që ligji të respektohet me lutje. Respektimi i ligjit do detyrim dhe shteti e ka detyrë ta kryejë këtë detyrim.

Unë po flas sot kështu, sepse e njoh historinë e rrezikimit të njerëzve që përfaqësojnë. Sot, kemi një tentim vrasje politike dhe kjo duhet të thuhet – në një moment shumë delikat politik për Kosovën, sepse është atakuar një njeri i cili përfaqëson komunitetin e vet dhe punon për integrimet në institucionin e Kosovës.

Unë personalisht i shpreh ngushëllime familjes së tij dhe shpresoj se do të shërohet. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi tema është serioze, unë kisha kërkuar, nëse të gjithë shefat e grupeve parlamentare donë të deklarohen. Atëherë, fjalën e ka kërkuar deputeti Ibrahim Gashi, në emër të Grupit të AKR-së.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përshëndetje zoti kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe unë, edhe në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së i bashkohem shqetësimit që shprehën edhe kryetari i Parlamentit, edhe kryeministri, edhe kolegu nga LDK-ja.

Natyrisht, është shqetësim i të gjithë ne kjo që po ndodhë, do të thotë është obstrukcion i hapur i politikës së një shteti për të minuar gjithë progresin që është arritur në shtetin e ri të Kosovës. Dhe, natyrisht, asgjë s'është koincidence këtu, kemi të bëjmë me përsëritje të zgjedhjeve në mënyrë të qëllimshme gjëja se atje s'po krijohet koalicioni në një kohë kur ne shpallëm se do të bëjmë zgjedhje në komunat e veriut, ata përsëritën zgjedhjet, domethënë për të treguar se mund të minojnë çdo proces të përpjekjeve për integrim të asaj pjese.

Pastaj ndodhi shpërthimi i një mjeti shpërthyes atje, që la shumë të plagosur dhe një viktimë, të cilës, natyrisht, në emër të Grupit i shpreh ngushëllime. Dhe, së fundi, ataku më i rëndë që i bëhet institucionit të Kuvendit dhe institucionit të shtetit të Kosovës është plagosja e kolegut tonë, zotit Miletqi. Dhe, të gjitha këto ndodhin në një kohë, në një moment tepër të rëndësishëm për Kosovën, kur Kosova po pret mendimin e Gjykatës së Drejtësisë dhe kur me iniciativë të Serbisë është thirrur një mbledhje e Këshillit të Sigurimit për të treguar se gjëja në Kosovë përpiqet e bashkësisë ndërkombëtare për të ndërtuar një shtet të qëndrueshëm dhe funksional janë të pamundshme, do të thotë është një obstrukcion i hapur para të cilit, mendoj, edhe institucionet ekzekutive, po edhe ne si legjislativ duhet të jemi shumë më aktiv në kuptimin për të treguar se jemi të vendosur, ashtu siç edhe u tha këtu dhe siç e kemi thënë më se një herë – jemi të vendosur t'i zbatojmë aktet tona kushtetuese në gjithë territorin.

Në momentin që indolencia jonë, hezitimi ynë për t'i thënë këto gjëra dhe për të vepruar mungon, do të kemi veprime dhe inkurajim të veprimeve të tilla të qëllimshme për të minuar progresin në Kosovë.

Edhe një herë mendoj se ne të gjithë duhet të solidarizohemi me familjen e kolegut tonë, në mënyrë që sot ai të mos ndihet i vetmuar, por që të inkurajohen edhe ata kolegë serbë që janë pjesë e institucioneve të Kosovës dhe të mos dekurajohen për t'u frikësuar dhe për t'u tërhequr nga një, si të them, veprim shumë normal që është në interes të familjeve të tyre, në interes të integritetit, në interes edhe të integriteteve më të gjera. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, po shkojmë nga një për grup parlamentar. Fjalën ia kisha dhënë Ardian Gjinit, nëse është lajmëruar.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i uron shërim të shpejtë kolegut Miletqi. Në të njëjtën kohë mendojmë se është atakuar një ulës e Kuvendit të Kosovës, do të thotë i një përfaqësuesi të popullit të Kosovës, pa marrë parasysh çfarë grupi etnik i përket.

Mendojmë se Kuvendi duhet të silltet edhe më me rigorozitet dhe më me kujdes se sa që jemi duke u sjell tani në orët dhe ditët që vijnë, për shkak se, edhe një herë po e përsëris, ne konsiderojmë se një përfaqësues i popullit është sulmuar, është plagosur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDD-së, deputeti Nexhat Daci e ka fjalën.

NEXHAT DACI: Faleminderit, kryetar!

Unë mendova që një herë në përbërjen e Parlamentit do të demonstrohet serioziteti dhe mendova që fjala e kryetarit të Parlamentit ishte e mjaftuar, sepse kështu po dëshmojmë që as në kohërat kur duhet të jemi një, ne jemi shtatë ose 17 dhe bëjmë politikë të vonuar.

Kolege dhe kolegë deputetë,

LDD, të shtunën e ka bërë të qartë qëndrimin e vet në përkrahje të çdo hapi, që institucionet e Kosovës, populli i Kosovës e respekton kushtetutshmërinë, e respekton luftën e vet, e respekton traditën e vet dhe po frikohem që në vazhdimësi në më tepër se dy vite me Kushtetutë nuk po tregojmë pjekurinë e duhur, por po bëjmë politikë shumë sipërfaqësore.

Unë e them që ngjarjet e tashme tregojnë sa jemi të vonuar. Sa kemi pasur mungesë pro aktivitetit në respektimin e vetvetes, në respektimin e traditës, në respektimin e institucioneve dhe tani ngjajnë përdhosje edhe të Parlamentit dhe unë më tepër dola që të mbrohet deputeti, pa marrë parasysh i cilit grup parlamentar është dhe t'i jepet përkrahje veprimit të respektimit të Kushtetutës.

Është shumë e dhembshme, është shumë e dhembshme kur sa vite pas lufte, sa vite pas deklarimit të pavarësisë ne merremi me çështjet elementare të demonstrimit të shtetësisë. Prandaj, kolegë të mi të respektuar, LDD nuk është opozitë e shtetit, po që ish në kohërat më të vështira me veprimet e pushtetit dhe me deklarimet e këtilla. Për shtetin duhet të deklarohet gjithmonë një zë dhe të gjithë ne do të qëndrojmë pas. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pasi që veç shkua me grupe, Xhezair Murati e ka fjalën dhe pastaj Branislav Gërbiq.

DŽEZAIR MURATI: Hvala, gospodine predsedniče!

Pozdrav premijeru, zamenicima, ministrima, kolegama u ovom teškom trenutku i mi delimo zajednički stav da je ovo zaista jedan težak trenutak za demokratiju, za sprovođenje zakona, za ravnopravnost građana, udar na državu, mladu državu Kosovo.

Kolega Miletić, koji nam je kratko vremena kolega, mogli smo da primetimo da je imao jednu viziju realnosti, jedno dobro poznavanje situacije, da je svojim iskorakom da bude deo ovih institucija u stvari pokazao svoju viziju zajedničkog življenja svih građana Kosova.

Danas kada se u ovom teškom trenutku saosećamo sa povređenim, odnosno napadnutim Miletićem, mi izražavamo saosećanje i sa žrtvama ovog vandalskog čina, sa povređenima, sa žrtvom, ali danas je prilika da kažem da smo i ranije ukazivali na jedan deo Bošnjaka koji žive na Kosovu, na krajnjem severu Kosova, selo Rvatska i neki zaseoci oko njega, kada sam i lično premijeru gospodinu Thačiju ukazivao na poteškoće i ostalim predstavnicima Vlade, ali razgovarao i sa tadašnjim predsednikom opštine Mitrovica, gospodinom Redžepijem, sa kojima sam razgovarao o veoma velikim poteškoćama sa građanima Bošnjacima koji Kosovo doživljavaju kao svoju državu na severu Kosova.

Ja razumem možda i teškoće sa kojima se suočava naša Vlada, ali mi ne shvatamo jednostavno apatiju, i ja bih rekao povremeno i dvoličnost predstavnika međunarodne zajednice koji nikako da shvate specifičnosti sa kojima se suočavamo na krajnjem severu.

Mislimo da je ovo trenutak kada neke stvari i istina konačno treba da se objasni. Mi pozivamo gospodina Miletića da se sa što manje posledica i fizičkih i psihičkih uključi u dalji rad na kojem je započeo, ali istovremeno apelujemo na sve predstavnike međunarodne zajednice, jer je sada, ja bih rekao, konačno lopta u njihovim rukama da se konačno obračunavaju sa onima koji koče i ometaju jedinstvenost Kosova i funkcionisanje naše države. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit! Branislav Gërbiq, e ka fjalën.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem, predsedniče!

Poštovani, gospodine premijeru, zamenice,

Gospodo ministri,

Dame i gospodo poslanici,

Ovo je trenutak koji je mogao da bude ali nije morao, ali je sigurno jedan momenat gde ipak moramo malo da raspravljamo o učešću predstavnika manjinskih zajednica i Srpske zajednice u institucijama Kosova. U ovom momentu kada čmo... na osnovu politike koju smo započeli 2004. godine i gde je sigurno nešto što se desilo i što je proces jedne tranzicije, jednog stvaranja države Kosova i u onom delu gde još uvek nisu zaživeli svi zakoni kako međunarodni, tako i Kosova. I sigurno je da je ovo momenat gde moramo da shvatimo i da prihvatimo jednu činjenicu, ono što smo i kao Poslanička grupa za integracije i kao predstavnici Srpske zajednice apelovali da je suviše malo predstavnika zajednice u onom delu koji njima pripada uključeno, da se suviše poverenja dalo vrlo malom broju ljudi od kojih smo zaista hteli mnogo odgovornosti za koje možda

nisu ni imali dovoljno kapaciteta. I sigurno da je mnogo bilo bolje da smo ukazali mnogo više poverenja ljudima i da smo prihvatili što veći broj onih građana koji žele da žive na ovim prostorima Kosova.

Još uvek vidite da je procenat izlaznosti na izborima, procenat odgovornosti građana Kosova koji ne žele da prihvate zakone, institucije i sam Ahtisarijev plan još uvek je veliki taj procenat. I to je nešto što sigurno treba da zbrinja prvenstveno nas Srbe, a sigurno i celu zajednicu na Kosovu. To je nešto što još uvek nije rešeno i što predstavlja problem u onom delu za koji smo evo imali i taj slučaj koji se desio u Mitrovici.

Rešavanja problema opštine Gračanica nije isto što i rešavanje problema Mitrovice. Mi smo to i na inicijativi LDD-ja hteli da razmatramo, međutim gospodin Miletić, o kojem nažalost danas razgovaramo, nije želeo da prihvati da pričamo, kao predstavnik Poslaničke grupe SLS nije hteo da prihvati tu temu. Sigurno da je možda imao razloga, možda nije imao razloga, ali sigurno je da je trebalo da se diskutuje i da se kaže, ako je bilo problema, koji su ti problemi.

I ono što ja zameram, to je danas da nemamo predstavnika nijednog ministra iz SLS-a ili člana Predsedništva koji bi ipak mogao da nam da neke konkretnije izveštaje, pošto se radi o njegovom zetu, da ipak možda ima više informacija.

Ja još jednom kažem da ovde nije stvar do institucija Kosova. Ovde je problem Mitrovice problem međunarodne zajednice. Mi Srbi koji smo ostali da živimo na Kosovu, mi smo ostali svesno da živimo i da radimo i sa Albancima, sa predstavnicima većinske zajednice. Mi nismo ostali zbog međunarodne zajednice, jer mi želimo da stvorimo odnose i zajednički život sa našim sugrađanima sa kojima smo živeli već vekovima i godinama. I to je nešto što je sasvim normalno i prihvatljivo. Mi ne želimo da budemo kolateralna šteta referenata međunarodne zajednice, referenata koji obilaze i koji manipulišu sa predstavnicima Srpske zajednice, koji žele da od bilo kakvog srpskog kadra naprave instituciju bez odgovornosti, koji nema sposobnosti da vodi ni svoju familiju a kamo li da vodi tako visoke institucije kao što su kosovske. Prema tome, hoću da kažem, meni je žao gospodina Miletića, meni je žao svakog čoveka, žao mi je i onog doktora koji je poginuo, jer zaista znači još uvek ta politička situacija nije rešena i smatram i pozivam gospodina premijera da što više Srba uključi u institucije, da što više prihvatimo odgovornost kako kolektivnu, tako i individualnu i da na osnovu rezultata pokažemo rezultate i spremnost da prihvatamo odgovornost zajedno sa vama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni! Kryeministri e ka fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, kryetar, edhe një herë!

Të nderuar deputetë,

Unë theksova edhe në fillim se vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës është vendim plotësisht në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës, me ligjet në fuqi dhe me dokumentin e presidentit Ahtisari.

Këto veprime, apo këto vendime janë vendime të cilat do të sjellin ligjshmëri edhe në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës që do të pasohen me rend demokratik, me zgjedhje të lira dhe investime në kuptimin e zhvillimit ekonomik. Pra, për rritjen e mirëqenies sociale të gjithë qytetarëve që jetojnë në këtë pjesë të Republikës së Kosovës.

Hapja e zyrës është një vendim i domosdoshëm për të qenë autoritetet vendore, për të qenë autoritetet legale, legjitime në shërbim të gjithë qytetarëve, pa dallim të përkatësisë etnike dhe kam kërkuar, siç po kërkoj edhe sot përsëri që ky proces i vënies së ligjshmërisë në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës të mos politizohet, të mos pretendohet të ndikohet apo, larg asaj, të partizohet. Iu kam kërkuar edhe zyrtarisht, në kuptimin përmes opinionit publik, edhe autoriteteve në Serbi që të distancohen nga veprimet e dhunshme, së ndikuari në veprimet e dhunshme, e në të njëjtën kohë edhe sot, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, iu kërkojmë autoriteteve zyrtare të Beogradit, zyrtarëve të Beogradit të distancohen nga sulmuesit

ndaj deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ndaj atyre njerëzve që pretendojnë ta pengojnë vënien e ligjshmërisë në këtë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës, sepse edhe sjellja e Beogradit në raport me Kosovën është dhe do të mbetet standard perëndimor për perspektivën e tyre evropiane.

Reagimi i Beogradit ka qenë ai si ka qenë, por ne do të vazhdojmë. Për fat të keq, ka pasur edhe pretendime nga ndonjë lider këtu që të deklarohet se ka qenë veprim i nxituar i Qeverisë. Qeveria e ka marrë një vendim i cili i ka munguar Kosovës në 11 vitet e fundit dhe është veprim kushtetues dhe ligjor. Pra, zyra do të vazhdojë së punuari, do të vazhdojmë me hapjen e gjykatës, e në të njëjtën kohë edhe kontrabandistët nuk do të jenë të qetë siç kanë qenë të qetë në këto 11 vitet e fundit, ju siguroj dhe garantoj në këtë drejtim. Në anën tjetër, nuk do të vazhdohet të lejohet që ajo pjesë e Kosovës të mbetet çerdhe e kriminelëve të luftës që kanë kryer krime ndaj popullatës shqiptare apo edhe qendër e kontrabandistëve apo kriminelëve tjerë që janë të strehuar aty dhe që ndiqen nga drejtësia kosovare dhe do të vazhdojmë me kontrollin e plotë të doganave. Faleminderit!

KRYETARI: Mendoj që e ekzagjeruam këtë pikë. Ju lutem, ne si Kuvend i Republikës së Kosovës kërkojmë nga Qeveria e Kosovës, nga EULEX-i, nga trupat profesionale që të marrin në mbrojtje Kushtetutën dhe ligjshmërinë dhe të mos merren shumë me deklarata politike.

Vazhdojmë me rendin e ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010

Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 25 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, e ka hartuar dhe Kuvendit i ka paraqitur për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve. Ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqet fjalën hyrëse. Më falni, atëherë le të urdhërojë ministri Shala, sepse unë e pata të shkruar kështu dhe kështu e lexova.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar zotëri kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë ministra,

Shumë të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që sot para jush të prezantoj rishikimin e Buxhetit për vitin 2010. Më lejoni që fillimisht t'ju informoj se ky projektligj i paraqitur para jush është një sukses i arritur i Qeverisë së Republikës së Kosovës pas shumë konsultimeve me dikasterë të caktuar të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe me faktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Qëllimi kryesor i rishikimit të buxhetit është përshtatja e politikave ekonomike dhe akomodimi i kërkesave me prioritet për organizatat buxhetore të mbështetura në obligime ligjore apo vendime të Qeverisë.

Negociatat e gjata të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar tanimë kanë përcaktuar nivelet e caktuara të shpenzimeve dhe kursimet përkatëse për vitin 2010. Ky rishikim këtë vit, siç e thashë, është më i veçantë pas arritjes së marrëveshjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar për përshtatjen e politikave ekonomike dhe politikave buxhetore, duke përcaktuar rritje të kursimeve të nevojshme të shpenzimeve për pjesën e mbetur të këtij viti.

Sidoqoftë, ndryshimet e ndodhura me rishikim të buxhetit për vitin 2010 kanë ndikuar në rishikimin dhe plotësimin e dokumentit edhe të Kornizës afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2011 – 2013, e cila është tanimë e harmonizuar.

Është me rëndësi të theksohet se ky proces nuk përfshin kërkesat për shpenzime shtesë nga disa organizata buxhetore dhe ky rishikim përfshin vetëm kërkesa që tashmë janë identifikuar dhe aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe që janë në harmoni me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Një aspekt që duhet përmendur këtu është edhe fakti se rishikimi i buxhetit ka ofruar gjithashtu një mundësi për harmonizime të brendshme ndërmjet programeve brenda organizatave buxhetore dhe efekte neutrale në kategori ekonomike.

Përderisa objektivi ynë ka qenë dhe mbetet që çdo rishikim të bëhet brenda kufijve fillestarë të buxhetit, qasja jonë megjithatë është se nuk është e thënë që të bëhemi rob të klisheve të caktuara, por novatorë në përpjekjet tona të gjetjes së burimeve shtesë dhe të kursimeve të nevojshme për financimin e projekteve të rëndësishme nacionale. Kështu, për shembull, në rast se gjenden burime shtesë të financimit pa rrezikuar qëndrueshmërinë fiskale, kufijtë fillestarë buxhetorë mund të ndryshohen varësisht prej nivelit të burimeve shtesë apo kursimeve të caktuara.

Në procesin e rishikimit buxhetor kemi pasur një kombinim të akomodimit të kërkesave të organizatave buxhetore brenda rregullimeve të brendshme, si dhe financime shtesë të pajtuara me Fondin për përshtatje të politikave sektoriale.

Më poshtë do të jap disa të dhëna specifike, të cilat konsideroj se meritojnë vëmendjen tuaj.

Është e rëndësishme të theksohet se në krahasim me buxhetin fillestar, ky rishikim ka arritur një ngritje të të hyrave prej 7,5%. Kjo padyshim nënkupton një rritje të madhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të të gjitha institucioneve shtetërore të Kosovës, duke marrë parasysh krizën ekonomike globale, e posaçërisht krizën financiare e cila ka kapluar tërë globin.

Kjo rritje e të hyrave reflektohet edhe në kategoritë e të dalave buxhetore. Ngritja në fjalë ekskluzivisht është e dedikuar për investime kapitale, kryesisht në projektin e autostradës, por edhe në projekte të tjera të rëndësishme kapitale të sektorëve të caktuar me prioritet.

Do të potencoj këtu edhe ngritjen e rezervës së buxhetit të shtetit nga 200 milionë në 241 milionë. Kjo ngritje besoj është tepër e rëndësishme në kohën e krizës ekonomike globale, por edhe në kohën kur dihet se Kosova nuk ka mundësi të zhvillojë politika monetare për shkak të mungesës së valutës së vet.

Përndryshe, procesi i rishikimit buxhetor është shënuar me rritje kualitative dhe kuantitative të indikatorëve të ndryshëm. Kjo është mundësuar nga kursimet e identifikuar që arrijnë shumën prej 51,5 milionë euro, e cila shumë rrjedh si rezultat i shkurtimeve prej 5,9 milionë euro nga kategoritë ekonomike - mallra dhe shërbime, natyrisht duke përjashtuar agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Kosovës, 5 milionë euro subvencione dhe transfere nga importi i energjisë, 10 milionë nga huaja e KEK-ut dhe 30,6 milionë euro nga kategoria e shpenzimeve kapitale.

Duke u mbështetur në politikat e Qeverisë së Republikës së Kosovës për të përfshirë sektorin privat në disa nga ndërmarrjet publike, me këtë rishikim kemi propozuar edhe deklarimin e dividendës nga Posttelekomunikacioni i Kosovës tanimë të deklaruar për 80 milionë euro, si dhe nga Aeroporti i Prishtinës prej 10 milionë euro.

Është e njohur tani se Qeveria ka marrë vendim për privatizimin e këtyre ndërmarrjeve dhe është e natyrshme që mjetet likuide që posedojnë këto ndërmarrje të jenë të vëna në dispozicion të pronarit, përkatësisht të Qeverisë së Republikës së Kosovës për financimin e projekteve me prioritet nacional.

Sa u përket financimeve shtesë, ato janë në pajtueshmëri të plotë me programin e Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe shuma më e lartë është ndarë në investimet kapitale për financimin e autostradës Morinë-Merdar prej 83,7 milionë euro dhe me këtë është përmbyllur me sukses nevoja për financimin e këtij projekti për vitin 2010 prej 130 milionë euro.

Projekte tjera të rëndësishme në këtë rishikim janë edhe prodhimi i pasaportave biometrikë për qytetarët e Republikës së Kosovës prej 2,5 milionë euro, prej të cilave 1,8 milionë investime kapitale dhe 0,7 milionë në mallra dhe shërbime.

Gjithashtu, financim shtesë është bërë në sektorin e shpenzimeve operative. Kategoria e pagave në shumë prej 16,3 milionë euro, për rritje të ndodhur në këtë vit të pagave, siç është në polici, shëndetësi, është fjala për 44 euro të famshme, e cila tanimë me këtë rishikim të buxhetit merr formën institucionale të përhershme të zgjidhjes së këtij problemi të trashëguar, Forcën e Sigurisë së Kosovës, rritjen e pagave për oficerë të burgjeve, sigurimin e pagave për rritjen e numrit të oficerëve në Shërbimin Korrektues të Kosovës, si dhe pagat për funksionimin e Ministrisë së re për Integritet Evropian, e cila tanimë është funksionale.

Është financuar pjesa e dytë për financimin për vitin 2010 të Radiotelevizionit të Kosovës në shumë prej 5,2 milionë euro, si dhe janë siguruar 1 milionë euro për fillimin e sigurimit të depozitave në bashkëpunim me KfV-në, pra Bankën për Zhvillim të Republikës së Gjermanisë, ku këtë vit kemi vu 1 milionë euro në dispozicion.

Gjithashtu, është rimbursuar programi i shpenzimit të paparashikuar prej 5 milionë euro, pra rezerva e shtetit, e dedikuar për shpenzime të jashtëzakonshme të institucioneve buxhetore.

Duke mos hyrë në detaje më të theksuara të këtij rishikimi të buxhetit, si ministër i Ekonomisë dhe Financave rekomandoj këtë buxhet të rishikuar si kontribut të mëtejshëm dhe të vazhdueshëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës dhe për rritjen e shkallës së mirëqenies së qytetarëve të saj.

Të nderuar deputetë,

Rishikimi buxhetor i këtij viti është në konsistencë të plotë me programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, strategjitë zhvillimore sektoriale, nevojat dhe prioritetet imediate si dhe politikat e hartuara nga ministritë e linjës.

Ky buxhet reflekton tërë dinamikën e punëve në shtetin tonë të ri, analizën, planifikimin adekuat dhe mbi të gjitha nivelin e lartë të përgjegjshmërisë ndaj fondeve publike. Andaj, si të tillë, kërkoj nga ju të gjithë që ta aprovojme në kohën sa më të shpejtë të mundshme, në mënyrë që të arrijmë që këto dhe ligjet tjera të cilat Qeveria e Republikës së Kosovës është zotuar se do t'i aprovojë si aksione paraprake, t'i aprovojme në kohën para se të mbahet bordi i Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili pritet të mbahet në javën e tretë të korrikut.

Duke ju falënderuar paraprakisht, unë me kaq po e përfundoj dhe do të jem në dispozicion sot këtu dhe në të ardhmen për të diskutuar dhe zgjedhur variante më të mira të mundshme për të aprovuar këtë buxhet dhe projekte tjera të rëndësishme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të flas me shifra sepse ato i tha vetë ministri i Ekonomisë dhe Financave. Ne para veti kemi buxhetin e rishikuar.

Unë dola të flas për dy çështje që kanë të bëjnë me buxhetin dhe që po na përcjellin edhe neve si Kuvend dhe si Komision për Buxhet dhe Financa. E para, është sepse edhe sot që po e lexojmë këtë dokument shumë të rëndësishëm këtu, Komisionit për Buxhet dhe Financa i kanë ardhur shumë kërkesa nga vetë sektorët e Ministrisë, përkatësisht ministritë e caktuara, kërkesa shtesë buxhetore dhe nuk di tash si kanë qenë të harmonizuara këto në Kabinetin qeveritar në mes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe ministrive përkatëse dhe kërkesat e tilla arrijnë gati në 20 milionë euro, prandaj ne si Komision për Buxhet dhe Financa do ta kemi shumë vështirë t'i harmonizojmë këto kërkesa dhe kishim lutur Qeverinë në këtë rast që të na ndihmojë ne si Komision për Ekonomi dhe Financa, sepse në qoftë se brenda Qeverisë nuk ka pasur një pajtueshmëri në mes të ministrive, me kërkesë të tyre, atëherë ne si Komision për Buxhet dhe Financa po dalim para do dilemave dhe do pamundësive tona edhe për sa i përket kapaciteteve tona të strukturimit ose të ristrukturimit të këtyre shifrave dhe të këtyre tabelave buxhetore.

Në anën tjetër, kemi mjaft agjencione buxhetore, që në raste të caktuara Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk i ka përfillë kërkesat e tyre, që mendoj se mund të jenë të arsyeshme, duke pasur parasysh ato që ne si komision i kemi para veti, prandaj në këtë drejtim do të duhej prapë Ministria e Ekonomisë dhe Financave të na ndihmojë që vërtet të harmonizojmë kërkesat e tyre në mënyrë që këto agjenci të jenë sa më funksionale dhe të kryejnë misionin dhe detyrën e vet mbi bazë të ligjit dhe të Kushtetutës.

Një çështje që veçanërisht duhet ta ngrejë këtu sot para jush, megjithëse kam pasur shumë presion edhe prej mediave, është çështja e kërkesës buxhetore të Gjykatës Kushtetuese. Ju e dini shumë mirë se, sipas ligjit, buxhetin e Gjykatës Kushtetuese e miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe pagat e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të administratës së Gjykatës Kushtetuese janë të përcaktuara me ligj dhe e dini shumë mirë se me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa ky Kuvend, më 29 dhjetor të vitit të kaluar, ka miratuar buxhetin e Gjykatës Kushtetuese në të gjitha linjat e saja buxhetore dhe Gjykata Kushtetuese nuk ka zbatuar vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për sa i përket ekzekutimit të pagave – në linjën – paga dhe mëditje. Unë dua të citoj ligjin për hir të opinionit, sepse edhe si person jam nën presion. “Paga e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese është 1.3 herë, do të thotë 30% më e madhe se paga e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme. Kjo është baza ligjore dhe kjo është formula me të cilën Komisioni për Buxhet dhe Financa ka përcaktuar pagën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Duke pasur parasysh rëndësinë e institucionit si kategori kushtetuese dhe si institucion më i lartë që mbikëqyr respektimin e Kushtetutës dhe kushtetutshmërinë e ligjshmërinë, ne si Komision për Buxhet dhe Financa kemi shkuar edhe me një shtesë mbi 54% të kësaj për secilin anëtar dhe kryetar të Gjykatës Kushtetuese.

Për sa i përket pjesës tjetër të asaj që quhet sekretariat, Ligji i Gjykatës Kushtetuese thotë shumë troç dhe shumë hapur se ai iu nënshtrohet të gjitha ligjeve që kanë të bëjnë me shërbyesit civilë, prej krijimit të marrëdhënies së punës deri te shpërblimet e tyre që i marrin. Po të merrni listën e pagave të ekzekutuara prej Zyrës së Thesarit dhe deri te departamenti i veçantë që është në Ministrinë e Administratës Publike, del se Gjykata Kushtetuese nuk ka respektuar këtë vendim dhe përkundër këtij vendimi ka bërë shtesa jo të rregullta për sa u përket pagave dhe mëditje dhe ka bërë alokime në 1/12, do të thotë të buxhetit që e ka pasur për çdo muaj për 55 punëtorë, ka tërhequr para për 55 punëtorë, ndërsa në Gjykatën Kushtetuese nuk janë të punësuar sot 55 punëtorë. Ndërsa kërkesa e tyre tash për një rishikim të buxhetit është për mbi 200 e diçka mijë euro më shumë në linjën e pagave dhe të mëditje.

Të nderuar deputetë,

Nëse jemi për respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, atëherë vërtet ky si institucion më i lartë do të duhej të ishte shembull i të gjithë të tjerëve në respektimin e kësaj...

Dhe, një çështje tjetër dua të them. Sipas Ligjit për menaxhimin e financave publike, secili agjencion buxhetor duhet në afatin e caktuar t'i paraqesë raportet e shpenzimeve buxhetore, ato periodike dhe ato vjetore. Raportin e shpenzimeve të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2009 Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka marrë sot, të nderuar deputetë, dhe sot po ashtu e ka marrë edhe Raportin e shpenzimeve buxhetore për tremujorin e parë të këtij viti në të cilin jemi.

Prandaj, në linja tjera - në mallra dhe shërbime, në shpenzime kapitale, në krijimin e kushteve të funksionimit të kësaj gjykatë, të këtij institucioni shumë të rëndësishëm, ne si komision mendojmë se duhet ta përkrahim dhe duhet të ndihmojmë, por për sa i përket linjës së pagave dhe mëditjeve, Gjykata Kushtetuese ka hyrë në borxh, sepse ka shpenzuar edhe pjesën e punëtorëve që nuk i ka të punësuar brenda këtij institucioni. Këtë nuk kam dashur ta them asnjëherë publikisht, por po e them sot para jush dhe ata janë të thirrur të interpretojnë ligjet dhe të interpretojnë Kushtetutën, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë dhe jo të shkelin mbi bazën e tyre.

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Shefat e grupeve parlamentare e kanë fjalën. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, fjalën e ka deputeti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti kryetar,

Në emër të Grupit Parlamentar për çështjet e buxhetit do të flasë Safete Hadërgjonaj, por unë kisha një propozim, nëse aprovohet nga kolegët deputetë.

Meqë janë lajmëruar bukur shumë deputetë, unë kisha thënë që ta shkurtojmë kohën e diskutimit në 5 minuta për deputetët, 10 për shefat dhe të procedojmë, sepse dihet se si mund të interpretohet dhe si mund të ndikohet në buxhetin, dihet në leximin e dytë, përmes komisionit e tjera, e tjera. Andaj, si të doni!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një mocion. Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të grupit, për buxhetin do të flasë zoti Naser Osmani, ndërkaq edhe unë mendoj dhe mbështes këtë propozim që të jemi më efikas, më konkret, të jetë siç propozoi zoti Buja. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, kemi kërkesat e dy grupeve dhe shkojmë për një votim formal.

Kush është që diskutimi në emër të grupit të jetë deri në 10 minuta, në emër të diskutuesve deputetë – 5 minuta. Kush është “për”?

Shumica absolute janë “për”. “Kundër”, a ka? Do të thotë, vazhdojnë shefat e grupeve me 10 minuta, deputetët me 5 minuta.

Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nëse analizojmë me kujdes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-177 për buxhetin e Kosovës, shohim se Qeveria ka planifikimin e duhur për të financuar dhe për të mbështetur të gjitha politikat e

saj, ka bërë një analizë të mirë të buxhetit në gjashtëmujorin e parë, kështu që rishikimi i buxhetit është bazuar në një plan realist të të ardhurave buxhetore, duke parashikuar njëkohësisht masat e nevojshme për pakësimin e shpenzimeve operative, rritjen e shpenzimeve kapitale dhe është kujdesur që të mbajë nën kontroll nivelin e deficitit buxhetor.

Rishikimi i buxhetit është një proces i rregullt nga ana e Qeverisë, përmes të cilit bëhen përshtatjet dhe rregullimet e brendshme të linjave buxhetore të agjencive buxhetore.

Me rishikimin e këtij viti vërehet se nuk ka reduktime të shpenzimeve, por ka në ngritje të lehtë të të hyrave dhe shpenzimeve të cilat reflektojnë me angazhimet e reja të Qeverisë, midis të cilave edhe projekti i autostradës, ku Qeveria për këtë projekt ka ndarë 83.7 milionë euro në këtë rivlerësim, kurse shuma e përgjithshme që është ndarë brenda këtij viti për realizimin e projektit të autostradës është 123.701.000 euro, projektin për financimin e pagave, një obligim ky që del me miratimin e Ligjit për pagat e shërbyesve civilë, mirëpo duhet vlerësuar edhe sigurimin e mjeteve që ka bërë Qeveria për rritjen e pagave në Polici, në shëndetësi, për Shërbimin Korrektues, për prodhimin e pasaportave biometrike, për rritjen e transfereve sociale, që ka të bëjë pra me përmirësimin e gjendjes sociale, si dhe ka ndarë mjete që të funksionojnë për realizimin e projekteve të komunave.

Qeveria, po ashtu, vazhdon në përmbushjen e premtimeve të veta, duke u angazhuar që të rritet në mënyrë progresive financimi për ndryshimin e jetës së qytetarëve, duke investuar në rrugë, shkolla, në ujësjellës, në kanalizime, në sisteme të ujitjes, në jetën kulturore e sportive.

Në kohën kur shumë shtete po ballafaqohen me kriza të mëdha financiare, Qeveria e Republikës së Kosovës ka arritur që në rishikimin e vet buxhetor të shtojë nivelin e vet financiar për afër 77 milionë euro, duke mos u bazuar në rritjen e taksave substanciale, kurse kjo rritje kryesisht është bërë me rritje të hyrave nga dogana dhe me inkasimin e dividendës së Post-Telekomit të Kosovës dhe Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, kurse shpenzimet i ka orientuar kryesisht në investime kapitale, duke i rritur ato nga 414 milionë euro në 495 milionë euro, pra ka rritje për 81 milionë euro, kurse ka zvogëluar shpenzimet për mallra dhe shërbime për 5 milionë euro, çka lë të kuptohet që Qeveria është fokusuar në përmirësimin e politikave dhe në disiplinën financiare, kërkesa këto të vazhdueshme të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Me këtë rivlerësim Ministria e Transportit dhe Post - Telekomunikacionit ka përfituar fonde shtesë për 90.270.000 euro dhe me këto investime Qeveria orientohet në përshpejtim të modernizimit të infrastrukturës rrugore në të gjithë vendin, veçanërisht në ndërtimin e projektit madhor të autostradës Morinë-Merdar, rrugë kjo që i hap perspektiva zhvillimit ekonomik të vendit.

Fondet për shëndetësinë rriten për 1.815.000 euro, kurse fondet për arsim rriten për 1.773.000 euro, çka do të thotë se Qeveria është fokusuar në realizimin e objektivave të saj për një arsim cilësor dhe për një popullsi të shëndoshë.

Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor ka përfituar mjete shtesë për 1.471.000, mjete këto për të mbështetur projekte të ndryshme që kanë të bëjnë me mjedisin. Ndërsa, Ministrisë së Punëve të Brendshme i shtohen mjetet për 1.867.000 euro, kurse Ministrisë së Drejtësisë po ashtu i shtohen mjetet për 1.259.000 euro, që është tregues i mirë i angazhimit të Qeverisë për ndërtimin e sistemit ligjor dhe për ndërtimin dhe forcimin e shtetit ligjor.

Përmes këtij buxheti do të vazhdohet të përmirësohen më tej kushtet për zhvillimin e biznesit dhe të ekonomisë private, duke krijuar një ambient sa më konkurrues e të liberalizuar, të çliruar nga ngarkesat apo pengesat burokratike, gjë që do të ndihmojë në shfrytëzimin më të mirë të potencialeve ekonomike, njerëzore dhe kapitale në vend, për çka është bërë edhe rritja e buxhetit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, kurse

nuk duhet nënvlerësuar vazhdimin e mbështetjes për rritjen e mirëqenies shoqërore nëpërmjet rritjes së pagave dhe pensione, që përbën një prioritet tjetër të buxhetit të vitit 2010.

Të nderuar deputetë,

Fondi Monetar Ndërkombëtar në kontinuitet ka bërë vërejtje për numrin e punëtorëve që financohen nga buxheti dhe në vazhdimësi ka kërkuar reduktime që të ulët barra e rëndë e administratës mbi supet e taksapaguesve, ashtu që të mbesin më shumë para për investime kapitale.

Sipas këtij rivlerësimi, përqindja e mjeteve për paga e mëditje në strukturë e përgjithshme të buxhetit është 24%, derisa organizatat buxhetore në nivelin qendror kanë bërë shkurtime për 43 punëtorë, ndoshta edhe të dhembshme, por të domosdoshme për një qeverisje të mirë në gjashtëmujorin e ardhshëm. Me përjashtim të 5 komunave që nuk kanë shtuar numrin e të punësuarve, të gjitha komunat tjera kanë shtuar numrin e të punësuarve, ku nga 42.633 është shtuar numri i të punësuarve në 42.899, pra është shtuar për 266 punëtorë të rinj.

Niveli qendror, 16% të fondit të tyre i shpenzojnë për paga e mëditje, kurse komunat shfrytëzojnë 49.5% të fondeve të tyre si fond pagash. Është mirë të shikohet a e respektojnë komunat rregullativën ligjore në formimin e drejtorive, sa respektohen kriteret e punësimit, sa qëndron arsyeshmëria kur pagat që merren nga grandit qeveritar kthehen në paga, sa ka arsyeshmëri, për shembull, që një komunë 60% të fondeve të saj i orientojnë në paga, kurse 30% në shpenzime kapitale, sa ka logjikë kërkesa për grante qeveritare për investime, kur ata me buxhetin e tyre nuk investojnë në rrugë, në përmirësimin e ambientit, në shkollë, në çerdhe për fëmijë, aty ku përmirësohet jeta e qytetarëve... por sigurojnë vende pune për ndonjë individ. Kjo gjë ka ndodhur në të gjitha komunat, edhe në ato që i ka pozita, por edhe në ato që i ka opozita.

Megjithatë, gëzon fakti se në nivelin lokal është rritur buxheti nga 285 milionë euro në 294 milionë euro, pra ka rritje për 9.888.000 euro, ku nga kjo rritje kanë përfituar të gjitha komunat pa asnjë përjashtim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është i mendimit se ka një dokument të përgatitur mirë dhe me prioritete të qartësuar, një dokument që iu hap perspektiva qytetarëve dhe si të tillë e përkrah dhe i fton të gjithë deputetët të japin votën për këtë buxhet, sepse vota për këtë buxhet është votë për një jetë më të mirë të qytetarëve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Desha të ngrej një çështje si deputetë dhe jo në emër të Grupit Parlamentar, por për të mos marrë fjalën edhe një herë, më lejoni ta ngrej një çështje që ka të bëjë me një projekt shumë të rëndësishëm për komunën e Deçanit.

Është fjala për projektin për trajtimin e ujërave të zeza. Komuna e Deçanit për 10 vite ka dështuar në realizimin e këtij projekti. Nuk ka bërë punën e duhur në lobim me donatorët e shumtë, të cilët kanë ndihmuar në projekte të tilla në të gjitha komunat e Kosovës. E vetmja komunë që nuk ka trajtim të tillë të ujërave të zeza është komuna e Deçanit. Qeveria, respektivisht Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në mars të këtij viti ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me komunën e Deçanit që më në fund ky projekt të bëhet i realizueshëm.

Konsideroj se Qeveria është dashur që këtë projekt ta materializojë dhe të gjejë mjete për realizimin e këtij projekti. Prandaj, insistoj që projekti i kanalizimit në komunën e Deçanit të vazhdojë dhe të mos ndërpritet punimet dhe të gjendet mundësia nga Qeveria, respektivisht nga Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor që këto mjete të sigurohen. Unë do të bëj të pamundur në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe kërkoj mbështetjen edhe të anëtarëve të tjerë të komisionit në realizimin e këtij projekti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete, vetëm trajtim dhe kanalizim nuk janë e njëjta gjë! Vazhdojmë me deputetin në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Naser Osmani e ka fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Kemi të bëjmë, të nderuar deputetë, me një rishikim buxhetor, i cili në vija të trasha, të themi, në limitet buxhetore ka një lëvizje të hyrat për 77 milionë dhe për shpenzimet 97 milionë.

Ajo që unë kisha dashur sot më tepër të përqendrohem, kishin për të qenë çështjet që prekin dhe për të cilat ministri i Financave duhet t'u japë sqarim deputetëve lidhur me pozicionet të cilat janë paraqitur në këtë ndryshim të buxhetit. Te të hyrat kemi një rritje për 18 milionë, te të hyrat në kufi, që është e kuptueshme, pasi që kemi bërë edhe ndryshime në ligjet e seancës së kaluar, që ka të bëjë me akcizën dhe kjo pritet, mirëpo një zvogëlim i të hyrave vendore për 8 milionë dhe rikthim në pozicionin apo në shumën e vitit 2009, thjeshtë është për mua e pakuptimtë, sepse nuk është bërë një përpjekje më e madhe që të ngriten të hyrat vendore për 8 milionë, sa ka qenë ashtu e paraparë në krahasim me vitin 2009.

Çështja e dividendës është një çështje që vërtet kemi nevojë për një sqarim. Figuron në vitin 2010 që do të kemi... fjala është gjithmonë për dividendat nga ndërmarrjet publike, nga posta, 85 milionë, mirëpo nuk do të kemi më dividendë as vitin 2011 as vitin 2012 as 2013. Çka do të thotë kjo? A do të thotë se do të shitet posta dhe cila pjesë e postës do të shitet. Te të hyrat, që zakonisht për deputetë është gjithmonë çështje më me rëndësi, kemi një pozicion shumë interesant të pagat dhe mëditjet, një ngritje për 16 milionë, që është thjeshtë në kundërshtim me amendamentin që kërkohet të bëhet të neni 10, është fjala për ngritjen e numrit të punëtorëve apo është fjala për rritjen e pagave apo çka është kjo ngritje për 16 milionë në krahasim me buxhetin.

Ndërsa te mallrat dhe shërbimet kemi vetëm një zbritje për 5 milionë. Kjo është me të vërtetë një zbritje simbolike, e vogël dhe ndoshta në fund të vitit kjo mund të jetë edhe një dallim më i madh, mirëpo kështu e ka paraparë Qeveria me politikën e saj dhe ne do ta respektojmë kështu qysh e kemi.

Te transferet sociale, përsëri ka një rritje për 16 milionë. A nënkupton kjo që do të jetë, është bërë rishikim i numrit të atyre që marrin asistencë sociale, apo është rritja e shumës që ata do të përfitojnë.

Mirëpo, krejt poenta e krejt kësaj përqendrohet te shpenzimet kapitale. Në përgjithësi kemi një rritje për 81 milionë, që normalisht krejt kanë për të shkuar në autostradë, që është e kuptuar. Mirëpo, nga shuma e tërësishme të 495 milionëve, 110 milionë është kërkuar që të rritet me këtë rishikim, do të thotë që të bëhen 130 milionë. Me fjalë tjera, nëse shikojmë të gjitha mjetet që janë ndarë për autostradë, kapin shumën 994 milionë euro – 1 miliardë, ndërsa, në bazë të asaj në media që kemi parë, bëhet fjalë për një kontratë për 700 milionë, plus – minus.

Shtrohet pyetja, zoti ministër - kjo shumë nëse përpjesëtohet me kilometra, do të na dalë neve një rrugë 8,5 milionë euro kilometri. A kemi të bëjmë këtu me një rrugë që do të shtrohet në mermer, apo kemi të bëjmë me një rrugë me standarde tjera. Mirëpo, një është e vërejtur, që është kostoja jashtëzakonisht e lartë – 1 miliardë euro.

Jemi të gjithë të përqendruar dhe të angazhuar që ky investim kapital të bëhet në këtë mënyrë ose në tjetrën mënyrë, të bëhet. Mirëpo, nuk e kemi të qartë me çfarë qasje do të realizohet ky projekt. Nëse vazhdohet edhe më tutje që të gjitha projektet e rrugëve të tjera të barten në autostradë, do të kemi një stagnim të ndërtimit të rrugëve të tjera dhe mirëmbajtjen e tyre. Prandaj, unë mendoj që ju duhet ta rishqyrtoni edhe një herë çështjen e investimit të këtij kapitali kombëtar. Ndoshta kishte qenë më mirë edhe të hyjmë në kredi, mirëpo e dimë që atë kredi kemi për ta larë për këtë projekt.

Një çështje tjetër për të cilën përsëri duam sqarim. Fjala është për paratë të cilat ia kemi dhënë KEK-ut – ndërmarrjes publike, disa herë, në tri vitet e fundit, është fjala. Ne kemi aprovuar një ligj në Kuvend që është kredi, ndërsa për 6 vite këtu nuk figuron kthimi i kredisë. Atëherë, kemi të bëjmë me subvencion, nuk është ajo më kredi. Dhe, duhet thjeshtë ta dimë si do të kthehen ato mjete apo do të kthehen apo do të kërkonin prej nesh që të aprovojmë, ato para t’ia falim krejt KEK-ut. Është fjala gjithmonë për 200 milionë euro.

Edhe një sqarim për deputetë do të ishte shumë interesant. Fjala është për të hyrat nga privatizimi – 300 milionë. A është kjo shumë virtuale, e dëshirueshme dhe për cilat privatizime është fjala. A është fjala për privatizimin e ndërmarrjeve publike të Postës, të Aeroportit dhe nëse është, se është një shumë prej 300 milionëve, se nuk është një shumë shumë më e madhe, ndërsa nëse është fjala për paratë e privatizimit të agjencionit për privatizim, atëherë kjo me të vërtetë është një shumë virtuale, se ato para duhet të jenë pak telashe deri sa nuk kryhen të gjitha obligimet ndaj ndërmarrjeve. (Edhe të kishte qenë Tali, e kishte keqpërdorë mikrofonin, kishte thënë – u ndal rryma).

OK. Dhe, si po duket, do ta kemi një deficit shumë më të madh, se që është e pasqyruar këtu. Ndoshta do ta kemi diku rreth 400 milionë një suficit.

Një çështje tjetër për të cilën unë nuk isha ndalë në detale, është fjala për ndryshimet që janë bërë te prioritetet e komunave, mirëpo ajo që është shqetësuese, është që këtu ka hyrë si pozicion edhe komuna e Prizrenit, kur e dimë që rishikimi i buxhetit në komunën e Prizrenit nuk ka shkuar në bazë të procedurave të parapara në ligj, pasi që nuk ka kaluar as në Komitetin për Politikë dhe Financa, as në Asamblenë komunale, mirëpo kjo është një çështje që do të merret më tepër ndoshta Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Në fund, zoti ministër i Financave, unë e di që je ekonomist, pak financiar, por... Grupi i LDK-së do ta votojë rishikimin e buxhetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Haki Shatri apo.... Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Zëvendëskryeministër, nga dy intervenime të vogla. Ministri i mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është mirë t’iu tregojë deputetëve se asnjë qytet në Kosovë nuk ka trajtim të ujërave të zeza dhe prapë t’ju tregojë po ashtu se është ndershëm t’ju tregojë që projektin për kanalizim e ka gjetur hazër, por Qeverisë iu kanë dashur 3 vjet të vendosë për ta implementuar. Thonë se është mirë të thuhet kështu, është mirë të implementohet, është shumë punë e mirë që bëhet në Deçan dhe e përgëzoj Qeverinë për këtë punë që e bën në Deçan, por duhet treguar që para 3 vjet e kanë gjetur projektin dhe tash po e implementojnë.

Një çështje tjetër, për të cilën po rri këtu, është vetëm pak element kurtuazie me kolegën Osmani. Për të ndërtuar uji në përpjetës në autostradë, duhet të kushtojë 8 milionë kilometri, se në Kroaci nuk iu rri uji e kushton 4 milionë. Domethënë, te na duhet të kushtojë 8 për të ndërtuar uji në përpjetës, iu kam kallëzuar, këta fenomenologët që duhet t’i thërrasim në Kosovë, ta studiojnë qysh po na rri uji neve në përpjetës. Krejt në rregull!

Po flasim për buxhetin dhe kam folur për buxhetin edhe para 6 muajve, ka folur edhe kolegu Shatri kur e kemi aprovuar këtë buxhet dhe kur e kemi marrë dhe e kemi studiuar këtë që e kemi tash, realisht dikujt i shkon mendja për ta përsëritur fjalimin komplet. Krejt çka kemi thënë me atë rast, gjë nuk ka ndryshuar. Unë nuk do ta përsëris fjalimin, por do të jap disa elemente të cilat janë prapë interesante edhe për Kuvendin, edhe për popullin e Kosovës për ta ditur... Unë kam me të vërtetë dilemë për ta kuptuar qysh munden historianët mos të mendojnë qysh kanë për t’u mbajtur në mend pasi ta lëshojnë. Thonë, secili njeri në pushtet e ka një dozë të mendimit të vet të punojë mirë, se të tjerët e mbajnë në mend pasi të shkojë, se në demokraci gjithkush shkon

një ditë dhe me këtë farë numri impresiv të historianëve, unë çuditërisht qysh nuk tuten qysh ka për t'i mbajtur në mend populli kur ta lëshojnë pushtetin dhe kam për t'iu kallëzuar se qysh kanë për t'u mbajtur në mend.

Buxheti është shpenzim i mjeteve të përbashkëta. Administrata Tatimore punon si në Gjakovë, si në Gjilan, si në Kamenicë, si në Mitrovicë. Do të thotë, gjithkund e kryen punën njëjtë, taksat i marrin të njëjta, varësisht prej numrit të banorëve dhe bizneseve. Do të thotë, ky është buxheti i përbashkët, sikur një shtëpi të mirë, duhet provuar të ndahet drejt. Duhet të ekzistojë të paktën minimumi i vullnetit në Qeveri për t'i ndarë drejt.

Ne e kuptojmë që zonat e pazhvilluara mund të marrin edhe dy herë më shumë. Po ju tregoj, shembull të marrim, Ministria e Mjedisit në vitin 2006 ka investuar një milionë në Skenderaj, e 400 mijë në Deçan. Ka qenë komunë pak më e zhvilluar dhe kjo ka qenë me insistimin e kryeministrit atëherë. Mirëpo, tash çka ndodhë? Për kokë banori, një komunë prej nga vijnë këta që nuk bëjnë ndarje krahinore, ndahen 45 herë më shumë mjete buxhetore se një komunë prej nga nuk vijnë. 45 herë do të thotë 4.500% më shumë buxhet për kokë banori një komunë prej nga vijnë vet, se një komunë tjetër. Këtë e kam thënë edhe herën e kaluar, po e them edhe tash. Çka ka ndodhur me rishikim, është rritja e këtij disproporcioni, nuk është zvogëluar, nuk kanë provuar të zbusin bile këtë padrejtësi që ka për t'iu mbajtur në mend historianëve, po e kanë rritur edhe më shumë. Dhe kjo, domethënë, është diçka që duhet shpjeguar, se është prapë fenomen, është fenomenologji. Duhet të matet, duhet të kemi këtu sistem për t'i studiuar këta njerëz. Këto janë ndarjet krahinore. Dhe çka bëjnë në ndarjet krahinore, realisht e shkatërrojnë solidaritetin në mes njerëzve në shtet, që kolegët e mi që i kanë studiuar shkencat politike, këtu që janë plotë, e dinë se sa esencial është solidariteti në mes të njerëzve për të bërë shtet normal. Nuk guxojnë njerëzit të ndihen të diskriminuar. Ne jemi duke punuar të gjithë për të mos u ndier të diskriminuar, serbët në veri ose ndonjë enklavë dhe mirë është që po punojmë ashtu. Po paramendoni çfarë diskriminimi 45 me 1. Dhe nuk është viti i parë. Është duke u përsëritur, mirëpo kjo rritja po shkon, domethënë po rritet, nuk po zvogëlohet ky diskriminim. Do të thotë, Qeveria nuk po mbledh mend, të thotë që nuk bën të bëjë kështu. Ajo çka mund t'ju premtoj unë juve, është që sa të shkon në opozitë, nuk kemi për t'ua bërë njëjtë, as përafërsisht, po historianëve ka për t'iu mbetur në mend se çka janë duke bërë gjatë pushtetit të vet. 4500% më tepër një komunë që udhëhiqet nga PDK-ja, se një komunë që udhëhiqet nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Për hir të korrektësisë dhe për të mos ndikuar në prishjen e solidaritetit, nuk po ju tregoj se cilat komuna janë, po i keni letrat, i çelni dhe i shihni vetë.

Domethënë, kjo është mungesë e minimumit të vullnetit. Nuk po lypim shumë, vetëm minimumin e vullnetit dhe ju të gjithë mbajeni në mend se historia ka për t'ju shënuar si pjesë të këtij diskriminimi që nuk është bërë asnjëherë në histori të Kosovës – kam lyp ta gjejë, kam provuar ta gjejë në periudha të ndryshme të Kosovës, periudhat më të errëta dhe brendapërbrenda Kosovës kësi sistemi nuk ka pasur. Po ju betohem këtu para të gjithëve, para kamerave që as në periudhat më të errëta brendapërbrenda Kosovës kësi diskriminimi nuk ka ekzistuar.

Tani po ju them, domethënë, se kur shkon duke u rritur ky dallim, jo duke u zvogëluar, shihet që është një arrogancë ekstreme. Do të thotë, unë të kam pushtuar, unë të sundoj dhe unë të bëj çka të dua. Domethënë, kjo është arrogancë se po shkon duke u rritur, edhe në shikim po shkon duke u rritur. Dhe, a do Kosova të ketë kësi sistemi? A do Kosova të ketë kësi ballafaqimi të pushtetit me njerëz të vet, pa marrë parasysh a ia kanë qitur votën a jo!?

Në fund të fundit, pa shkuar në detaje, nuk po shkoj më tepër, se më duket keni ndier boll dhe e keni boll, i keni letrat para jush dhe veç çka e teproj t'ua shpjegoj në detaje, se jam lodhur edhe vetë. Edhe ne jemi lodhur t'ua shpjegojmë juve detajet. Veç, po ju them, prej kryetarit të Kuvendit e teposhtë, a po ndiheni mirë? A po e ndieni vetën mirë me këtë diskriminim që jeni duke ia bërë vetvetes, në fund të fundit, popullit tuaj? Faleminderit!

KRYETARI: Buxhetin nuk e bën kryetari, Ardian! Vazhdojmë. Në emër të AKR-së, Ibrahim Makolli e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë, ministër,

Edhe unë do të përpiqem që shkurtimisht të jap vetëm disa prej vërejtjeve tona që kemi, sepse edhe kolegët tjerë do të flasin në vazhdim. Ky buxhet ose projektbuxhet i paraparë nuk garanton zhvillim, por vetëm vazhdim të funksionimit të administratës dhe revidimi i këtij buxheti vë në pah disa prej defekteve të politikave aktuale të Qeverisë. Projektbuxheti nuk reflekton prioritete të vendit, përkundrazi tregon fokusin e Qeverisë në shpenzimet të cilat me dinamikën e prezantuar në këtë buxhet do të sjellin Kosovën në deficit të rrezikshëm.

Mangësi të madhe në procesin e buxhetimit e shohim varshmërinë e mbledhjes së të hyrave nga kufiri, që vazhdon të jetë po e njëjtë me të kaluarën dhe tregon qartë se kemi ngecje të të hyrave vendore dhe rënie nga buxheti fillestar. Rritjet e të hyrave në kufij tregojnë rrugëtimin e njëjtë të ekonomisë që është varshmëria nga importi.

Çështja e dividendës, konsiderojmë se Kuvendi i Kosovës duhet të debatojë mbi alokimin e dividendës nga ndërmarrjet publike, sikurse është PTK-ja, por edhe Aeroporti. Do të përqendrohem vetëm në dy fusha, ato të cilat i përmendi kolegu Gjini. Investimet në infrastrukturën rrugore, qoftë si të veçanta, qoftë në bashkëfinancim me kuvendet komunale, janë tërësisht investime politike, pasi thjeshtë vazhdojnë të përqendrohen në komunat ku qeverisë një parti politike, në këtë rast Partia Demokratike. Ne nuk jemi kundër ndërtimit të rrugëve edhe në ato pjesë, por do të duhej të kishte një ndarje proporcionale të buxhetit në varësi të nevojave të cilat i ka.

Kjo flet, kjo mënyrë e ndarjes së buxhetit flet për segregim dhe tregon qartë për segregim që iu bëhet qytetarëve të Kosovës në baza partiake. Po ta shikoni mirë këtë material, e keni kodin 418 prej 47.230.000 euro për rehabilitim të rrugëve në një regjion që përfshin diku 1/10 e Kosovës, ka gjithsej 1.300.000 euro investime në infrastrukturë rrugore. Në kodin 420, që është programi i bashkëfinancimit me kuvendet komunale, që janë diku 14.000.000, i keni 300.000 euro dhe po ashtu me ndërtime të reja të rrugëve prej 13.000.000 eurove i keni 300.000 euro, nëse nuk gaboju, diku 300.000 euro, çka do të flet se prej rreth 80.000.000 të parapara për këtë çështje, vetëm 2.000.000 janë të ndara për një regjion, e thashë, që ka mbi 87 fshatra, që nënkupton diku 2%, as 2% të buxhetit të paraparë për infrastrukturën rrugore. Thjeshtë, kjo flet më së miri që ka pjesë të Kosovës të cilat nuk janë në fokus dhe nuk janë në interesin e kësaj qeverie që të investojë.

Po ashtu, edhe në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë, tek subvencionet dhe transferet, janë ndarë vetëm diku rreth 5.000.000, më pak se 5.000.000 për bujqësi dhe blegtori, përkundër faktit se bujqësia thuhet të jetë një ndër prioritetet e Qeverisë. Këto mjete vetëm sa do të vazhdojnë statuskuonë e sektorit të bujqësisë, duke mos ndikuar në asnjë rast në ngritjen e sektorit shumë të domosdoshëm për ngritjen e punësimit dhe të prodhimtarisë në Kosovë.

Grupi Parlamentar, kështu që është ky projektbuxhet, nuk do ta mbështetë dhe kërkon nga ministria, por edhe nga komisioni që të rishikojë një ndarje proporcionale të këtyre investimeve, në veçanti në infrastrukturën rrugore, sepse ka fshatra të tëra, në veçanti në brezin kufitar me Serbinë, të cilat janë të izoluar dhe, natyrisht, banorët e paktë të atyre fshatrave që tashmë kanë mbetur, janë detyruar për shkak të kësaj mungese të infrastrukturës që të zhvendosen në drejtim të Prishtinës.

Në njërën anë ankoheni pse Prishtina po mbi-popullohet dhe njerëzia po i braktis fshatrat dhe, në anën tjetër, me politikën e juaja po kontribuoni drejtpërdrejt në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Rishikimi i buxhetit për vitin 2010 nuk mund të vlerësohet ndryshe përpos një vazhdim-aneks i cili demonstroi qartë për ligjësimin e paaftësisë së kësaj qeverisjeje për të planifikuar dhe për të menaxhuar shtetin e pavarur të Kosovës.

Është gabim të theksohet dhe të pritët se do të përfundojë logjika e improvizimit dhe të merret seriozisht me përgjegjësitë në qeverisje të vendit dhe ajo që duhet të theksojmë është se edhe ky projekt, ashtu siç ka qenë edhe projekti në fillim vit, është në kundërshtim të plotë me kornizën afatmesme të shpenzimeve buxhetore dhe nuk mund të quhet sukses po mund të quhet vetëm politikë ad-hoc e cila nuk merr për bazë vizionin dhe strategjinë, nëse mund të thuhet kështu, që e ka planifikuar kjo qeverisje.

Qytetarët e Kosovës duhet ta dinë edhe me këtë rast se nuk ka tendencë që të ofrohen shërbime më të mira. Unë do ta marr vetëm një shembull, i cili është për të ardhur keq që edhe ministri i Shëndetësisë sot nuk është këtu. Programet farmaceutike janë zvogëluar për 2 milionë. Është një porosi që tek qytetarët e Kosovës tingëllon drejtpërsëdrejti. Nëse i referohemi asaj që shërbimet shëndetësore nuk janë të një niveli të kënaqshëm dhe në anën tjetër kemi atë çfarë për 2 milionë zvogëlohen shërbimet të cilat janë aq të domosdoshme, atëherë definitivisht ky është një sinjal dhe një porosi e keqe.

Ajo çka duhet të theksohet dhe është një politikë që po na përcjell në vazhdimësi e paqëndrueshmërisë buxhetore, është se po krijohet vazhdimisht një disfavor në raportin e të hyrave në buxhet, ato çka inkasohen në kufij me ato të hyrat vendore që inkasohen nga administrata tatimore. Pra, ky raport ndërmjet këtyre dy vijave të hyrave është më i larti se kurrë më parë, është 1 me 4, prandaj kjo tregon edhe një herë për paaftësinë e kësaj qeverisjeje për të mbledhur taksa dhe për të luftuar ekonominë informale.

Është shqetësuese në Kosovë se vazhdimisht numri i bizneseve të cilat kontribuojnë në aspektin numerik përmes tatimeve në buxhetin e Kosovës po zvogëlohet.

Është edhe më tepër shqetësuese që këtij informaliteti po i kontribuojnë dhe këtë e demonstrojnë qartë edhe raportet hulumtuese vendore dhe ndërkombëtare që tregojnë se ndërmarrjet që përfitojnë miliona euro nga tenderomania po privilegjojnë nga mbledhja e taksave.

Sot në Kosovë, për fat të keq, gjallërojnë vetëm ato biznese të cilat janë të lidhura drejtpërsëdrejti me politikën oficiale, me politikën qeverisëse. Me këtë buxhet, sektorët kryesorë mbesin të pa përkrahur. Është krijuar një praktikë që deklaratat tona të kësaj qeverisjeje në media të mos përcillen me politika buxhetore. Kemi pasur rastin që nga Ministria e Bujqësisë në kohën e fundit kemi pasur deklarata shumë inkurajuese për qytetarët. Mirëpo, programi respektivisht mbështetja buxhetore nuk ekziston. Prandaj, do të duhej që kjo përfundimisht të marrë fund dhe të kemi një koherencë, një koordinim me atë çka e flasim.

Rishikimi i buxhetit lirisht mund ta quajmë se është një përpjekje jo për ta ngritur cilësinë e jetesës, jo për ta ngritur performancën e kësaj qeverisjeje në kuptimin pozitiv, por është në fakt pjesë e një propagande që ndikohet në formimin e një opinioni të rrejshëm për ngritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës, çka në fakt nuk ekziston.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Dardanisë, Grupi i saj Parlamentar do të votojë kundër për vetë faktin se kemi të bëjmë me një planifikim që lirisht mund ta quajmë planifikim i dështuar në kuptimin e asaj që presin qytetarët e Kosovës. Dhe, të planifikosh, respektivisht të dështosh në planifikim do të thotë të planifikosh dështimin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit 7+, deputetja Myfera Shinik e ka fjalën.

MYFERA SHINIK: Teşekkür ederim!

Sayın Meclis Başkanı, Sayın Başbakan vekilleri, Sayın Bakanlar ve Milletvekilleri

Bu gün Kosova Cumhuriyeti Meclisinde 2010 yılına ait bütçenin yeniden görüşülmesi yapılmaktadır.

2010 yılına ait bütçe planlamasını görüştüğümüzde, Kosovanın her alanda ilerlemesi konusunda ve Avrupa Birliği kriterleri kapsamında ekonomik alanda da gelişmesi gereği gözönünde bulundurulmuştur. Bu gün ise bütçeyi yeniden gözden geçirirken bazı tamamlamaların yapılması gerektiği görülmektedir.

Örneğin, Kosova için çok önemli olan tarım alanındaki planlamaya baktığımızda, Kosova, bölge ülkeleri arasında tarıma en az destek sunmayı planlamıştır. Nüfusu aynı olan Makedonya 100 milyon planlarken, Kosova Hükümetinin tarıma desteği 10 defa daha az görülmektedir, yani 10 milyon euro planlanmıştır. Bölgedeki diğer tüm ülkelerde durum bizden çok iyidir. Gelişmemiş bir ülke olarak tarıma çok daha fazla bütçenin ayrılması gerekmektedir diye düşünüyoruz.

Diğer yandan Hade projesine ait bütçenin ayrılmaması yapılacak olan çalışmaların geç kalması ve hatta geri vurması anlamına gelmektedir. Hade projesi için bütçenin yeniden görüşülmesiyle ivedilikle bütçenin ayrılması gerekmektedir.

2010 yılı bütçe planlamasını tartıştığımızda, Kültür, Gençlik ve Spor Bakanlığının desteklemesi gereken, yani bütçe ayrılması gereken tarihi eserleri koruma konusunda Prizren'de tarihi Namazgah çalışanlarının maaşlarının sağlanmasını talep etmiştik, bu da bütçeye bu güne kadar koyulmamıştır.

2010 yılına ait bütçenin yeniden görüşülmesiyle, bu konuyla ilgili Kültür, Gençlik ve Spor Bakanlığının durumu düzelmelidir.

Topluluklar ve Geri Dönüş Bakanlığına ayrılan bütçedeki subvansiyonlar 300 bin euro olarak görülmektedir. Çoğunlukta olmayan toplulukların sayısı ve ihtiyaçlarına baktığımızda bu tutar az görülmektedir. Bu konuda da çalışmaların yapılması gerekmektedir.

Onun dışında 7+ Parlamenter grubu, 2010 yılına ait bütçe planlaması konusunda sunmuş olduğu öneri ve teklifleri gözönünde bulundurmıştır. Bu yüzden bu Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul ediyoruz. Komisyonda katkımızı sunarak, ikinci okunuşuna kadar ek önerilerimizin desteklenip, desteklenmemesi doğrultusunda oyumuzu kullanacağız.

Dinlediğiniz için teşekkür eder, saygılar sunarım.

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS, nuk ka të paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, kush e kërkon fjalën? Numan Baliq!

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zotëri kryetar i Kuvendit!

Da selamim prisutne poslanike i da kažem nekoliko principijelnih stvari koje smatram važnim za ukupno pitanje budžeta na nivou Kosova, ali i onog dela aspekta koji se tiče budžetiranja zajednica.

Najpre da se osvrnem na neke stavke koje se tiču pitanja koja smo uglavnom razmatrali tokom svih dosadašnjih pregleda budžeta vezano za zdravstvo, socijalu, kulturu, poljoprivredu, povratak i neka, rekao bih, esencijalna pitanja koje se tiču svih zajednica, ali i malobrojnih zajednica na Kosovu.

Oko resora zdravstva rekao bih da je i dalje aktuelno pitanje Fonda za zdravstveno osiguranje, koje nažalost još uvek nije pokrenuto i ne vidimo da je u rebalansu budžeta obuhvaćeno to pitanje s obzirom da smatram da bez osnivanja fonda za zdravstveno osiguranje nema valjanog zdravstvenog sistema na Kosovu uopšte i prema tome nema ni valjanog odnosa niti Vlade Kosova, niti uopšte kosovskog sistema prema građanima, odnosno pacijentu, običnom čoveku, stanovniku Kosova. To je pitanje koje se neizostavno mora riješiti zato što se bez obzira, naravno na sve teškoće koje postoje oko inicijalnog fonda za njegovo formiranje i onoga što je mnogo puta spominjano, a koje se tiče izdvajanja određenih ili, rekao bih, značajne količine sredstava za ovo pitanje, uprkos tome je bitno da se Fond za zdravstveno osiguranje konačno pokrene i mi smo u velikom kašnjenju.

Takođe bih istakao da sa istog ovog aspekta, a sa stanovišta interesa građana da je značajno pitanje lečenja naših ljudi van Kosova, i kao čovek, i kao humanista, i kao lekar i onaj koji sam u životu zajedno sa vama mnogima sa pitanjima mnogih pacijenata, mi i dalje imamo problem što je budžet koji se koristi za lečenje

van Kosova i dalje jako mali, a što imamo ogroman broj pacijenata koji se javljaju iz svih zajednica i koji imaju stanovite probleme vezano za lečenje van Kosova, odnosno na ogroman broj molbi odgovara se tek na nekoliko, a veliki broj pacijenata sa velikim zdravstvenim oštećenjima nemaju priliku da koriste ovaj fond.

U vezi sa onim pitanjima koji se tiču zajednica, da istaknem dve principijelne stvari. Mislim da je učinjena nepravda vezano za opštinske budžete, kancelarije zajednice, koje su do sada imale prema predašnjim pravilnicima UNMIK-a određeni procenat u svim opštinama. Taj procenat sada nedostaje. Kao što znate, u svim opštinama u kojima žive posebno druge zajednice, Peć, Istok, Prizren, Dragaš i neke druge, Ferizaj i tako dalje, postoji je procenat koji se izdvajao u kancelariji za zajednice. Sada taj procenat ne postoji a u opštinskim kancelarijama zajednica od prilike budžet koji se izdvaja 50, 60, 70 hiljada, koji jedva pokriva plate tih radnika. To je veliki nedostatak i naravno da ja nisam protivnik toga da se ovo pitanje ne treba sistemski rješavati i ono bi se na ovaj način moglo riješiti u narednih nekoliko godina, ali svakako da nedostaje jedan prelazni period i da je apsolutno neodrživo da se naglo pređe sa tog odvojenog izdvajanja zajednice po opštinama do ovog momenta kada je jednostavno to izdvajanje prekinuto. Morao je postojati jedan prelazni period i moralo se razgovarati sa predstavnicima zajednica i rješavati se ovo pitanje.

Sada imamo ovakvu situaciju, da recimo opštine na sjeveru Kosova imaju samostalne budžete, koji se nažalost pomažu od susjedne države, imamo takođe u okviru Kosova opštine koje su novo formirane, srpske opštine koje dobijaju budžet od Vlade Kosova, ali zato imamo druge zajednice kao: Bošnjaci, Gorani, Romi, Aškalije i druge zajednice, koje u okviru kosovskog budžeta nemaju tu povlasticu da mogu rješavati pitanja koja su selektivno određena za ove zajednice. Mislim da su na ovaj način, ovim načinom budžetiranja oštećene ove zajednice i da se mora naći jedno privremeno rješenje do konačnog rješenja ovog pitanja.

I da na kraju dodam još jedno principijelno pitanje koje se tiče odnosa Kancelarije predsjednika Kosova oko istog pitanja, a ono je opet povezano sa projektima vezanim za razvoj zajednice. Kao što znate, budžet predsjednika Kosova ima oko 3 miliona eura i prema Zakonu o promovisanjima prava i interesa zajednica, formirano je konsultativno veće zajednice. U okviru tog konsultativnog Veća zajednica je predviđeno, shodno Zakonu o promovisanju prava zajednica, shodno Ustavu Kosova, potom statuta o osnivanju konsultativnog Veća zajednica, predviđeno je finansiranje ovoga veća. Ovo veće već postoji treću godinu za redom i ono još uvek nema izdvajanje budžeta, što je nedopustivo. To je kršenje i Ustava i zakona i mislim da je od strane predsjednika Kosova apsolutno neprimereno da postoji jedno veće, koje ne samo da je formalno po svom karakteru i suštini, ne samo da je savjetodavno po načinu rada i da nema nikakvih izvršnih odluka, nego mu se već treću godinu zaredom uskraćuje budžet koji po Ustavu, po Zakonu o promovisanju zajednica i prema svim pravilima djelovanja Kancelarije predsjednika, mora da ima. Tako da mislim da treba, predlažem da se u okviru ove rasprave, da u govorima predstavnika grupa da se ovo razmotri kao jedna ozbiljna sugestija od predstavnika ove zajednice. Hvala vam lijepo!

Drejtmin e seancës e merr zoti Naim Maloku, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kalojmë në debat, vazhdojmë debatin me deputetët sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, përgatitet deputetja Myzejene Selmani.

SABRI HAMITI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I përshëndes këta ministra kaq pak që janë këtu, në krye me Ahmet Shalën!

Unë pikërisht diskutimin tim do ta lidhë me këtë problem. Duhet të kalojmë në një diskutim të një rishikimit të buxhetit, i cili diskutim në princip duhet të bëhet në mes të Parlamentit dhe ministrave të resorit të Qeverisë, përmes ministrave të vet. Unë mendoj që në këtë formë nuk ka shans që të bëhet suksesshëm dhe Qeveria e ka gabim nëse mendon që ia ka varë në qaftë këtë problematikë, që i takon për kah natyra Ministrisë, zotëri Ahmet Shala, por që të tjerët nuk duhet të jenë këtu.

Pse po e them këtë? E them këtë për shkak se ne kemi një dysi të ministrave të resorëve dhe të Qeverisë sa i përket raportit me Qeverinë, si tërësi, dhe me Parlamentin. Kjo na ka ndodhur edhe herëve tjera kur kemi miratuar buxhetin dhe rishikime buxhetesh, por ndodhë edhe sot. Këtë e dëshmoj edhe kryetari i Komisionit për Buxhet, që foli sot këtu, e dëshmoi këtë dysi të çuditshme që, nuk po i them që nuk është jotransparencë, por po i them që është papërgjegjësi, në fund të fundit.

Si është e mundur që ministrat të cilët në mbledhje Qeverie i çojnë të dy duart për një projekt të rishikimit të buxhetit, ndërsa shkruajnë letra paralele te organet e Kuvendit, konkretisht te Komisioni për Buxhet. Kjo nuk është në rregull dhe kjo tregon që ata ministra ose nuk e kryejnë punën si duhet, ose luajnë me dy fytyra, si thuhet, me dy pozicionime. Unë mendoj që rastet e tilla nuk duhet të shqyrtohen pa prani të tyre. Më në fund, janë të detyruar që ministrat, buxhetet e resorëve të veta t'i arsyetojnë para Kuvendit. Por, do të pranoj unë vetë që t'i përkrah ministrat, të cilët edhe në mbledhje Qeverie thonë për projektet e prioritetet e ministrisë time, Qeveria nuk më ka dhënë pëlqimin, unë nuk e kam votuar këtë formë të rishikimit dhe kërkoj nga Parlamenti ndihmë. Për të tillët po, për të tjerët jo, sepse letrat që shkruhen intime dhe mbahen në xhep të majtë, nuk dalin në Qeveri dhe përpiqen të kalojnë si tip i ankesave, i lutjeve në Parlament, nuk janë serioze. Ka qeveri ku ministrat, kur nuk ju kalon buxheti i vetë në qeveri, japin dorëheqje dhe kjo ndodhë dhe duhet të ndodhë. Unë nuk po them që këtu do të ndodhë kjo sot, por që kërkesat e tyre para Kuvendit, para resorëve, para përparësive të veta duhet të bëhen të pashme ose transparente në Kuvend, kjo është domosdo, prandaj zoti ministër i Financave, unë nuk dyshoj në aftësitë tuaja që ta arsyetoni një buxhet, sepse jeni ministër i buxhetit, po këta ministra që i kanë shkruar gjithë ato kërkesa në Kuvend, mos ta harrojnë që do të jenë përkrahës i ankesave të tyre pa ardhur për ta sqaruar kërkesën e tyre konkrete. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për ministrat që janë të pranishëm!

Përshëndetje për të gjithë deputetët në këtë seancë!

Duke marrë parasysh se rishqyrtimi i buxhetit vjen pas miratimit 6 mujor të Buxhetit 2010, Grupi Parlamentar i AKR-së ka shqyrtuar rishikimin e buxhetit 2010 dhe që nga faqja e parë mund të them se të hyrat e përgjithshme të planifikuara me buxhetin fillestar 2010, kanë qenë 1.029.2 milionë euro, kurse të hyrat me rishikim janë 1.106.00 milionë euro.

Kjo rritje është për shkak të dividendave të PTK-së dhe të Aeroportit të Prishtinës, që është planifikuar si të realizuara 85 milionë euro, e cila nuk është e hyrë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Buxheti i rishikuar në Kuvendin e Kosovës ka ndryshime jo të pranueshme, sepse të hyrat në ATK janë planifikuar që të mblidhen më pak. Me buxhetin fillestar në fillim të vitit, me buxhetin 2010, planifikimi i ATK-së ka qenë 235 milionë euro, kurse me rishqyrtim ka rënie në 216 milionë euro. Dallimet në mes të buxhetit 2010, të miratuar, dhe rishikimet janë 19 milionë euro, ku theksoj se edhe kthimet e TVSH-së që paraqesin të hyrat e realizuara, për të cilat kërkesat e biznesit ju kthehen për shkak të pabesës së tepërt TVSH-së, e cila është më se 28 milion euro. Nëse 216 milionë euro zbresim të hyrat që do t'iu kthehen bizneseve për 28 milion TVSH, atëherë të hyrat e planifikuara për ATK-në do të jenë 188 milionë euro.

Komuna e Prishtinës dhe x komuna tjera, realizojnë të hyra rreth 40 milionë euro, kurse ATK-ja me 712 punëtorë dhe agjencion i themeluar ekskluzivisht për mbledhjen e të hyrave, i cili mund t'i mbledhë të hyrat, pasi që i ka bërë bizneset me arka fiskale, ka deklaruar se do t'i realizojnë 240 milion euro. Pse pra ra planifikimi i të hyrave në ATK me kthim të TVSH-së në 188 milionë euro. Domethënë se i kemi zvogëluar të hyrat për 152 milionë euro për shkak se ATK-ja ka evazion fiskal, të dirigjuar direkt nga njerëzit e Qeverisë.

Të hyrat nga doganat janë 702 milion euro, i vetmi shtet në Evropë dhe në botë i cili planifikon të hyra rreth 80% nga doganat, është Kosova. Kjo tregon se arka e shtetit mbushet vetëm në kufi, që nuk ndodhë në asnjë vend tjetër të botës dhe është vendi më i pazhvilluar. Të hyrat jo tatimore, të hyrat vetanake, të cilat paraqesin të hyrat e realizuara nga ministritë dhe komunat, me miratimin e buxhetit kanë qenë 138 milionë euro, kurse me buxhetin e rishikuar i kemi zvogëluar në 130 milionë euro, që domethënë se 8 milionë euro i kemi zvogëluar të hyrat. A janë zvogëluar këto të hyra për shkak të efikasitetit apo ka hyrë evazioni fiskal edhe në ministritë që realizojnë të hyrat vetanake dhe komunat.

Si u bë që u avulluan 8 milionë euro? Si mendon t'i realizojë këto të hyra, kur në tremujorin e parë, të hyrat në ATK kanë rënë nga 50 në 47 milion euro, përqindja është 7% më të vola, kurse të hyrat jotatimore në tremujorin e parë kanë rënë nga 12 milionë, në 10 milionë, që do të thotë në përqindje 13%.

Dividenda e PTK-së dhe Aeroportit, 80 milion, plus 10 milionë euro, do të thotë se 90 milionë euro, kurse ju e kemi planifikuar 85 milionë euro. Ku janë edhe 5 milionë euro tjera. Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit 2010, të planifikuara me buxhetin fillestar kanë qenë 1.157.00 milionë euro, kurse me rishikim e kemi rritur në 1.254, dallimi që domethënë kemi rritje të shpenzimeve me rishqyrtim për 94 milionë euro, vetëm për mallra dhe shpenzime. Si planifikohen të shpenzohen 184 milionë euro për mallrat dhe shpenzimet, kur dihet popullsia e varfër e Kosovës dhe gjendja ekstreme e tyre. Mund të ceket se vetëm në tremujorin e parë kemi parë një rritje të shpenzimeve për mallrat dhe shpenzime 20 milionë euro, që janë shpenzuar në vitin 2009, 26% në tremujorin e vitit 2010, që domethënë për 3 muaj janë shpenzuar 6 milionë euro më shumë se në vitin e kaluar, ku në përqindje është 26%.

Subvencionet për ndërmarrje publike nga Qeveria dhe MEF-i, me rishikim i jepen 41 milionë euro. Kjo është një gjendje e përmirësuar në sektorin e energjisë, kur dihet se Qeveria çdo vit i jep sasi të mëdha të hollave KEK-ut, diku 100 milionë euro subvencion, ku mendoj se planifikimi për subvencione me qindra milionë euro po keqpërdoret edhe nga vetë Qeveria në KEK. Derisa në KEK pagat e menaxherëve kalojnë ...

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, përgatitet deputeti Bajram Kosumi.

MIMOZA AHMETAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh faktin se rishikimi i buxhetit të vitit 2010, është hartuar në pajtueshmëri të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ne kemi shumë arsye të presim që në të ardhmen e afërt Kosova të ketë qasje në programet e FMN-së, me çka do të na mundësojë që ne të kontribuojmë në zhvillimin e vendit, duke tejkaluar kufizimet që vijnë nga të hyrat buxhetore. Rishikimi i planifikuar i buxhetit është bërë në përputhje të plotë me prioritetet e përcaktuara nga Qeveria, e që janë: rritja ekonomike, zhvillimi dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale, arsimi, qeverisja e mirë dhe stabiliteti social.

Nga njëra anë, ky buxhet adreson nevojat e ekonomisë së vendit, ku ruajtja e nivelit të lartë të shpenzimeve kapitale synon krijimin e një ambienti stimulues për investime private, ndërsa nga ana tjetër, është respektuar parimi i ruajtjes së qëndrueshmërisë fiskale. Kjo do të thotë se përkundër rritjes së kufirit të shpenzimeve, kemi edhe rritje të të hyrave prej 85 milionë euro. Është inkurajues fakti që edhe përkundër prezencës së krizës ekonomike botërore, të hyrat vendore dhe ato nga kufiri nuk janë ndikuar negativisht nga kjo krizë. Kosova do të ketë një rritje të projektuar ekonomike prej mbi 4% gjatë vitit 2010. Rreth 32% e shpenzimeve primare të këtij buxheti apo mbi 495 milionë janë dedikuar për investime kapitale, duke ofruar shtypje të vazhdueshme për rritje ekonomike në vend. Do t'i përmend vetëm disa nga fushat kryesore. Transporti u përmend edhe më herët, nisja e ndërtimit të rrugës së kombit në të cilën do të investohen edhe 85 milionë euro

për fillimin e ndërtimit të autostradës, pastaj në fushën e arsimit, universitetit, sektori i arsimit është identifikuar të jetë burim i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik dhe prioritet i Qeverisë dhe ky projektbuxhet, në mes tjerash do të financojë themelimin e Universitetit të Prizrenit në një vlerë prej 2 milionë eurove, si dhe të zgjerojë kapacitetet e Universitetit të Prishtinës edhe për 4000 studentë të ri, si dhe tërheqjen e profesorëve me kualifikime të larta për këto universitete. Në shëndetësi, me rishikim të buxhetit do të ndahen mbi 8.3 milionë euro për rritjen e pagave të të punësuarave në nivelin shëndetësor. Tek buxheti komunal është me rëndësi të përmendet se planifikimi i buxhetit reflekton politikat e Qeverisë në fushën e decentralizimit, ku përfshihen edhe kostot e krijimit të komunave të reja. Po ashtu, për buxhetin komunal është ndarë edhe grandi qendror prej 3.3 milionë euro shtesë për mbulimin e rritjes së pagave dhe pagesën e 44 eurove shtesë për punëtorët shëndetësorë në komuna.

Duhet përmendet, gjithashtu, se me rishikim të buxhetit kemi rritje të kufirit të shpenzimit prej 111 milionë euro, rritje kjo e shpërndarë sipas institucioneve qendrore. Po i përmend vetëm disa më të rëndësishmet. Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, gjithsej 6 milion euro, nga të cilat policia do të përfitojë 3.5 milionë euro, pagat e policëve, dhe 2.5 milionë euro për pasaportat biometrike. Ministria e Drejtësisë, e Forcës së Sigurisë, 2 milionë euro për pagat e ushtarëve të FSK-së, e Shëndetësisë, 5.9 milionë euro, pastaj Radiotelevizioni i Kosovës. Me këtë rishikim është arritur, po ashtu, që në kuadër të këtij buxheti të përfshihet edhe krijimi i institucioneve të reja, si Ministria për Integritet Evropian, Agjencioni për Pasuri të Sekuestruar, si dhe shtesa për Radiotelevizionin e Kosovës. Përmes këtij procesi është ruajtur neutraliteti buxhetor. Aq sa ka qenë rritja e të hyrave, kemi pasur edhe ndarje të reja, apo rritje të kufirit të shpenzimeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, përgatitet deputetja Drita Maliqi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues i seancës!

Natyrisht që nuk mund të diskutoj ndryshe nga që kam diskutuar kur është miratuar buxheti, ky buxhet, do të thotë, Buxheti i vitit 2010, sepse edhe atëherë, edhe sot, me këtë rishikim ky buxhet vazhdon të jetë jo buxhet i prioritetëve që ka caktuar Qeveria në bazë të vizionit të vet, në bazë të programit të vet, në bazë të ideve të veta, por një buxhet i caktuar për interesa të llojllojshme, nuk po diskutoj tash cilat mund të jenë ato interesa, mund të jenë të shumta, por jo për ma të rëndësishmin. Jo pse Qeveria ka një prioritet të caktuar dhe me këtë fakt që, realisht, me keqardhje duhet të konstatohet, ndoshta asnjë qeveri, po edhe kjo jo se jo, nuk ka arritur të krijojë një vizion dhe një koncept zhvillimor për Kosovën, që të thotë - për këto 4 vjet ky është projekti themelor në të cilin do të investohen paratë publike në Kosovë.

Edhe ky buxhet, edhe këto rishikime janë të shpërndara, është i hartuar dhe paratë shpërndahen në bazë të interesave momentale ose në bazë të fuqisë që kanë ministrat brenda Qeverisë, në bazë të autoritetit që kanë ministrat brenda Qeverisë.

Paratë publike në Kosovë shkojnë pse një ministër ka autoritet më shumë, e jo pse populli i Kosovës ka interes më shumë në një fushë të caktuar. Mjafton të përmend dy shembuj. Para shtatë muajve, Qeveria nuk ka kërkuar asnjë euro për Universitetin e Prizrenit, do të thotë në konceptet e Qeverisë nuk ka ekzistuar projekti i Universitetit të Prizrenit dhe për njëherë vjen projekti i Prizrenit dhe tash Qeveria e mbanë si flamur të reformave në arsim. Është një tregues për politikat e çastit që është duke i bërë Qeveria, që po vazhdon të bëjë çdo ditë e tjera. Ose merreni shembullin tjetër, autostradën, për të cilën me aq pompë po flitet në Kosovë. Qeveria po planifikon që t'i shesë pronat publike të Kosovës dhe me paratë e fituara prej privatizimit të ndërtojë autostradën. Kjo është ta shesësh kapitalin e gjallë për ta futur në kapital të vdekur.

Nëse po bëka ta shesësh kapitalin e gjallë, PTK-ja është kapital i gjallë, gjeneron të ardhura, nëse po bëka ta shesësh, pse nuk po bëka të investohet në termocentral të ri, pra, të investohen paratë e gjalla në një projekt që përsëri gjeneron para. Çfarë logjike ka koncepti për një autostradë moderne e cila do të flejë, nuk dihet sa do të flejë derisa të lidhet me autostradën me Serbi dhe me Evropën qendrore.

Qytetari i Prishtinës, edhe në këtë moment po ti hipë makinës së tij, shkon në kufi për dy orë. Edhe po ta bëjmë autostradën, që po shkuar për një orë. Cili është fitimi i Kosovës? Gjysma e Kosovës, pjesa perëndimore e Kosovës për të shkuar në kufi, edhe po të ndërtohet autostrada, ai nuk do të shkojë fare nëpër autostradë, edhe për një pjesë të Kosovës jugore, po ashtu. Ku ka logjikë të zhvillimit ekonomik të shitet kapitali i gjallë dhe të shtihen paratë në asfalt. Kjo është tregues i fuqishëm jo vetëm për mungesën e vizionit të cilës do qeveri, konkretisht edhe kësaj qeverie, mungesën e vizionit të zhvillimit ekonomik, por është tregues se për shkak të kësaj mungese të vizionit, Kosova është kah hyn në qorrsohak ekonomik. Kosova mund të ngulfatet në të ardhmen ekonomikisht. Ne po hyjmë në shpenzime të pallogaritura për shkak të mungesës së këtij vizioni e tjera.

Arsyeja e dytë, është ajo që u përmend disa herë, politikat joharmonike të zhvillimit ekonomik në Kosovë. Vetëm një shembull po përmend. Prej 202 milionëve të Ministrisë së Transportit, vetëm 800.000 euro janë të ndara për komunën e Kamenicës. Është disproporcion i patolerushëm, i papranushëm për cilëndo qeveri, për cilindo ministër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Drita Maliqi, përgatitet deputetja Synavere Rysha.

DRITA MALIQI: Ju faleminderit, zoti kryesues, ju përshëndes!

Të nderuar deputetë,

Ministra prezentë,

Unë isha ndalur në tabelën 4.2 - Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2010. Duke i analizuar transferet qeveritare nëpër komuna, pash një laramani të këtyre transferove. Zoti ministër, më intereson të dijë në bazë të çfarë kriterëve është bërë kjo ndarje e këtyre investimeve. Unë po nisem nga regjioni nga vijë edhe unë, për shembull, Gjilani, Kamenica dhe Vitia. Shoh që për këto komuna, duke i krahasuar me komunat përafërsisht të njëjta, nuk është bërë një ndarje e drejtë për Gjilanin, ku janë ndarë 2.430.000 euro, kurse për shembull, në se ndalemi te Podujeva, 4.300.000 euro, gati dy herë më tepër. Prizreni 8.150.000 euro, apo 3.4 herë më tepër, Gjakova 3.360.000, Ferizaj 3.780.000 e kështu me radhë, apo kur i krahasojmë edhe komunat më të vogla, për shembull, në qoftë se e shohim Kamenicën dhe Vitinë, me disa komuna të tjera përafërsisht të njëjta, si për shembull Lipjani, Rahoveci, e kështu me radhë, apo Suhareka, Vushtrria e të tjera, shohim se këto komuna përfitojnë për gjysmë më pak se komunat se tjera të lartpërmendura.

Duke i pa të gjitha këto, i nderuar, kërkoj të bëhen korrigjime dhe edhe këto tri komuna të trajtohen si edhe ato komunat e tjera. Kjo po ndodhë prej viteve, domethënë, që jam unë këtu në këtë legjislaturë prej tri viteve. Ju lutem, nëse keni mundësi, kërkoj që vërtetë edhe Gjilani dhe komunat që i ceka më lartë, të trajtohen njëjtë, sepse jemi të një vendi, të një shteti që jemi duke e zhvilluar bashkërisht. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Synavere Rysha, përgatitet deputeti Driton Tali.

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Është mirë që këtu prezent pak më parë ishte edhe zoti Hamza, zëvendësministër, por edhe drejtori i buxhetit. Neve këtë rishikim të buxhetit që po e bëjmë, po e bëjmë vërtetë për t'ia dhënë formën e ligjit. Por edhe planifikimi dhe miratimi i buxhetit vjetor kur po bëhet, nga momenti kur kalon nga ky Kuvend, duhet ta marrë formën e ligjit dhe asnjë pozicion nuk guxon të ndryshohet pa pëlqimin e këtij Kuvendi.

Mirëpo, kjo sikur është zbehur fare nga Qeveria dhe sikur Qeveria po vazhdon në mënyrën e vet dhe pozicionet po i ndryshon pa pëlqimin e Kuvendit. Prandaj, unë fillimisht do ta kisha vë në dilemë, a ka nevojë

të bëjmë rishikim, a ka nevojë ky Kuvend t'ia japë formën e Ligjit këtij buxheti apo buxhetin t'ia lëmë në hierarki, t'ia lëmë kryeministrit dhe ministrave përkatës që ta shpenzojnë dhe ta menaxhojnë në mënyrën qysh ata mendojnë, sikur ta kenë parënë në xhep dhe ta shpenzojnë në mënyrën ad-hoc apo të momentit. Cila do kërkesë që i paraqitet dhe e shohin të arsyeshme si Qeveri, ata ndërhyjnë dhe e miratojnë pa pëlqimin e Kuvendit. Kjo të paktën shihet nga raportet vjetore për shpenzimet që krijohen për periudhat përkatëse, e më i freskët ishte Raporti i vitit 2009, ku kemi pasur pozicione të cilat ky Kuvend fare nuk i ka miratuar, megjithatë kanë figuruar apo kemi pasur lëvizje të shumave në pozicionet e ndryshme, të cilat Kuvendi nuk i ka miratuar. Sido që të jetë, tashmë kemi hyrë në debat dhe është mirë që të debatojmë edhe për rishikimin dhe ta kenë parasysh institucionet se duhet të respektohet në mënyrë strikte dhe në mënyrë të përpiktë.

Nga raporti të cilin e ka paraqitur Ministria, nga raporti me rishikim, buxhetin me rishikim gjashtëmujor që e ka pru Ministria para nesh, që në fillim shihet një mospërputhje midis asaj që është planifikuar dhe është vendosur nga ky Kuvend, dhe buxhetit fillestar të vitit 2010, që pasqyrohet në rishikim. Kemi dy dokumente të ndryshme, kemi edhe shuma që aty-këtu me miliona, 1 milion, 3 milionë, 10 milionë ndryshojnë dhe nuk janë pasqyruar drejt.

Mandej, po të shkohet në analizë të buxhetit fillestar dhe të buxhetit të rishikuar, që vërtet sot është roli ynë si deputetë, sepse të paktën nuk kemi nevojë të jemi, të vlerësojmë, është buxhet i mirë, është buxhet i keq, por megjithatë të shohim brenda këtij buxhetit të mirë apo të keq se çka është bërë dhe si është ndarë. A është ndarë në mënyrën më të mirë të mundshme apo shkuar dhe është thelluar ky hendek, domethënë ka shkuar një qasje edhe më negative. Ajo që vërehet te të hyrat, janë vetëm dividendat ato që e kanë rritur buxhetin për vitin 2010, domethënë nga ky rishikim gjashtëmujor dhe këto dividenda nuk e di pse nuk janë paraparë në fillim të vitit, në buxhetin fillestar, por megjithatë është mirë që të paktën janë paguar këto dividenda dhe janë derdhur në buxhetin e Kosovës.

Sido që të jetë, qasja kryesore është te shpenzimet. Shpenzimet si kategoria më e rëndësishme e buxhetit të Republikës së Kosovës dhe atë jo shpenzimet kapitale, por shpenzimet përgjithshme, ku hyjnë shpenzimet rrjedhëse, shpenzimet për paga dhe mëditje dhe shpenzimet për mallra dhe shërbime.

Ajo që vërtet është ndoshta për t'u shqetësuar, sepse vazhdimisht kemi pasur deklarime nga Qeveria se po i zvogëlojmë shpenzimet, në të kundërtën kanë ndodhur rritje të shpenzimeve.

Më intereson kategoria – Pagat dhe mëditjet. Janë diku 19 milionë rritje dhe uroj që këto rritje të shkojnë kryesisht për implementimin e Ligjit mbi shërbimin civil, sepse është kategoria e shërbyesve civil ajo që më së pakti është përkeqësuar dhe urojmë që këto 19 milion, të prekin të paktën kategorinë e të punësuarve të administratës. Mandej, kemi pozicionin tjetër – Mallra dhe shërbime, një pozicion që vazhdimisht nga Qeveria është potencuar se po zvogëlohet dhe sa kemi zvogëlim aty, kemi vetëm 5 milion dhe vërtet kjo është shqetësuese. Kemi me numër, nuk di sa projektligje dhe sa kresa buxhetore, ku Qeveria arsyeton vlerësimin e ndikimit buxhetor. Kemi zotin Krasniqi këtu, që vërtet është ai që i nënshkruan të gjitha vlerësimet e ndikimit buxhetor dhe thotë – pozicioni që do të sigurohet, janë pozicioni i mallra dhe shërbime. Por, vërtet unë kam pritur që të paktën 50 milionë t'i kemi nga ky pozicion, i nderuar, sepse kështu të paktën po i pasqyroni projektligjet, kështu të paktën po i mbulonin dhe po i arsyetonin kërkesat buxhetore nga institucionet e ndryshme dhe ky pozicion po lëvizë vetëm 5 milionë euro. Aty janë vetëm 5 milion euro kursime dhe nuk di Qeveria çka do të bëjë me të gjitha ato kërkesa, të paktën vetëm në gjashtëmujorin e parë që i ka pasur, por edhe gjashtëmujori i dytë që do të vjen me këtë ndikim dhe ua tërheq vërejtjen të jeni pak më korrekt dhe të respektoni këtë pozicion, sepse vërtet po bëni lojë me deputetët dhe po e gjeni ndoshta si mbështetje apo si arsyetim për të thënë - do të sigurohen nga ky pozicion, kur po mbeteni pa buxhet.

Për ta analizuar këtë pozicion, unë të paktën kam pritur që ky pozicion të jetë i zvogëluar, sepse....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë të Kosovës, ky debat tregon edhe një herë se si udhëheq kjo Qeveri, ky koalicion i panatyrshëm. Pikat më të rëndësishme, i shkurtrojnë debatet nga 10 minuta në 5 minuta, ashtu patën bërë edhe me Strategjinë për energjinë, kur kryeministri e kontrabandoi atë, apo Qeveria e futi me zor “Kosovën B” në paketë. Unë nuk po habitem me deputetët e koalicionit, po them të panatyrshëm qeveritar, por me këta opozitarë jam kah çuditë pse votojnë, mbase kanë filluar edhe me kryeministrin të luajnë shah, ashtu sikur me presidentin.

I thashë këto fjalë, se jam përgatitur, ka shumë që janë përgatitur për 10 minuta dhe tash çka të flasim përpara. Por, sidoqoftë, unë do të ndalem në disa pika këtu, që të them diçka ndryshe.

Duke e parë këtë buxhet, ma çon mallin e njëfarë debati goxha moti ka qenë në qarqet akademike të ekonomisë, e ekonomia është shkencë, është art, megjithatë u vendos që është shkencë, sepse i ka ligjet e veta, i ka rregullat e veta, por ky buxhet jo që e bënë ekonominë art, por e bënë atë abstrakt, sepse të gjitha ligjet e ekonomisë i shkel me dy këmbët. Dhe shikoni se si përpilohet. Ja, po ua lexoj disa shifra për qytetarin e Kosovës. Fillimisht po e marr vitin 2009, sepse kështu vazhdon gjithnjë në kontinuitet. Të hyrat, thotë, në kufi, patën qenë të planifikuara 645 milionë. U bë këtu debat, se s’mund t’i arrin ato, jo i arrijmë, bënin be e rrëfe dhe më në fund doli se të hyrat në kufi ishin 635 milionë.

Pastaj, po i marrim të këtij viti. Të hyrat vendore u planifikuan 235 milionë, tash 216 milionë, domethënë nuk përcillet logjika ekonomike, po përpilohet në atë stilin – buxhet sivjet kemi 680 milionë, jo 680 por 700, jo 750, zgjate dorën – 700, kështu e bëjnë punën në këtë buxhet. Domethënë, po them, duhet të jesh goxha një artist dhe atë ta kuptosh atë abstrakten për t’ua kuptuar kokën se si e përpilojnë këtë buxhet. Ajo që desha të marr një informatë, unë nuk jam kah mund ta marr atë informatë, se e prita ministrin të kthehet, është puna e 266 milionëve, sa është marrë fitim vjet. E dimë që më 2008 keni marrë 3 milionë, të paktën kështu publikisht keni deklaruar, 3 milionë euro fitim në 266 milionë, pra kamata ka qenë 1.12%. Shih ti! Inflacioni në eurozonë atëherë ka qenë 3.77. Pra, realisht, shikuar krye për krye, është dashur të jenë 10 milionë për ta përcjellë pra paranë, mos të humbë, 10.228.200 euro, pra na i kanë humbur këta ekspertë, këta gjenitë, na i kanë humbur 7.490.000 euro veç në vitin 2008. Janë futur në do loja, që nuk kanë lidhje me krye apo dikush atje dinë, andaj edhe Banka Qendrore është bërë bunker, asnjë informatë nuk e lëshojnë, se një zot e di çka del aty dhe nuk na i japin për vitin 2009. Këta ekspertë na i humbin partë, futen në disa, të them, në disa çështje që dikush mbase i dinë atje, nuk dyshoj, por të tjerët nuk i dinë dhe nuk na japin informata. Unë e di që tash zoti ministër do të thotë se kjo është çështje e guvernatorit të bankës, se ju e keni zgjedhur, por nuk thotë se e kanë zgjedhur deputetët e koalicionit të panatyrshëm qeveritar, bile - bile goxha ka pas hequr kryeministri me disa deputetë, se nuk donin t’ia votonin. Sidoqoftë, unë nuk e kam të qartë, t’i bie si shkurt, se ka shumë për të thënë, unë nuk e kam të qartë se si do të mund ta realizojnë këtë buxhet, tash, pa u futur në ato politikat shpenzuese, kur tatimi në kufi, deri në javën e 22-të ka qenë për 21 milionë euro më pak, ngjashëm ka pasur edhe tatimi në korporatë, sepse tash mbase Qeveria u kujtua që akcizën ta rrisin për ta mbuluar atë grumbullimin e tatimit në korporatë, të cilin përndryshe do ta...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, përgatitet deputetja Besa Gaxherri.

FATMIR REXHEPI: Ju faleminderit!

Përsëndetje!

Në parim, jam për politikë të mirë të Qeverisë që ka të bëjë me pasqyrimin e saktë të realitetit për gjendjen reale të ekonomisë. Me rastin e rishikimit të buxhetit, praktika që po ofron Qeveria është me plotë ndërhyrje dhe politika të investimeve joparimore. Njëherësh po krijon dhe thellon dallime regjionale, si dhe po del jashtë strategjisë dhe parimeve bazë të kornizës zhvillimore.

Sot më duhet të rikujtoj edhe fazën e debatit për buxhetin në fund të vitit 2009. Në mënyrën më konkrete ky projekt po tregon edhe dallimin me fjalët e vet kryeministrit gjatë fushatës zgjedhore, i cili thoshte: “bujrëm popull, rrugë, ujë, shkolla, universitete, paga të fuqishme do t’ua japim nga 50, 100, 150 milionë e deri te luginat e silikonit”. Atëherë, ku mbeti dhe avulloi e vërteta në gjashtëmujorin e parë?

Në kushtet kur kjo situatë nuk pranohet nga Qeveria, rezulton jo vetëm një premtim i gabuar që po përsëritet, por flet për performancën që rezulton nga një mos vlerësim i saktë i potencialit ekonomik që ka vendi dhe mungesa e përgjegjësisë, transparencës dhe premtimeve politike para qytetarit.

Zoti ministër, me këto politika buxhetore sa do të jeni në gjendje të mbani stabilitetin makro-ekonomik, si dhe ku do të gjenden paratë tjera për të financuar rritjen e pagave për arsimtarët, për gjyqësorin, policinë, administratën, pensionistët, sepse kjo politikë e investimeve në këtë rishikim rrezikon fondet zhvillimore të këtyre veprimtarive, si dhe nuk do të mundësojë zbutjen e çështjeve të papunësisë dhe ato sociale.

Leximi me kujdes i buxhetit rritë dilema se si do të financohen investimet për të garantuar një rritje ekonomike, apo do të vazhdohet duke shitur pasurinë publike dhe pronën për t’u kthyer në qiraxhi dhe të jetojmë me qira në shtëpinë tonë të pavarur. Atëherë, lind pyetja – çfarë është pavarësia politike pa pavarësi ekonomike për një qeveri demokratike, sepse financimi i shtesës së shpenzimeve dhe investimeve kapitale, me të cilat mburret Qeveria, paralizohet nëpërmjet parave nga privatizimi i nxituar dhe shitja e shpejtë e kompanive publike më profitabile edhe atë në mungesë të politikave të Qeverisë, vetëm e vetëm që ato të menaxhohen mirë. Kudo dhe zakonisht politika e buxhetit dhe e investimeve duhet të synojë dhe të mundësojë, pra, rishikimin e parametrave buxhetor që të mbajë parasysh modelin e një ekonomie konkurruese, mbështetje çdo stimulimi për biznesin që i hapë rrugë rritjes ekonomike, por jo duke i mbajtur fondet milionëshe jashtë Kosovës.

Për vitin 2010, FMN-ja ka propozuar një rritje prej 3.5% si dhe rreziqet që i vijnë ekonomisë nga mos transparenca me fondet e investimeve, si dhe nevojën e ruajtjes së ekuilibrave makro ekonomikë, atëherë si po ecim ne? Qeveria edhe me këtë rishikim buxhetor vazhdon jo vetëm të planifikojë, por edhe të zhvillojë politika që nuk garantojnë një rritje të shpejtë ekonomike të vendit, në zvogëlimin e shkallës së lartë të papunësisë.

Kështu, unë kam vlerësim shumë kritik në rishikim të buxhetit, duke kërkuar nga Qeveria e koalicioni detyrimisht qëndrim realist ndaj potencialit ekonomik, perspektivës zhvillimore njësoj për të gjithë qytetarët. Po ashtu, unë mbaj një qëndrim objektiv me këtë rast, sepse nga tabelat e ofruara, Kosova me këto politika sektoriale duket se po kalon në një zonë edhe më të rrezikshme drejt mos zhvillimit harmonik, investimeve të gabuara, që nesër mund të prekin në stabilitetin makro-ekonomik.

Kolegë deputetë, kështu edhe ky draft-buxhet, në formën e tanishme nuk ofron qëndrueshmërinë ekonomike të synuar, sepse investimet në super asfalt, do ta hanë të gjithë pasurinë e kompanive publike, si dhe rrezikun për borxhe të mëdha. Prandaj, duhet të ndryshojë strategjia e financimit të ndërtimit të autostradës. Faza e parë deri në Prizren, i dini problemet, kontratat, pasojat. Faza e dytë, Prizren – Lipjan – Prishtinë – Gjilan, e të quhet rrugë e kombit pra, duhet të dalë në Bujanovc. Afatet kohore duhet të rishikohen bashkë me procesin e privatizimit të PTK-së, e cila nuk duhet të ndodhë. Nëse e duam për 10 vitedo t’i kemi të gjitha bashkë, atëherë ne mund ta kemi autostradën, PTK-në, pa borxhe, por me investime në një formë tjetër. Po kështu, investimet dhe politika e ofruar vazhdon të diskriminojnë, pamundësojnë zhvillimin e Anamoravës dhe të Kosovës Lindore. Ja faktet: mungesë e magjistrales, hekurudhës, zonës ekonomike, tani do të mbyllet edhe Fakulteti i

Edukimit. Atëherë, pyetni qytetarët, biznesin dhe rininë – çka mendojnë? Janë edhe fakte tjera nga rishikimi i buxhetit. Shkolla në Zhegrën e Agim Ramadanit, që po rropaten që 3-4 vjet – 750.000, ndërsa krahasojë me Komogllavën, sa është një mëhallë e Zhegrës - 4 milionë për një shkollë fillore.

Rehabilitimi i rrugëve regjionale 47 milionë, Gjilani nuk e ka të ndarë asnjë cent. Bashkëfinancimi 14 milionë, Skenderaj - 3.5 milionë, Gjilani - gjysmë milioni. Ndërtimet e reja prej 13 milionëve, Skenderaj dhe Glllogovc kanë ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Besa Gaxheri, përgatitet deputeti Rexhep Hoti.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Realisht, serioziteti i debatit për këtë çështje kaq të rëndësishme për Republikën e Kosovës, automatikisht jep për kuptuar se sa serioz jemi ne, ose sa serioze është Qeveria e Kosovës, por pa e mohuar as përgjegjësinë e deputetëve apo të Kuvendit.

Të nderuar kolegë, çështja e buxhetit është kruciale, është shumë e rëndësishme. Në çdo shtet të botës demokratike, debatohet me ditë të tëra, qoftë për aprovimin e buxhetit, qoftë për rishqyrtimin e buxhetit, ndërsa ne në Republikën tonë, me shumë probleme politike, ekonomike, gjithçka kalojmë ad-hoc, edhe debatin për buxhetin e Kosovës e kalojmë ad-hoc ose me procedura urgjente, siç po ndodhë edhe sot. Edhe sot shkurtohet debati në 5 minuta dhe deputetët, natyrisht, mund të thonë diçka apo nuk mund të thonë asgjë. Nga kjo shihet se vërtet Qeveria nuk ka strategji kombëtare për politikën në përgjithësi dhe për atë fiskale buxhetore që gjithçka shkon ad-hoc, nuk ka projekte konkrete, nuk ka projekte kombëtare, që nuk ishte dashur ne t'i ndajmë pastaj në pozitë dhe opozitë. Unë do të ndalem shumë shpejt, natyrisht, se i kam vetëm 5 minuta, për të hyrat e përgjithshme.

Performancat e të hyrave buxhetore kanë trend negativ. Ta shikojmë, domethënë të hyrat vendore kanë rënie dhe ka ngritje nga të hyrat doganore, që këtë çdo ekonomist e kupton se kur kemi ngritje nga të hyrat doganore, atëherë kemi ngecje në zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht kemi, faktikisht planifikimi i kësaj Qeverie, që shikon ngritje prej buxhetit 1. miliardë e 106 milionë, këtë e shikon nga dividendat, jo nga performanca e të hyrave buxhetore, por nga dividendat, që realisht ne nuk e kemi të qartë, zoti ministër. Ti duhesh të na japësh ta kuptojmë ne decidivisht nga është kjo dividendë, 85 milionë, por ne e dimë, 80 milionë tashmë është publike që nga PTK-ja, ndërsa 10 milionë nga Aeroporti, 5 milionë kush i ka avulluar dhe kush do t'i avullojë, duhet të jeni shumë të qartë në këtë drejtim. Pastaj, shpenzimet. Në shpenzime shihet një diskrapancë nga ajo e planifikuar dhe nga të hyrat që keni realisht të planifikuara. Nga kjo shohim, pastaj, një ndarje ose një tërheqje të buxhetit në disa ministri, siç është për shembull, Ministria e Bujqësisë, që i tërheqni 1 milion, ia heqni, Ministrisë së Kulturës 1 milion, Ministrisë së Administratës Publike deri në 8 milionë, Ministrisë së Pushtetit Lokal 1 milion dhe, çka është më shqetësuese, Agjencionit të Intelejencës ia tërhiqni 1 milion. Kjo na jap për të kuptuar se çka planifikon kjo Qeveri. Ndryshe del e flet për projektet zhvillimore të bujqësisë, ndërsa këtu në rishikim planifikon t'ia marrë Ministrisë së Bujqësisë 1 milion. Njëkohësisht, për Administratën Publike, që veç kemi menduar që duhet të bëhen përmirësime, ndërsa këtu ka zbritje tek buxheti i kësaj Ministrie.

Pastaj, ju zoti ministër, nuk e keni sqaruar ende se vërtet kredia për KEK-un, është kredi apo subvencion. Definitivisht, duhet të jetë kufiri tashmë në këtë çështje dhe njëkohësisht më ka bërë përshtypje ndarja për Radiotelevizionin e Kosovës për 10.464.000. Kjo Qeveri, me gjithë këtë Kuvend, nuk planifikojnë të gjejnë mënyrën e financimit të Televizionit publik, të këtij mediumi publik, por shikojnë ta kenë në kthetrat e veta dhe, natyrisht, shihet në çfarë forme funksionon ky medium publik dhe shihet edhe këtu, keni prurje të

gatshme dhe asnjë propozim se në çfarë forme duhet të gjejmë për ta financuar këtë medium, por i keni ndarë nga buxheti i Kosovës, ua keni marrë ministrive të Kulturës, Bujqësisë e tjera dhe i keni ndarë Radiotelevizionit të Kosovës. Kjo është krejtësisht e papranueshme.

Pastaj, diskriminimi tek ndarja e buxhetit jo të drejtë për kuvendet komunale. Këtu nuk dua të ndalem konkretisht, sepse të gjithë deputetët e kanë buxhetin përpara dhe ne shohim realisht një ndarje shumë të padrejtë, jo vetëm në aspektin politik partiak, por edhe në aspektin e ministrave të cilët kanë autoritet apo të cilët janë më “sherifa” këtu në Qeveri, ata kanë më shumë mundësi për ta ndarë buxhetin për komunat nga vijnë ata. Kjo është, të nderuar kolegë deputetë, krejtësisht e papranueshme dhe natyrisht se Lidhja Demokratike e Dardanisë një buxhet të tillë, një ndarje të tillë të padrejtë, një ndarje të tillë të pamenduar dhe ad-hoc, shumë urgjent, që për ne nuk ka nevojë të jetë urgjent, buxheti duhet të debatohet me ditë të tëra dhe duhet të realizohet, është e paarsyeshme.

Krejt për fund, dua t’ua tërheq vërejtjen, zoti ministër, për devidendën e PTK-së...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka Rexhep Hoti, përgatitet deputeti Heset Cakolli.

REXHEP HOTI: Ju faleminderit, kryesues!

Më lejoni që në fillim të shpreh brengën se nuk është praktikë e mirë që ka filluar të bëhet që për tema të caktuara të shkurtohet koha e deputetëve. Shpreh mendimin se kjo është një praktikë e gabueshme për vetë mazhorancën, deputetët duhet t’i lënë të flasin atë çfarë kanë për të thënë. Nuk është kjo hera e parë që përndodhet dhe shpreh një brengë në këtë drejtim, sepse kjo është çështje shumë e keqe.

Në lidhje me rishikimin e buxhetit të Kosovës unë i kam përgatitur disa pika, për të cilat do të mundohem të flas me radhë. Kemi kënaqësinë të themi edhe një herë se populli i Kosovës, me Qeverinë e koalicionit PDK-LDK, arriti të kuptojë se në Kosovë, megjithatë, buxheti ka të holla dhe mund të punohet me paranë publike. Kjo është shenjë shumë e mirë, e cila i ka bërë të vetëdijshëm të gjithë qytetarët e Kosovës për t’i kapur ato forma dhe për të besuar se vërtet në Kosovë ka të holla me të cilat ne mund të punojmë, por kjo njëkohësisht i ka dhënë kënaqësi opozitës dhe aspektet e tjera t’i shprehin mospajtimet dhe brengat e tyre për një buxhet të caktuar. Prandaj, pika e parë, ne duhet të kuptojmë se qeverisja PDK-LDK ka ofruar për herë të parë argumentin se Kosova ka buxhetin e vet dhe me buxhetin e saj ajo mund të zhvillohet.

Pikë e dytë, dua të them se qëllimi i çdo buxheti qeveritar është që të ketë një karakter multidimensional. Pra, ai nënkupton në radhë të parë zhvillim ekonomik, stabilitet ekonomik, minimizon tensionet sociale, ka efekte pozitive në të gjitha aspektet nga politika e jashtme e deri te ambientalizmi, pra është një çështje, një buxhet që njerëzit i bënë të ndihen më mirë. Mirëpo, pikë kulminante e gjithë kësaj është që buxheti duhet të jetë veprimtari kulmore që bën të mundshëm funksionimin e shtetit në aspektin politik dhe funksional.

Pikë e tretë, për të cilën unë dëshiroj të flas, është buxheti i dy niveleve në aspektin qendror dhe aspektin lokal. Konsideroj që diferenca në mes të buxhetit qendror dhe atij lokal duhet të ndryshohet në të mirë të pushtetit lokal, sepse ne kemi zhvillime të hovshme të komunave, të proceseve integruese të decentralizimit e tjera e tjera. Pra, me fjalë tjera, buxhetin duhet ta kuptojmë në shërbim të qytetarit, e ne e dimë fare mirë se komunat janë organizatat e para, organizmat e parë të gjallë të shtetit që iu shërbejnë atyre dhe në këtë drejtim duhet bërë ndryshim, gjithashtu.

Pikë e katërt, që kisha për ta parë, është fuqizimi që i është bërë me buxhet Ministrisë së Transportit. Më lejoni të them se ky fuqizim mund të arsyetohet në tri rrafshje. Në rrafshin kombëtar pra kemi një zhvillim të hovshëm, që do të fillojë nga turizmi, tregtia, ekonomia e deri te aspirata e bashkimit kombëtar, ndërkaq në

rrafshin evropian, ne e dimë se shqiptarët kufizohen me dy shtete evropiane, me Greqinë dhe Italinë, pra është një segment dhe një gjë shumë e qëlluar, mos të harroj të përmend edhe vërejtjet që Shtefan Fyle ua dha institucioneve të Kosovës, duke thënë - merreni nga Shqipëria atë që keni nevojë për ta marrë, pa frikë e pa brengë.

Ndërkaq, në aspektin ndërkombëtar, më lejoni t'ju them se rruga Durrës –Merdar është rrugë e cila i shërben në mënyrë të shumanshme edhe NATO-s dhe ky element deri me sot nuk është bërë shumë publik.

Pikë e pestë, është fjala..., i kisha marrë dy ministritë problematike, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Bujqësisë. Ministria e Shëndetësisë për nga volumi, për nga të hollat, ka 7 herë të holla më tepër se e Bujqësisë. Që të dyja janë pika të dobëta tonat, për të cilat ne duhet të punojmë jashtëzakonisht shumë. Në shikim të parë, mbi 70 milionë, sa i ka Qeveria e Shëndetësisë, duket se ajo mund t'i plotësojë nevojat e veta. Mjerisht, me buxhetin që e ka, ajo nuk mund të funksionojë ashtu si duhet, pra nuk i kryen problemet e veta dhe krijohet në fakt si një ministri invalide. E njëjta gjë është edhe me Ministrinë e Bujqësisë. Me mbi 10 milionë që i ka, ajo gjithashtu nuk mund t'i kryejë funksionet e veta për t'iu ofruar 60% të popullit të Kosovës mundësitë dhe format e ndryshme të subvencionimit. Në këtë pikë, kisha për të thënë se më tepër se 100 milionë shkojmë, ne eksportojmë para të gatshme në fushën e shëndetësisë në rajon, në Serbi, në Maqedoni a....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Heset Cakolli, për gatitët deputeti Zef Morina.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kosova si në fushat tjera, ashtu edhe në fushën e shpenzimeve të buxhetit ka karakteristikat dhe specifikat e saja, andaj duke u mbështetur në ligj, është paraparë që të bëhet rishikimi i të hyrave dhe veçmas i shpenzimeve buxhetore me qëllim që ato të riorientohen dhe të specifikohen nëpër organizata buxhetore, sipas prioriteteve dhe rëndësisë së tyre.

Pas një analize gjithëpërfshirëse që i është bërë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177, për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010, do të mundohem që vërejtjet e mia t'i...në dy pjesë:

- a) në vërejtje parimore, dhe
- b) në vërejtje konkrete

Në vërejtjet parimore lidhur me buxhetin e Republikës së Kosovës, do të veçoja disa prej tyre:

1. Ekziston mospërputhje në mes të të hyrave dhe të dalave të mjeteve buxhetore, që paraqet njërin ndër prioritetet apo parimet kryesore të buxhetit, që më së miri shihen në tabelën 1, ku të hyrat janë paraparë 1 miliard e 106 milionë, ndërsa shpenzimet 1 miliard e 254 milionë, dhe

2. Prezenca e invazionit buxhetor, që është rezultat i veprimit të kontrabandës ekonomike, ekonomisë informale dhe krimit të organizuar e tjera. Vërejtjet konkrete janë të shumta. Në vazhdim po i paraqesë vetëm disa prej tyre, duke mos u lëshuar në detaje.

Në bazë të të dhënave në tabelën 1, rezulton se totali i të hyrave buxhetore është paraparë të ketë një rritje prej 77 milionë, ndërsa shpenzimet buxhetore, sipas të njëjtës tabelë, do të shtohen për 97 milionë, që do të thotë se shpenzimet do të jenë për 20 milionë më të mëdha se të hyrat e përgjithshme.

Të nderuar deputetë, duke pasur parasysh buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nevojat e shumta që ka shteti ynë për investime të shumta në sektorë të ndryshëm, rezulton se ky buxhet nuk mjafton për përmbushjen e kërkesave për investime kapitale, por megjithatë Qeveria duhet t'u japë prioritet disa sektorëve, unë me këtë rast kisha përmendur sektorin e bujqësisë, të shëndetësisë, të arsimit e tjera.

Organizata buxhetore me kodin 422, do të thotë ndërtimi i autostradës, i projektit numër 11302, në fillim të vitit 2010 ka pasur të ndarë shumë prej 20.500.000 euro, ndërsa me rishikim të projekteve kapitale për projektin me numër të kodit, tani 10419, ndërtimi i autostradës Morinë-Merdare, janë paraparë mjete prej 123.711.126 milionë euro. Vetëvetiu shtrihet pyetja – a janë avancuar punimet në atë nivel sa është paraparë shumat e mjeteve për këtë projekt për vendin tonë, sepse shumë regjione të Kosovës kanë nevojë për mbështetje, për projektet e infrastrukturës rrugore. Unë mendoj se edhe regjionit të Gallapit i mungojnë shumë rrugë që kishin për ta lidhur me qendrat urbane dhe kërkoj që të ndahen fonde shtesë për këtë regjion, sepse është interes strategjik, politik dhe ekonomik për shtetin tonë nëse ajo pak popullatë që ka mbetur atje, ta ndiejnë se institucionet e shtetit të Kosovës interesohen edhe për këtë pjesë të vendit.

Në tabelën e prezantuar nuk është vërejtur se mjetet e premtuara nga Qeveria prej 1 milion euro për Programin kombëtar të shkencës janë ndarë, edhe pse Programi kombëtar i shkencës ende nuk është aprovuar në këtë Kuvend, por unë konsideroj se me Programin kombëtar të shkencës janë paraparë disa aktivitete që duhet të zhvillohen gjatë vitit 2010 dhe duhet të mbështeten edhe në aspektin financiar. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Zef Morina, përgatitet deputetja Zylfije Hundozi.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Kolegë deputetë,

Rishikimi i buxhetit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-177 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010 është i nevojshëm, sepse në këtë mënyrë do të planifikonte më mirë shfrytëzimin dhe menaxhimin e buxhetit të shtetit në të mirë të ndërtimit të vendit. Gjithashtu, rishikimi i buxhetit do të bëjë të mundur plotësimin e kërkesave dhe kritereve të caktuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Pas një analize që unë i kam bërë këtij projekt buxheti ose rishikim buxheti, kam disa shqetësime të cilat dëshiroj t'i ceku dhe shpresoj që duhet të merren parasysh, pikërisht kanë të bëjnë me investimet kapitale. Gjer me tani vlera e përgjithshme e investimeve kapitale, ka qenë rreth 417 milionë euro, ndërsa me rishikim do të rritet në rreth 480 milionë euro, gjë që është vështirë të realizohet gjatë kësaj pjese të mbetur të vitit.

Nuk e kam të qartë arsyen pse gjatë këtyre muajve që kaluan, qoftë agjencionet shpenzuese, qoftë ato qendrore apo ato lokale, nuk kanë realizuar projektet më shumë se 10%, që do të thotë që realizimi i projekteve të investimeve kapitale për kohën e mbetur do të ishte shumë vështirë, duke pasur parasysh procedurat të cilat janë të nevojshme për t'i realizuar ato projekte. Andaj, kërkesa ime është që pas miratimit të rishikimit të këtij projekt-buxheti, të gjitha agjencionet shpenzuese, si ato të nivelit qendror, pra ministritë, dhe ato të nivelit lokal të përshpejtojnë me projekte të cilat i kanë prezantuar gjatë miratimit të buxhetit për vitin 2010 dhe të mos ndodhë që këto projekte për investime kapitale të humbasin në kohë dhe mjetet të cilat mund të kalojnë në suficit, të shfrytëzohen për qëllime tjera, gjë që do të ishte vërtet jo e mirë, sepse të gjitha ato projekte të cilat janë aprovuar në këtë parlament, domethënë janë të bazuara me ligj, duhet të realizohen dhe në këtë mënyrë unë besoj dhe shpresoj që pas miratimit të këtij buxheti, Qeveria duhet të përshpejtojë procedurat, duhet të jetë më azhure, në mënyrë që të gjitha projektet për investimet kapitale në të gjitha ministritë, nuk flas vetëm për një, të cilat janë në vonesë, t'i kryejnë detyrat me kohë në mënyrë që projektet kapitale të kryhen apo të zhvillohen dhe qytetarët vërtet mjetet të cilat i kanë grumbulluar, të shohin frytin e tyre.

Ajo që është më shqetësuese, është e vërtetë që në disa komuna nuk ka gatishmëri ose nuk ka interesim për të ofruar projekte, në mënyrë që të thithen mjetet nga Qeveria. Në këtë drejtim, shpresoj që edhe Qeveria, edhe institucionet komunale duhet të kenë një bashkëpunim më të ngushtë, sepse në këtë mënyrë qytetari do ta pësojë. Në përgjithësi, unë shpresoj se këto vërejtje do të merren parasysh dhe unë e mbështes në parim Projektligjin për buxhetin.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Zylfije Hundozi, përgatitet deputeti Naser Rugova.

ZYLFIJE HUNDOZI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Nëse analizohet edhe ky rishikim i buxhetit për këtë vit, mund të kuptojmë se nuk ka ndonjë ndryshim substancial nga ai i para gjashtë muajve. Shpenzimet e zotuar, sidomos për projektet kapitale, janë menaxhuar në mënyrë të dobët deri më tash, duke bërë që çdo vit të ketë një shpenzim të ultë të mjeteve të definuara për këtë qëllim. Po i marr shembull vetëm disa nga investimet kapitale të dedikuara për Qendrën Klinike Universitare. Renovimi i kulmit të Klinikës Infektive, ndërtesës së pediatriisë, i nyjeve sanitare për të gjitha klinikat, sistemi i gazrave medicinave figurojnë në projekte të reja që nga viti 2005 dhe çdo vit të njëjtat projekte barten prej vitit në vit dhe prapë deri në ditën e sotme mbesin të pakryera. Edhe pse buxheti për Ministrinë e Shëndetësisë është rritur këtë vit, situata e shërbimeve shëndetësore mbetet edhe më tutje e ultë dhe pacientët gjithnjë e më shumë shkojnë në vende të rajonit që të kërkojnë shërim në spitalet e tyre.

Pra, edhe ditën e sodit, qeverisja, efikasiteti dhe qëndrueshmëria financiare e sektorit publik shëndetësor duhet të përmirësohet substancialisht nëse dëshirojmë ta ndryshojmë situatën kaotike e cila tash mbretëron, sidomos në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Diçka që ishte befasuese, ishte ndarja e buxhetit për regjistrimin e popullsisë vetëm prej 1.300.000 euro, për regjistrimin e popullsisë në vitin 2010 është e nevojshme të ndahen 2,8 milionë euro.

Në Zyrën për regjistrimin e popullsisë janë të ndara për këtë vit vetëm 330.000 euro. Nëse nuk ndahen edhe 2 milionë e gjysmë euro me rishikimin e këtij buxheti, që nuk po figuron këtu, atëherë do të ketë probleme për realizimin e planit të aktiviteteve për regjistrimin e popullsisë. Sa ka rëndësi regjistrimi i popullsisë, nuk ka nevojë, besoj, që këtu ta elaboroj. Edhe pse ky projekt do të mbështetet dhe do të bashkëfinancohet nga projektet e IPS, shifrat që i përmenda pak më parë, është dashur që të sigurohen me këtë rishikim të buxhetit nga ana e Qeverisë. Edhe me këtë rishikim të buxhetit, nuk ka stimulim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të sektorit të bujqësisë, sektorë këta që kishin për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik të Kosovës, zhvillim ky mëse i nevojshëm dhe jetik për jetën e qytetarëve të Kosovës. Pra, në përgjithësi buxheti nuk është instrument efikas i politikës fiskale dhe nuk kontribuon në parashikushmerinë e zhvillimeve ekonomike.

Edhe në këtë rishikim mund të kuptohet se buxheti do t'iu përgjigjet presioneve shpenzuese ad-hoc. Po e jap vetëm një shembull qysh kuptohet për këtë gjë. Janë aktivitetet që i ka ndarë Qeveria që t'i plotësojë kushtet për liberalizim të vizave. Për Departamentin për kufi, azil dhe migracion janë ndarë vetëm 604.828 euro, e për riatdhesim të personave të kthyer, që është kusht themelor për ta fituar Udhërrëfyesin e vizave, nuk figuron në buxhet asnjë cent. Mendoj se përkushtimi ynë në këtë drejtim duhet të jetë serioz dhe me mbulesë e jo të jetë i prezantuar vetëm me retorikë boshe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, përgatitet deputeti Zafir Berisha.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ky rishikim i buxhetit për vitin 2010 flet qartë për një logjikë vërtetë ballkanase, provinciale, me ndarje buxhetore nëpër komuna jo proporcionale, tendencioze, shihet ndikimi i liderëve politikë, sidomos i

partnerëve të koalicionit, injorohen zona të tëra dhe regjione të tëra dhe kjo është për shqetësim, sepse kur po flitet për ndarje të Kosovës, ne me grande qeveritare, me buxhet të taksapaguesve të Kosovës po e ndajmë dhe po e parcializojmë vetë Kosovën. Nuk dua të marr shembuj konkret, vetëm dy komuna. Në komunën e Istogut, që tri vite nuk jeni një gjendje një palestër sportive, që kushton gjysmë milioni euro, ta përfundoni, bëhet fjalë për 70 mijë banorë. Kjo vërtet nuk ka kuptim dhe çfarë kontinuiteti dhe koordinimi ndërinstitutional të investimeve kapitale. Është një rrugë për bjeshkët e Istogut, që është rast konkret për alternativë zhvillimore të asaj komune dhe nuk lodhet askush për këtë. Pastaj, regjioni i Pejës dhe Bjeshkët e Rugovës, nuk jeni në gjendje 7 kilometra rrugë deri në Bogaj, njerëz të komunitetit të biznesit kanë investuar atje, kanë bërë çmos që të mbijetojnë dhe t'ia kthejnë dinjitetin dhe jetën e perspektivën e atij regjioni dhe Qeveria nuk qanë fare kokën për një nga pjesët vërtet më rentabile dhe që kanë mundësi të zhvillimit edhe të bujqësisë, edhe blegtorisë, edhe turizmit dhe eko-turizmit.

Po kthehem te Ministritë. Parashikime futuristike dhe premtime interesante për mua, por edhe për qytetarët në fushën e bujqësisë së agrobiznesit dhe të blegtorisë dhe kur i hiqen 1 milionë euro këtij sektori, që është shpresë për rimëkëmbjen ekonomike të vendit, atëherë kjo është paradoks dhe nuk ka koment. Nuk di si e shihni alternativën dhe ku po thirreni në një zhvillim ekonomik që e pritni 6% , mbase kjo do të mund të ishte vetëm një dëshirë e mirë.

Te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, asnjë projekt konkret për pjesën më vitale, për rininë. Te trashëgimia kulturore është një kala në Novobërdë që konsiderohet është 1200 vjet e vjetër, është shenjë e vetme që tregon prejardhjen tonë, është një kala ilire, le që nuk rikonstruohet dhe nuk kujdeset askush për te, por ka edhe tendenca të rrënimit të asaj kalaje nga bizneset ilegale, me adresë të caktuara që ju lidhet kryet në institucionet e shtetit.

Te Ministria e Shëndetësisë, zoti ministër, në mënyrën më koelgiale po ua them, nuk ka kontinuitet të investimeve në Qendrën Klinike Universitare. Nuk e di pse te Kirurgjia Pediatrie e shtyni për vitin 2011 dhe në rishikim të buxhetit ndahen vetëm 50.000 euro. Është i pakuptueshëm mënjanimi i këtij projekti që ka të bëjë me fëmijët, me shëndetin e nënës, fëmijës dhe Pediatrisë neo-natale, në kuptimin më pozitiv. Duhet të mendohet seriozisht për projekte në kontinuitet dhe më intereson a do të fillojë Kardiokirurgjia publike të jetësohet apo jo? Keni bërë një hap të mirë me nënshkrimin e marrëveshjes me ambasadorin italian, ju lutem, edhe Kardiokirurgjia private le të ecë tutje, po populli i Kosovës dhe pacientët e lodhur të Kosovës, e meritojnë një kardiokirurgji publike dhe t'i vënohet kapak kësaj pune, sepse vërtet u bëmë përrallë para pacientëve, po i ndajmë nga 2-3 milionë euro çdo vit e po shkojnë në adresa që edhe nuk ia donë fort të mirën Kosovës. Dhe, krejt në fund, ky buxhet do të rrisë trendet negative në vend, nuk ka shpresa për zhvillim, konsolidim as në aspektin ekonomik-social, do të rritë shkallën e varfërisë, do të rritë barrierat e investimeve të huaja në Kosovë dhe disa ministri veç po i keqpërdorin në sektorët e caktuar, p.sh. janë mënjeluar 2 milionë euro për barëra. A është gjendja më e mirë e furnizimit të listës esenciale? Jo. E dimë që janë vjedhur 1 milionë e gjysmë euro blanko, ish ministri me një kompani. Zoti ministër, a e keni shkëputur kontratën me atë kompani, që është lënda në prokurori? Dhe disa ministrive tjera, që po ju mbesin suficit me ka miliona euro, atëherë vërtet t'ju merren, t'ju merret buxheti dhe të kalohet në bujqësi dhe në mjedis, që janë fusha që kanë të bëjnë mbi 35% me agjendën evropiane për Kosovën. Vërtet këto ndarje buxhetore mua më shqetësojnë dhe do ta shqetësojnë edhe më shumë ditët në vijim popullin e lodhur të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! E ka kërkuar fjalën ministri Bujar Bukoshi.
E keni fjalën, zoti ministër!

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: Ju faleminderit, për fjalën, zoti kryesues. Nuk e kam paraparë, nuk i di edhe këto praktika në këto debatet tonat. Ishte një apel dhe një drejtim kolegjal, sa mora vesh unë. E ndiej për detyrë t'ju përgjigjem në këtë apel kolegjal. Para kësaj, do të kërkoja nga ju personalisht kolegjalisht, por edhe nga të gjithë kolegët e tjerë, por sidomos kolegët nga bramsha e mjekësisë, që Parlamenti, ky Kuvend i Kosovës mos të habitemi të bëjmë një divertim të vëmendjes, por të përqendrohemi në problemet të cilat asnjëri prej

neve nuk i mohon. Ne të gjithë e dimë si është gjendja në shëndetësi, si ka qenë, si janë grumbulluar problemet me dekada, si janë trashëguar ato dhe me çka po përballemi. Desha të them kështu, prapë në mënyrë kolegjiale, që mos të abuzohet mikrofoni në Parlament, duke bërë aludime folklorike, populiste, se e mori lumi këtë vend e tjera e tjera. Nuk është gjendja aq alarmante sikur që do të prezantohej te kusheritë apo ndërlikllat tona tash duke na shikuar në televizion këtu. Ju lutem, këtu duhet pasur kujdes, se është punë e përbashkët e jona.

Unë prej momentit kur e kam marrë këtë post, kam thënë që vet nuk mund t'i kryej këto punë, por edhe iu jemi përveshur punës. Tash, të kaloj në disa aspekte konkrete në mënyrë shumë të shpejtë, nuk dua ta abuzoj aspak vëmendjen e juaj, por edhe një herë duhet të konfirmoj përkushtimin e Ministrisë, të cilën unë tash e udhëheq me atë ekip çfarë e kam edhe me atë ekip çfarë do ta bëjë, që së pari nuk do të ketë mëshirë aspak, kurrfarë mëshire, të them kështu, në implementimin të komponentëve të shtetit juridik, të shtetit të së drejtës në ato fenomene, të cilat ne i dimë, domethënë parregullsi, shkelje të ligjit, abuzim të parave e tjera e tjera.

E dyta, profesionalizmi dhe ekspertiza, do të kërkohet punë, jo vetëm të kërkohet në financa, siç po kërkoj unë shpeshherë, gati, gati po gjendem në pozita të palakmueshme. Nuk është absolutisht gjithçka në financa, por është shumë me rëndësi, e dini ju atë, kolegë. Ndërsa termat “populli i lodhur”, “i palodhur” janë të gjitha institucionet tona të cilat do të kujdesen a të lodhet ai popull apo jo. Për informim tuajin, përmendet rasti i një skandali, një hajnie ose një abuzimi i parave publike që nga Ministria e Shëndetësisë janë... është dëmtuar Ministria e Shëndetësisë për afër 1.5 milionë, por për shkak të korrektësisë tani, unë e kam shkruar këtë edhe më saktësisht 1.408.629,34 centë. Unë po insistoј edhe për këto 34 centë, jo për ta bërë para folklor këtu, por do të... Ky rast është prezantuar, iu ka dorëzuar Prokurorit të përgjithshëm, zotit Kabashi, ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit ndërkombëtar, që të vazhdojnë investigimet. Unë nuk di më tutje çka del prej kësaj. Nëse del puna pastër, shumë mirë, do të jemi të lumtur të gjithë. Por, nuk ma merr mendja se do të dalim aq të lumtur.

Po të vargoja tash të shkoj pikë për pikë, do të na qonte larg. Unë me këtë, kaq e kisha përfunduar. Mua më shumë më nxiti ajo që po i ngatërrojmë këto apele këtu prej çështjeve esenciale që janë. Ministria e Shëndetësisë nuk ka financa të mjaftueshme, nuk ka menaxhim të mjaftueshëm. Punëtorët nuk janë paguar. Po të shkojmë, ju lutem, po të shkojmë në Qendrën Klinike Universitare, shumicën prej nesh do ta rrokte trishtimi, po e them këtë si ministër, se çfarë ambienti, domethënë një institucion shëndetësor si trajtohet, natyrisht pastaj shkojnë milionat jashtë për mjekim. Puna jonë është për t'i konsoliduar këto punët tona këtu, ta konsolidojmë funksionimin, t'i konsolidojmë aparaturat, Institutin Onkologjik që rri që 6 vite aty, e tjera e tjera, domethënë, për këto ne bisedojmë kur të doni këtu. Por, unë u kapa më shumë për këtë jo me ndonjë siklet, por ne fare mirë jemi duke e ditur, ne e kemi emëruar edhe ushtruesin e detyrës tash të QKUK-së, edhe unë e di se do ta kemi përkrahjen nga të gjithë kolegët....

(Nga salla parashtrohen pyetje, nuk dëgjohen për transkriptim)

MINISTRI BUJAR BUKOSHI: ... më falni! Edhe për atë e hapim një pikë të debatit në Parlamentit, nëse doni por nuk do të doja të abuzoj më shumë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, unë e shfrytëzoja të drejtën time, si kryesues i kësaj seance, që i a dhashë fjalën ministrit, Bujar Bukoshi. Gati sa një deputet mori kohë, afër 5 minuta, për shkak se nga disa deputetë u thirr. Lus ministrat që në fund të debatit, në parim kështu bëhet kur shqyrtohet buxheti dhe rishikimi. Për kundër replikë e ka fjalën, një minutë, Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër Bukoshi, krejt ato çka i thatë ju, vërtet unë ato shqetësime i ngrita dhe nuk jemi duke e zbuluar ujët e nxehtë këtu, por po tentojmë që të filloni nga Ministria që e udhëheqësi, se është e kontaminuar

dhe të vazhdoni tutje. Vërtet janë disa projekte nacionale që ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmirësimin e sistemit shëndetësor në vend. Ky është shqetësim i joni. Kurse ato aferat tjera, që edhe ju po i pranoni, ne e ngrisim shqetësimin si njerëz të zgjedhur dhe keni deklaruar vetë që kjo Qeveri e ka çjerrë Kosovën. Ishalla nuk e qvjerrni më, se vërtet ky popull është lodhur. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Zafir Berisha, përgatitet deputeti Eqrem Kryeziu.

ZAFIR BERISHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë do të përqendrohem kryesisht në ligjshmërinë rreth shfrytëzimeve të buxheteve. Do të nisem nga fala e kryetarit të komisionit, zotit Gani Koci, ku foli se pasi Qeveria e ka sjellë rishikimin e buxhetit në Kuvend, domethënë ka tendencë edhe rreth 20 milionë euro të pozicionohen, të gjindet vend. Kjo nënkupton se sa joserioze ka qenë kjo çështje për Qeverinë, e veçanërisht për ministrin.

Gjithsesi, kryetari i komisionit përmendi edhe Gjykatën Kushtetuese, njërin nga organet që është i thirrur për ta respektuar ligjin dhe Kushtetutën dhe, në fakt, shpenzimet e buxhetit, domethënë i bën shkeljet vetë. Unë dua të dal te ajo në kuadër të këtij rishikimi, pozicioni buxhetor për komunën e Prizrenit. Ne të gjithë e dimë gjendjen kaotike në komunë të Prizrenit dhe unë ministrin e kisha pyetur se si ka mundësi që të futet në rishikim buxheti i komunës së Prizrenit, kur rishikimi nuk është bërë në komunën e Prizrenit dhe, në fakt, shkelja e nenit 40.2 të Ligjit për qeverisje lokale, thjeshtë neve na vë, të nderuar deputetë, para një përgjegjësie. Në fakt, ne si organ më i lartë vendimmarrës, në rast se realisht votojmë këtë buxhet kësi soji, ne në fakt legalizojmë anarshinë në institucionet varëse, në këtë rast në nivelin lokal. Kështu që, unë, kisha kërkuar, pa dallim partie, nga të gjithë kolegët deputetë që mos ta votojnë rishikimin e buxhetit, sepse ne po legalizojmë shkeljen e ligjit në nivele, domethënë, varse. Ju faleminderit! Po e di që zotit kryeministër nuk po i pëlqen shumë, por ja që ky është qëndrim dhe unë kisha kërkuar mbështetje nga të gjithë deputetët. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Eqrem Kryeziu dhe, i fundit para pauzë, të përgatitet deputeti Ibrahim Gashi.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Me lejen tuaj, unë do të përshëndetja kryeministrin Thaçi, ministrat këtu të pranishëm, natyrisht edhe deputetët dhe edhe deputetët e këtij Kuvendi të nderuar,

Koincidoj me gjasë, ju keni bërë aty një magji dhe na keni lënë neve bashkë a bashkë, Zafirin dhe mua, njërin pas tjetrit, se unë jam paraqitur i fundit, t'ju them të drejtën, në listë por, sidoqoftë, e pranoj këtë kombinim dhe çka është më interesant, është hera e parë që do të pajtohem me zotin Zafirin. Edhe unë duhet të kërkoj falje, se edhe unë do t'i referohem pak rastit të Prizrenit, po kërkoj falje se natyrisht mua më ka kaluar koha të jem i përcaktuar sipas, si të them, koordinatave lokale tash. Je partizan i lokalizmit, por deri në njëfarë mase, deri në njëfarë moshe, e pastaj i kapërcen ato koordinata. Natyrisht, unë nuk jam i interesuar ta mbrojë çështjen e komunave nga vij, komunës nga vij, por sidoqoftë zotëri Naser Osmani e tha parimisht shumë mirë. Ne e përkrahim buxhetin si grup i Lidhjes Demokratike të Kosovës, mirëpo çështja ligjore e përfshirjes së buxhetit të komunës së Prizrenit duhet të kemi kujdes që të përfilllet, sepse unë jam më shumë ekspert i pasojave politike, sesa ekonomike, me të cilat, natyrisht, në qoftë se më lejon Sanija të flas edhe pak, natyrisht, unë nuk jam ekspert për ekonomi, por pasojat politike do të ishin shumë të rënda në qoftë se ky Parlament e përligj, do të thotë, një shkelje të procedurave.

Çka do të thotë kjo? Ne të gjithë e dimë që jemi në jetën publike, që na mërzisën shumë, si të them, ndërtimi i vlerave demokratike edhe shpeshherë, sidomos, jo veç fara e moçme, si jam unë ose kryetari i Prizrenit, por edhe të rinjtë thonë - "ah, qysh s'jemi në diktaturë e mi t'i zhar hiq pa kuvend, pa asamble, pa kurgjë, po vetë të vendosim"! Në qoftë se e miratojmë një gjë të tillë, e përligjim nga komuna e Prizrenit, atëherë na praktikisht po i japim inkurajim këtij mentaliteti totalitar. Unë e di se është torturuese ndërtimi i demokracisë. Vetë e kam përjetuar dhe përditë po e përjetojmë. Mirëpo, sidoqoftë do të duhet bërë përpjekje

shtesë, për mos me thënë ndoshta përpjekje shumë më të mëdha, që mos të lëmë këso përshtypje në jetën shoqërore të Kosovës.

Edhe, ju lutem, unë edhe pse nuk jam portparol i kryeministrit, kam kërkuar mirëkuptim nga mediat që t'i japim kohë kryeministrit dhe Qeverisë të prononcohet rreth fenomeneve të ndryshme. Dhe, ato 13-14 minuta të kryeministrit, secili prej nesh i ka pritur me një kënaqësi. Besoj që në qoftë se intimisht deklarohet secili nga opozitarët që janë vëllezër ose motra, sado që opozitarë, edhe ata e kanë pritur me kënaqësi fjalën e kryeministrit, do të thotë si një farë lloji premtimi ngushllues. Në këtë kuadër, edhe unë them që definitivisht, ne gjithkund ku mundemi, nuk do të duhej lejuar shkelja e procedurave ligjore. Ju faleminderit shumë për mirëkuptim!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është lajmëruar kryeministri, Hashim Thaçi. E keni fjalën, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Unë ju falënderoj dhe ndihem tepër mirë që projektet që i kam filluar në Prizren, ka bashkuar edhe Eqën edhe Zafën, por edhe mbi të gjitha, të gjithë qytetarët e Prizrenit, mbështetje të projekteve historike, mund të them, për Qytetin e Prizrenit, pa dallim partie, pa dallim etnie, gjetje mbështetje të realizimit të projekteve madhore dhe të investimeve të jashtëzakonshme të papara ndonjëherë, siç është ai për fillimin e autostradës, për ndërtimin, natyrisht janë rritur kapacitetet edhe tash po punohet me kapacitet të plotë. Është një projekt, këtu u përmendën më herët do shifra, por është një projekt mbi 700 milionë euro, bile unë do t'ju kisha ftuar një ditë, edhe si Qeveri, edhe si Parlament, të shkojmë të gjithë së bashku. Ajo auto-rrugë, ajo autostradë është e të gjithëve, të gjithë qytetarëve, është e shtetit, në shërbim të gjithë qytetarëve, ta vizitojmë, se nuk fshihen punët aty, nuk fshihen ato investime, askush nuk mund t'i mbulojë, askush s'mund t'i përvetësojë në kuptimin as partiak, as individual. Në anën tjetër, ju falënderoj gjithmonë për mbështetje të gjithanshme politike, institucionale dhe gjithë qytetare për hapjen e Universitetit të Prizrenit dhe unë dua të besoj se edhe krejt deputetët e Prizrenit dhe të zonës përreth aty do të jenë në ditën e fillimit të punimeve nga ky universitet, më 1 tetor të këtij viti. Gjithashtu, edhe në realizimin e projekteve tjera, jashtëzakonisht të rëndësishme, në veçanti ai i rregullimit të shtratit të lumit, që është një projekt shumë i shtrenjtë, por që po fillon dhe do të vazhdohet me të gjitha investimet. Prandaj, qytetarët e Prizrenit, e gjithë politika e Prizrenit, pa dallim, në kuptimin as partiak, as etnik, janë duke përjetuar realizimin e projekteve madhore. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, kryeministër!

Fjalën e ka, ua ka përmendur emrin se iu ka bërë bashkë juve dyve, po kundër replikë, 1 minutë, Zafir Berisha, e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Zoti kryeministër,

Ti e di që pajtohem plotësisht në këto investime kapitale, por besoj që edhe Eqremi pajtohet. Fjala ishte për respektimin e Ligjit në raport me buxhetin. Në rast se ne realisht, domethënë e miratojmë buxhetin, ku është pozicioni këtu edhe për Prizrenin, thjesht ne po legalizojmë anarkinë. Universiteti i Prizrenit është një projekt shumë domethënës, jo vetëm për Prizrenin, autostrada gjithsesi dhe kur kemi mundur dhe kur është kërkuar, ne i kemi mbështetur, por ne nuk do ta mbështetim shkeljen e ligjit në asnjë mënyrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kryeministër, urdhëroni!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ndërtimi i autostradës ka qenë një ëndërr e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe është plotësisht në përputhshmëri kushtetuese dhe ligjore me një transparencë të paparë në rajon, me një konzorcium prej më të mirëve në botë që punon dhe që nuk ka qenë projekt fare i lehtë për t'u vendosur, për t'u ndërtuar. Dhe ju shumë mirë e dini se nuk është lehtë në këtë kohë të krizës ekonomike globale dhe financiare të sigurosh 700 milionë euro për të filluar ndërtimi i autostradës. Në anën

tjetër, ju e dini se ky projekt do të krijojë edhe rreth 4000 vende të reja të punës, që gjithashtu vetë qytetarët e dashur e të respektuar të Prizrenit, do të jenë përfitues të mëdhenj. Në anën tjetër, është një projekt shumë ligjor dhe shumë transparent dhe shumë i mirëpritur, jo vetëm për Prizrenin, por për të gjitha pjesët e territorit të Republikës së Kosovës e më gjerë, hapja e Universitetit të Prizrenit e gjithashtu edhe të projekteve tjera, kështu që janë projekte ligjore, në të njëjtën kohë janë projekte të vullnetit të qytetarëve, jo vetëm të Prizrenit, por të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit, kryeministër!
Fjalën e ka deputeti Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sigurisht që sot këtu dihet, domethënë, në mënyrë afirmative për projektbuxhetin edhe për planifikimin e ndryshimit të tij në këtë fazë të vitit, flet pozita dhe natyrisht opozita flet të kundërtën. Por, unë jam i prirur që të mund të flas sa më racionalisht dhe jo për ta kontestuar atë që e thotë pozita, por ta kontestoj veç atë pjesë kur ajo thotë, pa mbulesë. U quajti këtu, domethënë, projektbuxhet zhvillimor dhe u fol për efektet sociale. Një vend që e ka buxhetin një miliard dhe që e ka eksportin veç 5%, në krahasim me importin, s'mund të flasë për projektbuxhet zhvillimor edhe s'mund të flasë për efekte sociale. Aq më tepër kur prej fillimit kemi pasur vërejtjen se ka mungesë të një strategjie zhvillimore dhe nuk janë gjetur rrugët se si të zbutën problemet sociale që ka ky vend. Sigurisht që projektet e mëdha qysh janë autostradat, nuk besoj që e zbusin shpejt gjendjen e rëndë sociale që ka Kosova dhe projektet, për shembull, si investimet në bujqësi, nëse lihen aq shumë mbrapa, të cilat në rrethanat e vendeve të pazhvilluara ose të vendeve në zhvillim qysh është Kosova, mund të japin efekte të drejtpërdrejta, u jepet kaq pak rëndësi.

Unë kam pritur më shumë që Komisioni për Buxhet dhe Financa do të na flasë konkretisht për presionet që i ka pasur, këtu tha diçka kryetari, por nuk e tha saktësisht, prej njësive buxhetore që kanë kërkuar prej tij dhe u mor shumë me buxhetin e Gjykatës Kushtetuese. Unë sa e di ligjin që e kemi miratuar në për buxhetin e Gjykatës, ata e projektojnë në mënyrë të pavarur dhe ne veç e aprovojmë, por nuk e ndryshojmë dhe nuk janë njësi si njësitë tjera buxhetore që duhet të na raportojnë neve, sepse është pushtet i ndarë dhe është mirë për ta qartësuar këtë dhe jo për të krijuar huti. Nuk po dua më shumë të merrem me këtë.

Do të ndalem thashë te Ministria e Bujqësisë, është hera e 4-të në këtë legjislaturë kur bëhet rishikimi i buxhetit, unë kërkoj që ky Kuvend të mendojë më shumë, sepse është segmenti që mund të gjenerojë vende të reja pune dhe ta zbusë sadopak gjendjen sociale në këtë vend. Nëse mendojmë më shumë që të subvencionojmë në projekte zhvillimore në këtë fushë, të cilat janë shumë pak të kushtueshme, krahasuar me projektet që i kemi përpara kur rritet në këtë fazë të modifikimit të buxhetit janë për nga 100 milionë, e nuk e dimë a mund të shfrytëzohen deri në fund të vitit me këto kapacitete realizuese që i ka Ministria, përkatësisht segmenti i ndërtimit rrugor në Kosovë, sot. Me këtë teknologji që e kemi nuk e di këtë buxhet a mund ta shpenzojmë, por e projektojmë dhe shkon. Dhe prej atij të kishim menduar ndoshta veç një 10% ta qonim në bujqësi do t'i kishim parë efektet me mbjelljet vjeshtore, me hapjen e ndonjë kapaciteti përpunues të atyre produkteve që i prodhojnë sot blegtorët e bujqit tanë, ai segmenti i perimtarisë që s'dinë çka bën mandej me produktet e veta kur i lëshohet konkurrenca jo lojale e tregjeve të rajonit, po mendoj e prodhuesve të rajonit.

Sidoqoftë edhe një dimension që këtu ndoshta dal pak në mbrojtje të pozitës. Flitet shumë se shumë projekte zhvillimore shkojnë në regjionin prej nga unë vi si deputet i një partie që nuk është në pushtet. Unë i mora edhe grandet qeveritare që ndahen për Drenasin janë shumë të vogla, janë 7 milionë, por edhe investimet që vinë prej ministrive me projekte zhvillimore krejt, nuk e kalojnë 3 milionëshin. Dhe ju lutem këtu ka ende vend të kërkojë kjo komunë, sepse ka aq pak dhe nëse kaloni nëpër Drenas e shihni që është regjioni prapë, visi ma i pazhvilluar i Kosovës edhe pse Qeveria aktualisht, partia në pushtet ka më së shumti deputetë këtu. Unë mendoj që si në segmentin e ndërtimit të shkollave, merrni këqyrni janë vetëm më pak se një milion investime në atë komunë, në ndërtimin e rrugëve janë më pak se 2 milionë investime dhe kjo është e tëra që investohet sot në Drenas, përveç atij, domethënë, buxheti që e ka komuna, i cili është sipas një kriteri i për mua jo shumë të

mirë në bazë të numrit të banorëve, sepse nuk kihet parasysh se ajo komunë s'ka trashëguar kurrëgjë. Dhe krejt çka të bëjë i ka nisur këto 3 – 4 vjetët e fundit, dhe është ende larg me sistemin e rrugëve, me sistemin e rrjetit shëndetësor, të kujdesit primar...

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Pauzë deri në 14:30. E fillojnë Qamile Morina, pasojnë Abdyl Ymeri dhe Njomza Emini.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me mbledhjen plenare.

Të lajmëruar janë edhe 14 deputetë për fjalë.

Fjalën e ka deputetja Qamile Morina, le të përgatitet deputeti Abdyl Ymeri.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Deputetë të nderuar,

Do të filloja së pari me vërejtje teknike për rishikimin e buxhetit. Tabelat e detalizuara në këtë rishikim të buxhetit të shpenzimeve buxhetore janë të papërdorshme për debat me që ato nuk paraqesin dallim nga buxheti fillestar i Kosovës, andaj edhe nuk shihet se ku ka rritje, ku rënie, ku ka projekte të reja e ku janë fshirë projektet ekzistuese. Ajo që bie në sy me buxhetin e rishikuar parashihet një rritje e të hyrave buxhetore prej 77 milionë euro. Në fakt e tërë kjo rritje vjen nga tërheqja e fitimeve të PTK-së, përderisa të hyrat tatimore parashihet të bien. Rënia sidomos është e lartë nga tatimet e brendshme dhe atë për 19 milionë euro, që paraqet një rënie drastike prej 9%. Kjo është arsye e mjaftueshme, ministri s'qenka këtu, pra ministri i Ekonomisë për të diskutuar për performancën e Administratës Tatimore të Kosovës. Me buxhetin e rishikuar për vitin 2010 parashihet rritja e shpenzimeve buxhetore për 97 milionë, që është për 20 milionë më e lartë se rritja e parashikuar e të hyrave. Kjo nënkupton edhe një thellim të mëtejme të deficitit buxhetor të vendit. Në të njëjtën kohë parashihet rritje e mëtejme e të hyrave nga doganat, një zhvillim i tillë nuk është karakteristikë i ekonomive që zhvillohen, por i ekonomive që varfërohen. Kjo po ashtu nuk është në përputhje me konstatimet për rritjen e qëndrueshmërisë fiskale të vendit, qëndrueshmëria fiskale promovohet duke rritur rolin e tatimeve të brendshme e jo duke u përqendruar kryesisht në pikat kufitare.

Tek rishikimi i shpenzimeve kapitale thuhet se do të ketë rritje prej 81 milionë eurosh, ndërsa si kategori e veçantë e ngritjes së shpenzimeve paraqitet autostrada me një rritje prej 110 milionë. Kjo është e mundur vetëm nëse kemi rënie të dukshme të shpenzimeve kapitale në pozicione tjera. Kjo nuk është e paraqitur askund në tabelë. Është shumë me rëndësi që prapë, zoti ministër, për ne që dimë se cilat projekte po sakrifikohen për hir të autostradës.

Kur deficitit primar i shtojmë edhe pagesën e interesit, atëherë deficiti i përgjithshëm rritet në 218 milionë. Financimi i tij parashihet kryesisht nga shfrytëzimi i mjeteve të akumuluar nga suficitet e më parme. Kjo nënkupton se kjo Qeveri po i shtjerrë të gjitha mundësitë për grumbullim dhe konvertim në asfalt të mjeteve financiare të vendit. Ajo po ua merr fitimin ndërmarrjeve publike, po i shet ato ose koncesionon ato, po merr borxh nga jashtë dhe po i shfrytëzon suficitet e më parme vetëm për asfalt. A është qeverisja vetëm asfalt apo nënkupton edhe aktivitete tjera?

Shfrytëzimi i mjeteve të akumuluar në Bankën Qendrore nga suficitet e mëparshme është i paraparë në masën e 98 milionëve. Në këtë rast gjendja në bilancin bankar do të duhej të binte ekzakt 98 milionë, kurse në tabelën një, ajo bie në 99 milionë. Kjo tregon një gjë, faktin se gjatë kësaj kohe këto para nuk kanë sjell asnjë centë nga interesi bankar, por në të kundërtën janë tkurrur ose mbase keqpërdorur, ose mund të jetë edhe gabim, nëse është gabim, atëherë gabimet e tilla prej njëmilionëshe po janë imtësi për këtë Qeveri, duke pasur parasysh që ato përsëriten disa herë në këtë rishikim të buxhetit.

Për Ministrinë e Shëndetësisë do të thosha që është e papranueshme se me rishikimin e buxhetit është përgjysmuar buxheti për projektin kryesor që duhet të finalizohet, për Kardiokirurgjinë. Prandaj, është pyetja a po mendohet të prolongohet projekti i Kardiokirurgjisë?

Gjithashtu është e arsyeshme përgjysmimi i buxhetit për sistemin informativ të shëndetësisë, kjo që na jep me dije që edhe një kohë të gjatë nuk do të kemi politika të mirëfillta shëndetësore në bazë të cilave hartohen ato.

Gjithashtu, është shumë dekapjures dhe frustruese që në këtë rishikim të buxhetit fare nuk

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete!

Fjalën e ka deputeti, Abdyl Ymeri, le të përgatitet deputetja Myrvete Pantina.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë rishikimit është me rëndësi identifikimi i kërkesave apo projekteve prioritare që kanë një rëndësi të madhe klasifikimi i tyre dhe identifikimi i burimeve shtesë për financimin e këtyre projekteve, por edhe ruajtja e stabilitetit buxhetor si domosdoshmëri.

Sikur është krijuar një praktikë të disa organizata buxhetore në kategori të ndryshme, sidomos në kategoritë e shpenzimeve kapitale, duke mos shpenzuar mjetet e tyre buxhetore në 6 mujor sipas planifikimit të tyre. Vetë rishikimi i buxhetit në esencë do të ishte një harmonizim midis planit vjetor buxhetor dhe planit të realizuar buxhetor në 6 mujor.

Nëse shikohen me kujdes tabelat shihet se buxhetin e rishikuar në krahasim me buxhetin fillestar për vitin 2010 e karakterizon si rritja e të hyrave në total gjithashtu kemi edhe rritje të shpenzimeve.

Rritja e të hyrave në total krahasuar me buxhetin fillestar është për 77 milionë, po ashtu kemi edhe rritje të shpenzimeve në total prej 97 milionë eurove. Është mirë që kemi një shkurtim të shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve për 5 milionë euro.

Qeveria është treguar e kujdesshme gjatë rishikimit të buxhetit me çka e karakterizon investimi në projekte që janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe që ndikojnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve. Në këtë rast po përmend alokimin e mjeteve për autostradën për të cilën gjithë jemi dakord dhe të gjithë dimë për rëndësinë e saj ekonomike politike dhe kombëtare.

Pastaj,projekte në sektorë të ndryshëm si dhe mbështetja apo bashkëfinancimi me institucione komunale për realizimin e projekteve të cilat janë prioritare dhe që kanë rëndësi për zhvillimin e komunave ku përfitues të drejtpërdrejtë janë qytetarët në gjithë Kosovën.

Në buxhetin e Ministrisë së Arsimit nuk kam vërejtur ndonjë vijë buxhetore për shkollat ekselente, ndërsa në kërkesën e Këshillit koordinues pranë Ministrisë së Arsimit, kanë përfunduar të gjitha procedurat e rekrutimit të stafit për këto shkolla dhe janë kryer trajnime të duhura, që do të thotë se janë të gatshëm që të fillojnë punën me 1 shtator të këtij viti. Prandaj, është mirë që Komisioni për Buxhet dhe Financa t'i ketë parasysh këto kërkesa.

Të nderuar deputetë,

Ka dritë të mjaftueshme për ata që duhet të shohin dhe errësirë të mjaftueshme për ata që nuk duan të shohin. Natyrisht si synim i çdo qeverie, pa marrë parasysh se cili subjekt e udhëheq çdoherë duhet të bëjë një planifikim real të buxhetit, menaxhim të mirë si dhe shpërndarja e të mirave materiale të jetë e drejtë, pa dallime me qëllim të balancimit të zhvillimit harmonik dhe të barabartë në tërë territorin e Kosovës.

Në një mënyrë këtë, si shumë u tha se kemi koncentrim apo zhvillim të një numri të projekte në zona të caktuara. Po ju them të drejtën, nuk po më vjen mirë, shumë mirë që në këtë sallë po dëgjoj diç të tillë dhe sidomos nga ata që deri dje e udhëhiqnin këtë vend. Po ua përkujtoj të gjithë qytetarëve të Kosovës se në ish-sistemin, një zonë e Kosovës, e quajtur Drenicë, është cilësuar si zonë e rrezikshme dhe e nënvizuar me të kuq dhe për këtë pushtetarët e asaj kohe nuk ishin fare të interesuar për të investuar po thuaj se në asnjë sektor. Për kontributin e kësaj zone të quajtur Drenicë, në të gjitha periudhat historike dhe luftën e fundit unë dua të flas, sepse janë qytetarët e Kosovës ata që më së miri e dinë dhe e vlerësojnë këtë. Mirëpo edhe pas lufte kjo zonë, përpos lirisë së fituar dhe aty- këtui përkrahur nga donatorë të ndryshëm nga jashtë nuk ishte ndonjë zhvillim që do të përmirësonte jetën e qytetarëve të kësaj zone, qeveritë tona nuk kishin vullnetin që të investonin dhe për këtë kam argumente të shumta, sepse kam qenë pjesë e udhëheqjes komunale që nga pas lufta. Ne kemi pritur se pa marrë parasysh kushdo që e udhëheq me vendin do të ketë parasysh këtë zonë dhe do të investojë hiq më shumë se sa ta barazonte këtë zonë me zona të tjera të cilat kanë pasur zhvillim më të madh edhe në të kaluarën, por kjo nuk ndodhi.

Askush nuk duhet të mendojë se në këtë zonë po bëhet diçka e veçantë, po ndodh mrekullia, jo. Janë duke u ndërtuar rrugët që në pjesë të tjera të Kosovës kanë qenë kaherë të përfunduara, bile edhe pas luftës. Janë duke u ndërtuar disa shkolla sikur që janë duke u ndërtuar po thuaj se në të gjitha komunat e Kosovës, është duke u ndërtuar kompleksi memorial "Adem Jashari" dhe Kompleksi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në Marinë dhe asgjë më tepër. Prandaj, nuk është mirë që për qëllime të caktuara në opinionin e gjerë të krijohet huti dhe ndarja, që nuk janë aspak të mira, sepse Kosova edhe ashtu një territor jo edhe aq i madh dhe këto ndarjet rajonale nuk i bënë mirë shëndetit të Kosovës dhe as qytetarëve të saj. Kjo Qeveri në këtë drejtim ka treguar një prekuri të lartë dhe ka qenë shumë e kujdesshme duke investuar në tërë territorin e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina, le të përgatitet deputeti Riza Smaka.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Pas pavarësimit të Kosovës zhvillimi ekonomik është sfida më e madhe për Kosovën nga e cila sfida burojnë edhe sfida të tjera, sikurse papunësia e lartë dhe varfëria. Nga rishikimi i buxhetit për vitin 2010, pritet rritja e të hyrave për këtë vit dhe atë për 77 milionë. Dhe është mirë, domethënë, që do të ketë rritje të hyrave buxhetore, sepse ato do të mundësojnë edhe rritjen e shpenzimeve buxhetore që janë më së të nevojshme për financimin e nevojave apo projekteve shtesë për këtë vit fiskal. Ajo çka vazhdon të mbetet shqetësuese sa i përket të hyrave është se edhe më tutje të hyrat kryesisht grumbullohen nga tatimet në kufi, kjo nuk është asgjë e re. Dhe për këtë periudhë pritet që të hyrat në kufij të rriten për 18 milionë, mirëpo është shqetësuese se me rishikim të buxhetit pritet që të zvogëlohen të hyrat nga tatimet e brendshme, për 19 milionë, si edhe të hyrat jo tatimore dhe të hyrat vetjake për 8 milionë, gjithsej do t'iu del se zvogëlimi i këtyre të hyrave për 27 milionë. Parashtrohet pyetja: Ku qëndron arsyeja e uljes së këtyre të hyrave? A nuk do të arrihet efikasiteti më i madh në grumbullimin e të hyrave, a nuk do të ketë rritje të disiplinës fiskale, përkundër futjes në përdorim të arkave fiskale?

Po ashtu, duhet të theksojmë se numri i ndërmarrjeve të regjistruara në tremujorin e parë të këtij viti është rritur për 25%, a nuk do të thotë kjo më shumë të hyra për buxhetin e Kosovës? Të gjitha këto bien në kundërshtim me masat dhe politikat e proklamuar të Qeverisë. Në anën tjetër, a nuk është paradoksale nëse investimet kapitale prej vitit 2007 deri në vitin 2009 janë rritur prej 156 milionë euro, në 495 milionë sa pritet të jenë me rishikim të buxhetit për këtë vit. Domethënë, ato veç janë trefishuar për periudhën trevjeçare, po a nuk ka filluar të ketë ndonjë ndikim pozitiv nga këto investime në ekonominë e vendit?

Të hyrat tatimore nga kufiri për vitin 2009 përbënin 55% të hyrave të përgjithshme në vitin 2009, kurse në vitin 2010, pritet që ato të përbëjnë 63% të hyrave të përgjithshme, domethënë, do të ketë rritje në krahasim me të hyrat e përgjithshme. Dhe kjo na bën me dije se politikat e deritashme zhvillimore nuk kanë qenë mjaftë efikase

për të ndikuar në zhvillimin e ekonomisë vendore, sidomos të sektorit të prodhimtarisë. Prandaj, varësia e vendit tonë është në rritje nga ekonomitë e vendeve të tjera që shprehet me rritjen e importeve.

Sipas të dhënave të publikuara nga Enti i Statistikave të Kosovës edhe pse në tremujorin e parë të vitit 2010, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2009, vlera e eksporteve është dyfishuar dhe atë prej 10 milionë në 20 milionë, por importi po ashtu ka vazhduar të shënojë rritje edhe për periudhën e cekur është rritur për afër 14%.

Edhe deficitit tregtar ka shënuar rritje dhe atë për 9 milionë, domethënë edhe më tutje importi është shumë i madh, eksporti është në nivele modeste, ndërsa deficitit tregtar vazhdon të thellohet. Parashtrohet pyetja, zoti ministër edhe pse ministri mungon, besoj që do ta dëgjojë diku: Kur do të fillojë të zvogëlohet varësia e ekonomisë së Kosovës nga importi? Definitivisht bujqësia duhet të ketë një përkrahje më të madhe në të ardhmen, ne gjithnjë më shumë po bindemi se prodhimtaria e vendit nuk po mund të zhvillohet sipas dinamikës së paraparë dhe me...

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, le të përgatitet deputetja Vezira Emrush.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues, ministër,
Deputetë të respektuar,

Disa vërejtje parimore, do të përpiqem që të mos përsëris asgjë, është vështirë, sepse shumë kanë diskutuar më parë. Unë do të përqendrohem në nenin 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin ku, ndër të tjera, është stipuluar që agjencitë e pavarura, madje edhe agjencitë do të përjashtoheshin nga restriksioni i pozitave të punësimit. Unë do të isha angazhuar për të kundërtën, sidomos agjencitë të cilat tash për tash kanë status të privilegjuar përballë institucioneve të tjera.

Dy, te kodi i programit 241, këtu figuron, këshilltarët për tranzicion edhe pozicioni 2 milionë e gjysmë, unë nga zotëri ministri, jo në këtë rast ndoshta, po me të vërtetë sinjerisht do të kisha kërkuar shpjegime plotësuese se ç'është kjo, çfarë këshilltarësh janë këta për tranzicion, tek e fundit, ç'është edhe tranzicioni në kushtet tona, a ekziston fare, si të them, apo a mund të ekzistojë?

Te kodi i programit 804, te trashëgimia kulturore, do të isha angazhuar që si organizata buxhetore të radhitej edhe Kulla e Junikut, e cila me bazë një kohë të gjatë është quajtur "Gjykata Supreme e Kosovës" ka peshë në politikë, në etnologji, etnografi, histori e në kulturën tonë. Po asisoj do të isha angazhuar, zoti kryesues, që salla e Shtëpisë së Kulturës në Kaçanik të radhitej poasisoj si organizatë buxhetore në kuadrin e trashëgimisë kulturore, sepse e ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Për herë të parë, deputetët e këtij vendi në mënyrë tanimë, jo veç me armë, por aty në mënyrë edhe politike edhe kushtetuese edhe juridike e kanë manifestuar vullnetin politik të këtij popullit.

Sa i përket kodit programor 243, do të kisha apeluar në ato thënie që i tha zotëri Koci, kryetari i Komisionit për Buxhet, referuar Gjykatës Kushtetuese, në të cilën nuk përfilllet, ju lutem, nuk përfillen propozicionet e vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 29 dhjetor 2009, po shkelen me të katër këmbët, që nuk është absolutisht në rregull edhe nuk do të duhej të ndaleshin vetëm me një konstatim të këtillë apo jo, aq më parë kur e kem zgjedhur e kem konstituar në mënyrë shumë dubioze.

Dhe përfundimisht do të isha angazhuar për investime më intensive në shkencë, nuk ka përparim pa shkencë, në bujqësi ju lutem, një miliard e 100 milionë importojmë, 100 milionë eksportojmë e kuotën më të madhe të importimeve e kapin produktet bujqësore, që do të kishin mund t'i eksportonim. Pastaj bie fjala për të investuar në punktet kundër breshrit para 30 vjetëve ka pasur punkte efektive, efikase kundër breshrit, hiq më larg se dje, pardje po e zëmë, me mijëra hektarë i ka shkatërruar breshri edhe Ministria e Bujqësisë, përkatësisht Qeveria, indolente, indiferente ndaj një kulture, ndaj një branshe ekonomike, relevante, fundamentale të ekonomisë sonë.

Do të kisha apeluar që të investojmë më shumë edhe në kadastër edhe në statistika, sepse çështja e pronave edhe kadastrit është shumë delikate në vendin tonë edhe statistikën pa pasur të dhëna statistikore ne nuk mund të planifikojmë asgjë prej gjëje, do të punojmë me duar në xhepa sikur ndoshta para 1000 vjetëve.

Edhe përfundimisht do të isha angazhuar, kolegë të nderuar, që në këtë rast Ministria e Ekonomisë edhe e Financave t'i ndërtonte disa kritere, disa objektiva, disa parametra të nevojshëm në bazë të cilëve do të duhej të aplikoheshin edhe distributimi edhe investimi, se bie në sy, deshëm s'deshëm aty mund ta shpjegojmë edhe pro e contra, që disa zona favorizohen, disa tjera nuk favorizohen. Unë do ta marr vetëm një shembull ekzemplar: Peja, Prizreni, unë nuk jam xheloz negativ po pozitiv, nuk jam për ta disfavorizuar Prizrenin, por jam për ta favorizuar Pejën, së paku në nivelin e Prizrenit, dua të them

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Vezira Emrush, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ja sam se javila danas u svojstvu poslanice, ne pred grupom, i htela sam da dam do znanja nekoliko stvari kada je u pitanju rebalans budžeta Kosova za 2010. godinu.

U ovom rebalansu sve kolege potrudili smo se maksimalno da vidimo koje su promene u ovom rebalansu. Vidimo da su jedine promene da se očekuje povećanje prihoda od 77 miliona i povećanje troškova od 82 miliona u odnosu na usvojeni budžet za 2010. godinu. Međutim, jako je zabrinjavajuće da i dalje politika Vlade ima samo za cilj da jedino zarađuje preko carinskih prihoda. Jedino na pragu tamo gde se tuđa roba uvozi na Kosovo. Ovaj rebalans očekivali smo ga puno sa osećajem da će biti poboljšanja u politici kako ekonomskoj, tako i socijalnoj politici za Kosovo, međutim ove dve stvari nisu ni taknute sa ovim rebalansom. Jednostavno samo su premeštene, da kažem, finansijska sredstva u Ministarstvo za puteve, transport i telekomunikacije i dolazimo do znanja i svi znamo da je u sferi početka izgradnje veliki kapitalni projekat Vlade, autoput, i vidimo da je rebalans namenski napravljen zbog tog autoputa koji košta 2010. godine 123 miliona Vladi. Međutim, šta se dešava i sa tim autoputom. Mi znamo da su ugovori javni i znamo da je potpisan ugovor na 700 miliona, što Vlada nije demantovala, a vidimo u kratkoročnom periodu do 2012. godine, da treba da se izdvoji negde oko 974 miliona na ime ovog autoputa raspodeljeno po godinama. Ovo je jedna zabrinjavajuća stvar ako smo nešto ugovorili za 700 i 294 miliona, znači okruglo 300 miliona za nas su takoreći sredstva koja mogu da idu u procenu plus minus.

Međutim, jedno što je jako zabrinjavajuće, kategorije gde je ekonomska politika u pitanju, nemamo kategoriju izvoza, nemamo planiranje proizvodnje, nemamo planiranu poljoprivredu, nemamo planiranu nijednu granu praktično koja proizvodi. Nemamo planiranu proizvodnju električne energije, nemamo prodatu, imamo subvencije, kako smo i dalje navikli javna preduzeća da budu paraziti, da ih Vlada subvencionime, da neznamo kakvi su to krediti, da li su subvencije, da li su krediti, sa koliko kamate, na koliko godina treba da vraćaju te pozajmice, da li su pozajmice u pitanju, to se sve zavija u nekoj formi i stavlja pod tepih i uporno gura ova Vlada pune dve godine pred nama ovde.

Jedno što je jako zabrinjavajuće, ja sam malo pogledala Ministarstvo za socijalni rad i socijalnu politiku i meni je žao što moram da kažem, ja ne verujem da su ministar i Vlada dobili od MMF-a i Svetske banke podršku kada je u pitanju socijalna šema i socijalna primanja, kako da počnemo od penzija, od plata, od socijalnog davanja, od toga koliko naši građani mogu da učestvuju u ukupnom budžetu, ni 10%. Sakupite kategorije plate, i dnevnice, i penzije, i socijalna davanja, 10% ne opterećuju budžet Kosova.

Kada su u pitanju kapitalne investicije, vidimo da se maksimalno daje, kada su u pitanju subvencije, što nam i transferi kada su u pitanju lokalna samouprava, opet vidimo veliku nepravdu po opštinama tamo gde se vrši privilegija za pojedine opštine na štetu drugih opština i nerazvijenih opština. Jako mi je žao što moram da

kažem da sam očekivala od Vlade u ovom rebalansu da će imati plan i program za razvoj nerazvijenih krajeva, međutim takav plan i program ja više i ne verujem da ćemo ikad dobiti ovde kao poslanici, ali ja moram da kažem tamo gde su opštine zajedničke, kao što je Prizren, Dragaš, da jedna petina u ukupnom budžetu Dragaša od 3. miliona...

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Gani Buçinca, le të përgatitet deputetja Njomza Emini.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues dhe miku i nderuar, Naim Maloku! Po më duket pak jam i privilegjuar që ju po e udhëhiqni mbledhjen e Kuvendit, kam kënaqësinë që ma dhatë fjalën.

Desha të inkuadrohem edhe unë në diskutim për të dhënë një kontribut, përkatësisht për të sqaruar diçka në lidhje me rishikimin e buxhetit për këtë periudhë.

Unë mund t'ju them se disa diskutues e tepruan kur thanë se ndërtimi i autostradës nuk ndikon në zhvillimin ekonomik dhe nuk ndikon në gjendjen sociale të qytetarit të Kosovës, 4000 vende të punës dhe 40% e punëve që do t'i kryejnë ndërmarrjet tona, pa dyshim kanë ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen sociale të qytetarëve të Kosovës, përveç ndikimeve tjera. Tre prej faktorëve kryesorë e di nga ajo që kam mësuar, janë dominues për zhvillimin ekonomik të vendit: infrastruktura rrugore, energjetika dhe resurset humane, do të thotë, dija. Unë mund t'ju them se kjo Qeveri ka një strategji pikërisht në këta tre faktorë duke i dhënë përparësi infrastrukturës rrugore, duke i dhënë përparësi arsimit, shkollimit të qytetarëve të Kosovës që të jenë të gatshëm të inkuadrohen në tregun e punës dhe njëkohësisht duke bërë përpjekje që me privatizimin e KEK-ut të sigurohet edhe energji elektrike për investitorët e mundshëm në të ardhmen, do të thotë, në të gjitha këta sektorë Qeveria ka një strategji mjaftë të qartë.

Mund t'ju them se planifikimi, ekonomia e planifikuar një herë e përgjithmonë ka perënduar, nuk mund Qeveria të planifikojë për të gjitha sferat e ekonomisë, për arsye se koncepti i kësaj Qeverie është që të krijojë kushte për ekonominë e tregut të lirë nëpërmes: legjislacionit, politikave fiskale, infrastrukturës rrugore, investimeve në arsim e të tjera, e të tjera. Nuk janë qeveritë ato që do të planifikojnë sikur në të kaluarën, për shembull, të centralizojnë planifikimin e zhvillimit ekonomik.

Disa diskutues ma mori mendja që janë duke diskutuar sikur Kosova të ishte shtet sovran dhe i pavarur para 300 vjetëve, ne duhet të jemi koshient se kjo fazë e zhvillimit tonë nuk është ajo që ne e dëshirojmë këtu edhe dëshirojnë qytetarët, mirëpo realisht, është ajo çka është e mundur të bëhet në këtë kohë.

Unë mund t'ju them se Qeveria ka ruajtur treguesit makroekonomik, ka ruajtur ekuilibrat social, me rishikimin e buxhetit që na ka ofruar dhe njëkohësisht ka rritur investimet kapitale duke mos i anashkuar edhe ngritjen e pagave që kanë një impakt të drejtpërdrejtë edhe në jetën e qytetarëve.

Desha të kthehem edhe te disa pikëpamje regjionaliste që po shfaqen në Parlament, gjëja se regjioni i Drenicës është i favorizuar me buxhetin e Kosovës. Mund t'ju them se edhe pse jam deputet i asaj zone, nuk do të përkrah kurrë një Qeveri në Kosovë e cila i diskriminon zonat e caktuara mbi bazat e përkatësive regjionale, kurrë, as këtë qeveri sikur ta kisha atë ndjenë, nuk do ta kisha përkrahur. Por mund t'ju them se në Drenas për vitin 2009 janë investuar 027%, ka investime në raport me buxhetin e Kosovës, kurse në komunën e Shtimes, e cila i ka vetëm 21 këshilltarë, kurse Drenasi 31, janë investuar 028%, do të thotë, nuk ka pasur asnjë favorizim. E mora komunën e Shtimes se edhe për nga numri i popullatës edhe i këshilltarëve është shumë më i vogël se komuna Drenasit.

Ekzistojnë në Kosovë, sipas një studimi të NDP, 10 komuna me ngecje të mëdha në zhvillim ekonomik dhe unë mund të ju them se në mesin e atyre komunave janë Drenasi edhe Skenderaj. Ju e dini të gjithë, të nderuar deputetë, se Drenica si regjion ka qenë e diskriminuar edhe në kohën e kralit edhe në kohën e sistemit komunist

dhe është më shumë se 100 vjet si region i diskriminuar në kuptimin e investimeve në ekonomi dhe infrastrukturë. Dhe unë mund t'ju them se Drenica nuk është favorizuar po ka nevojë qysh kanë edhe 7 komuna tjera, 7 regjione tjera, që të bëhen investime më të mëdha në mënyrë që sadopak të vijë deri te rrudhja e diferencës që është shumë e madhe në zhvillim ekonomik. Nuk po dua ta zgjas, por unë e përkrah këtë rishikim të buxhetit...

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Njomza Emini, le të përgatitet deputeti Esat Brajshori.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

I nderuari Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Unë parimisht e mbështes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, por i kam disa shqetësime sa i përket shpërndarjes së buxhetit për rini, konkretisht në Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

Derisa mbi 60%, kuptohet që e dimë edhe ne që jemi këtu që jemi popullsia sa i përket edhe në rajon me popullsi më të re, unë mendoj që është dashur t'ju jepet më prioritet edhe sikur që është thënë në fillim që të jetë rinia prioriteti i Qeverisë. Mirëpo deri më tani jo vetëm kjo Qeveri, por asnjë Qeveri nuk ka qenë e përkushtuar sa i përket buxhetit të rinisë. Andaj, në këtë drejtim konsideroj se është e domosdoshme që perspektiva e të rinjve të jetë prioritet për Qeverinë e Republikës së Kosovës, sepse rinia dhe problemet e saj nuk janë konsideruar dhe trajtuar ashtu si është dashur të trajtoheshin.

Shpërndarja e buxhetit sikur në nivelin qendror e fatkeqësisht edhe nëpër komunat e Kosovës është në disfavor për zhvillimin dhe integrimin e rinisë.

Qeveria e Republikës së Kosovës për vitin 2010 ka paraparë që për rininë konkretisht për Departamentin e Rinisë, i cili merret me çështjen e rinisë janë ndarë vetëm 629 mijë e 299 euro, që i bie pak më shumë se 50 centë për kokë të riut. Fatkeqësisht këto mjete të ndara për rini nuk sigurojnë faktikisht as implementimin e Ligjit për rini. Derisa jemi tek buxheti dhe shpërndarja e tij as në komunat tona si në nivel lokal i qeverisjes nuk i jepet prioritet rinisë dhe përkrahjes së saj. Sa për krahasim kam marrë disa shembuj sa i përket komunave, mirëpo këtu nuk do t'ju marrë shumë kohë, nuk do të filloj me shifra, sepse edhe janë, i kemi ne para vetes. Unë mendoj që, përveç Departamentit të Rinisë edhe te kultura edhe te sporti, nuk janë ndarë mjete të nevojshme kur dihet që kultura, sporti dhe rinia janë ambasadorët më të mirë të një vendi sikur dihet që tek ne në sport nuk është investuar aq shumë dhe po dihen edhe telashet që i kemi dhe pasojat nëpër ndeshje që po mbahen dhe faktikisht kushteve të këtyre sportistëve.

Nëse ne dom që të investojmë në rini atëherë investojmë për të ardhmen tonë. Unë kërkoj që me këtë rishikim tuajin të parashihni që të rritet bile së paku buxheti sa i përket rinisë, duke konsideruar që jemi një vend, do të thotë, me një perspektivë edhe jemi popullsia më e re në rajon. Atëherë kjo ishte çka unë kam paraparë të flas për sot. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Esat Brajshori, le të përgatitet deputeti Gani Geci.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë desha të flas për tri çështje konkrete.

E para, sa i përket zhvillimit të rajonit të Gollakut, me që çështja e investimeve rajonale është bërë shqetësim për secilin deputet dhe që mendoj se edhe kësaj radhe kjo krahinë e Kosovës ka ngelur jashtë interesimit të duhur të Qeverisë kur dihet se përbën një rreze qindra kilometrash në kufi me Serbinë dhe se çdo ditë e më

tepër banorët e këtyre anëve po ikin nga pamundësia për të bërë jetë, mbijetuar. Por me që u prek nga një kolegu imi kjo çështje nuk do ta zgjas.

Dhe e dyta, është kultura. Unë e mbështes mendimin e dikujt prej deputetëve këtu që e nxori në pah mungesën e ministrave të fushave përkatëse që do të mund të bisedonim konkretisht për rishikimin e buxhetit. Sipas Projektligjit që ka ardhur për ndryshimin dhe plotësimin ose më saktë rishikimin e buxhetit, Ministrisë së Kulturës i është marrë një shumë prej 344 mijë eurosh nga buxheti i fillim vitit. Unë jam i interesuar ta di pse i janë marrë këto mjete Ministrisë së Kulturës, i janë marrë për shkak se ka mungesë të politikave të Ministrisë për investime apo cila është arsyeja? Do të ishte mirë ta dimë edhe këtë se a ka qenë ministri i Kulturës dakord me këto shkurtime apo nuk ka qenë dakord me këto shkurtime? Për faktin se po ky ministër sa po ka ardhur në postin e tij i ka identifikuar shumë probleme në Ministrinë e Kulturës dhe ka deklaruar se do të shtohet, do të rritet buxheti për vitin 2010 i Ministrisë së Kulturës. Pra, a janë shkurtuar mjetet për shkak të mungesës së politikave të Ministrisë apo për nevoja të tjera dhe ku kanë shkuar?

Unë mund të them që edhe Qendra Kinematografike e Kosovës është lënë si të thuash në harresë, përkundër asaj se janë ndarë mjete dhe akoma nuk alokohen në masën e duhur mjetet që janë premtuar dhe ka probleme shumë në realizimin e projekteve artistike. Unë kam menduar që kjo qendër do të ndihmohet me këtë rishikim të buxhetit dhe do të duhej të ndihmohet me buxhet shtesë nga ai që e kemi miratuar në fillim të vitit, por kjo prapë nuk ka ndodhur as këtu.

Me interes është të thuhet edhe një gjë sa i përket kulturës. Mendoj se kujtesa nacionale e këtij populli dhe këtij vendi po varrosën duke mos investuar në kulturë dhe se buxheti i tanishëm, rishikimi i tij është një këmishë e ngushtë për të bërë kulturë në vendin tonë. I bëj Qeverisë thirrje që me shumë kujdes, sidomos ministrit të Kulturës që të ketë shtim të buxhetit në kulturë e jo t'i mirën edhe ato pak mjete sa i ka.

E treta çështje që do ta prekja pak më esencialisht ka të bëjë me Radiotelevizionin e Kosovës, me mediumin publik.

Unë kam parë se këtu është ndarë një buxhet prej 10 milionë e 400 mijë euro e diçka, dhe unë nuk e di realisht se si janë ndarë këto mjete. Në qoftë se janë ndarë mjete për mirëmbajtjen e këtij mediumi për zhvillimin e teknologjisë, për arkivin, mirëmbajtjen e arkivit, për parkingun e gjëra të tilla, është e pranueshme që të bëhet kjo gjë. Në qoftë se janë ndarë këto mjete që të bëjë politikë editoriale mediumi publik, duhet të harrojmë se do të jetë medium i pavarur, këtu kam nevojë për një sqarim. Në anën tjetër dua të them edhe këtë se Kuvendi i Kosovës as me ligjin e tanishëm, nuk është i obliguar që t'ia gjejë partnerin Radiotelevizionit të Kosovës se kush, cili agjencion do t'ia mbledhë parapagimin atij mediumi.

Në këtë vazhdë do ta ngre edhe një çështje, zoti ministër e kjo ka të bëjë konkretisht me KEK-un dhe Radiotelevizionin e Kosovës. Unë kam një shkresë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, i cili kërkon nga KEK-u që mbi 38 milionë që i detyrohet nga parapagimi deri në pezullimin e mbledhjes së taksës nga Gjykata Kushtetuese, t'i derdhen mjetet e veta. Realisht, në mars të këtij viti në këtë Kuvend është ndihmuar Radiotelevizioni i Kosovës nga ky Kuvend më 5.2 milionë e diçka. Mirëpo pika e dytë e asaj kërkesë të Kuvendit ka qenë që të ulen Ministria e Financave, Administrata Tatimore dhe RTK-ja që ta shkojnë këtë çështje të borxheve të KEK-ut për RTK-në

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Gani Geci, le të përgatitet deputeti Shkumbin Demaliaj.

GANI GECI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Unë nuk pata ndërmend të flas, por duke shikuar buxhetin dhe duke shikuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e këtij buxheti pash diçka shumë interesant, konkretisht rreth çështjes së decentralizimit dhe

komunave të reja. Në asnjërin nga të hyrat vetjake nga këto komuna nuk figuron se dikush do të paguajë ndonjë centë tatim për shtetin e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, komunat tjera janë të privilegjuar se nga tatimet ose nga tatimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës do të paguhen këto komuna dhe konkretisht është fjala për Graçanicën, Klllokotin edhe Ranillugun, komuna të cilat nuk do të paguajnë asnjë cent për vitet e ardhshme. Është ky paradoks, mua po më duket shumë interesant, po vraponi t'ju jepni kartela telefoni, t'ju falni gjithçka edhe mos të japin kurrëgjë, as rrymën të mos e paguajnë dhe kjo është një privilegj ose një diskriminim pozitiv qysh po e quani ju për komunat e reja dhe kjo nuk ka kurrfarë kuptimi për vetë buxhetin.

Në anën tjetër unë shoh këtu që edhe sa i përket Agjencionit Kosovar të Inteligjencës janë zvogëluar të hyrat e buxhetit për këtë agjencion, që do të thotë që Agjencioni Kosovar i Inteligjencës s'është askund, ai do të duhej të ishte funksional, do të duhej sot të vinin raportet nga agjencioni se çka ka ndodhur me Mitrovicë, sepse sikur të kishte një agjencion të mirëfilltë me një telefon të thjeshtë do të kishte mundësi të incizohet komplet se çka ka ndodhur në Mitrovicë dhe assesi nuk ndodh kjo dhe përkundrazi i shkurtrohet buxheti këtij agjencioni që jep të kuptosh se edhe vetë agjencioni edhe Qeveria e Republikës nuk janë askund me sigurinë e vendimit.

Në anën tjetër unë kërkoj nga zoti Piter Feith, që kur të kthehet nga Brukseli t'ua sjell mirënjohjen ministrave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përditë po kërkojnë mirënjohje për punën që e kanë bërë dhe mua po më duket larg marsi për punë të mirënjohjeve. Do të ishte mirë që kah nëntori të vijnë mirënjohjet për ministrat e Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilët në vendet perëndimore do të duhej të jepnin dorëheqje, kështu tha Piter Feith në Bruksel, prandaj, unë duke pasur parasysh atë që ministrat po kërkojnë mirënjohje, kërkoj nga zoti Piter Feith edhe EULEK-si, edhe prokurori i EULEK-sit sa më shpejtë t'ua sjell mirënjohjet këtyre ministrave, sepse me të vërtetë në bazë të deklaratave të tyre ata kanë bërë punë më të mira dhe këtu do të duhej ose Piter Feith t'ua sjell mirënjohjet këtyre ose të shkojë në Bruksel dhe të sundojë Brukselin, se s'ka nevojë të ishte më në Kosovë. Këtë desha ta them. Ju faleminderit!

Kryesuesi: Faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demaliaj, le të përgatitet deputeti Ramadan Avdiu.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Kolegë të nderuar deputetë,

Sot para vetes kemi një dokument të modifikuar të draftligjit për rishikimin e buxhetit, është dokument që nuk i largohet kornizës buxhetore edhe të vitit të kaluar, po edhe gjashtëmujorit të parë, mirëpo kryesisht Qeveria kur i sjell këto dokumente në Parlamentin e Kosovës, i modifikon në atë formë që të mësojë edhe diçka më shumë se si ta rregullojë këtë draftligj apo këtë rishikim të Ligjit për buxhet për periudhën e ardhshme, sepse nuk kanë kohë për ta lexuar edhe për të mësuar më shumë, po mundohen të mësojnë prej deputetëve këtu, e them këtë në kuadër të ekspertëve.

Në radhë të parë dua t'i njoftoj edhe deputetët, por edhe Qeverinë edhe ministrin e krejt se, buxheti i Kosovës është ligj edhe për çdo shkelje të këtij buxheti dikush duhet të përgjigjet, për secilin centë. Sot kemi në Kosovë kategori të qytetarëve që jetojnë më 35 euro, ministra të ndryshëm poste pas postesh pranojnë këtu se kanë marrë një ministri të korruptuar tash për ta drejtuar, për ta rregulluar pas vitit të tretë të qeverisjes. Flitet për një milion e 400 mijë edhe disa centë, të keqpërdorura apo të vjedhura në këtë rast edhe ministri si ka ardhur në detyrë thotë: ne do t'i gëzohemi faktit pasi drejtësia do ta shpallë fajtorin. Tash e kujt është kjo përgjegjësi, a flitet për këtë qeveri, apo këtë strukturë qeverisëse apo për kënd flitet? Është shumë shqetësuese në qoftë se ne, unë jam anëtar i Komisionit për Buxhet, si Komision nuk jemi në krye të detyrës për t'i hetuar këto raste, atëherë unë kisha menduar që ekspertë nga Kuvendi të mblidhen deputetë, ekspertë edhe ta formojnë një komision hetimor për secilin centë që dyshohet që është keqpërdorur në kuadër të Ligjit për buxhet.

Më vjen keq se edhe deputetët e pozitës në këtë rast ndiejnë keqardhjen se është kufizuar koha në 5 minuta për të folur deputetët, por nuk është keqardhja e atyre, por janë lot krokodili se kjo i mohohet opozitës se iu ka

kufizuar koha e deputetit, mirëpo besoj se edhe për këta, por edhe për neve që sot jemi në opozitë, shihen në shkelje, ky është diskriminim që ndodh edhe në të ardhmen se e kanë mundësinë për të votuar edhe 5 minutshin, ndoshta edhe 3 minutshin kur hidhet në votim për me diskutua për Ligjin për buxhet, por në këtë rast ata lot le t'i shpallin diku tjetër se fjalët edhe lëvdatat për qeverisjen. Më vjen shumë keq kur flasim në emër të vlerave të lirisë edhe them dikush po mundohet ta ndaj vetë Kosovën në regjione.

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Deputet, rishikimin e kemi, në rend dite.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju lutem, zoti kryetar, për rishikimin po flas.

KRYETARI: Jo, ajo s'është në rend të ditës.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Pra, jam duke u folur për nivelin e shpërndarjen së buxhetit nëpër zona. Në emër të vlerave të lirisë nuk bëhet buxheti, unë e di se ka pjesërisht dhe jam shumë falënderues, po unë e di se ka edhe deputetë këtu se për vetë komandantin Adem Jashari nuk kanë ditur deri në vitin 2009 ku është i varrosur a edhe me të vërtetë i kanë qitur lule mbi varrin e tij. Është me keqardhje, kërkoj falje në përgjithësi në këtë rast, por mos të flasim në emër të vlerave të lirisë, se për buxhetin dhe rishikimin e tij po flasim, edhe të mos mohojnë. Nuk ka Dukagjin në Kosovë, ka Rrafsh Dukagjini, të mësojnë prej hartave topografike se patëm rastin të dëgjojmë fjalë miradije edhe hipoteza për bashkimin kombëtar, po u frikova mos mbetëm në Jugosllavi se thanë vetëm me Greqinë edhe me Italinë kufizohemi ne. Kështu që të jemi pak më përmbajtjesor. Unë jam anëtar i Komisionit për Buxhet, do ta kem rastin që çdo amendament edhe çdo nen të këtij ligji për buxhet për që mund ta shqyrtojmë në të ardhmen, po më vjen shumë keq prej deputetëve që iu ka marrë e drejta edhe në rishikimin, pas kalimit në parim të këtij projektligji do ta kenë rastin veç ta votojnë ose mos ta votojnë. Kaq, kisha pasur dëshirë kryetar të them. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe unë po kërkoj që vërtet të flisni për buxhetin dhe nëse flisni për rishikimin e buxhetit unë jam i bindur që 5 minuta iu mjaftojnë bile iu teprojnë. Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më qe vërtet mendoj se është i konsumuar tash më debati dhe nuk do t'i marrë as 5 minuta. Sikur të kisha folur sikur disa deputetë, sigurisht nuk do mjaftonin edhe një orë ndoshta për të folur vetëm për të folur kot. Por, ajo çka është dua të them që me ndihem mirë dhe zakonisht ndihem mirë kur para vetes kemi materialet e përgatitura profesionalisht dhe materialet të cilat garantojnë një stabilitet të vendit tonë.

Sa i përket rishikimit të buxhetit unë vetëm dua të theksoj se do ta mbështes pa rezervë, ngase me këtë me një lexim shumë sipërfaqësor e sheh se kemi rritje të hyrave, kemi zvogëlim të shpenzimeve operative, rritje të investimeve kapitale dhe kemi një përpjekje për të bërë një zhvillim harmonik në nivelin lokal. Dhe kjo është inkurajuese për secilin deputet dhe duhet të jetë, por edhe për secilin qytetar të Kosovës, prandaj unë e përgëzoj Qeverinë për planifikimet e bëra dhe për garancitë që do të vazhdojë me intensitetin e deritashëm, ashtu siç ka punuar deri tash do të vazhdojë edhe në gjashtëmujorin e këtij viti e pa dyshim që edhe në vitin tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, edhe për kohën!

Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin të Republikës së Kosovës në parim është çështje madhore për zhvillimin e vendit tonë. Shumë çështje u thanë këtu nga deputetët e mëparshëm, por unë do t'i them disa çështje pak më të decentralizuara për rishikimin e buxhetit në komunën e Prizrenit.

Në mbështetje të dispozitave të Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe nisur nga fakti i ligjeve në fuqi, Ligji i vetëqeverisjes komunale neni 40.2.v, neni 52.2, si dhe neni 56.b dhe neni 60 i Statutit të komunës së Prizrenit, rishikimi i buxhetit nuk mund të nënshkruhet nga askush tjetër, përveç kuvendit komunal, pra as nga kryetari i komunës së Prizrenit, andaj çfarëdo veprimi tjetër është joligjor.

Kuvendi Komunal në Prizren është jofunksional, në anën tjetër nuk e ka krijuar Komitetin për Politikë e Financa si dhe votën e asamblesë komunale në Prizren. Projektimi i rishikimit të buxhetit rreth 26 milionë e 414 mijë euro për komunën e Prizrenit është nënshkruar nga kryetari i komunës së Prizrenit në forma joligjore, pa kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në asamblenë komunale, pra, këtë formë të rishikimit të buxhetit për Prizrenin e kemi në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës 2010, të cilin po e shqyrtojmë sot. Konsiderojmë njëherit edhe kërkojmë që kjo çështje gjerë në leximin e dytë të Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për buxhetin të rregullohet, pra të kthehet kjo formë e rishikimit të buxhetit në Prizren për dy arsye.

E para, të respektohen procedurat nëpërmjet Komitetit për Politikë e Financa si dhe të thirret asambleja komunale për miratim të buxhetit.

E dyta, nëse e para nuk funksionalizohet atëherë të kthehet në gjendjen e pararishikimit të buxhetit për komunën e Prizrenit, që të dy këto arsye i paraqita me qëllim që mos të shpenzohet buxheti jashtë binarëve ligjor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kur flisni deputetë për kryetarë e komunave dhe për asamblatë komunale është mirë ta njihni Ligjin për vetëqeverisjen lokale, kam përshtypje se nganjëherë nuk e njehni atë ligj. Fjalën e ka deputeti Adem Hajdaraj.

ADEM HAJDARAJ: Zotëri kryetar, faleminderit!

Ministër, zotëri deputetë, stafi mbështetës e tjerë,

Unë me këtë rast, ndonëse nuk jam profesionalist i çështjeve ekonomike e tjerë, sado kudo kam lexuar këtë projektligj të buxhetit edhe të kaluarin edhe këtë si të fundit, do të thotë, dhe unë kam vërejtur në radhë të parë se ka ndryshime të mëdha prej komune në komunë edhe sa i përket stafit që kanë edhe investimeve për kulturë, për arsim dhe shkencë, por edhe në totalin e buxhetit që i takon komunave. Ajo është kryer meqë e kemi pasur buxhetin, por vetëm të shtoj është dashur paka shumë të kihen parasysh disa rajone. Nuk jam subjektiv as nuk dua të trajtohem kështu nga deputetët edhe nga qytetarët, por të them të vërtetën se disa projekte janë ndryshuar, do të thotë, nuk janë sikurse kemi menduar të jenë. Pra, projektet më të shumta janë shkuar në një rajon dhe në disa rajone nuk janë dhënë fare.

Në radhë të parë dua ta shtoj çështjen e Rugovës, një regjioni i cili, ku i ka mbi 13 fshatra, është regjion turistik e tjera e tjera, me vende të bukura ku do të duhej të investohej pak.

Në vitin 2009 dhe 2010 nuk është investuar asnjë centë, domethënë, për Rugovën. Shikoni projektbuxhetin edhe këtë të fundit nëse figuron Rugova, atëherë unë nuk kam të drejtë.

E dyta, domethënë, shtrohet pyetja a thua është në hartën historike Rugova a jo? Edhe Peja është lënë pas dore kësaj radhe, jo vetëm me grandet qeveritare që janë shumë të vogla dhe disa herë e kem shtruar, por nuk është bërë sa duhet këtu, dhe grandet qeveritare arsyetohen me atë se Rugova ka një popullsi të regjistruar më parë e në të vërtetë me madhësinë e popullsisë edhe si regjion vjen menjëherë pas Prizrenit dhe këtu ka ndryshime të mëdha për sa i përket kësaj. Shikoni vetëm të them se çka është përfshirë për Pejën dhe për atë anë tash, shumë

pak. Për shembull për Spitalin Regjional të Pejës në vitin 2009 janë dhënë 38 mijë e 400, në vitin 2010 asgjë, për Pejën s'ka edhe për Mullirin e Haxhi Zekës është dhënë në fillim e në vitin 2010 asgjë.

KRYETARI: Regjia i bie ziles për të ardhur deputetët për të votuar.

ADEM HAJDARAJ: Për Rugovën një milion euro janë paraparë atëherë dhe nuk di ku janë ato para dhe nuk është dhënë asgjë për këtë rrugë, sidomos për pjesën Kuqishtë – Bogë edhe ka qenë paraparë. Shkolla e mesme Ekonomike 114 mijë edhe 2010 s'është dhënë kurrëgjë. Lutogllava, shkolla me aq ngulm theksonte zëvendëskryeministri do ta mbarojmë një shkollë, kurrëgjë nuk është bërë, 20 mijë janë dhënë në fillim dhe ka mbetur 2010 asgjë. Shkolla fillore “Migjeni” 67 mijë, dhe tash asgjë e tjera e tjera, “Dardania” e kështu me radhë, po shumë pak janë përfshirë, është përfshirë regjioni i Pejës, një qytet shumë i rëndësishëm, qytet i lashtë dhe që e meriton vëmendje.

Unë propozoj që me këtë ndryshim të përfshihet çështja e rrugës së Rugovës, është premtuar disa herë dhe prandaj duhet të realizohet brenda këtij viti. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Unë kisha kërkuar nga deputetët që janë në vazhdim edhe dy deputete t'i shkurtojnë sa të munden diskutimet e tyre. Fjalën e ka Sala Berisha- Shala, le të përgatitet Drita Kadriu.

SALA BERISHA- SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsërendetje zoti kryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Do të mundohem të flas sa më shkurt, sepse fjalët e shumta janë fukarallëk ajo dihet, mirëpo do të përpiqem të përfshij ato shqetësime më preokupojnë mua gjatë analizimit të këtij projektbuxheti.

Që në fillim e them se e mbështes fuqishëm projektbuxhetin, rishikimin e planifikuar të buxhetit. Ky rishikim është i bërë në përputhje të plotë me prioritetet e përcaktuara nga Qeveria që për synim kanë mbështetjen e politikave zhvillimore që adresojnë nevojat e qytetarëve të Kosovës. Me fjalë të tjera, struktura e buxhetit respekton prioritetet kyçe siç janë: rritja ekonomike, zhvillimi, fuqizimi i kapaciteteve institucionale, qeverisja e mirë dhe stabilitetit social. Vlen të përmendet si fakt inkurajues që edhe përkundër prezencës së krizës ekonomike, botërore të hyrat vendore dhe ato nga kufiri nuk kanë ndikuar negativisht nga kjo krizë.

Rishikimi i buxhetit 2010 është hartuar në pajtueshmëri të plotë me FMN-në dhe me këtë Qeveria ka përgatitur buxhetin sipas strukturës së këtij programi. Prandaj, jemi optimistë me arsye, presim që në të ardhmen e afërt Kosova do të ketë qasje në këto programe. Kjo domethënë se është një ndër alternativat e burimeve financiare.

Dihet se është krejt e natyrshme që gjatë përgatitjes së këtij projektbuxheti Qeveria të përballet me kërkesa dhe presione të shumta konkurruese nga organizatat e ndryshme buxhetore. Duke analizuar këtë rishikim fitohet përshtypja se Qeveria ka përdorur logjikën financiare të trajtuarit njësoj i të gjithë të pakënaqurve. Objektivi i Qeverisë ka qenë ruajtja e qëndrueshmërisë fiskale dhe kredibiliteti planifikues duke respektuar përkushtimin e saj për ofrimin e një rritje qëndrueshme ekonomike.

Vërejtjet e mia shkurtimisht do t'i paraqes te planifikimi i buxhetit komunal dhe këtu kisha dashur një mirëkuptim që këto vërejtje nuk janë për pikëpamje lokaliste, sepse lokalizmi e dëmton Kosovën si e tillë siç është, do të dëshiroja t'i mirëkuptoj të gjithë kolegët e mi deputetë që patën preokupime të arsyeshme prej rajoneve prej të cilave vijnë.

Ndarja e buxheteve komunale në bazë të kritereve unike sigurisht që më së shumti i dëmton komunat e vogla. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme për gjenerim vetjak të hyrave po thuaj se ¼ e këtij buxheti i ndahet komunave. Mirëpo në radhë të parë siç thashë dëmtohen komunat e vogla nga këto kritere siç është për

shembull kriteri i numrit të banorëve. Po nisem pa u keqkuptuar nga Drenasi i cili vetëm votues i ka 43 mijë banorë e jo të trajtohen si banorë të tillë, mirëpo ka përafërsisht 80 mijë banorë. Ky fat, në këtë rast kjo fatkeqësi në bazë të këtij kriteri e ka përcjellë e Drenasin, mandej ju mund të shihni se në këtë rishikim ka projekte kapitale që parashihen, mirëpo disa prej tyre përcillen vit pas viti, në letër. Ndryshimin në këtë rishikim në raport me Drenasin është se disa nga projektet që kanë qenë prioritet tani më nuk janë as në letër, siç është fjala infrastruktura rrugore që është fshati Bytyq, Dobroshevc, Komorani e ka vetëm magjistralin që e gëzon si rrugë të asfaltuar, mandej rruga e Vasilevës. Për t'i demantuar disa paragjykime të deputetëve se në Drenicë është investuar së tepërmi, unë do ja sjellë një shembull sui generis i një fshati që ju nuk mund ta merrni me mend se për 10 vjet në atë fshat nuk është investuar asgjë dhe nuk e kanë ndie dorën e Qeverisë as pushteti as pushtetit vendor. Vasileva një fshat i cili 99% ka qenë i dëmtuar nga lufta dhe aty janë vetëm shtëpitë e rindërtuara nga donacionet e huaja, por ata qytetarë dhe unë dëshiroj të kemi mirëkuptim për këtë "anashkalim" sepse kapacitetet e komunës, po edhe përkushtimi i Qeverisë është i tillë, sepse s'ka mundësi të jetë më tutje.

Sa i përket infrastrukturës së arsimit dihet se në Drenas ende punohet me tri ndërrime nëpër shkolla dhe në vitin 2009 asnjë shkollë e re nuk është ndërtua, domethënë, nuk janë rritur hapësirat fizike për mësim. Mandej, ka nevojë Drenasi për përkrahjen nga Qeveria edhe sa i përket ambientit, edhe sa i përket çështjeve tjera, trajtimit të ujërave të zeza, mandej, nuk është bërë asgjë në ndërtimit e varrezave të dëshmorëve e kështu me radhë.

Po sidoqoftë siç po shihet nga këto diskutime të pakënaqur gati se jemi të gjithë, po kjo nuk është për shkak të trajtimit të anuar nga ana e Qeverisë po për shkak të mundësive buxhetore që i ka Kosova.

Qeveria është munduar ta mbajë një balancë të trajtimit përball presioneve...

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetë, unë kam respekt për fshatrat dhe komunat, por realisht Kosova nuk është aq e madhe sa të interesohet veç për fshatrat tona. Unë e kam paralajmëruar deputeten e fundit, Drita Kadriu.

DRITA KADRIU: Faleminderit, kryetar!

Me qenë se jemi në rishikimin e buxhetit diskutimi im është i përqendruar në dy pika dhe besoj që nuk do të jetë i gjatë.

Në Stan Tërg të "Trepçës" ka filluar ndërtimi i Muzeut të Kristaleve, i cili është i rëndësishëm për shkak të shumë arsyeve. Përveç që promovon vlerat e pasurisë minerale të Kosovës sigurisht se ky muze do të promovojë edhe vlera turistike në Mitrovicë po gjithsesi edhe rritjen e qarkullimit të njerëzve dhe shpenzimin e parasë këtu. Prandaj, besoj që me rishikim të buxhetit do të gjinden mundësitë që do të vazhdojnë punimet në Muzeun e Kristaleve në Mitrovicë.

Gjithashtu edhe te kodi i programit 910, i cili parasheh ndarjen e një milion e 936 mijë eurove për trajnimin e mësimdhënësve që besoj do të përfshihen edhe trajnimet e metodologjisë së mësimdhënies, përveç trajnimeve të përdorimit të teknologjisë informative, shpresoj që në këtë kod buxhetor ka mundësi që përmes rishikimit të ndahet edhe një buxhet për funksionalizimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës. Me qenë se ky këshill kombëtar i shkencës tanimë përmes Qeverisë ka përcjell në Kuvend programin kombëtar të shkencës, i cili sigurisht se do të shqyrtohet dhe do të miratohet në Kuvend, ka mundësi që në këtë rishikim të buxhetit të krijohen mundësi për funksionalizimin e këtij këshilli kombëtar të shkencës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Do të thotë nuk kemi diskutues të lajmëruar për debat, është harxhuar edhe pse Rexhep Hotit i ka mbetur merak që veç 5 minuta i ka pasur.

Tani fjalën, i fundit e ka kryeministri i Kosovë, zoti Hashim Thaçi,

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari kryetar i Parlamentit, zoti Krasniqi!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Do të dëshiroja që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe si kryeministër t'ju falënderoj shumë për debatin korrekt dhe konstruktiv, mbështetës, por natyrisht edhe plotësues. Rishikimi i buxhetit është një mundësi për qëndrueshmëri dhe për zhvillim ekonomik. Pra, është një rishikim i buxhetit që siguron zhvillim ekonomik dhe proces integruar, në të njëjtën kohë. Është një rishikim që përcakton funksionalizimin e plotë të institucioneve tona, në të njëjtën kohë dëshiroj t'ju falënderoj për të gjitha sugjerimet, vërejtjet tuaja, por më lejoni që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, t'ju ftoj të gjithëve që ta votoni këtë rishikim të buxhetit. Këto janë mundësitë tona, jemi duke bërë punën më të mirë të mundshme. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, 16 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-177 për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe komisionet e përhershme. Komisionet duhet që sa më shpejtë që është e mundur Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Mirupafshim në seancën e radhës.

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës